



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në

“Kantierin e Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve, Pashaliman” dhe “Ministrinë e Mbrojtjes”, Tiranë.

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve

“Auditim i Përputhshmërisë”

Tiranë, Dhjetor 2024

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1.	Përshkrim i shkurtër i rezultateve të auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit	4-6
II.	HYRJA	7
1.	Objektivat dhe qëllimi	7
2.	Identifikimi i çështjes	8
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	8
4.	Përgjegjësitë e audituesve	8
5.	Kriteret e vlerësimit	8
6.	Standardet e auditimit	8
7.	Metodat e auditimit	9
8.	Dokumentimi i auditimit	9
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	10
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	10
2.	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	10
2.1	Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, (Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Administrimit dhe Administratori) vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.	10-13
2.2	Auditim mbi hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e planit të biznesit nga organet drejtuese. Auditimin mbi planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve dhe të të ardhurave. Auditim mbi përcaktimin e tarifave të shërbimit të mjeteve lundruese dhe pajisjeve.	13-32
2.3	Zbatimi i strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.	32-38
2.4	Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj).	38-43
2.5	Mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit.	43-55
2.6	Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.	55-96
2.7	Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.	96-99
2.8	Auditim mbi realizimin e kontratave të lidhura për riparimin e mjeteve lundruese të Forcave të Armatosura si dhe për kryerjen e punimeve dhe shërbimeve për të tretë, në përputhje me kapacitetet teknike të ndërmarrjes.	100-111
2.9	Të ndryshme, të rezultuara gjatë auditimit	111-125
IV.	REKOMANDIME	125-136
V.	ANEKSE	137-139

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1 Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim

KNRA u krijua si Ndërmarrje Shtetërore me VKM nr. 397, datë 11.05.2015, bazuar në nenin 3, të ligjit nr. 7582, datë 13.7.1992, “Për ndërmarrjet shtetërore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe Këshillit të Ministrave. KNRA e ka qendrën (selinë) në Pashaliman, Vlorë. KNRA, është ngritur mbas kryerjes së akt vlerësimit të tokës, trojeve, objekteve ndërtimore, ndërtimeve speciale rrugë, ura bankina dhe vepra të infrastrukturës si dhe vlerësimit të makineri e paisjeve. Ky akt vlerësim është kryer nga ekspert të vlerësimit të pasurive, sipas porosisë së Ministrisë së Mbrojtjes, Komanda e Forcës Detare sipas Urdhrit nr.574, datë 07.04.2015 dhe shkresës nr. 3283, datë 09.04.2015, “Për vlerësimin e KNRA”.

Sipas këij akt vlerësimi, sipërfaqe totale e truallit është 148,860 m², nga të cilat sipërfaqe funksionale 112,735.3 m². Sipërfaqe ndërtimi është 16,465.9 m². Këto objekte janë ndërtuar kryesisht rreth viteve 1960 dhe një objekt i vitit 2008.

Shuma e kapitalit themeltar është 2,446,392,291 lekë.

Shuma prej 97,874,561 lekë është transferuar nga Komanda e Forcës Detare Durrës në favor të ndërmarrjes shtetërore “Kantieri i ndërtimit dhe riparimit të anijeve”.

Kjo ndërmarrje, nga fondet që u transferuan në llogarinë e saj në shumën 78,970,879 lekë, janë shpenzuar për likuidimin e fondit të pagave deri në datën 31.12.2015, shpenzime materiale, shërbime nga të tretë, shpenzime për mirëmbajtje, shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për largim nga puna, shpenzime gjyqësore, si dhe shpenzime tatim taksa.

Objekti i veprimtarisë së KNRA-së është ndërtimi dhe riparimi i mjeteve lundruese ushtarake dhe pajisjeve të forcave të armatosura, të mjeteve lundruese civile, të tilla si anije, skafe, motovedeta, gomone etj, si dhe kryerja e punimeve dhe shërbimeve për të tretë, në përputhje me kapacitetet teknike të ndërmarrjes. Organet drejtuese të KNRA janë Këshilli Drejtues dhe Drejtoria. Antarët e Këshillit Drejtues zgjidhen dhe miratohen nga Ministria e Mbrojtjes.

a. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.

Auditimi në Shoqërinë “Kantieri i ndërtimit dhe riparimit të anijeve” u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. KNRA me VKM Nr 397, datë 11.05.2015, fitoi statusin e Ndërmarrjes Shtetërore, ku si objekt të veprimtarisë ka riparimin dhe mbajtjen në gadishmëri të mjeteve lundruese të Forcave të Armatosura por dhe punime dhe shërbime me të tretë (subjekte private). Aktiviteti i punës së KNRA-së zhvillohet në një territor prej 509`314 m². Kantieri ka një Inventar të pasur dhe të larmishëm të AQT-ve.

Është audituar aktiviteti i KNRA për periudhën e auditimit, fokusuar në operacione financiare, por jo vetëm. Është audituar dokumentacioni mbi shqyrtimin dhe miratimin e planit të biznesit nga organet drejtuese, përcaktimin dhe miratimin e tarifave në KNRA dhe në Ministrinë e Mbrojtjes, të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i shkallës referuar ndërtimit dhe riparimit të anijeve, realizimin e kontratave të lidhura për riparimin e mjeteve lundruese të forcave të armatosura si dhe kryerja e punimeve dhe shërbimeve për të tretë në përputhje me kapacitetet teknike të ndërmarrjes, zbatimi i kriterëve ligjore në lidhje me procedurat e prokurimit publik të realizuara, respektimi i strukturës organizative, dosjet e personelit, përlllogaritja e pagës, inventarizimi fizik i pasurisë etj.

b. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim.

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi, Kantierin e ndërtimit dhe riparimit të anijeve, Orikum, për periudhën prej fillimit tetor 2015 deri më datë 31.12.2023, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme

çështjeve, që lidhen me efektivitetin e përdorimit të fondeve, pasurisë në administrim dhe qëllimin e krijimit të kesaj shoqërie.

c. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Auditimi është kryer me zgjedhje për prokurimet dhe pagesat e situacioneve dhe në total për amendamentet referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion.

d. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve.

Nga auditimi, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 21 gjetje dhe ka dhënë 23 rekomandime.

I.2 Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nga auditimi i kryer janë konstatuar mangësi kryesisht në:

- miratimin e tarifave nga Ministria e Mbrojtjes me kohë vonesë deri në 3 muaj nga data e dërgimit nga KNRA,
- amortizimi I shkallës Kosjakova e cila shërbën për ndërtimin dhe riparimin e anijeve si shkak i mos ndërhyrjes dhe neglizhencës të strukturave drejtuese të MM,
- mos aplikim i rritjes së pagave duke mos respektuar VKM-në në fuqi,
- krijimi i detyrimeve me efekt financiar negativ të konsiderueshëm nga Ministria e Mbrojtjes ndaj KNRA si shkak i ndërprerjes së mardhënieve të punës për punonjësit e KNRA në kohën që KNRA ka qenë në varësi të plotë nga Komanda e Forcës Detare, si dhe çështje të tjera në përshkruara në mënyrë më të detajuar më poshtë.

a. Paraqitja e rekomandimeve kryesore.

- Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Buxhetit në mënyrë të menjëhershme të shqyrtoj propozimin e KNRA-së për trajtimin financiar të punonjësve, sipas klasifikimit të nivelit të pagave në përputhje me VKM-në në fuqi, nga ku referuar VKM-së, ndaj punonjësve të KNRA-së të aplikohet rritja e pagës si domosdoshmëri për shkak të trajtimit financiar jo në nivelin e duhur dhe jo në përputhje me VKM-në duke qenë se nuk është aplikuar rritja e saj që nga viti 2016, situata e cila cënon ndjeshëm aktivitetin e Institucionit si shkak i largimeve nga puna të punonjësve.
- Ministria e Mbrojtjes/Strukturat drejtuese dhe KNRA, të marrin të gjitha masat e nevojshme për kryerjen e një inspektimi, kontrolli dhe plani për përmirësimin e gjendjes së shkallës në pjesën e nënujshme dhe të mbiujshme, të linjave të shinave dhe karelit lëvizës.
- Nga Ministria e Mbrojtjes/strukturat përgjegjëse të merren masa për rishikimin e planit të veprimit, të rishikohet mundësia për lirimin e bankinës dhe të vaskës dhe të trajtohen problematikat në lidhje me anijet e vjetra të mbytura dhe anijet e amortizuara.
- Ministria e Mbrojtjes dhe Këshilli Drejtues të marrin masa për vlerësimin e veprimtarisë ekonomike financiare të KNRA si dhe bazës ligjore mbi të cilën është krijuar dhe hartimin e një plan veprimi për të arritur qëllimin dhe pritshmëritë, për riparimin e mjeteve të Flotës Detare.

I.3 Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

Ne audituam përputhshmërinë e aktivitetit, sa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti **Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve**, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e vlerësimit të përputhshmërisë*), mbi prokurimet publike, planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve dhe të ardhurave, për përcaktimin e tarifave të shërbimit të mjeteve lundruese, pagat dhe shpërblimet, etj.

Opinion i modifikuar i kualifikuar ¹.

¹ Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalië apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit kemi konstatuar se subjekti i audituar gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij nga data e krijimit të shoqërisë deri në 31.12.2023, përveç rasteve të cilësuar në bazën për opinionin e auditimit ka vepruar në përputhje me kriteret e paracaktuara të vlerësimit. Shkeljet dhe devijimet nga kriteret e vlerësimit (Ligji nr. 9874 datë 14.02.2008 “Për Ankandin Publik”, Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimit Publik”, Ligji nr. 7582 datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, i ndryshuar, etj) kanë rezultuar materiale por jo të përhapura, gjë e cila ka kushtëzuar/justifikon dhënien e një opinion të modifikuar, të kualifikuar.

Baza për dhënie të opinionit:

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI 100; ISSAI 400-499; ISSAI 4000-4899). Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar. Në besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e këtij opinion.

ISSAI 100-Parimet themelore të Auditimit të Sektorit Publik;

ISSAI 400- Parimet themelore të auditimit të Përputhshmërisë;

ISSAI 4000-Standardet e auditimit të përputhshmërisë;

Manualin e Auditimit të Përpunshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;

Nga auditimi i kryer janë konstatuar mangësi kryesisht në:

- miratimin me vonesë të tarifave financiare nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, deri në 3 muaj nga data e dërgimit nga KNRA, kjo ka sjellë: ndërprerje dhe vonesa në veprimtarinë e punës për riparimin e mjeteve lundruese të FA dhe mos riparimin e të gjithë mjeteve lundruese brenda vitit kalendarik, duke mos realizuar në këtë mënyrë të ardhurat.

- mos aplikim i rritjes së pagave për punonjësit e KNRA që prej vitit 2016, nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, duke mos respektuar VKM-në në fuqi,

- krijimi i detyrimeve me efekt financiar negativ të konsiderueshëm nga Ministria e Mbrojtjes ndaj KNRA si shkak i ndërprerjes së marrdhënieve të punës për punonjësit e KNRA.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësisë të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet. Shoqëria brenda caqeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, kryen çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

Përgjegjësitë e audituesve: Audituesit e KLSH janë përgjegjës për dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e opinionit, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Nga auditimi i kryer janë konstatuar mangësi kryesisht në: miratimin e tarifave nga Ministria e Mbrojtjes me kohë vonesë deri në 3(tre) muaj nga data e dërgimit nga KNRA, amortizimin e shkallës Kosjakova e cila shërbën për ndërtimin dhe riparimin e anijeve si shkak i mos ndërhyrjes dhe neglizhencës të strukturave drejtuese të MM, mos aplikim i rritjes së pagave duke mos

respektuar VKM-në në fuqi, krijimi i detyrimeve me efekt financiar negativ të konsiderueshëm nga Ministria e Mbrotjes ndaj KNRA si shkak i ndërprerjes së marrdhënieve të punës për punonjësit e KNRA në kohën që KNRA ka qenë në varësi të plotë nga Komanda e Forcës Detare, si dhe çështje të tjera në përshkruara në mënyrë më të detajuar më poshtë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të projektit dhe programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH nr. 347/2 prot. datë 28.03.2024, nga data 28.03.2024 deri më datë 31.05.2024, për periudhën nga krijimi i shoqërisë deri më datë 31.12.2023, u krye auditimi i “Përputhshmërisë” në subjektin “Kantieri i Njërtimit dhe Riparimit të Anijeve”, Pashaliman, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. V. B., përgjegjese grupi
2. Q. M., auditues;
3. J. B., auditues.

II.1 OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

Objekti dhe qëllimi i auditimit:

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditori, Kantierin e ndërtimit dhe riparimit të anijeve, Orikum, për periudhën prej fillimit tetor 2015 deri më datë 31.12.2023, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me efektivitetin e përdorimit të fondeve, administrimin i pasurisë dhe qëllimin e krijimit të kësaj shoqërie.

Është audituar aktiviteti i shoqërisë për periudhën e auditimit, fokusuar kryesisht në operacione financiare, por jo vetëm. Konkretisht janë audituar krijimi i shoqërisë, shpenzime për investime, shpenzimet operative, strukturat dhe pagat, programi ekonomik dhe realizimi i tij, etj. Është audituar vendimmarrja e organeve drejtuese, si edhe probleme të tjera.

Identifikimi i çështjes: Projekt Raporti mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Kantieri i ndërtimit dhe riparimit të anijeve, Pashaliman, për periudhën nga fillimi viti 2015 deri më datë 31.12.2023, ka identifikuar sipas kriterëve specifikë të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

- Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e Këshillit Drejtues, si dhe bazueshmërinë ligjore të vendimeve të marra dhe realizimin e tyre.
- Auditim mbi hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e planit të biznesit nga organet drejtuese.
- Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
- Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, etj.).
- Organizimi dhe mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e pasqyrave financiare nga organet drejtuese të KNRA, si dhe dërgimi e miratimi i tij në institucionet eprorë.
- Analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit.
- Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet për investime, për blerje mallrash e shërbimesh, si dhe zbatimi i kontratave.
- Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.
- Auditim mbi realizimin e kontratave të lidhura për riparimin e mjeteve lundruese të Forcave të Armatosura si dhe për kryerjen e punimeve dhe shërbimeve për të tretë, në përputhje me kapacitetet teknike të ndërmarrjes.
- Të ndryshme, të rezultuara gjatë auditimit.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të auditur lidhur me çështjen nën auditim:

Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësiave të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet. Shoqëria brenda caqeve të parashikuara nga legjisllacioni në fuqi, kryen çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

Përgjegjësitë e audituesve: Audituesit e KLSH janë përgjegjës për dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e opinionit, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Kriteret e vlerësimit: Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjisllacionin bazë e dytësor, në dispozita të tjera si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit:

- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”
- Ligji nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”
- Ligji nr. 9154 datë 06.11.2003 “Per arkivat”
- Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”;
- Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”,
- Ligji nr. 9874 datë 14.02.2008 “Per Ankandin Publik”.
- Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimit Publik”
- Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, perditësuar 2017
- Ligji nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punes i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr. 7850 datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës Së Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
- Ligji nr. 7582 datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, i ndryshuar
- Ligji nr. 92/2014 datë 24.7.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”;
- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me ndryshimet përkatëse, etj.
- VKM nr. 397 datë 11.05.2015 “Për krijimin e ndërmarrjes shtetërore Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve”
- VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”
- Akte ligjore apo nënligjore që do të jenë të nevojshme gjatë auditimit

Standardet e auditimit të aplikuar: Bazuar në standardet ISAI 100 “*Parimet themelore të auditimit në sektorin publik*” dhe ISAI 400 “*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*” si edhe në Kodin Etik të KLSH.

Metodat e auditimit: Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve dhe konsultave me nëpunësit e Shoqërisë, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura, programin e auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuara me akt-konstatimet dhe observacionet e subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Projekt-Raporti.

Dokumentimi i auditimit:

Është kryer bazuar në kërkesat e manualit të auditimit të përputhshmërisë, në standardet ndërkombëtare të auditimit (ISAI), për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Projekti dhe Raporti Përfundimtar i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Shoqëria “Kantieri i ndërtimit dhe riparimit të anijeve”, është ndërmarrje shtetërore e cila funksionon sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 397, datë 11.05.2015 në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, ku si objekt të veprimtarisë ka riparimin dhe mbajtjen në gadishmëri të mjeteve lundruese të Forcave të Armatosura por dhe puninme dhe shërbime me të tretë (subjekte private). Aktiviteti i punës së KNRA-së zhvillohet në një territor prej 509,314 m². Kantieri ka një Inventar të pasur dhe të larmishëm të AQT. Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve- Pashaliman ka një histori të gjatë të operimit të tij në riparimin dhe ndërtimin e anijeve. Kantieri ndodhet në Gjirin e Pashalimanit, Vlorë. I ndërtuar në vitin 1969 në Pashaliman, ai ka shërbyer në fillimet e tij duke riparuar të gjitha mjetet e Flotës Luftarake Detare. Pas viteve '90 Forcat e Armatosura u ristrukturuan dhe Kantieri e reduktoi aktivitetin. Për herë të parë në historinë e vet, KNRA në bashkëpunim me shoqërinë hollandeze “Damen Shipyards”, në Maj të vitit 2009 filloi prodhimin e anijeve të reja të klasit “ILIRIA”, me peshë 240 ton, gjatësi 42m, shpejtësi max 26 Nyje. Kantieri i Ndërtimit të Anijeve Pashaliman, nëpërmjet këtij bashkëpunimi arriti të prodhonte vetë me sukses 3 Anije.

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi, Kantierin e ndërtimit dhe riparimit të anijeve, Orikum, për periudhën prej fillimit tetor 2015 deri më datë 31.12.2023, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me efektivitetin e përdorimit të fondeve, administrimin e pasurisë shtetërore dhe qëllimin e krijimit të kesaj shoqërie.

2. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT, SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMI:

2.1.Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e Këshillit Drejtues, si dhe bazueshmërinë ligjore të vendimeve të marra dhe realizimin e tyre.

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Vendimet e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Këshillit Drejtues nga viti 2015 deri në vitin 2023.

- Me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, KNRA me VKM Nr 397, datë 11.05.2015, fiton statusin e Ndërmarrjes Shtetërore, ku si objekt të veprimtarisë ka riparimin dhe mbajtjen në gadishmëri të mjeteve lundruese të Forcave të Armatosura por dhe puninme dhe shërbime me të tretë (subjekte private).

- Objekti i veprimtarisë së KNRA-së është ndërtimi dhe riparimi i mjeteve lundruese ushtarake dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura, të mjeteve lundruese civile, të tilla si anije, skafe, motovedeta, gomone etj, si dhe kryerja e punimeve dhe shërbimeve për të tretë, në përputhje me kapacitetet teknike të ndërmarrjes.

- Me vendimin Nr. 07, datë 10.05.2016 të Këshillit Drejtues është miratuar rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e Kantierit të Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve, Pashaliman, Vlorë” ku qëllimi dhe objekti i kësaj rregulloreje janë:

1. Qëllimi i hartimit të kësaj rregulloreje është realizimi i shpejtë, i saktë, dhe i drejtë i funksioneve dhe kompetencave të strukturave përbërëse të ndërmarrjes, të drejtat dhe detyrimet si dhe bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punës midis tyre.

2. Objekti i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i organizimit, mënyrës së funksionimit, të drejtat e detyrimet e të gjitha strukturave përbërëse të Ndërmarrjes Shtetërore Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve, Pashaliman, si dhe vendosja e normave mbi bazën e të cilave KNRA. do të kryejë dhe referojë veprimtarinë e saj, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Këshilli drejtues

1. Në vitin 2015 datë 11.05.2015 KNRA fiton statusin e Ndërmarrjes Shtetërore, Këshilli Drejtues që nga fitimi i këtij statusi gjatë vitit 2015 ka marrë 9 vendime.
 2. Në vitin 2016 janë zhvilluar 21 mbledhje nga të cilat janë marrë në total 21 vendime.
 3. Në vitin 2017 janë zhvilluar 12 mbledhje nga të cilat janë marrë në total 11 vendime.
 4. Në vitin 2018 janë zhvilluar 10 mbledhje nga të cilat janë marrë në total 8 vendime.
 5. Në vitin 2019 janë zhvilluar 7 mbledhje nga të cilat janë marrë në total 6 vendime.
 6. Në vitin 2020 janë zhvilluar 10 mbledhje nga të cilat janë marrë në total 10 vendime.
 7. Në vitin 2021 janë zhvilluar 20 mbledhje nga të cilat janë marrë në total 18 vendime.
 8. Në vitin 2022 janë zhvilluar 13 mbledhje nga të cilat janë marrë në total 8 vendime.
 9. Në vitin 2023 janë zhvilluar 16 mbledhje nga të cilat janë marrë në total 7 vendime.
- Aktualisht Këshilli Drejtues ka 5 anëtarë, nga të cilët Drejtori i Përgjithshëm është Kryetari i Këshillit Drejtues, anëtarët e Këshillit Drejtues janë si më poshtë:

1. Z.A. G. **Kryetar (Drejtor i KNRA)** - emëruar më 01.09.2015 dhe në vazhdim kryetar
2. Z. F. H. **Anëtar** –emëruar më 01.09.2015 dhe larguar në datë 01.02.2016
3. Znj. M. M. **Anëtar** – emëruar më 01.09.2015 dhe larguar në datë 15.03.2022
4. Znj. K. P. **Anëtar** – emëruar më 01.09.2015 dhe në vazhdim anëtar
5. Z. A. Sh. **Anëtar** – emëruar më 01.09.2015 dhe larguar në datë 02.03.2019
6. Z. A. K. **Anëtar** – emëruar më 01.04.2016 dhe në vazhdim anëtar
7. Znj. L. L. **Anëtar** – emëruar më 29.04.2021 dhe në vazhdim anëtar
8. Z. I. V. **Anëtar** – emëruar më 22.11.2022 dhe në vazhdim anëtar

Nga auditimi u konstatua se:

Këshilli Drejtues në vitin 2018 ka zhvilluar 10 mbledhje, në vitin 2019 ka zhvilluar 7 mbledhje dhe në vitin 2020 ka zhvilluar 10 mbledhje, duke mos vepruar në përputhje me rregulloren e institucionit, Neni 13 ku përcaktohet se: “Këshilli Drejtues mbledhet sa herë e kërkon interesi i ndërmarrjes, por si rregull jo më pak se një herë në muaj.”

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi Drejtori i KNRA Z. A. G. dhe Anëtarët e Këshillit Drejtues Z. F. H., Znj. M. M., Znj. K. P., Z. A. Sh., Z. A. K..

Me anë të shkresës nr. 347/6 prot, datë 28.08.2024, është paraqitur observacioni në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

“ . . . Fakti që, ligji përmend se si rregull mbledhjet e Këshillit Drejtues bëhen një herë në muaj, nuk është taksativ dhe detyrues. Mbledhjet dhe vendimet mund të merren kur lind nevoja disa brenda Muajit sikundër mund të bëhen më rrallë nëse nuk është e nevojshme. Vitet 2020 dhe 2021 kanë qënë vitet e pandemisë se coronavirusit dhe duke qënë një force madhore ka kufizuar në tërësi aktivitetin administrativ të të gjithë administratës shtetërore. . . . ”

Qëndrimi i grupit të auditimit

Pas analizimit të observacionit dërguar nga përfaqësues të KNRA, grupi i auditimit rithekson që është Neni 13 i rregullores së KNRA e cila përcakton qartë se “Këshilli Drejtues mbledhet sa herë e kërkon interesi i ndërmarrjes, por si rregull jo më pak se një herë në muaj.” Këshilli Drejtues duhet të mbledhet aq herë sa përcakton rregullorja për realizimin e objektivave dhe besueshmërisë së kësaj ndërmarrjeje. **Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.**

Në periudhën Prill 2019 deri në Maj 2021 Këshilli Drejtues ka pasur 4 anëtarë për shkak të vonesave dhe mospërgjigjeve të shkresave për miratimin e Këshilli Drejtues nga Ministria e Mbrojtjes. KNRA me kërkesën datë 27.08.2019 Nr. 547 prot. ka kërkuar miratimin e Këshillit Drejtues nga Ministria e Mbrojtjes në zbatim të ligjit Nr.7582 datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”. Ministria e Mbrojtjes me Urdhër Nr. 542 datë 29.04.2021 ka urdhëruar emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues sipas kërkesës dhe ligjit Nr. 7582 datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”.

Situata e vonesave dhe mospërgjigjeve të shkresave nga Këshilli Drejtues drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes ka vazhduar edhe në raste të tjera.

KNRA në vazhdimësi ka qënë në situatë financiare jo të mirë, duke rezultuar me humbje, situatë e cila është e miratuar me vendimet e Këshillit Drejtues për llogaritë vjetore dhe veprimtaritë ekonomike e financiare për cdo vit. Referuar Urdhrit të MM-së Nr 3, datë 06. 01. 2016, “Për ngritjen dhe funksionimin e komisionit të miratimit të tarifave të shërbimeve për mjetet lundruese dhe paisjeve të Forcave të Armatosura” rezulton se faktor që ka ndikuar negativisht në gjendjen ekonomiko financiare të ndërmarrjes është dhe vonesa në miratimin e tarifave të shërbimeve për mjetet lundruese të Forcës Detare nga ana e këtij komisioni.

Sipas KNRA mos marrja parasysh nga Komisioni i Ministrisë së Mbrojtjes për Tarifat i kostove reale të KNRA-së, ka sjell një humbje të konsiderueshme (fitim të munguar) gjatë veprimtarisë së punës që nga krijimi i Ndërmarrjes Shtetërore.

Propozimi i tarifave të bëra nga ana e KNRA-së ndaj Komisionit të Ministrisë së Mbrojtjes për tarifatat janë si më poshtë:

Viti	Drejtuar KD të KNRA-së nr. Prot, datë	Vendimi i KD të KNRA për propozim tek MM	Shkresa dërguar për miratim në MM
2016	1210/1, 24. 11. 2015		1325, 30.12.2015
2017	703, 09.12.2016	Nr. 18, 09.12.2016	703/2, 09.12.2016
2018	598, 21.12.2017	Nr. 7, 11.12.2017	599, 21.12.2017
2019	510, 30.11.2018	Nr. 08, 30.11.2018	638, 30.11.2018
2020	815, 06.12.2019	Nr. 07, 06.12.2019	815/1, 06.12.2019
2021	833/1, 27.11.2020	Nr. 10, 02.12.2020	842, 02.12. 020
2022	827, 03.12.2021	Nr. 18, 07.12.2021	839, 07.12.2021
2023	636, 06.12.2023	Nr. 08, 06.12.2016	638, 06.12.2023

Me vendimin Nr. 04 datë 10.05.2022 Këshilli Drejtues vendosi informimin me shkresë zyrtare Ministrin të Mbrojtjes mbi situatën problematike për shkak të mos miratimit tarifave të punimeve dhe shërbimeve për mjetet lundruese të Forcave të Armatosura.

KNRA ka kërkuar bashkëpunim me kompani të tregut vendas dhe atë të jashtëm, për prodhime të reja apo edhe bashkëpunim në fushën e riparimit të anijeve. Për këtë i janë drejtuar organeve eprore me projekte bashkëpunimi për të cilat nuk kanë marrë përgjigje.

KNRA, me kërkesën me Nr.1012 Port. datë 21.09.2015, ka kërkuar nga Ministria e Mbrojtjes vlerësimin e propozimit të ardhur nga shtetasi italian D. R. për prodhimin e mjeteve lundruese në bashkëpunim me KNRA, bashkangjitur kësaj kërkesë është edhe plan biznesi i detajuar për bashkëpunimin në këtë projekt të përbashkët që është kërkuar.

Me vendimin Nr. 1 datë 08.01.2016, Këshilli Drejtues i KNRA ka shprehur dakordësinë për kërkesën e shoqërisë “M. G.” për dhënien me qera të ambienteve të KNRA, kërkesë e cila nuk ka marrë përgjigje nga Ministria e Mbrojtjes sipas pikës 6 të VKM-së Nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

Në shumë raste kryesisht për miratimin e tarifave, Ministria e Mbrojtjes nuk është përgjigjur kundrejt vendimeve të Këshilli Drejtues të KNRA, duke vendosur në veshitësi financiare ndërmarrjen. Veprime në kundërshtim me parimet e përgjithshme të Kodit të Procedurës Administrative, konkretisht këto veprime bien në kundërshtim me Nenin 14 “Parimi i objektivitetit”, 15 “Parimin e përgjegjësisë”, 16 “Parimi i marrjes së vendimeve” dhe 18 “Parimi i deburokratizimit dhe i efijencës” të Kodit të Procedurës Administrative.

2.2 Auditim mbi hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e planit të biznesit nga organet drejtuese.

Në zbatim të pikës 2/1, të Programit të Auditimit nr. 347/2, datë 28.03.2024, u shqyrtua dokumentacioni sa më poshtë vijon:

- Dokumentacioni i krijimit të ndërmarrjes;
- Programi ekonomik financiar;
- Dokumentacioni i të ardhurave dhe shpenzimeve;
- Raportimet mbi realizimin e programeve ekonomike, etj.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dizpozicion, rezultoi:

• Situata ekonomike me krijimin e KNRA:

“Ndërmarrja Shtetërore Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve” është në varësi të drejtëpërdrejtë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe është krijuar në mes të një viti buxhetor, sipas VKM nr. 397, datë 11.05. 015.

KNRA, është ngritur mbas kryerjes së akt vlerësimit të tokës, trojeve, objekteve ndërtimore, ndërtimeve speciale rrugë, ura bankina dhe vepra të infrastrukturës si dhe vlerësimit të makineri e paisjeve. Ky akt vlerësim është kryer nga ekspert të vlerësimit të pasurive, ing G. K., (numër license VP nr. 0106/1 dhe Mbikqyrje Kolaudim nr. 0579, sipas kontratës së lidhur nr. 1963/3, datë 13.05.2015 me Forcën Detare), sipas porosisë së Ministrisë së Mbrojtjes, Komanda e Forcës Detare sipas Urdhrit nr. 574, datë 07.04.2015 dhe shkresës nr. 3283, datë 09.04.2015, “Për vlerësimin e KNRA”.

Sipas akt vlerësimit është marrë parasysh gjendjen aktuale të ndërtesave, makineri i paisjeve, mjeteve të transportit të shqyrtuara në vend, veç e veç për secilin objekt inventari, mungesat dhe difektet e paisjeve, amortizimin fizik dhe moral, shërbimet teknike, investimet kapitale, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e tyre, duke patur si bazë vlerën aktuale që kanë këto objekte dhe mjete në momentin e rivlerësimit. Sipas këij akt vlerësimi, sipërfaqe totale e truallit është 148,860 m², nga të cilat sipërfaqe funksionale 112,735.3 m². Kjo sipërfaqe është vlerësuar sipas VKM nr. 514, datë 30.07.2014, ku për zonën e Orikumit është 5,530 lekë/m². Sipërfaqe ndërtimi është 16,465.9 m². Këto objekte janë ndërtuar kryesisht në rreth viteve 1960 dhe një objekt i vitit 2008.

a- Asetet e vlerësuara janë:

Nr.	Asetet e vlerësuara	Vlera në lekë
1	Toka	823,195,800
2	Ndërtesa	773,030,413
3	Rrjeti inxhinierik dhe i infrastrukturës	99,750,877
4	Makineri e paisje	301,280,071
5	Mjete transporti	26,939,450
	Totali	2,024,196,611

Burimi i informacionit: Akt vlerësimi i pasurisë

b- Amortizimi i asetëve të trashëguara në lekë, paraqitet:

Aseti	Sasia	Vlera fillestare	Deri 31. 03. 15		Vlera rivlerësuar	Diferenca Rivlerësim vlera mbetur	Vlera kontabilitet 31. 05. 2015 me amortizim	% e amortizimit
			Amortizimi akumuluar	Vlera mbetur				
Ndërtesa inventari	28	784,832,939	118,885,674	665,947,265	773,030,413	107,083,148	891,916,087	15. 15
Ndërtesa jo në inventar	7				19,601,182	19,601,182	19,601,182	
Infrastruktura	7	119,097,424	18,507,428	100,589,996	99,750,877	-839,119	118,258,305	15. 54
Makinieri e paisje	138	557,735,698	204,629,441	353,106,257	301,280,071	-51,826,186	505,909,512	36. 69
Mjete transporti	14	93,135,276	93,135,276	0	26,939,450	26,939,450	120,074,726	100. 00
Shuma		1,554,801,337	435,157,819	1,119,643,518	1,220,601,993	100,958,475	1,655,759,812	27. 99
Paisje zyre dhe informatike (inventari fizik/kontabël)	134	6,832,353	2,683,325	4,149,028	4,149,028	0	6,832,353	39. 27
Totali		1,561,633,690	437,841,144	1,123,792,546	1,224,751,021	100,958,475	1,662,592,165	28. 04

Burimi i informacionit: Akt vlerësimi i pasurisë

c- KNRA, ka trashëguar vlera monetare pjesë të buxhetit të mbetur (shumica fond pagash) nga Komanda e Forcës Detare (në vazhdim KFD), të përcaktuar për ish njësinë joshpenzuese buxhetore KNRA, e cila me statusin e ri vepron në kushtet e konkurrencës së lirë e të ligjshme. Sipas VKM nr. 397, datë 11.05.2015, është bërë transferimi i fondeve të detajuar sipas shkresës nr. 5070/2, datë 16.06.2015, sipas akt rakordimit, ku në total janë transferuar në llogarinë e KNRA^{-së}, fondi prej 97,874,561 lekë, nga të cilat fondet e likuiduara për periudhën maj-korrik 2015, janë në shumën 18. 903. 682 lekë dhe fondet që u transferuan në llogarinë e KNRA^{-së} në shumën 78,970,879 lekë. Në këtë shumë që u transferuan, përfshihet likuidimi i fondit të pagave deri në datën 31.12.2015, shpenzime materiale, shërbime nga të tretë, shpenzime për mirëmbajtje, shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për largim nga puna në shumën 900,000 lekë, shpenzime gjyqësore në shumën 100,000 lekë, si dhe shpenzime tatim taksa.

Përpara kalimit të KNRA^{-së} në ndërmarrje shtetërore, KFD porosiste prodhime dhe shërbime që sot nuk kryhen më, si prodhimin e bovave detare për Shërbimin Hidrografik Kombëtar, kulla vrojtimi, dyer, kasaforta, bënte mirëmbajtjen e të gjithë mjeteve të transportit etj. Të gjitha këto shërbime, punime apo prodhime të reja sot nuk porositen më nga Forcat Detare, nënrepartet e saj apo nga FA në përgjithësi. Këto prodhime apo shërbime FA i marrin nga prokurimet publike.

Kushtet në të cilat u krijua ndërmarrja ishin të njëjta me ato të funksionit të mëparshëm, pasi referuar VKM nr. 397, datë 11.05.2015, për vitin 2015, shërbimet që ndërmarrja do të kryente për mjetet lundruese të Forcave të Armatosura, do të ishin pa shpërblim, dhe të vetmet të ardhura që ndërmarrja siguronte nga të tretët, **nuk e justifikonte numrin ekzistues të punonjësve.** Për këtë arsye, me shkresën nr.745 Prot. datë 17.06.2015, KNRA i është drejtuar me kërkesë Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, për kryerjen e punimeve për çmontimin dhe shkatërimin e anijeve luftarake detare të dala jashtë përdorimit, **me qëllim rritjen e të ardhurave të ndërmarrjes.**

Në kushtet e mungesës së frontit të punës dhe për shfrytëzimin e kapaciteteve teknike e njerëzore, me shkresën nr.1053 prot. datë 01.10.2015, drejtuar Drejtorit të Menaxhimit të Aseteve në Ministrinë e Mbrojtjes, me një ofertë për demontimin dhe shkatërrimin e mjeteve të Forcës Detare të klasifikuara për skrap.

Me shkresat nr. 584 Prot. dhe 586 Prot. datë 31.05.2014, KNRA, i është referuar Ministrit të Mbrojtjes dhe Komandantit të Forcës Detare, se me mbarimin e projektit të prodhimit të anijeve

të Rojës Bregdetare, duhej menduar për një front të ri pune, pasi për shumicën e punonjësve, nuk kishte më punë për të kryer. Duke qenë se kontratat individuale të punës, për shkaqet e sipërcituara ishin lidhur me afat të caktuar, dhe duke qenë se klienti kryesor i KNRA ishte KFD, me shkresën nr.1156 Prot. datë 05.11.2015, i është kërkuar kësaj Komande që të dërgonte brenda muajit nëntor, parashikimin e fondit që do të shërbente për riparimin e teknikës detare për vitin 2016. (trajtuar më hollësisht në pikën e pagave).

• **Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i planit të biznesit nga organet drejtuese**

Nga auditimi i vlerësimit të procedurave të ndjekura për përgatitjen e programeve të zhvillimit ekonomik – financiar rezulton se bazuar në ligjin nr. 7582, datë 13.07.1992, “Për ndërmarrjet shtetërore”, KNRA ka përgatitur plane financiare për çdo vit ushtrimor, të cilat janë të miratuara nga Këshilli Drejtues i Ndërmarrjes me vendime të veçanta.

Në programin e zhvillimit ekonomik financiar janë parashikuar:

- të ardhurat nga riparimi i mjeteve lundruese për llogari të Forcave Detare;
- të ardhurat nga riparimet dhe shërbimet me të tretë;
- të ardhura nga qiratë e objekteve në administrim;
- të ardhura nga transaksione të ndryshme.

Në programet vjetore financiare ekonomike janë parashikuar shpenzimet direkte dhe indirekte ku konstatohet se megjithëse për vitet 2016 -2023 shpenzimet sipas zërave nuk janë tejkualuar, ndërmarrja ka rezultuar me humbje. Në analizë treguesit ekonomik-financiar sipas periudhave 2004 -2015 dhe 2016 -2023 paraqitet sipas tabelës në vijim:

Tabela: Treguesit ekonomik-financiar viti 2004 deri në vitin 2023

Në lekë

Vitet	AQT	Të ardhurat	Shpenzime materiale	Shpenzime amortizim	Numër punonjësish	Fond page	Fitim/Humbje
2004	931,964,142	8,394,351	5,716,734	34,347,697	84	65,520,000	-
2005	889,802,425	1,373,295	10,292,287	50,921,992	84	65,520,000	-
2006	846,799,293	2,459,662	16,656,377	33,516,595	85	66,300,000	-
2007	814,612,765	1,647,078	31,796,238	6,794,487	99	77,220,000	-
2008	820,229,637	3,017,886	88,018,301	12,749,261	139	108,420,000	-
2009	1,014,604,782	2,686,230	59,806,875	34,347,697	135	105,300,000	-
2010	1,090,858,751	4,441,891	53,830,525	47,277,285	149	130,524,000	-
2011	1,092,554,460	3,644,825	19,184,381	3,427,949	158	138,408,000	-
2012	1,172,056,319	4,276,923	48,259,944	31,405,399	155	135,780,000	-
2013	1,183,437,014	1,596,874	95,987,451	11,380,695	154	134,904,000	-
2014	1,136,065,168	-	368,775,955	62,000,000	155	135,780,000	-
Deri në mes të vitit 2015, ka qenë me llogari buxhetore, pjesë e KFD, më tej njësi shpenzuese KNRA.							
2015	2,005,104,100	5,096,176	14,128,057	62,282,316	82	71,832,000	(105,970,572)
2016	1,945,425,381	50,205,681	29,037,402	59,800,162	43	37,668,000	(98,832,268)
2017	1,894,451,719	59,833,280	112,209,675	44,977,679	44	33,250,836	(52,376,395)
2018	1,860,834,030	81,139,643	129,605,327	45,788,273	44	33,322,775	(48,465,684)
2019	1,815,727,045	68,879,305	114,158,100	45,771,133	45	33,782,841	(45,278,795)
2020	1,770,020,649	40,722,158	112,389,875	45,731,248	47	35,990,720	(71,667,717)
2021	1,722,163,519	49,273,156	108,384,132	47,857,131	42	32,636,338	(59,110,976)
2022	1,676,806,686	46,824,471	93,065,458	45,356,834	38	29,023,150	(46,240,987)
2023	1,633,778,431	47,041,534	94,087,018	42,997,056	37	29,003,954	(47,045,484)
	Total			440,541,832			

Burimi i të dhënave: KNRA

– **Periudha 2004 -2023:**

- o Vlera e AQT në vitin 2016 duke ju referuar të dhënave të tabelës, është rritur me 50% më shumë në raport me vitet 2004- 2014, kjo rritje ka ardhur për shkak të rivlerësimit të aseteve në vitin 2015.

- Po ashtu vlera e amortizimit është rritur, pasi është shtuar vlera e AQT, ku amortizimi në vitin 2016 është rritur me 20% më shumë në raport me vitet 2004- 2014, tregues i cili rëndon mbi shpenzimet, rrjedhimisht ulet fitimi.
- Përsa i përket numrit të fuqisë punëtore, ajo është reduktuar në masën 50% në raport me vitet 2004- 2014, në vitet 2015, 2016 është punuar dhe punohet me një numër prej 45 punonjësish.
- Gjithashtu edhe Fondi i pagave në vitin 2016, është reduktuar në masën 50% në raport me vitet 2004- 2014, pasi është punuar me një numër prej 45 punonjësish, ndërsa në vitin 2023 me 37 punonjës.
- Me një numër prej 45 punonjësish KNRA ka realizuar në vitin 2016 të ardhura në shumën prej 50,205,681 lekë, duke shfrytëzuar të gjitha kapacitetet e mundshme për riparim, si dhe duke kursyer fondin e pagave në raport me vitet e mëparshme në shumën rreth 50,000,000 lekë. Sipas analizës së treguesve ekonomiko-financiar në vite, vihet re se në vitin 2016 treguesit janë më rentabël, pasi me një numër prej 45 punonjësish, janë realizuar të ardhura në shumën 50,205,681 lekë, pavarësisht se punohet me një shkallë teje të amortizuar, si dhe me hapësira të kufizuara për riparim.

Të ardhura të realizuara nga KNRA periudha: viti 2015 deri 2023

Në lekë

Vitet	Ardhura FD		%	Ardhura Privat		%	Ardhura Qera		Ardhura kontenierë	Total
	plan	fakt		plan	fakt		plan	fakt		
2015				-						13,452,524
2015					13,452,524		-	-		-
2016	53,300,000	39,156,043	73	15,000,000	11,038,160	74	46,080	46,080		50,240,283
2017	88,603,938	46,423,536	52	14,000,000	11,207,889	80	46,080	46,080	2,155,775	59,833,280
2018	88,911,901	63,463,129	71	10,000,000	5,196,795	52	46,080	46,080		81,139,643
2019	92,509,110	62,078,338	67	13,000,000	6,754,887	52	46,080	46,080		68,879,305
2020	96,953,564	37,070,307	38	12,000,000	3,605,771	30	46,080	46,080		40,722,158
2021	75,163,500	45,352,643	60	10,000,000	3,874,433	39	46,080	46,080		49,273,156
2022	74,154,143	44,740,619	60	8,400,000	2,037,772	24	46,080	46,080		46,824,471
2023	69,707,190	45,828,526	66	4,400,000	1,166,928	27	46,080	46,080		47,041,534
Total	639,303,346	384,113,141		86,800,000	58,335,159		368,640	368,640	2,155,775	457,406,354

Burimi i të dhënave: KNRA

Shpenzime të realizuara nga KNRA periudha: viti 2015 deri 2023, (- 36,027,169 lekë humbje e mbartur)

në lekë

Vitet	Shpenzime		%	Fitim/humbje
	plan	fakt		
2015		83,395,927		- 69,943,403
2015				- 36,027,169
2016	150,200,700	149,072,551	99	- 98,832,268
2017	122,700,212	112,209,675	91	- 52,376,395
2018	133,696,313	129,605,327	97	- 48,465,684
2019	125,959,713	114,158,100	91	- 45,278,795
2020	128,037,487	112,389,875	88	- 71,667,717
2021	142,844,376	108,384,132	76	- 59,110,976
2022	98,473,621	93,065,458	95	- 46,240,987
2023	121,378,041	94,087,018	78	- 47,045,484
Total		996,368,063		- 574,988,878

Burimi i të dhënave KNRA

Ndërsa treguesit ekonomiko financiar për vitet 2015 deri 2023 janë si më poshtë:

- Të ardhurat në shumën 457,406,354 lekë
- Shpenzimet në shumën 996,368,063 lekë
- Humbja në shumën 574,988,878 lekë

Humbja në shumën 574,988,878 lekë, ka ardhur kryesisht nga amortizimi prej 2015 deri 2023, në shumën **440,541,832 lekë**. Nëse bëjmë një analizë të humbjes rezulton si më poshtë:

- Humbja (2015-2023) në shumën 574,988,878 lekë
- Amortizimi total (minus) në shumën 440,541,832 lekë
- **Total humbje - amortizim 134,447,046 lekë**
- Humbja e mbartur (2015 minus) 105,970,572 lekë
- Humbja pa amortizim **28,476,471 lekë**

Amortizimi si shpenzim ka ndikuar në humbjen e veprimtarisë së KNRA, por jo në likuiditete, pasi dhe me krijimin e KNRA-së, kishin likuiditete si dhe gjendje materiale në magazinë.

- **Për të ardhurat e realizuara nga riparimi i mjeteve lundruese të Forcës Detare.** Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga riparimi i mjeteve lundruese të KFD, për vitet objekt auditimi paraqitet me një realizim i cili shkon nga 73% deri në masën 38%. Ky planifikim është bërë bazuar në tarifën e propozuar nga KNRA për Ministrinë e Mbrojtjes. Sipas viteve objekt auditimi realizimi bazuar në tarifën e propozuar nga KNRA, paraqitet sipas grafikëve sa më poshtë vijon:


Në fakt bazuar në tarifën e miratuar nga Ministria e Mbrojtjes, nga ana e KNRA duhej të bëhej përditësimi i planifikimit të të ardhurave, sipas tabelës sa më poshtë vijon:

Në lekë

Vitet	Vlera e kontratës midis KFD dhe KNRA-së (Fond për riparim m tvsh)	Koeficienti propozuar KNRA	Planifikimi i të ardhurave tarifave propozuara nga KNRA (TVSH) A	Të ardhurat miratuar nga KMT (planifikim) (TVSH) B	Koeficient miratuar KMT	Plani që duhej rishikuar në fakt tarifave	Diferenca plan fakt me tarifën MM
2016	38,670,833	2.24	53,300,000	37,010,575	0.8	30,936,666	6,073,909
2017	42,729,746	1.9	88,603,938	55,675,626	0.8	34,183,797	21,491,829
2018	45,500,000	1.56	88,911,901	72,809,832	0.95	43,225,000	29,584,832
2019	74,500,000	1.3	92,509,110	72,520,000	0.95	70,775,000	1,745,000
2020	40,000,000	1.27	96,953,564	72,320,000	0.95	38,000,000	34,320,000
2021	55,000,000	1.86	75,163,500	45,375,570	0.95	52,250,000	-6,874,430
2022	54,370,951	1.76	74,154,143	43,991,244	0.95	51,652,403	-7,661,159
2023	54,060,000	1.68	69,707,190	45,041,024	0.95	51,357,000	-6,315,976

Burimi i të dhënave KNRA

Ndërsa realizimi faktik i kësaj të ardhure krahasuar nga viti në vit, paraqitet



Realizimi i detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e shërbimit, të lidhur sipas viteve objekt auditimi, ndërmjet KNRA-së dhe KFD me objekt “Dokim dhe riparim i teknikës Detare për vitin 2023” ka qenë objekti kryesor dhe parësor i veprimtarisë së KNRA-së .

Të analizuara sipas viteve këto devijime të të ardhurave paraqiten sa më poshtë vijon:

Për vitin 2017: Të ardhurat nga riparimi i mjeteve lundruese të Forcës Detare, krahasuar me vitin 2016 janë realizuar 125.4%. Kjo rritje e të ardhurave ka ardhur, si rezultat i faktorëve të mëposhtëm:

- Kërkesë nga KFD për punime jashtë planit të dokimit, për demolim në skrap të anijes P207.
- Montimi dhe instalimi i sistemit të armatimit 20 mm në anijen Butrinti dhe anijes Lissus
- Rritja e numrit të anijeve për riparim në planin e dokimit për vitin 2017.

Për vitin 2018: Të ardhurat nga riparimi i mjeteve lundruese të Forcës Detare në vitin 2018, krahasuar me vitin 2017, janë realizuar 29.2% më shumë. Kjo rritje e të ardhurave ka ardhur, si rezultat i faktorëve të mëposhtëm:

- Shtimi i fondit të riparimit nga ana e FD, për mjetet lundruese.
- Montimi dhe instalimi i sistemeve të armatimit 20 mm në anijet e klasit “Iliria”.
- Rritja e numrit të anijeve për riparim në planin e dokimit për vitin 2018.

Për vitin 2019: Të ardhurat nga riparimi i mjeteve lundruese të Forcës Detare në vitin 2019, krahasuar me vitin 2018 janë realizuar 2.2% më pak. Kjo ulje e të ardhurave ka ardhur, si rezultat i faktorëve të mëposhtëm:

- Fondi i pamjaftueshëm për riparime dhe shërbime të gjithë mjeteve lundruese të FD. Për vitin 2019, nuk janë paraqitur sipas planit të dokimit për riparim tre mjete lundruese.
- Vendosja e koeficientit nga ana e Komisionit të miratimit të trafifave, e cila ndikon në tarifat e mjeteve lundruese dhe rrjedhimisht dhe në të ardhurat e faturuara.
- Mungesa e projekteve për modernizimin e mjeteve lundruese të FD-së, siç ishin sistemet e bazamenteve të armatimit në anijet e klasit “Iliria”

Për vitin 2020, krahasuar me vitin 2019 të ardhurat, janë realizuar 59.71% më pak. Kjo ulje e të ardhurave ka ardhur, si rezultat i faktorëve të mëposhtëm:

- Mosparaqitja për riparim dokim të mjeteve lundruese nga KFD, duke moszbatuar planin e dokimit miratuar me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm. Në vitin 2020, KFD^{ja} ka sjellë në KNRA për riparim, 8 mjete lundruese.
- Vendosja e koeficientit nga ana e Komisionit të miratimit të trafifave, të shpenzimeve indirekte, e cila ndikon në tarifat e mjeteve lundruese dhe rrjedhimisht dhe në të ardhurat e faturuara.

– Mungesa e projekteve për modernizimin e mjeteve lundruese të FD-së, siç ishin sistemet e bazamenteve të armatimit në anijet e klasit “Iliria”.

Në planin e riparim dokimit nga KFD ishin planifikuar për të kryer shërbime dhe riparime në KNRA, 21 mjete lundruese të Forcave të Armatosura. KNRA, për vitin 2020 ka bërë të mundur riparim dokimin e 9 mjeteve lundruese të Forcës Detare. Në mënyrë analitike më poshtë po paraqesim kostot e riparimit për mjetet lundruese të FA-së të faturuar nga KNRA.

Tabela: “Kostot e riparimit për mjetet lundruese të FA-së të faturuar nga KNRA për vitin 2020”:

Në lekë

Nr.	Emërtimi i anijes	Vlera pa TVSH
1	Arch - Angel P-02	
2	Arch - Angel P-05	
3	Arch - Angel P-04	1,318,119
4	Arch -Angel P-03	
5	Arch -Angel P-01	
6	Pantoni i Qitjes	
7	Anija Amerikane P-118	1,723,478
8	Anija Amerikane P-117	2,545,685
9	Anija Oriku	7,695,677
10	Anija Antindotje Y-32	
11	Anija Antindotje Y-31	

Nr.	Emërtimi i anijes	Vlera pa TVSH
12	Anija e hidrografisë A-81	
13	Anija Iliria P-131	5,867,020
14	Skafi i Hidrografisë Ms 1171	
15	Anija Amerikane P-116	
16	Anija Butrinti P-134	6,752,925
17	Anija Lissus P-133	7,338,589
18	Anija Shqiponja A-82	
19	Anija Amerikane P-110	2,017,289
20	Anija Amerikane P-112	1,811,528
21	Skafi i polumbarëve	
	Shuma pa tvsh	37,070,307

Burimi i të dhënave KNRA

Siç shihet dhe nga tabela e mësipërme, KFD nuk ka dërguar për riparim në KNRA 12 mjete lundruese, duke moszbatuar Urdhërin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm nr. 60, datë 08.06.2020.

Për vitin 2021: Të ardhurat nga riparimi i mjeteve lundruese të KFD, krahasuar me vitin 2020 janë realizuar 22.3% më shumë. Kjo rritje e të ardhurave ka ardhur, pasi:

- Dalja për riparim dokim e më shumë mjeteve lundruese të FA-së, në krahasim me vitin 2020, gjithsej 18 mjete lundruese.
- Fondi në vlerë më të madhe në kontratën e riparimit/dokimit të lidhur ndërmjet KFD-së dhe KNRA-së.
- Ezaurimi total i fondit të paraqitur nga FD-ja për riparimin e mjeteve lundruese.

Në planin e riparim dokimit nga KFD ishin planifikuar për të kryer shërbime dhe riparime në KNRA për 21 mjete lundruese të FA-së. KNRA, për vitin 2021 ka bërë të mundur riparim dokimin e 18 mjeteve lundruese të KFD, me vlerë të faturuar të punimeve dhe shërbimeve të kryera në bazë të preventivave 45,352,643 lekë pa TVSH. Në mënyrë analitike më poshtë po paraqesim kostot e riparimit për mjetet lundruese të FA-së të faturuar nga KNRA.

Në lekë

Nr.	Emërtimi i anijes	Vlera pa TVSH
1	Arch Angel P-02	1,155,668
2	Anija Shqiponja A-82	806,040
3	Arch Angel P-03	1,995,662
4	Arch Angel P-05	1,070,644
5	Anija Antindotje Y-32	2,027,375
6	Anija Amerikane P-116	2,333,318
7	Anija Amerikane P-118	2,119,875
8	Anija Antindotje Y-31	3,437,940
9	Anija e Hidrografisë	1,429,919

Nr.	Emërtimi i Anijes	Vlera pa TVSH
10	Anija Iliria P-131	6,208,644
11	Anija Amerikane P-117	2,170,126
12	Anija Oriku P-132	9,159,896
13	Arch Angel P-01	1,427,537
14	Pantoni I Qitjes Detare	342,550
15	Anija Lissus P-133	6,088,244
16	Anija P-112	1,488,161
17	Motoskafi	618,350
18	Anija P-110	1,472,695
	Shuma pa tvsh	45,352,643

KFD për vitin 2021, nuk ka dërguar për riparim në KNRA, 3 mjete lundruese, duke moszbatuar Urdhërin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm nr. 470, datë 07.04.2021.

Nga ana e KNRA është paraqitur zyrtarisht KFD-së, kërkesa për amendim kontrate dhe shtim fondi si dhe aftësia dhe mundësia e KNRA^{së} për riparimin e tre mjeteve lundruese të sipërpërmendura.

Për vitin 2022: Të ardhurat nga riparimi i mjeteve lundruese të FD, krahasuar me vitin 2021 janë realizuar 1,35% më pak. Kjo rënie e të ardhurave ka ardhur, si rezultat i:

– Dalja për riparim dokim e më pak mjeteve lundruese të FA-së, në krahasim me vitin 2021. Në vitin 2022 KFD-ja solli në KNRA për riparim 17 mjete lundruese.

– Riparimi i anijeve të KFD-së ka filluar me vonesë, në muajin qershor 2022

Për vitin 2023: Të ardhurat nga riparimi i mjeteve lundruese të KFD, krahasuar me vitin 2022 janë realizuar 2. 43% më shumë. Kjo rritje e të ardhurave, ka ardhur, si rezultat i:

- Dalja për riparim dokim më shumë mjeteve lundruese të FA-së, pasi KFD^{ja} ka sjellë në KNRA për riparim 16 mjete lundruese.

- Riparimi i anijeve të KFD-së ka filluar me vonesë - maj 2023.

Vlen të theksohet se për periudhën objekt auditimi 2016 -2023, për të gjitha punimet që KNRA ka kryer tek këto mjete lundruese komisionet për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës nuk kanë patur mosmarrveshje dhe kontestime midis palëve.

• **Për të ardhurat e realizuara nga të tretët:**

Për vitin 2017: Të ardhurat nga shërbime e riparime nga të tretët në vitin 2017, krahasuar me vitin 2016 janë realizuar më pak, ose 77.6%.

*Ky mosrealizim i të ardhurave krahasuar me vitin 2016, ka ardhur si rezultat i rritjes së kërkesave në vitin 2017 nga Komanda e Forcës Detare për shërbime ekstra jashtë planit të dokimit, e cila solli mungesën e hapësirave për riparimin e anijeve me të tretët.

Për vitin 2018, krahasuar me vitin 2017 janë realizuar në përqindje 39.9%, më pak. Ky mosrealizim i të ardhurave krahasuar me vitin 2017, ka ardhur si rezultat i faktorëve të mëposhtëm:

– Rritja e kërkesave në vitin 2018 nga Komanda e Forcës Detare për shërbime ekstra jashtë planit të dokimit, e cila solli mungesën e hapësirave për riparimin e anijeve me të tretët.

– Futja në proces riparimi i shkallës “Kosjakova” dhe transportierit lëvizës. Riparimi dhe mirëmbajtja e këtyre asetëve, ka bërë që për një periudhë dy mujore, KNRA të mos kryejë asnjë proces pune që mund të arkëtonte të ardhura.

– Të ardhurat nga qera të tjera në vitin 2018, krahasuar me vitin 2017, janë realizuar 38,661 lekë më shumë, ose në përqindje 72.2% më shumë, kjo ka ardhur si rezultat i të ardhurave të tjera si pagesa nga qera paneli.

– Të ardhurat nga AQT (Rikonstruksioni i shkallës) në vitin 2018, janë në shumën 12,433,639 lekë,

Për vitin 2019, rritja e të ardhurave në vitin 2019 nga të tretët, ka si rezultat i këkesave më të mëdha të subjekteve private, si dhe funksionimi me efikasitet të plotë të shkallës “Kosjakova” pas riparimit. Në vitin 2018, janë realizuar të ardhura nga AQT për rikonstruksionin e shkallës në shumën 12. 433. 639 lekë, shumë e cila sjell dhe tejkalimin në total të ardhurave krahasuar me vitin 2019.

Për vitin 2020, krahasuar me vitin 2019 janë realizuar 46. 62%, më pak. Kjo ulje e të ardhurave krahasuar me vitin 2019, ka ardhur si rezultat i faktorëve të mëposhtëm:

– Periudha e Pandemisë Covid 19, zbatimi i masave parandaluese nga autoritetet ka sjellë, që për një periudhë disa javore KNRA-ja të mos operonte me subjekte private.

– Kërkesat nga subjektet private ishin të vogla, edhe pse KNRA-ja dispononte hapësira duke kryer riparimin dhe dokimin e 15 mjeteve private në vlerën 3,605,771 lekë pa TVSH.

Për vitin 2021 është kryer riparimin dhe dokimin e 16 mjeteve private dhe krahasuar me vitin 2020 janë realizuar 7.45%, më shumë, pasi kërkesat nga subjektet private ishin më të mëdha, gjë që ndikoi në rritjen e të ardhurave nga subjektet private.

Për vitin 2022, është kryer riparimin dhe dokimin e 11 mjeteve private dhe krahasuar me vitin 2021 janë realizuar 47.41%, më pak, pasi kërkesat nga subjektet private ishin më të vogla, gjë që ndikoi në uljen e të ardhurave nga subjektet private.

Për vitin 2023 janë realizuar 42.74%, më pak se viti 2022, pasi kërkesat nga subjektet private ishin më të vogla, 6 mjete private, gjë që ndikoi në uljen e të ardhurave nga subjektet private.

- **Shpenzimet:** Realizimi i shpenzimeve kundrejt shpenzimeve të planifikuara për periudhën objekt auditimi paraqitet sipas grafikut sa vijon, me një % mesatare realizimi 89%.

Realizimi i shpenzimeve kundrejt atyre të planifikuara paraqitet në tabelën në vijim:

Në lekë

Vitet	Shpenzime sipas viteve		
	Plan	Fakt	%
2016	150,200,700	149,072,551	99
2017	122,700,212	112,209,675	91
2018	133,696,313	129,605,327	97
2019	125,959,713	114,158,100	91
2020	128,037,487	112,389,875	88

Vitet	Shpenzime sipas viteve		
	Plan	Fakt	%
2021	142,844,376	108,384,132	76
2022	98,473,621	93,065,458	95
2023	121,378,041	94,087,018	78
Total	1,023,290,463	912,972,136	89 %

Në analizë sipas viteve:

- **Viti 2016:** Shpenzimet në total janë realizuar në shumën 149,072,551 lekë. Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme për vitin 2016 është llogaritur në vlerën 59,800,162 lekë. Gjithashtu një zë tjetër me vlerë të konsiderueshme janë shpenzimet gjyqësore të vendosura ndaj KNRA kundrejt punonjësve të larguar nga KNRA- ja me krijimin e saj, për shpërblim vjetërsie në shumën 10,276,733 lekë, për likuidim diete ushqimore në shumën 9,067,806 lekë.

- **Viti 2017:** Shpenzimet në vitin 2017 janë realizuar më pak, duke e krahasuar me vitin 2016, ose 76. 2%. Kjo ulje e shpenzimeve të materialeve, ka ardhur pasi në vitin 2016 për riparimin e anijeve të tipit Iliria, janë përdorur materiale nga gjëndja e magazines Damen të cilat në inventar kanë patur një vlerë të lartë.

– Shpenzimet për karburant në vitin 2017, krahasuar me vitin 2016 janë konsumuar 2933 litra më pak, ose 87.4%. Kjo ka ardhur kryesisht nga dalja jashtë përdorimit e dy mjeteve të transportit. Ulja e amortizimit pasi për mjetet e transportit nuk llogarisin më amortizim, pasi janë amortizuar totalisht.

- **Viti 2018:** Shpenzimet në vitin 2018 janë realizuar më shumë, nga viti 2017, 15.5%, nga shpenzime materiale për rikonstruksionin e shkallës, amortizimi vjetor për shkak të kalimit në AQT të vlerës së rikonstruksionit të shkallës për të cilën është llogaritur amortizim, si dhe nga blerja e paisjeve informatike; Rritja e shpenzimeve sipas Vendime Gjykatës në vitin 2018, rezulton për shkak të Vendimeve Gjyqësore që kanë hapur punonjësit e larguar.

- **Viti 2019:** Shpenzimet janë realizuar duke e krahasuar me vitin 2018, ose 12% më pak, si rezultat edhe i nxjerrjes jashtë përdorimit të AQT-ve.

- **Viti 2020:** Shpenzimet në vitin 2020 janë realizuar **1,768,225 lekë** më pak, duke e krahasuar me vitin 2019, ose 1.55% më pak. Kjo ulje e shpenzimeve materiale në vitin 2020, ka ardhur kryesisht nga shpenzime materiale të cilat janë përdorur më pak, pasi numri i anijeve për riparim në vitin 2020 ka qënë më i vogël se në vitin 2019 dhe amortizimi vjetor në vitin 2020

është 39,885 lekë më pak, duke e krahasuar me vitin 2019, ose në përqindje 0.09% më pak, kjo ka ardhur si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimit të AQT-ve.

- **Viti 2021:** Shpenzimet në vitin 2021 janë realizuar **4,005,743 lekë** më pak, duke e krahasuar me vitin 2020, ose 4% më pak.

– Shpenzime materiale në vitin 2021, janë realizuar 21% më pak se 2020, si rezultat i reduktimit të shpenzimeve materiale për infrastrukturën e KNRA-së. rrethimi i teritorit të Kantierit (kangjella metalike) dhe riparime pjesore (mirëmbajtje) në shkallën Kosjakova dhe transportierin lëvizës të cilët patën shpenzime të konsiderueshme.

- **Viti 2022:** Shpenzimet në vitin 2022 janë realizuar **15,442,783 lekë** më pak, duke e krahasuar me vitin 2021, ose 14.24% më pak, kryesisht nga mosrealizimi i shpenzimeve për sigurimin e shkallës.

- **Viti 2023:** Shpenzimet në vitin 2023 janë realizuar **1,021,560 lekë** më shumë, duke e krahasuar me vitin 2022, 1.09% më shumë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

- Kjo ndërmarrje ka sipërfaqe totale të truallit 148,860 m², nga të cilat sipërfaqe funksionale 112,735.3 m². Objektet janë të ndërtuara kryesisht në rreth viteve 1960 dhe një objekt i vitit 2008.

- Vlera fillestare e aseteve të trashëguara janë në shumën 1,561,633,690 lekë me një amortizim të akumuluar deri në 31.03.2015 në shumën 437,841,144 lekë, ndërsa vlera nga rivlerësimi i aseteve është në shumën 1,662,592,165 lekë, me një amortizim mesatar 28%. Mjetet e transportit të trashëguara kanë rezultuar me një amortizim 100%.

- Kjo ndërmarrje, nga fondet që u transferuan në llogarinë e saj në shumën 78,970,879 lekë, janë shpenzuar për likuidimin e fondit të pagave deri në datën 31.12.2015, shpenzime materiale, shërbime nga të tretë, shpenzime për mirëmbajtje, shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për largim nga puna, shpenzime gjyqësore, si dhe shpenzime tatim taksa.

- Përpara kalimit të KNRA-së në ndërmarrje shtetërore, KFD porosiste prodhime dhe shërbime që sot nuk kryhen më, si prodhimin e bovave detare për Shërbimin Hidrografik Kombëtar, kulla vrojtimi, dyer, kasaforta, bënte mirëmbajtjen e të gjithë mjeteve të transportit etj. Të gjitha këto shërbime, punime apo prodhime të reja sot nuk porositen më nga Forcat Detare, nënrepartet e saj apo nga FA në përgjithësi. Këto prodhime apo shërbime FA i marrin nga prokurimet publike.

- Amortizimi i akumuluar prej vitit 2015 deri në vitin 2023, është në shumën 440,541,832 lekë. Amortizimi si shpenzim ka ndikuar në humbjen e veprimtarisë së KNRA, por jo në likuiditete, pasi dhe me krijimin e KNRA-së, kishin likuiditete si dhe gjendje materiale në magazinë.

- Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga riparimi i mjeteve lundruese të KFD, bazuar në tarifën e propozuar nga KNRA, për vitet objekt auditimi paraqitet me një realizim i cili shkon nga 73% deri në masën 38%. Në fakt bazuar në tarifën e miratuara nga Ministria e Mbrojtjes, nga ana e KNRA duhej të bëhej përditësimi i planifikimit të të ardhurave bazuar në tarifën e miratuara.

- FD nuk ka dërguar për riparim në KNRA të gjithë mjetet lundruese, duke moszbatuar Urdhërin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm nr. 60, datë 08.06.2020.

- Realizimi i shpenzimeve kundrejt shpenzimeve të planifikuara për periudhën objekt auditimi paraqitet sipas grafikut sa vijon, me një % mesatare realizimi 89%.

Në zbatim të pikës 2/2, të Programit të Auditimit nr. 347/2, datë 28.03.2024, u shqyrtua dokumentacioni mbi përcaktimin dhe miratimin e tarifave në KNRA dhe Ministrinë e Mbrojtjes:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Me Urdhërin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 03, datë **06.01.2016**, “Për ngritjen dhe funksionimin e komisionit të miratimit të tarifave të shërbimeve për mjetet lundruese dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura”, bazuar në:

- 1- Pika 4, neni 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
- 2- Neni 13, ligji nr. 64/2014, datë 26.06.2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,
- 3- Ligjit nr. 8480, datë 27. 05. 1999, “Për funksionimin e organeve kolegjale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;
- 4- VKM nr. 397, datë 11. 05. 2015, “Për krijimin e ndërmarrjes shtetërore “Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve”,

është vendosur Komisioni me përbërje:

- Përgjegjës i Sektorit të buxhetit dhe kontabilitetit, Drejtorja e Financës, Ministria e Mbrojtjes – kryetar;
- Përgjegjës i Sektorit të mirmbajtjes (J-4), SHPFA, antar;
- Shefi i Degës llogjistike (G-4) Forca Detare, antar;
- Shefi i Sektorit të preventivit, IGJIU, antar;
- Specialist mirmbajtje i mjeteve detare, antar.

Në komisionin e ngritur me Urdhërin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 03, datë 06.01.2016, “Për ngritjen dhe funksionimin e komisionit të miratimit të tarifave të shërbimeve për mjetet lundruese dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura (FA)”, nuk është përcaktuar asnjë antar i KNRA, ndërkohë që ka 2 anëtar nga Forcat Detare.

Sipas këtij Urdhëri, është përcaktuar se:

“2- Drejtori i Kantierit të Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve, brenda datës 10 dhjetor të cdo viti të dërgojë pranë komisionit të mësipërm, tarifat e shërbimeve për mjetet lundruese dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura për vitin pasardhës. ”

“4- Kryetari i Komisionit brenda 7 ditë pune nga dërgimi i dokumentacionit nga Drejtori i ndërmarrjes, nëpërmjet sekretarit teknik përgatit materialin dhe ua dërgon të gjithë anëtaëve të komisionit si dhe cakton datën e mbledhjes së komisionit, por jo më vonë se 7 ditë pune nga paraqitja e dokumentacionit pranë këtij komisioni. ”

“6- Pas përfundimit të procedurave të mësipërme (pika 5), komisioni në mbledhjen e radhës por jo më larg se 20 ditë pune nga paraqitja e dokumentacionit për miratim, bën shqyrtimin përfundimtar dhe miraton tarifat e shërbimeve për mjetet lundruese dhe pajisjet e Forcave të Armatosura (FA). ”

“7- Pas miratimit të tarifave të shërbimeve për mjetet lundruese dhe pajisjeve të FA, komisioni përgatit projekt Urdhërin e Ministrit të Mbrojtjes për miratim. ”

“8- Vlefshmëria kohore e tarifave të shërbimeve për mjetet lundruese dhe pajisjeve të FA është 1 vit nga data e miratimit të tyre nga Ministri i Mbrojtjes. ”

Nga auditimi i zbatimit të afateve të miratimit të tarifave, sipas VKM, rezulton se:

Në bazë të Urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes nr 3, datë 06.01.2016, “Për ngritjen dhe funksionimin e komisionit të miratimit të tarifave të shërbimeve për mjetet lundruese dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura”, nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për gjithë periudhën objekt auditimi, rezulton se: KNRA brenda datës 10 dhjetor të çdo viti ka dërguar pranë komisionit, tarifat e shërbimeve për mjetet lundruese dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura.

Afat i përcaktuar për miratim, është tejkaluar nga Komisioni dhe Titullari i Ministrisë, mbi afatin e përcaktuar në Urdhërin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 03, datë 06.01.2016, dhe që shkojnë nga 46 – 135 ditë, (1.5 muaj deri 3.5 muaj), duke sjellë:

- ndërprerjen e vonesa në veprimtarinë e punës për riparimin e mjeteve lundruese të FA, në pritje të ardhjes së tarifave të miratuara nga Komisioni i Ministrisë së Mbrojtjes dhe lidhjes së kontratës së riparimit,
- mos riparimin e gjithë mjeteve lundruese brenda vitit kalendarik, pasi tarifat kanë afat kohor vlefshmërie një brenda vitit kalendarik, duke mos realizuar në këtë mënyrë të ardhurat.
- lidhja e kontratës së shërbimeve me Komandën e Forcës Detare po ashtu është lidhur jo në fillim viti (janar) por disa muaj me vonesë, duke mos respektuar nga FD planin e riparim dokimit të miratuar nga Shefi Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Konkretisht këto afate janë sipas grafikut sa më poshtë vijon:

Në ditë




Tabela analitike me të dhënat sipas shkresave dhe viteve objekt auditimi paraqiten sa vijon:

Viti	Drejtuar KD të KNRA-së nr. Prot, datë	Vendimi i KD KNRA për propozim tek MM	Këshilli Drejtues i KNRA	Shkresa dërguar për miratim në MM	Vendimi i Komisionit të MM për tarifafat	Miratuar nga MM Urdhër, nr, datë.	Data prot. në KNRA	Ditë nga dërgimi per miratim deri në prot. të KNRA
2016	1210/1 24.11.2015		A. G. F. H. K. P. M. M. A. Sh.	1325 30.12.2015	nr. 1, datë 02.03.2016	Nr. 430, 04.03.2016	15.03.2016	74
2017	703 09.12.2016	Nr. 18, 09.12.2016	A. G. A. K. K. P. M. M. A. Sh.	703/2 09.12.2016	nr. 1, datë 13.03.2017	Nr. 548, 21.03.2017	04.04.2017	79
2018	598 21.12.2017	Nr. 7, 11.12.2017	A. G. A. K. K. P. M. M. A. Sh.	599 21.12.2017	nr. 1, datë 07.02.2018	Nr. 246, 21.02.2018	28.02.2018	46
2019	510. 30.11. 018	Nr. 08, 30.11.2018	A. G. A. K. K. P. M. M.	638 30.11.2018	-	Nr. 219, 15.02.2019	27.02.2019	58

Viti	Drejtuar KD të KNRA-së nr. Prot. datë	Vendimi i KD të KNRA për propozim tek MM	Këshilli Drejtues i KNRA	Shkresa dërguar për miratim në MM	Vendimi Komisionit të MM për tatifat	Miratuar nga MM Urdhër, nr, datë.	Data e prot. në KNRA	Ditë nga dërgimi per miratim deri në prot. të KNRA
			A. Sh.					
2020	815 06.12.2019	Nr. 07, 06.12. 019	A. G. A. K. K. P. M. M.	815/1 06.12.2019	nr. 1 datë 17.03.2020	Nr. 637 08.06.2020	18.06.2020	135
2021	833/1 27.11.2020	Nr. 10, 02.12.2020	A. G. A. K. K. P. L. L. I. V.	842 02.12.2020	nr. 1 datë 25.01.2021	Nr. 470, 07.04.2021	08.04.2021	89
2022	827 03.12.2021	Nr. 18, 07.12.2021	A. G. A. K. K. P. L. L. I. V.	839 07.12.2021	nr. 1 datë 31.01.2022	Nr. 716, 13.05.2022	17.05.2022	70
2023	636 06.12.2022	Nr. 08, 06.12.2012	A. G. A. K. K. P. L. L. I. V.	638 06.12.2023	nr. 1, datë 25.01.2023	Nr. 370, 07.03.2024	19.03.2024	70

Burimi i të dhënave KNRA dhe Ministria e Mbrojtjes

Nga auditimi i dokumentacionit në KNRA rezulton vendosja e pa argumentuar nga Komisioni i Miratimit të Tarifave (KMT) e koeficientit të shpenzimeve indirekte në tarifatat e FA-së. Nga auditimi rezulton se vetëm në vitin 2016 ka dokumentacion nga ana e Komisionit, (sipas shkresës nr. 229 /1, datë 16.01.2017 “Kërkesë për argumentim”), mbi kundërshtimin e tarifave të propozuara nga KNRA. Për periudhën tjetër (2017 -2023) nuk dispozohet asnjë dokumentacion (gjurmë auditimi) për argumentimin e mosmiratimit të tarifave të propozuara si dhe për mënyrën e përlllogaritjes së tarifave nga ana e tij pra nuk jepet asnjë argument (analizë, kundërshtim) mbi koficientin e shpenzimeve strukturore, koeficient i cili ndikon në cmimin e tarifave.

Konkretisht në vitin 2016. sipas shkresës nr. 229 /1, datë 16.01.2017 “Kërkesë për argumentim”:
Pretendimi i Komisionit në lidhje me: *“Materialet e kaluara si kapital në Ndërmarrjen Shtetërore ,“Kantieri Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve”, nga Komanda e Forcës Detare të mos jenë objekt i tarifave të shërbimit dhe riparimit të mjeteve lundruar të Forcave të Armatosura.*

Nga ana e KNRA është argumentuar se: “mospërfshirja e materialeve në tarifatat e shërbimit dhe riparimit bie në kundërshtim me VKM nr. 397, datë 11.05.2015 “Për krijimin e ndërmarrjes shtetërore “Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve”, pasi ky vendim përcakton si të vetmin detyrim të KNRA, atë të kryerjes së riparimit të mjeteve lundruar të Forcës Detare pa shpërblim, përshtimisht vetëm për vitin 2015. Në asnjë dispozitë të këtij akti nënligjor apo të Urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 1033, datë 24.06.2015 “Për organizimin e ndërmarrjes shtetërore “Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve”, nuk është parashikuar si detyrim që materialet të mos jenë objekt i tarifave të shërbimit dhe riparimit. Këto materiale ashtu si dhe të gjitha aktivitetet e tjera, janë përfshirë në kapitalin themeltar të ndërmarrjes, të cilat janë përcaktuar në pikën 4, të VKM nr. 397, datë 11.05.2015 dhe mund të ndryshohen vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pretendimi i Komisionit në lidhje me: *“Llogaritja e koeficientit indirekt duhet të rishikohet duke marrë në konsideratë faktin që KNRA nuk ka kryer asnjë shpenzim për amortizimin. Përfshirja e të gjithë vlerës së amortizimit sipas bilancit të ndërmarrjes në shpenzime indirekte,*

rrit në mënyrë artificiale koeficientin indirekt duke rritur në të njëjtën kohë koston e shpenzimeve indirekte në raport të zhdrejtë me koston e shpenzimeve direkte“.

Nga ana e KNRA është argumentuar se: amortizimi nga pikpamja kontabile, mbështetur në ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare“*, nenet 9,10,11, shprehin qartë efekshmërinë, rregullshmërinë, kthyeshmërinë dhe parimet bazë të investimeve. Sipas Udhëzimit nr. 14, datë 28.12.2006, *“Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore. . . .“*, në lidhje me amortizimin vjetor theksohet, se amortizimi vjetor të llogaritet dhe të kontabilizohet sipas normave të përcaktuara në VKM nr. 401, të vitit 1999, ndërsa për paisjet informatike dhe elektronike të përdoret ligji aktual fiskal *“Për tatimin mbi të ardhurat“*, me norma amortizimi 25% për paisjet informatike dhe aplikimi të bëhet mbi vlerën e mbetur. Në ligjin nr. 8428, datë 28.12.1998, *“Për tatimin mbi të ardhurat“*, neni 22, amortizimi, pika 1, në përcaktimin e fitimit të tatueshëm, amortizimi për aktivet e veprimtarisë, llogaritet nga aksioneri i aktiveve të veprimtarisë. Në rastin tonë, në se në shpenzime indirekte nuk duhet të përfshihet vlera e amortizimit të aseteve, kjo duhet të jetë e miratuar nga aksioneri sipas propozimit të bërë nga Këshilli Drejtues i Ndërmarrjes. Por theksojmë se, vlera e mbetur e AQT^{ve} nuk pasqyron realitetin, në një moment të caktuar në se nuk llogaritet amortizimi sipas ligjit.

Sipas Standarteve kombëtare të kontabilitetit vlera e amortizueshme e një aktivi afatgjatë njihet si një shpenzim në mënyrë sistematike përgjatë jetës së këtij aktivi.

Në zbatim të Urdhërit të Ministrisë së Mbrojtjes Nr. 2347, datë 21.12.2017 nga ana jonë është bërë ndarja e AQT -ve (ndërtesa e makineri) jashtë funksionit. Shuma e amortizimit të ndërtesave jashtë funksionit është në shumën 1,986,594 lekë. Makineri e pajisje jashtë funksionit janë në shumën 11,514,143 lekë. Në total shuma e amortizimit të AQT-ve jofunksionale është **13,500,737 lekë**. Amortizimi kontabël i llogaritur për vitin 2017 është në shumën 44,947,679 lekë.

Pretendimi i Komisionit në lidhje me: *Të rishikohet mënyra e kostimit të bazës materiale të përdorur në procesin e riparimit të anijeve, pasi aplikimi i koeficientit indirekt në këto materiale e rrit koston e tyre në mënyrë të pajustificuar“.*

Nga ana e KNRA është argumentuar se:

- Koeficienti mund të aplikohet mbi totalin e shpenzimeve direkte, ose mbi pagat dhe sigurimet, por efekti është i njëjtë sepse nëse aplikohet mbi shumën e shpenzimeve direkte ashtu edhe do shperndahen shpenzimet indirekte, nëse llogaritet mbi pagat po ashtu do të zbatohet mbi pagat dhe në rastin konkret koeficienti i llogaritur mbi shpenzimet direkte totale është 1.9, kurse mbi pagat është 4.03.

- Në Manualin Nr. 4, *“Punime dhe instalime teknologjike“* thuhet se struktura e një preventivi apo situacione përbëhet nga :

1. Vlera e punimit dhe shërbimit që përmban – lëndën e parë, pagat dhe sigurimet shoqërore, lëndët e tjera ndihmëse, vlera e makinerisë (që nënkupton amortizimin), transporti etj. të karakterit direkt.

2. Shpenzimet plotësuese, që do të thotë shpenzimet indirekte të llogaritura mbi shpenzimet direkte të punimit apo shërbimit.

3. Fitimi i planifikuar i ndërmarrjes, i cili në rastin tonë është 20 %, dhe aplikohet mbi shumën 1+2.

Për këto arsye kemi zbatuar koeficientin mbi shpenzimet direkte totale.

Pretendimi i Komisionit në lidhje me: *Nga ana e KMT nuk është pranuar koeficienti i propozuar në raport me organikën.*

Nga ana e KNRA është argumentuar se: Në përcaktimin e koeficientit, në fund të çdo viti financiar, për hartimin e tarifave që do t'i propozohen Ministrisë së Mbrojtjes për miratim, jemi

bazuar bazuar në Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare“, në Udhëzimin nr.14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore . . .” si dhe Standardeve Kombëtare Kontabël në fuqi.

Në hartimin e tarifave jemi bazuar në strukturën e mëposhtme:

➤ **Shpenzimet direkte**

- Pagat dhe sigurimet shoqërore për orët e punës të kryera faktikisht në mjetet lundruese.
- Shpenzimet materiale, për materialet e përdorura direkt në anije.
- Materialet ndihmëse, energji elektrike, shpenzime transporti për sasinë faktike të evidentuar.

➤ **Shpenzimet indirekte**

- Pagat dhe sigurimet shoqërore të administratës dhe të tjera të papërfshira në shpenzimet e pagave direkte.
- Shpenzimet materiale si, kanceleri, detergjente etj.
- Karburante dhe lubrifikante për mjetet e transportit.
- Energjia elektrike.
- Amortizimi i AQT -ve.
- Udhëtime e dieta.
- Komisione bankare, postare, telefonike etj.

Koeficienti i shpenzimeve indirekte i propozuar nga ana jonë është llogaritur si raport i shpenzimeve indirekte me shpenzimet direkte, e cila aplikohet mbi totalin e shpenzimeve direkte.

Pretendimi i Komisionit në lidhje me: *Një kërkesë tjetër e KMT ka qenë edhe rishikimi i normës së fitimit.*

Nga ana e KNRA është argumentuar se: Në hartimin e situacioneve, norma e fitimit nga ana e KNRA është llogaritur në masën 20% dhe rentabiliteti është në masën 5%, megjithëse amortizimi është llogaritur jo më shumë se 50% e vlerës totale të amortizimit vjetor.

Argumentimi me shifra nga KNRA për kundërshtitë e vitit 2016:

Treguesit ekonomiko-financiar në vite që prej vitit 2004 deri në vitin 2016, paraqiten, sipas pasqyrës, nr. 1 si dhe sipas paraqitjes grafike nr. 2 si më poshtë:

- Vlera e AQT^{ve} në vitin 2016, duke ju referuar të dhënave të tabelës, është rritur me 50% më shumë në raport me vitet 2004- 2014, kjo rritje ka ardhur për shkak të rivlerësimit të asetëve në vitin 2015.
- Po ashtu vlera e amortizimit është rritur, pasi është shtuar vlera e AQT, ku amortizimi në vitin 2016 është rritur me 20% më shumë në raport me vitet 2004- 2014, tregues i cili rëndon mbi shpenzimet, rrjedhimisht ulet fitimi.
- Përsa i përket numrit të fuqise punëtore, ajo është reduktuar në masën 50% në raport me vitet 2004-2014, në vitet 2015, 2016 është punuar dhe punohet me një numër prej 45 punonjësish.
- Gjithashtu edhe fondi i pagave në vitin 2016, është reduktuar në masën 50% në raport me vitet 2004- 2014, pasi është punuar me një numër prej 45 punonjësish.
- Me një numër prej 45 punonjësish KNRA ka realizuar në vitin 2016 të ardhura në shumën prej 50,205,681 lekë, duke shfrytëzuar të gjitha kapacitetet e mundshme për riparim, si dhe duke kursyer fondin e pagave në raport me vitet e mëparshme në shumën rreth 50,000,000 lekë.
- Sipas analizës së treguesve ekonomiko-financiar në vite, (nga viti 2004), vihet re se në vitin 2016 treguesit janë më rentabël, pasi me një numër prej 45 punonjësish, janë realizuar të ardhura në shumën 50,205,681 lekë, pavarësisht se është punuar me një shkallë teje të amortizuar, si dhe me hapësira të kufizuara për riparim.

- Miratimi dhe kontrolli i tarifave për FA nga Ministria e Mbrojtjes, pa marrë parasysh nga komisioni përkatës i shqyrtimit të tarifave, kostot reale të KNRA, si shpenzimet e amortizimit, kostot reale të punës etj., referuar ligjit nr. 7582, datë 13.07.1992, “Për Ndërmarrjet Shtetërore”, neni 6, ndërmarrjet shtetërore përcaktojnë vetë programin ekonomik e financiar, përcaktojnë lirisht çmimet e mallrave në bazë të kërkesës dhe ofertës me përjashtim të atyre rasteve që përcaktohen me dispozita të veçanta, siç është pika 5 e VKM, nr. 397, datë 11.05.2015, “Për krijimin e ndërmarrjes shtetërore KNRA”. Në këtë rast referuar nenit 14, të ligjit 7582, datë 13.07.1992, pika 2, “Shteti nuk financon humbjet e ndërmarrjes shtetërore, me përjashtim të rasteve të veçanta kur kjo ka të bëjë me subvencionimin e çmimeve të kontrolluara sipas miratimit të Këshillit të Ministrave”, nuk kanë argumenta dhe bazë ligjore.


Mosllogaritja e shpenzimeve në kostot reale dhe vendosja e koeficientit të shpenzimeve indirekte pa u argumentuar nga ky komision, megjithë kundërshtimet e Drejtorisë së KNRA^{së}, ka çuar këtë të fundit në pamundësi për të bërë investime të reja apo për të kryer shpenzime për të mbajtur në gadishmëri teknike asetet e saj.

Gjëndja e aseteve të KNRA është me një amortizim të mbartur të akumuluar deri në 31.05.2015 në shumën 437,841,144 lekë dhe nga kjo datë deri në 31.12.2023 është në shumën 440,541,832.

Këtu vlen të përmendet shkalla, linjat e shinave dhe kareli lëvizës. Në gjëndjen teknike që janë paraqisin një rrezik potencial për jetën, shëndetin e punonjësve dhe të efektivave të anijeve, por edhe për pasurinë shtetërore dhe atë të palëve të treta. Paisjet dhe veglat e punës të blera gjatë projektit DAMMEN, janë amortizuar, dalë jashtë përdorimit apo dëmtuar nga vitet në përdorim (Projekti DAMMEN ka filluar në vitin 2007). Po ashtu ambientet e punës, si ndërtesa, kapanone, mjete transporti kanë nevojë për riparim dhe zëvendësim. Në asnjë rast Ministria e Mbrojtjes nuk ka subvencionuar çmimet e kontrolluara.

Sa më sipër, të ardhurat e munguara për shkak të përcaktimit të koeficientit ndjeshëm më të ulët se llogaritja e koeficientit real, gjatë 8 viteve të veprimtarisë së ndërmarrjes, janë në shumën **194,559,475 lekë pa TVSH (llogaritja koeficienti i përcaktuar nga KNRA në diferencë me koeficientin e miratuar nga KMT).**


Konkretisht tarifat e propozuara dhe ato të miratuara për vitet 2016 -2023, paraqiten:



Burimi i të dhënave

KNRA

Ku koeficienti i miratuar është në të gjitha rastet është në ulje në krahasim me tarifat e propozuara nga KNRA:



Burimi i të dhënave KNRA


Në tabelën sa më poshtë vijon është analizuar planifikimi i të ardhurave me tarifatat që KNRA ka paraqitur për miratim në Ministrinë e Mbrojtjes, si dhe planifikimi i të ardhurave sipas tarifave të miratuara nga Komisioni i Miratimit të Kostove. Planifikimi është bërë referuar kërkesave dhe shërbimeve që Komanda e Forcës Detare ka dërguar zyrtarisht çdo fillim viti në KNRA për mjetet lundruese. Konkretisht të ardhurat e planifikuara sipas koeficientit të KNRA me të ardhurat e realizuara nga koeficienti i Komisionit të Ministrisë së Mbrojtjes, paraqiten **me të ardhura të munguara** për periudhën objekt auditimi (2016 – 2023) në shumën **194,559,475 lekë, konkretisht:**

Në lekë

Vitet	Vlera e kontratës midis KFI dhe KNRA-së (Fondi për ripartim me tvsh)	Koeficienti i propozuar nga KNRA	Planifikim i të ardhurave me tarifatat e propozuara nga KNRA (pa TVSH) A	Te ardhurat me tarifatat miratuara nga KMI (planifikim) (pa TVSH) B	Diferenca e të ardhurave të munguara A-B	Koeficienti i miratuar nga KMI	Plani që duhej rishikuar në fakt me ardhjen e tarifave	Diferenca plan fakt me tarifatat MM
2016	38,670,833	2.24	53,300,000	37,010,575	16,289,425	0.8	30,936,666	6,073,909
2017	42,729,746	1.9	88,603,938	55,675,626	32,928,312	0.8	34,183,797	21,491,829
2018	45,500,000	1.56	88,911,901	72,809,832	16,102,069	0.95	43,225,000	29,584,832
2019	74,500,000	1.	92,509,110	72,520,000	19,989,110	0.95	70,775,000	1,745,000
2020	40,000,000	1.27	96,953,564	72,320,000	24,633,564	0.95	38,000,000	34,320,000
2021	55,000,000	1.86	75,163,500	45,375,570	29,787,930	0.95	52,250,000	-6,874,430
2022	54,370,951	1.6	74,154,143	43,991,244	30,162,899	0.95	51,652,403	-7,661,159
2023	54,060,000	1.68	69,707,190	45,041,024	24,666,166	0.95	51,357,000	-6,315,976
total					194,559,475			

Burimi i të dhënave KNRA

Në lekë



Burimi i të dhënave KNRA

Gjatë ushtrimit të kontrollit nga ana e Auditit të Brendshëm të Ministrisë së Mbrojtjes (viti 2017), janë evidentuar një sërë problematikash, problematika të cilat kanë ndikuar negativisht në performancën ekonomiko-financiare të ndërmarrjes. Këto problematika janë pasqyruar edhe në Urdhërin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 2347, datë 21.12.2017, (nr. 3174/3, datë 21.12.2017), “Për përfundimet e angazhimit të auditimit të plotë të ushtruar në “Kantierin e Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve” Pashaliman. Ndër të tjera, në pikën 4-5 të këtij urdhri citohet :

“4. KNRA. dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të përcaktojnë saktë një metodikë të pranuar nga të dyja palët, lidhur me përcaktimin dhe ndarjes e saktë të shpenzime direkte dhe indirekte të Kantierit për përllogaritjen e koeficientit, i cili do të shërbejë në caktimin e tarifave dhe çmimeve për mjetet lundruese dhe pajisjeve të F. A. -së.

5. Këshilli Drejtues i KNRA-së, bazuar në standardet kombëtare të kontabilitetit, si dhe të VKM Nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”, kapitulli II, gërma “A”, paragrafi 3, dhe seksionit I, aktivet e qëndrueshme të trupëzuara, pika 4 dhe në bashkëpunim me ekspertin kontabël të autorizuar:

- Të gjejnë mundësinë e çregjistrimit nga bilanci të objekteve (ndërtesa e makineri) të cilat janë jashtë funksionit dhe jo të dobishme, të cilat nuk ndikojnë direkt apo indirekt në aktivitetin prodhues të kantierit.

- Të përcaktohet saktë vlera e mbetur e tyre, me qëllim ndërprerjen e përllogaritjes së shpenzimeve të amortizimit për këtë kategori aktive të qëndrueshme;

- Ky proces të marrë miratimin edhe të aksionerit të kantierit”.

Në lidhje me pikën nr. 4, të këtij Urdhri, nuk ka asnjë ndërveprim midis Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të Ministrisë së Mbrojtjes dhe KNRA për përcaktimin e një metode të pranuar nga të dyja palët, lidhur me përcaktimin dhe ndarjen e saktë të shpenzimeve direkte dhe indirekte të KNRA për përllogaritjen e koeficientit, i cili do të shërbejë në caktimin e tarifave dhe çmimeve për mjetet lundruese dhe pajisjeve të F. A. -së.

Ndërsa në lidhje me pikën nr. 5 nga auditimi rezulton se: Në rregjistrin e prokurimeve janë parashikuar shpenzime për ekspertin vlerësues të AQT jashtë funksionit në shumën 270. 000 lekë që prej vitit 2019 e në vazhdim. Duke qënë gjithmonë në veshtirësi financiare nuk është realizuar si shpenzim.

Konkretisht **tarifat e propozuara nga KNRA, në fund të vitit 2023** për aktivitetin e punës të vitit 2024, bazuar në treguesit sipas bilancit viti 2023, janë përcaktuar sa vijon:

Treguesit sipas bilancit viti 2023 që përbëjnë tarifat e propozuara për vitin 2024, në lekë			
Shpenzimet	2023	Indirekte	Direkte

	A	B	C
Shpenzime Amortizimi	43,100,000	43,100,000	
Shpenzime Page	43,318,293	12,051,215	31,267,078
Shpenzime Kont. Sigurime Shoqërore	7,234,155	2,012,553	5,221,602
Shpenzime Energji Elektrike	2,900,000	1,500,000	1,400,000
Shpenzime Shypshkrime Kancelari & Detergjent	180,000	180,000	
Shpenzime Materiale	4,600,000		4,600,000
Shpenzime Karburant - lubrifikante	3,013,000	1,900,000	1,113,000
Shpenzime Siguracion Makine	198,300	198,300	
Shpenzime Udhetim dieta	220,000	220,000	
Shpenzime materiale për mirëmbajtje	2,500,000	2,500,000	
Shpenzime Telefoni e Postare	30,000	30,000	
Shpenzime për Ekspertin	420,000	420,000	
Shpenzime tjera(Kom. bankare etj)	22,000	22,000	
Shpenzime kolaudim fikse zjarri	48,000	48,000	
Shpenzime interneti,Ëëbsiti, TV	300,000	300,000	
Vegla pune jashte perdorimit	1,514,459	1,514,459	
shuma	109,598,207	65,996,527	43,601,680

Burimi i të dhënave KNRA

Koeficienti i përllorarit nga KNRA është 1. 51, sa vijon:

B	Shpenzime Indirekte / në lekë	65,996,527
C	Shpenzime direkte / në lekë	43,601,680
B/C	Koef. Indirekt	1. 51

Burimi i të dhënave KNRA

Nga ana e Komisionit është miratuar koeficienti 0.95, sipas Urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 370, datë 07.03.2024, nr. Prot 391/1, datë 07.03.2024, "Për miratimin e tarifave të shërbimeve për mjetet lundruese dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura për vitin 2024".

Bashkëlidhur kësaj shkrese është aneksi nr. 1 dhe nr. 2, "Struktura e cmimit të tarifave së shërbimeve për mjetet lundruese dhe pajisjet e FA për vitin 2024", në të cilën në kolonën B, "Shpenzime strukturore", është shumëzuar kolona A, "Shuma orë punë + baza materiale", me koeficientin 0.95.

Nuk ka asnjë argumentin nga ana e këtij Komisioni mbi metodikën e ndjekur për përcaktimin e këtij koeficienti dhe arsyet pse ndryshon nga koeficienti i propozuar nga KNRA.

Ky mosargumentim nga ana e Komisionit të Miratimit të tarifave, i koeficientit të strukturës së cmimit të tarifave nuk i është argumentuar në asnjë nga vitet objekt auditimi KNRA, konkretisht tabela në vijim:

Vitet	Koeficienti i propozuar nga KNRA	Koeficient i miratuar nga KMT
2016	2. 24	0. 8
2017	1. 9	0. 8
2018	1. 56	0. 95
2019	1. 3	0. 95
2020	1. 27	0. 95
2021	1. 86	0. 95
2022	1. 76	0. 95
2023	1. 68	0. 95

Burimi i të dhënave KNRA

Për më tepër që ky koeficient në vitet 2016 e 2017 ka qenë 0.8 dhe më tej duke mbetur një koeficient i pandryshuar 0.95 nga viti 2018 -2024 i pargumentuar në asnjë rast. Ky koeficient

nuk ka në përlllogaritje as ndikimin e pagës minimale sipas VKM-ve përkatëse të dala gjatë kësaj periudhe. Mungesa e një metodike të pranuar nga të dy palët në përcaktimin dhe ndarjen e saktë të shpenzimeve direkte dhe indirekte, ka sjellë që tarifave e cmimeve të propozuar nga KNRA të mos jenë të njëta me ato të miratuara.

Për sa trajtuar mban përgjegjësi Komisioni i Miratimit të Tarifave, sipas viteve.

Antarët e Komisionit të miratimit të tarifave sipas viteve:

Vitet	Komisioni
2016	Z. N. L., N/Kolonel L. Ç., N/Kolonel P. S., Kap/Lejtnant E. D., Z. S. Xh.
2017	Z. N. L., N/Kolonel L. Ç., N/Kolonel P. S., Major A. S., Z. S. Xh.
2018	Z. N. L.; N/Kolonel D. I.; N/K. P. S., N/Kolonel A. K., Z. S. Xh.
2019	N. L., A. H., O. Sh., S. Xh.
2020	Z. N. L., N/Kolonel A. H., N/Kolonel E. A., Kapiten i Rangut III Ol. Sh., Z. S. Xh.
2021	Z. N. L., N/Kolonel A. B., N/Kolonel E. A., Kapiten i Rangut III O. Sh., Znj. E. T.
2022	Z. N. L., N/Kolonel A. B., Kapiten i Rangut II A. S., Z. F.R.
2023	Z. N. L., Kapiten i Rangut III E. M., Z. F. R.
2024	Z. N. L., N/Kolonel A. K., Kapiten i Rangut III O. Sh., Z. F. R., Major A. M.

- **Afat i përcaktuar për miratim, është tejkaluar** nga Komisioni dhe Titullari i Ministrisë, mbi afatin e përcaktuar në Urdhërin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 03, datë 06.01.2016, dhe që shkojnë nga 46 – 135 ditë, (1.5 muaj deri 3.5 muaj) duke sjellë:

- ndërprerjen e vonesa në veprimtarinë e punës për riparimin e mjeteve lundruese të FA, në pritje të ardhjes së tarifave të miratuara nga Komisioni i Ministrisë së Mbrojtjes dhe lidhjes së kontratës së riparimit,

- mos riparimin e gjithë mjeteve lundruese brenda vitit kalendarik, pasi tarifave kanë afat kohor vlefshmërie një brenda vitit kalendarik, duke mos realizuar në këtë mënyrë të ardhurat.

- lidhja e kontratës së shërbimeve me Komandën e Forcës Detare po ashtu është lidhur jo në fillim viti (janar) por disa muaj me vonesë, duke mos respektuar nga FD planin e riparim dokimit të miratuar nga Shefi Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

- Koeficienti i miratuar nga Komisioni i Miratimit të Tarifave në asnjë rast nuk është i argumentuar.

- Në vitet 2016 e 2017 ky koeficient ka qenë 0.8 dhe më tej duke mbetur një koeficient i pandryshuar 0.95 nga viti 2018 -2024, i pargumentuar në asnjë rast.

- Ky koeficient nuk ka në përlllogaritje as ndikimin e pagës minimale sipas VKM-ve përkatëse të dala gjatë kësaj periudhe.

- Mungesa e një metodike të pranuar nga të dy palët në përcaktimin dhe ndarjen e saktë të shpenzimeve direkte dhe indirekte, ka sjellë që tarifave e cmimeve të propozuar nga KNRA të mos jenë të njëta me ato të miratuara dhe ka ndikuar ndjeshëm në gjendjen financiare të kësaj ndërrmarje.

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi: Komisioni i miratimit të tarifave sipas viteve object auditimi.

2.3 Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

-Zbatimi dhe respektimi i strukturës organike të miratuar, mbajtja e rregjistrimit themeltar për punonjësit dhe pasqyrimi i lëvizjeve. Zbatimi i kontratës kolektive dhe individuale të punës dhe procedurat e rekrutimit të personelit, dosjet e personelit etj.

-Përlllogaritja e pagës sipas të gjithë elementëve përbërës, dokumentacioni justifikues për pagat. Ndalesat mbi pagat dhe transferimi i tyre në llogari të degës së tatimeve.

-Rakordimi i pagave me listë pagesa, si dhe pasqyrimi në kontabilitet. Zbatimi i dispozitave ligjore për shpërblimet e dhëna gjatë vitit.

-Nga auditimi rezultoi se është respektuar struktura organizative e përcaktuar pasi nuk është tejkualuar numri i punonjësve të planifikuar sipas organigramës përkatëse. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se struktura për vitet respektive është propozuar nga këshilli drejtues dhe është miratuar nga Ministria e Mbrojtjes (MM), nga ku mbështetur në strukturën e planifikuar të dërguar nga MM rezultoi se është ruajtur struktura në total, madje struktura faktike është me mungesa përkundrejt strukturës së miratuar, kryesisht mungesat lidhen me pozicionet teknike si: tornitor, elektrikist anijesh, teknik riparues armësh, teknik motorist etj, e paraqitur si më poshtë :

Nr. Punonjësve	viti 2016		viti 2017		viti 2018		viti 2019		viti 2020		viti 2021		Viti 2022		Viti 2023	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
	45	43	45	42	55	42	55	39	55	43	55	43	55	34	55	34

Burimi i të dhënave KNRA, përunuar nga grupi auditimit

Pra referuar tabelës struktura faktike paraqitet me mungesë.

Nga intervistat e kryera me punonjësit e KNRA si dhe nga praktikatat e ndjekura nga Institucioni rezultoi se kryesisht mungesa në pozicionet teknike si tornitor, elektrikist anijesh, teknik riparues armësh, teknik motorist, etj vjen si shkak i mungesës së stafit të kualifikuar profesional për këto pozicione pune si dhe trajtimin financiar jo në nivelin e duhur pasi pagat e punonjësve nuk kanë ndryshuar që nga viti 2016 të miratuara sipas Urdhërit të MM, nr. 405, datë 02.03.2016, “Mbi miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e KNRA”, situatë e cila ka ndikuar drejtëpërdrejtë në mbarëvajtjen e punës dhe në uljen e performancës të KNRA. Ndërkohë që në lidhje me mungesën për pozicionet në administratë gjithashtu ka ndikuar paga e ulët, situatë e cila ka krijuar boshllëk në menaxhimin e brendshëm.

-Në lidhje me procedurat e rekrutimit referuar dhe mungesës së theksuar, vakancave të krijuara Institucioni për vendet bosh, bën shpalljen në Ëebpage/faqen zyrtare nga ku përcaktohet vetëm pozicioni i punës së kërkuar dhe kontakti nëpërmjet email dhe numrit të telefonit. Pas fazës së interesimit për pozicionin përkaktës, paraqitet kandidati, bëhet vleresimi i kandidatit sipas kriterit (arsimimi i cili duhet të përputhet me pozicionin e punës) për pozicionin përkatës. Me pas lidhet kontrata individuale e punës nga ku përshkruhen të drejtat dhe detyrimet e punëmarrësit dhe punëdhënësit mbështetur në Kodin e Punës. Gjithashtu rregullat dhe kriteret, të drejtat dhe detyrimet e punëmarrësit dhe punëdhënësit janë të përcaktuara në rregulloren e miratuar me vendimin nr. 7, datë 10.05.2016, të Këshillit Drejtues, rregullore e cila ka të përshkruar organizimin, funksionimin, detyrat, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, kompetencat e Këshillit Drejtues etj. Është përshkruar gjithashtu organigrama, numri i punonjësve i miratuar, përshkrimi i detyrave për punonjësit dhe strukturat drejtuese etj.

Kushtet, procedurat dhe format e pranimit, fillimit, mbarimit dhe çdo gjë që lidhet me marrëdhëniet e punës janë të përcaktuara në kontratën individuale dhe kontratën kolektive që lidhet midis punëmarrësve dhe punëmarrësit.

Pavarësisht sa u theksua më sipër, në lidhje me shpalljet, procedurat e rekrutimit sipas shpalljes në faqen zyrtare nuk ka informacion për kandidatët e interesuar në lidhje (përshkrimin e punës për pozicionin përkatës, kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët, faza e dokumentave, faza e verifikimit të dokumentave.)

Largimet nga puna me efekt financiar negativ;

Gjetjet e konstatuara,

KNRA pas krijimit është përballur me një mori procedurash për ekzekutim vullnetar të vendimeve gjyqësore të cilat e kanë detyruar Kantierin të paguaj ndaj ish-punonjësve shuma të konsiderueshme dhe me efekt financiar negativ të konsiderueshëm ndaj Institucionit. Krijimi i detyrimeve, ka ardhur si shkak i ndërprerjes së mardhënieve të punës për punonjësit e KNRA në kohën që KNRA ka qenë në varësi të plotë nga Komanda e Forcës Detare pasi u shkurtua i numri i punonjësve si shkak i largimit të Kompanisë Hollandeze “D. Sh.”, largimi i të cilës ndikoi në uljen e aktivitetit të Institucionit. KNRA u krijua në mes të një viti buxhetor dhe trashëgoi vlera monetare nga Komanda e Forcës Detare vetëm atë pjesë buxheti të mbetur (kryesisht fond pagash), pra likuiditete të pakta. Në momentin e ndërprerjes së mardhënieve të punës me punonjësit, KNRA funksiononte si Njësi Vartësie e Komandës së Forcës Detare, pra të gjitha këto detyrime kanë lindur në kohën që Kantieri ka qenë në varësi të plotë nga Komanda e Forcës Detare, e cila nënkupton që këto detyrime janë krijuar përpara krijimit të KNRA si Ndërmarrje Shtetërore. Këto detyrime të cilat janë përgjegjësi e Komandës së Forcës Detare lidhen me refuzimin e dhënies së pagës për shpërblim për vjetërsi në punë dhe shpërblim për ushqimin që konsumohet gjatë pushimit në Ndërmarrje, janë përcaktuar në Ligjin nr.7961, **neni 70** ku thotë: *Punëdhënësi vë në dispozicion të punëmarrësit lokal për ngrënien me kushte higjienike të pranueshme kur kjo justifikohet nga numri i punëmarrësve, largësia e vendit të punës dhe mënyra e organizimit të punës* si dhe **nenin 145** ku thotë: *Punëmarrësi përfiton shpërblim për vjetërsi, kur kontrata është zgjidhur nga punëdhënësi dhe marrëdhëniet e punës kanë zgjatur jo më pak se tre vjet. Shpërblimi për vjetërsi është të paktën sa paga e një 15-ditëshi, mbi çdo vit pune të plotë, që llogaritet në bazë të pagës që ekziston në përfundim të marrëdhënieve të punës. Kur paga është e ndryshueshme, shpërblimi llogaritet mbi mesataren e pagës të vitit paraardhës dhe indeksohet.* 3. *Shpërblimit për vjetërsi i shtohet shpërblimi që jepet në rastin e zgjidhjes së kontratës pa shkaqe të arsyeshme ose të zgjidhjes me efekt të menjëhershëm pa shkaqe të arsyeshme ;VKM nr. 139, datë 14. 03. 2007, VKM nr. 139, datë 14. 03. 2007, “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyre dhe që i shtohet pagës “për pushimet vjetore”.*

Sa më sipër punonjësit të cilëve iu është ndërprerë mardhënia e punës, i janë drejtuar KNRA për dhënien e pagës për shpërblim për vjetërsi në punë dhe dietën ushqimore të munguar, gjë të cilën Ndërmarrja e ka refuzuar pasi së pari e ka konsideruar që nuk janë detyrime që i përkasin Ndërmarrjes dhe së dyti vështirësia financiare në të cilën është ndodhur në momentin e krijimit, pra likuiditete të pakta. Refuzimi i dhënies së pagës ka bërë që punonjësit të drejtohen Gjykatës nga ku si rrjedhë e vendimit të Gjykatës në një rast për një ish-punonjës është shoqëruar me nxjerrjen e urdhërit për vënien e sekuestros konservative nga një zyrë përmbarimore mbi llogaritë e ndërmarrjes. Shuma apo vlera që Kantieri ka shlyer ndaj të gjithë ish-punonjësve është **19,839,570 lekë**. Pra detyrimet janë shlyer nga KNRA por që me vështirësi për shkak të likuiditeteve të pakta. Ministria e Mbrojtjes në momentin e krijimit të ndërmarrjes nuk kreu një analizë ekonomike duke qenë se Kantieri gjendej përballë një situatë të vështirë si shkak i rënies së aktivitetit dhe shkurtimit të numrit të punonjësve, pra vlerën monetare që do të trashëgonte Ndërmarrjes gjendur përballë likuiditeteve të pakta. Gjithashtu nuk u krye analizë në lidhje numrin e punonjësve, nevojës për ristrukturim, shkurtimin e numrit të punonjësve që do të ndodhte

aktivitet, përcaktimin e drejtë të të gjithë detyrimeve financiare pasi krijimit të Ndërmarrjes. Pra mos kryerja e veprimeve praktike nga MM ka detyruar KNRA të shlyej detyrimet e krijuara përpara krijimit të Insitucionit detyrime të cilat nuk i përkasin kësaj të fundit.

Gjithashtu 23 punonjës kanë ngritur kërkesë padi me objekt “Pavlefshmëri e akteve administrative për mosrespektim afatit njoftimit për ndërprerjen e marrdhënieve të punës” drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së parë, nga ku është kërkuar dëmshpërblim mbështetur në Nenet 32, 153 të Kodit të Procedurës Civile, nenet 7, 143, 145, 146, 148, 159 të Kodit të Punës pasi kanë qenë në marrëdhënie pune Repartin Ushtarak 6022 Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve Pashaliman në disa vite duke konsideruar se kjo e fundit në mënyrë arbitrare dhe të njëanshme pa bërë më parë njoftimin ka shkëputur marrdhëniet e punës për efekt të reformës duke ju zgjidhur Kontrata e punës në mënyrë të njëanshme pa shkaqe të arsyeshme dhe pa u ndërmarr procedurat e parashikuara në nenet 143/1, 148 të Kodit të Punës, bazuar në nenin 143/1.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 420, datë 27.03.2017, vendosi rrëzimin e kërkesë padisë pune të pandërprerë dhe prej datës 01.04.2015 deri në datën 31.12.2015 të gjithë paditësit kanë lidhur kontratë punë me afat me palën e paditur. Gjykata çmon se nga provat e administruara në gjykim, rezulton se paditësit ka qenë në marrëdhënie punë me afat 9 muaj pasi për shkak të shkurtimit të vendeve të punës, për të cilën edhe vetë punonjësit ku midis tyre edhe paditësit janë njoftuar për këtë zgjidhje të kontratës së punës dhe për punonjësit janë lidhur kontrata 9 mujore dhe pala paditëse si punëmarrës me vullnetin e lirë dhe të pavesuar kanë lidhur kontratat individuale të punës me afat 9 muaj , nga data 01.04.2015 deri ne 31.12.2015. Pra Gjykata ka vendosur të rrëzojë kërkesën padinë.

Kundër këtij vendimi pala paditëse e ankimoi në Gjykatën Administrative të Apelit, nga ku kërkoi ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë.

Gjykata Administrative e Apelit rrëzoi vendimin e Gjykatës Administrative pasi gjykoi që Gjykata e Shkallës së Parë nuk ka bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët. Gjykata Adminisistraitve e Apelit ka vlerësuar se vendimi nr. 420, datë, datë 27.03.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë duhet të ndryshohet duke vendosur pranimin e kërkesë padisë si të bazuar në ligj dhe prova.

Konkluzion: Ndërprerja e padrejtë e marrdhënieve të punës me 23 ish punonjësit pa respektuar asnjë procedurë, e diktuar dhe nga vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit nr. 1062 datë 18.06.2024, ka ndikuar në krijimin e detyrimeve me efekt financiar negativ në vlerën 11,558,727 lekë.

Dosjet e personelit;

Në lidhje me dosjet e personelit, u audituan, me zgjedhje 15 dosje, ku nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk u konstatua mangësi në dokumentacion duke respektuar të gjitha kriteret e përcaktuara. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjet e personelit të KNRA, konstatohet se, nuk ka mangësi përsa i përket kriterëve të detyrueshme sic janë diploma, certifikata notave, CV.

Përlllogaritja e pagës sipas të gjithë elementëve përbërës, dokumentacioni justifikues për pagat. Ndalesat mbi pagat dhe transferimi i tyre në llogari të degës së tatimeve. Rakordimi i pagave me

listë pagesa, si dhe pasqyrimi në kontabilitet. Zbatimi i dispozitave ligjore për shpërblimet e dhëna gjatë vitit;

Gjetjet e konstatuara,

Mos miratim i nivelit të pagave si dhe mos trajtim financiar ndaj punonjësve të KNRA sipas VKM-së në fuqi nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes. Këshilli Drejtues i KNRA-së me vendim nr.6, datë 01.02.2016, ka propozuar për miratim pagat e punonjësve në Ministri të Mbrojtjes në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, shkronja a, të pikës 1, nenit nr 6, të ligjit nr.10405, datë 24.03.2011 “*Për kompetencat e përcaktimit të pagave dhe shpërblimeve*”. Referuar pikë 11, të VKM Nr. 397, datë 11.05.2015 për krijimin e Ndërmarrjes Shtetërore “*Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve*” ku citohet : *Pagat e punonjësve të KNRA-së miratohen në përputhje me legjislacionin në fuqi*”, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 405 datë 02.03.2016 “*Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të ndërmarrjes shtetërore*” dhe në zbatim të VKM-së nr. 717, datë 23.06.2009, “*Për pagat e punonjësve*” është bërë i mundur miratimi dhe trajtimi i nivelit të pagave për punonjësit e KNRA. Për vitet 2017 dhe në vazhdim dhe pse me ndryshimin e VKM-së, pra hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 187, datë 08.03.2017, trajtimi financiar nuk ka ndryshuar por është vazhduar me trajtimin financiar sipas VKM-në nr. 717, datë 23.06.2009, pasi nuk ka pasur miratim nga Ministria e Mbrojtjes mbi ndryshimin e kategorisë së pagave. ***-Pra trajtimi financiar për punonjësit, miratimi i nivelit të pagave nuk është bërë sipas VKM-së në fuqi por është vazhduar me VKM-në e vjetër.*** KNRA. Këshilli drejtues, referuar VKM-së nr. 113, datë 01.03.2023 “*Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi*” si dhe VKM-së Nr. 325, datë 31.05.2023, “*Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të Zëvendësministrit, Funkionarëve të Kabineteve, Prefektit, Nënprefektit, Nënpunësve Civile dhe Nënpunësve në disa Institucione të Administratës Publike*”, me vendimin nr. 5, datë 26.06.2023, vendosi të propozojë ndryshimin e nivelit të pagave për personelin e KNRA-së, kjo bazuar në VKM-në e sipërcituar si dhe në nevojën dhe domosdoshmërinë për shkak të rritjes së inflacionit dhe çmimeve të shportës së përditshme. Administrata e KNRA-së me shkresë nr. 350, datë 27.06.2023 “*Propozim për ndryshim të nivelit të pagave për KNRA*”, në përputhje me nenin 10 të Ligjit nr. 35/2023, “*Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimet të të punuarve në Institucionet e Administratës Publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi*” nga ku citohet : *organet kolegjiale miratojnë nivelin e pagave pas marrjes së miratimit nga Ministria Përgjegjëse, ka paraqitur për miratim në Ministrinë e Mbrojtjes propozimin për rritjen e nivelit të pagave për personelin teknik dhe nënpunës të KNRA-së. Ky propozim për ndryshimin e nivelit të pagave për shkak të nevojës për ndryshim si rrjedhojë e inflacionit aktual, i referohet edhe VKM-së Nr. 325, datë 31.05.2023, pika 6, shkronja b) ku citohet: b) institucionet e administratës publike, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, të propozojnë deri në datën 30 qershor 2023, sipas legjislacionit në fuqi, ndryshimet në strukturat dhe organikat ekzistuese për përshtatjen e tyre sipas klasave të pagave të përcaktuara në këtë vendim; **Ministria e Mbrojtjes në asnjë rast nuk i ka kthyer përgjigje KNRA për miratimin e nivelit të pagave sipas VKM-së në fuqi, pra dhe miratimin e nivelit të pagave sipas legjislacionit në fuqi.***

Me shkresë nr. 107, datë 14.02.2024, “*Informacion mbi nivelin e pagave të personelit të KNRA-së*”, Administrata i është ri-drejtuar përsëri Ministrit të Mbrojtjes për miratimin e nivelit të pagave të tyre. Aktualisht nuk ka asnjë përgjigje zyrtare për miratim ose mosmiratim të pagave të cilat janë propozuar nga Administrata e KNRA-së. Vlen të theksohet se që prej vitit 2015 dhe deri më sot, administrata e KNRA-së nuk ka aplikuar rritje page edhe pse inflacioni dhe çmimet e

shportës kanë qenë në rritje çdo vit. Paga e punonjësve të reparteve kryesor dhe ndihmës variojnë si me poshtë: paga minimale (paga bazë- 33,160 lekë dhe shtesat kushte të vështira në punë) është 45,000 lekë neto. Paga maksimale (paga bazë dhe shtesat) është 76. 000 lekë për punonjësit në pozicione të larta. Paga mujore aktuale e Drejtorit të Kantierit të Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve (KNRA) është 108 780 lekë bruto, përcaktuar me VKM-në Nr. 397, datë 11.05.2015 “Për Krijimin e Kantierit të Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve”. Pra përcaktimi i pagave sipas kategorive duhet ti referohet VKM-së nr. 325 datë 31.05.2023.

Veprime e kryera janë në mospërputhje me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave”, neni **6 (Ligj i shfuqizuar)**; Ligji nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimet të të punësuarve në Institucionet e Administratës Publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi” neni **10**; V. K. M nr. 187, datë 08. 03. 2017; V. K. M nr. 717, datë 23.06.2009; VKM nr. 113, datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” si dhe VKM- Nr.325, datë 31.05.2023, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të Zëvendësministrit, Funkionarëve të Kabineteve, Prefektit, Nënprefektit, Nënpunësve Civile dhe Nënpunësve në disa Institucione të Administratës Publike”

Mos veprimet e Ministrisë së Mbrojtjes si shkak i mos miratimit të nivelit të pagave sipas VKM-së në fuqi kanë sjellë largimin e punonjësve për shkak të trajtimit financiar jo në nivelin e duhur dhe si shkak dhe i rritjes së inflacionit.

Mos miratim i Ministrisë së Mbrojtjes të nivelit të pagave sipas VKM-së në fuqi, “Për miratimin e pagave” e cila ka detyruar KNRA të vazhoje me trajtimin financiar ndaj punonjësve me të njëjtën pagë të pandryshuar që nga viti i krijimit.

Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Buxhetit në mënyrë të menjëhershme të shqyrtoj propozomin e KNRA-së për trajtimin financiar të punonjësve, sipas klasifikimit të nivelit të pagave në përputhje me VKM-në në fuqi, nga ku referuar VKM-së, ndaj punonjësve të KNRA-së të aplikohet rritja e pagës si domosdoshmëri për shkak të trajtimit financiar jo në nivelin e duhur dhe jo në përputhje me VKM-në duke qenë se nuk është aplikuar rritja e saj që nga viti 2016, situata e cila cënon ndjeshëm aktivitetin e Institucionit si shkak i largimeve nga puna të punonjësve.

Auditim i ushtruar në listëpagesat e punonjësve për të gjithë periudhën e kontrollit me përzgjedhje sipas muajve si më poshtë :

- Për vitin 2017: muaji janar, mars, maj.
- Për vitin 2018: muaji shkurt, prill, korrik.
- Për vitin 2019: muaji maj, gusht, tetor.
- Për vitin 2020: muaji qershor, shtator, tetor.
- Për vitin 2021: muaji janar, shkurt, nëntor.
- Për vitn 2022: muaji prill, maj, nëntor
- Për vitin 2023: muaji maj, shtator, nëntor.

Në lidhje me auditimin e listëpagesave u konstatua se në përllogaritjen e pagave nuk janë respektuar dispozitat ligjore në fuqi si shkak i mos aplikimit të Vkm-së për pagat të ndryshuar pasi nuk ka miratim nga Ministria e Mbrojtjes. U verifikuan listë pagesa dhe borderotë, me të gjithë dokumentacionin bashkangjitur justifikues si listë prezencat, elementët e pagës për çdo person për të gjithë periudhën e kontrollit, nga ku rezultoi se cdo element është përllogaritur sipas VKM-në Nr 717 datë 23.06.2009, “Për pagat e punonjësve mbështetës të Institucioneve Buxhetore dhe Nënpunësve”, Ligjin Nr 7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore”, i ndryshuar; Ligji Nr. 8438 datë 28.12.1998” Për tatimin mbi të ardhurat”, Nga kontrolli i

dokumentacionit rezultoi se në përgjithësi të gjithë elementët e pagës ishin përlllogaritur saktë, klasifikimi i klasave për punonjësist mbështetës ishin të sakta konform akteve ligjore në fuqi. U morën me përzgjedhje disa libreza pune për efekt të llogaritjes së elementit të pagesës “ *vjetërsisë në punë*” dhe rezultuan se ato ishin përlllogaritur saktë, në përputhje me borderotë dhe pagesat. Nga kontrolli i ushtruar për dokumentacionin justifikues u konstatua se listë pagesat për cdo muaj janë të shoqëruara me gjithë dokumentacionin justifikues konform akteve ligjore në fuqi si listë prezenca sipas sektorëve, procesverbale për mbajtjen e kohë shënuesve, listë pagesë sipas formatit e-sig 25-a etj. Në dokumentacionin justifikues janë bashkëlidhur urdhërat për emërimë dhe lëvizje të personelit të konfirmuara nga titullari i Institucionit. Listëpagesat janë firmosur nga specialistët e pagave dhe përmbledhësja është firmosur nga Përgjegjësi i sektorit ekonomik, Përgjegjësi i administratës dhe Drejtori. Gjithashtu janë të evidentuara urdhërat për kryerjen e lejeve të zakonshme, si dhe raportet për paafësi të përkohshme dhe leje lindje. Mbi bazën e këtyre dokumentave janë përgatitur listë pagesat, janë xhiruar në llogaritë individuale të punonjësve pagat respektive duke bërë dhe ndalesat përkatëse. Nga kontrolli i dokumentacionit u konstatua se ndalesat për efekt të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për llogari të degës së Tatimeve, janë pasqyruar saktë, deklaruar dhe paguar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu ndalesat për sigurime e tatime rakordojnë me ato të deklaruara dhe kaluara në bankë. Nga kontrolli i dokumentacionit rezultoi se pagat janë kontabilizuar në librat e pagave dhe në libër të madh, u bë kryqëzimi i të dhënave që gjenden në listë pagesë dhe Urdhër transfertë për efekt pagese të pagës neto dhe rezultuan të kuadruara. Pagat e muajit të marra në kontroll me përzgjedhje rakordojnë me listëpagesat dhe me shumat neto të kaluara në bankë.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të P/Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresën me nr. 495/1 prot, datë 26.08.2024, protokolluar në KLSH me nr. 347/6 prot, datë 28.08. 024 “Komente mbi projektraportin e auditimit”, nga ana e përfaqësuesve të institucionit, të cilat janë të paraqitura më poshtë, pa ndërhyrje dhe rregullime nga ana drejtshkrimore:

2.4 Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, etj.).

u shqyrtua dokumentacioni sa më poshtë vijon:

- Dokumentacioni i pagesave të bankës.
- Ditarët dhe llogaritë përkatëse.
- Dokumentacioni për marrjen në dorëzim të furnizimeve.
- Dokumentacioni justifikues për pagesat e kryera, etj.
- Shpenzimet e karburantit dhe dietat.
- Procedurat e auditimit për blerje të vogla.

Nga auditimi me zgjedhje në lidhje me bankën, bazuar në vlerësimin e riskut u auditua periudha si më poshtë.

- Për vitin 2016: muaji qershor, shtator, tetor, nëntor.
- Për vitin 2017: muaji shkurt, mars, tetor, nëntor.
- Për vitin 2018: muaji qershor, shtator, tetor, nëntor.
- Për vitin 2019: muaji janar, prill, korrik, dhjetor.
- Për vitin 2020 muaji qershor, shtator, tetor, nëntor.
- Për vitin 2021: muaji shkurt, maj, gusht, tetor.
- Për vitin 2022: muaji janar, shkurt, nëntor, dhjetor.

- Për vitin 2023: muaji maj, shtator, nëntor.

Nga auditimi i veprimeve të kryera me bankë rezultoi se rregullshmëria e plotësimit dhe përpunimit të dokumentacionit të bankës, përgjithësisht është mbështetur në dokumentat justifikuese si fatura, situacione përmbledhëse, listë pagesave etj.

Përpilimi i urdhër transfertave është i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si: urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër transfertë, përputhen me vlerat e dokumenteve financiare që mbështesin shpenzimin. Nga verifikimi i shumave të urdhër transfertave, për periudhën 12-mujore, për vitet periudhë auditimi, rezultoi se totali është i barabartë me shumën totale të shpenzimeve të akt rakordimit përfundimtar të shpenzimeve sipas ekstraktit të bankës. Të ardhurat dhe shpenzimet i përkasin periudhës raportuese, të rakorduar këto me bankën. Llogaria e disponibiliteteve është e barabartë me rezultatin e ushtrimit e rakorduar me bankën. Dokumentacioni bazë që pasqyron veprimet e kryera me bankë e magazinë është pasqyruar në ditarët përkatës.

Në pagesat me bankë për periudhën e audituar rregjistrimi i veprimeve kontabile në ditar është kryer në mënyrë kronologjike dhe konformë planit kontabël. Dokumentacioni është i sistemuar dhe i rregjistruar në ditarin përkatës të bankës dhe shuma e veprimeve të kryera përputhet me ekstratin vjetor të lëshuar nga banka, të cilat, në të gjitha rastet kuadrojnë me ditarin e shpenzimeve të konfirmuara

Shumat e shpenzuara për periudhat objekt auditimi rezultoi se të ardhurat dhe shpenzimet i përkasin periudhës raportuese.

Nga auditimi i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës në lidhje me shpenzimet rezultoi:

Vonesa në likuidim ndaj subjekteve privatë (kontraktorëve).

Në disa raste raste ka pasur vonesa në likuidim në shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve (subjekteve privatë), kontrata furnitorësh me afat pagesë të përcaktuar 30 ditë nga hartimi i faturës përfundimtare. Pra mbështetur në dokumentacionin justifikues si (urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit) likuidimi ndaj tyre është kryer me kohë vonesë. Veprimet e kryera kanë ardhur si shkak i vështirësisë financiare në të cilët ndodhet KNRA, pasi dhe burimin e vetëm të të ardhurave e siguron nëpërmjet aktivitetit që kryen nga ku si objekt kryesor ka riparimin dhe mbajtjen në gatishmëri të mjeteve lundruese të forcave ushtarake FA si dhe shërbime me të tretë subjekte private kundrejt tarifave të miratuara. Aktiviteti i KNRA i ardhur në ulje është shoqëruar me mungesë likuiditetesh.

- **Shpenzimet për udhëtime, dieta dhe shpenzimet e karburantit.**

Shpenzimet për udhëtime e dieta dhe shpenzimet e karburantit për periudhën e auditimi paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

lekë

Vitet	Shpenzime Dieta		% realizimit	Shpenzime karburant		% e realizimit
	Plan	Realizim		Plan	Realizim	
2017	200,000	135,500	67,75	3,145,000	2,596,096	82,55
2018	200,000	199,000	99,50	3,458,400	2,326,080	67,26
2019	180,000	137,500	76,39	3,920,400	3,665,165	93,49
2020	180,000	118,000	65,56	3,933,500	2,510,273	63,82
2021	180,000	89,000	49,44	2,440,260	2,337,728	95,80

2022	180,000	112,500	62,50	2,639,600	2,160,059	81,83
2023	180,000	170,000	94,44	3,231,600	3,001,654	92,88
Totali	1,300,000	961,500	73.9%	22,768,760	18,597,055	81.6%

Burimi i të dhënave: KNRA

Referuar tabelës së mësipërme, konstatohet se, shpenzimet e kaburantit dhe shpenzimet për udhëtime e dieta paraqiten me realizim mbi **70%**, pra të mirë menaxhuara për periudhën e audituar.

Shpenzime karburanti.

Shpenzimet e karburantit janë kryesisht për mjetet lëvizëse për transportin e punonjësve të KNRA, mjetet e transportit për mallrat si dhe mjetet e punës si (*vinc, vinc pirun, motogjenerator*), këto të fundit të cilat i shërbejnë Kantierit për kryerjen e punës në shkallë. Vlen të theksohet se mjete lëvizëse për transportin e punonjësve me të dhëna teknike: (*Autobus tip Benz 303, prodhim i vitit 1985, me targa MM435MM*) është në gjendje jo të mirë teknike me konsum 38L/km, nga ku në shpenzimet e karburantit zë 50% të sasisë totale. Theksojmë se nga nga ana e Kantierit nuk është kryer analizë në lidhje me nxjerrjen jashtë përdorimit të mjetit dhe pajisjen me mjet transporti të ri me parametrat dhe kushtet e duhura. Nuk janë kryer veprime praktike në lidhje me procedurën që duhet të ndiqet në lidhje me nxjerrjen jashtë përdorimit të automjetit dhe pajisjen me mjet të ri transporti për shkak të kostos së madhe të konsumit të karburantit.

Normativat e konsumit/harxhimit janë të mbështetura në analizën e kostos të kryer nga komisioni i ngritur me urdhërin e titullarit për vitet respektive nga ku për sasinë e nevojshme për tu furnizuar me karburant për mjetet e transportit dhe motogjeneratorët, komisioni sasinë e përlllogaritur e ka kryer duke u mbështetur në (numrin e mjeteve që disponon, të dhënat teknike të mjeteve, dhe konsumin ditor të karburantit të testuar me grup pune pasi për shkak të vjetërsisë së mjeteve nuk disponohen katalogje apo normativa.) Ndërkohë që në lidhje me përlllogaritjen e vlerës komisioni është mbështetur (*Cmimin sipas Buletinit të APP për naftën D1:767S/Ton*(kursi i këmbimit lekë/\$, datë 06.04.2023=79,484.21 lekë/ton, taksën doganore sipas të gjithë komponentëve të përfshirë si akciza, taksë karboni, taksë qarkullimi etj).*

-Në lidhje me normativat e harxhimit për mjetin e sipërcituar që përdoret për transportin e punonjësve të KNRA, përcaktimi prej 38L/100 Km është i mbështetur sipas një testimi të kryer nga grupi punës përpara krijimit të ndërmarrjes ndërkohë që ky mjet tashmë është tërësisht i amortizuar. Nga ana Titullarit të KNRA duke qenë se matja e konsumit nuk është kryer që me krijimin e ndërmarrjes shtetërore në vitin 2015 i lind e drejta që të kryejë një përlllogaritje të re mbi konsumin e karburantit për të gjithë automjetet e transportit sipas një komisioni të ngritur prej 5 antarësh duke e matur për 100 km të përshkruara.

- **Shpenzime udhëtimi e dieta brenda dhe jashtë vendit.**

Shpenzimet e udhëtimit dhe dietat janë kryer bazuar në ligjin nr. 7582, datë 13.07.1992, “Për ndërmarrjet shtetërore”, VKM, nr. 997, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”, nga ku kanë të bashkangjitur dokumentacionin justifikues si, (*destinacionin, shkakun e udhëtimit, aprovimin e Titullarit, urdhër shërbimit etj*). Për shpenzimet e dietave dhe udhëtimit për punonjësit që shkojnë me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit janë përcaktuar kriteret e përfitimit të dietave për qëllime shërbimi si edhe masa e përfitimit prej 5,500 lekë/ditë dhe 1,200 lekë/ditë, për shërbimet me largësi mbi 50 km Në lidhje me lëvizjet e kryera rezulton se kryesisht destinacioni apo qëllimi i udhëtimit lidhet me takime në (*Ministri të Mbrojtjes në Tiranë, Laboratorin Qëndrot të Forcave të Armatosura, Komandën e Forcës Detare në Durrës, Shoqatën e Peshkatarëve etj*). Nga auditimi i shpenzimeve të udhëtimit, u konstatua se urdhër shërbimet janë plotësuar korrekt

referuar dokumentacionit justifikues bashkëlidhur. Nga auditimi i shpenzimeve për dietat rezultoi se nuk ka pasur trajtim financiar për punonjësit të cilët janë dërguar jashtë vendit.

-Analiza dhe vlerësimi zbatimit të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël viti 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022, 2023.

Auditimi i dokumentacionit në lidhje zbatimin e kërkesave, kriterëve të përcaktuara në V. K. M nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; e ndryshuar me V. K. M nr. 285, datë 19.05.2021, neni 56 (Procedura me vlerë të vogël) si dhe Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018; i ndryshuar, “Mbi zhvillimin e procedurave me vlerë të vogël”

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH, Nr. 1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me objektin e këtij akti konstatimi. Kantieri i ndërtimit dhe riparimit të anijeve (KNRA), për vitet periudhë auditimit, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022, 2023 ka realizuar 46 procedura me vlerë të vogël, në shumën 18,566,239 lekë, për blerjen e artikujve dhe shërbimeve si dhe të grup artikujve dhe grup-shërbimeve Nga auditimi për blerjet me vlera të vogla, sipas viteve objekt auditimi, rezultoi se janë zhvilluar sa vijon:

Vitet	Blerje të vogla		Seleksionuar për tu audituar bazuar në riskun e auditimit		
	Numër	Fond limit	numër	vlerë fond limit	në % ndaj totalit/vlerë
2017	6	2,920,000	3	1,218,240	41.7%
2018	12	3,476,855	6	1,947,855	56%
2019	11	3,920,477	6	3,400,897	86.7%
2020	7	2,516,380	4	1,784,800	70.9%
2021	4	984,900	2	400,000	40.6 %
2022	3	784,000	2	584,000	74.4%
2023	3	1,064,000	3	1,064,000	100%
Totali	46	15,666,882	26	10,399,792	66.3%

Tabela e procedurave të prokurimit me blerje me vlerë të vogël të audituara

Objekti/nr	Urdhër Prokurimi	OE fitues	Renditja	Vlera fituar e	Urdhër transferta	Fatura tatimore/vlere	Akt-marrja dorëzim	në
1. Blerje gazra teknike	Nr. 88prot, datë 13.02.2023	G. shpk	3	575,500 lekë	Pjesor, datë 28.02.2023	Nr1344/2023, datë 28.12.2022	01.03.2023	
2. Shërbime telefonike dhe internet	Nr. 542 prot, datë 16.10.2023	N. shpk	2	179,999 lekë	08.11.2023	Nr. 3956/2023, datë 29.09.2023	Nuk realizohet me akt-marrje në dorëzim	
3. Siguracion automjetesh	Nr. 550 prot, datë 18.11.2023	E.	1	198,300 lekë	15.11.2023	Nr. 183902/2023, datë 25.10.2023	Nuk realizohet me akt-marrje në dorëzim	
1. Shërbime Telefonike, Televizioni & internet	Nr. 254prot, datë 07.10.2022	N.	1	179,520 lekë	Pjesore, datë 10.11.2023 cdo muaj në shumën 14,985 lekë	Nr. 108929/2022 datë 29.09.2022	Nuk realizohet me akt-marrje në dorëzim	
2. Shtypshkrime Kancelari	Nr. 270prot, datë 01.11.2022	A-S	3	120,000 lekë	15. 12. 2022	Nr. 11/2022 datë 21.11.2022	21.11.2022	
1. Shpenzime për mirëmbajtje makineri dhe pajisje	Nr. 156 prot, datë 23.07.2021	I F. SHPK	1	98,800 lekë	09.09. 2021	Nr. 892/2021 datë 01.09.2021	Proces verbal kontrolli	
2. Siguracion automjetesh	Nr. 238prot, datë 28.10.2021	E.	1	155,000 lekë	29.10.2021	4762/2021 datë 22.10.2021	Nuk realizohet me akt-marrje në dorëzim	
1. Blerje materiale lende e zeze	Nr. 223prot, datë 18.08.2020	V. A.	4	785,000 lekë	28.08. 2020	35 datë 26.08 2020	26.08.2020	

2.Shpenzime per mirembajtje makineri dhe pajisje	Nr. 39prot, datë 09.03.2020	E. P.	2	88,888 lekë	03.06. 2020	37 datë 21.05.2020	21.05.2020
3.Shpenzime telefonike ,Televizion dhe Internet	Nr. 196 prot, datë 30.07.2020	N.	1	189,900 lekë	18.08. 2020	3780 datë 13.08.2020	Nuk realizohet me akt-marrje në dorëzim
4.Shtyp shkrime dhe Kancelari	Nr. 195 prot, datë 30.07.2020	D. Z.	1	97,690 lekë	18. 08. 2020	921 datë 11.08.2020	11.08.2020
1. Blerje mareriale pjese kembimi per automjete	Nr. 208 prot, datë 23.10.2019	S.	1	499,800 lekë	12.11.2019	39 datë 07.11.2019	07.11.2019
2.Blerje pjese kembimi per vagona të shkalles	Nr. 256prot, datë 19.12.2019	S.	2	729,000 lekë	30.12.2019	45 datë 27.12.2019	27.12.2019
3.Blerje Veshmbathje per pune	Nr. 256prot, datë 19.12.2019	V. A.	3	689,000 lekë	20.01. 2020	42 datë 08.01.2020	08.01.2020
4.Pajisje zyre (Inventar ekonomik	Nr. 19prot, datë 25.02.2019	S.		689,000 lekë	13.03. 2019	01 datë 05.03.2019	05.03.2019
5. Shpenzime per mirembajtje makineri pajisje	Nr. 18prot, datë 25.02.2019	E. P.	3	79,998 lekë	21.03. 2019	96 datë 08.03.2019	Proces verbal kontrolli
6.Shtypshkrime dhe Kancelari	Nr. 39 prot, datë 08.03.2019	M. B.	7	309,700 lekë	08.05. 2019	452 datë 09.04.2019	24.04.2019
1.Mirembajtje terreni (lulishte, gjelberim dhe sistemim)	Nr. 245 prot, datë 26.12.2018	S.	1	679,300 lekë	04.01. 2019	29 datë 31.12.2018	31.12.2018
2. Blerje pjese kembimi per automjete	Nr. 145 prot, datë 20.07.2018	S.	2	68,900 lekë	27.07. 2018	5 datë 27.02.2018	27.07.2018
2.Blerje pjese kembimi per automjete	Nr. 118prot, datë 29.06.2018	S.	1	63,480 lekë	06.07. 2018	2 datë 05.07.2018	04.07.2018
3. Marje me qera makineri per pastrim me skorje	Nr. 201prot, datë 08.10.2018	S.	1	140,000 lekë	31.10. 2018	11 datë 11.10.2018	11.10.2018
4. Blerje karrukulle dhe suporte metalike per shllan	Nr. 186 prot, datë 26.09.2018	S.	2	476,300 lekë	03.10. 2018	9 datë 03.10.2018	03.10.2018
5.Blerje pajisje informatike	Nr. 26 prot, datë 21.02.2018	T.i Vi.	7	448,900 lekë	19.03.2018	1515 datë 07.03.2018	08.03.2018
1. Rikonstruksion i transportierit ekzistues të shkallës dhe linjës së shinavem	Nr. 234 prot, datë 18.12.2017	S.	3	679,930 lekë	29.12.2017	313 datë 28.12.2017	28.12.2017
2. Blerje materiale për riparim anije	Nr. 138 prot, datë 12.09.2017	S.	2	370,240 lekë	19.09.2017	6 datë 15.09.2017	15.09.2017
2. Blerje materiale për riparim anije	Nr. 59prot, datë 11.05.2017	U. C.	2	548,000 lekë	19.05.2017	1168 datë 18.05.2017	18.05.2017
3.Siguracion makinash	Nr. 177prot, datë 17.10.2017	A.	1	158,000 lekë	27.10.2017	66 datë 20.10.2017	Nuk realizohet me akt-marrje në dorëzim

Baza e të dhënave KNRA, përpunuar nga grupi auditimit

Nga auditimi i rezultoi se:

- Në të gjitha rastet AK ka bërë përlllogaritjen e fondit limit, duke u bazuar në ofertat e marra në treg dhe të pasqyruara dokumentin e hartuar për llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike.

- Miratimi i kërkesës për prokurim në të gjitha rastet janë miratuar nga Nëpunësi i Autorizuar i AK.
- Shpallja elektronike në sistem e procedurës, është realizuar në kohën e përcaktuar sipas dispozitave ligjore në fuqi. Anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël në të gjitha rastet, pasi kanë krijuar në sistem dosjen e tenderit, u janë drejtuar nëpërmjet ftesës për ofertë (sipas formularit nr. 3), 5 (pesë) operatorëve ekonomikë për një periudhë 1-2 ditë nga nxjerrja e urdhrin të prokurimit.
- Në të gjitha rastet është zbatuar kriteri i çmimit më të ulët për klasifikimin përfundimtar.
- Në të gjitha rastet nga anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, është mbajtur procesverbal për shpalljen e OE fitues, mbi bazën e ofertës më të ulët të shpallur nga sistemi. (Në të gjitha rastet ishin printuar ofertat e gjeneruara nga sistemi).
- Në të gjitha rastet OE fitues është njoftuar nëpërmjet sistemit elektronik.
- Procesverbalet e mbajtura nga komisioni për kalimin tek operatori i radhës kanë qenë të firmosura nga komisioni.
- Në dosjen e prokurimeve me vlera të vogla ndodheshin Faturat Tatimore Shitje, të njëjta me vlerën e ofertuar si dhe me urdher shpenzimet përkatëse.
- Për gjithë periudhën objekt auditimi për procedurat me blerje të vogla, është bërë inventarizimi i dosjeve dhe arkivimi, sipas Udhëzimit nr. 3 datë 08.01.2018, *“Për zhvillimin e Prokurimeve me vlerë të vogël”* në sistem të prokurimit elektronik për autoritetin kontraktor dhe operatorët ekonomik *“ku thuhet shprehimisht që “Autoriteti kontraktor duhet të bëjë arkivimi e procedurës së prokurimit brenda 1ditë punë nga mbyllja e fazës së njoftimit fitues”*, pasi faza arkivimit të kontratës është e papërfunduar.
- Për të gjitha rastet e blerjeve si për shërbimet dhe mallrat është kryer procesi i marrjes në dorëzim të mallit dhe shërbimit nga komisioni i ngritur për çdo rast nga Nëpunësi Autorizues.

Konkluzion: Nga auditimi i pagesave për blerje me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël rezultoi se procedurat në përgjithësi ishin të plotësuara dhe dokumentacioni bashkëlidhur bankës përbën gjurmën e auditimit të këtyre procedurave në të gjitha fazat dhe hapat e kryera për realizimin e këtyre procedurave deri në momentin e kontabilizimit të tyre në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për rregullat e prokurimit publik”*; e ndryshuar me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, Udhëzimin i APP nr. 3, datë 08.01.2018; *“Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”*, i ndryshuar pika 2 dhe me UMF nr. 57 datë 12.06 2014 *“Për Gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”*.

2.5. Organizimi dhe mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e pasqyrave financiare nga organet drejtuese të KNRA, si dhe dërgimi e miratimi i tij në institucionet eprore.

Analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj. , ndaj buxhetit të shtetit.

Inventarizimi fizik i pasurisë, zbatimi i afateve, cilësia e inventarizimeve, si dhe mbyllja e sistemimi i rezultateve në pasqyrat financiare vjetore.

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 347/2 prot., datë 28.03.2024, pika 5 *“Organizimi dhe mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e pasqyrave financiare nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi e miratimi i tij në institucionet eprore”*.

“Analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit”.

Inventarizimi fizik i pasurisë, zbatimi i afateve, cilësia e inventarizimeve, si dhe mbyllja e sistemimi i rezultateve në pasqyrat financiare vjetore, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
Dokumentacioni i pasqyrave financiare.

Dokumentacioni i regjistrimit të llogarive kontabël.

Dokumentacioni mbi hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare.

Dokumentacioni i mbajtur mbi përlllogaritjen, njohjen, pagesën dhe regjistrimin e detyrimeve fiskale.

Dokumentacioni i mbajtur mbi debitorët dhe kreditorët.

Dokumentacioni për menaxhimin e aktiveve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet që:

Me vendimin Nr. 397, datë 11.05.2015, me propozim të ministrit të mbrojtjes, Këshilli i Ministrave vendosi: Krijimin e ndërmarrjes shtetërore “Kantieri i ndërtimit dhe riparimit të anijeve”, në vijim KNRA, në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, me qendër në Pashaliman, Vlorë, me objekt të veprimtarisë ndërtimi dhe riparimi i mjeteve lundruese ushtarake dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura, të mjeteve lundruese civile, të tilla si anije, skafe, motovedeta, gomone etj, si dhe kryerja e punimeve dhe shërbimeve për të tretë, në përputhje me kapacitetet teknike të ndërmarrjes.

Territori, inventari dhe çështje të tjera të pronësisë janë përcaktuar sipas vendimit, raportit të ekspertit kontabël dhe vlerësimit të pasurive të paluajtshme.

Shuma e kapitalit themeltar është 2,446,392,291 lekë.

Shuma prej 97,874,561 (nëntëdhjetë e shtatë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një) lekësh transferohet nga Komanda e Forcës Detare Durrës në favor të ndërmarrjes shtetërore “Kantieri i ndërtimit dhe riparimit të anijeve”, si shtesë në kapitalin themeltar, sipas aneksit bashkëlidhur këtij vendimi.

	Ministria linjës	Kodi institucionit	Kapitulli	Emërtimi i institucionit	Programi	Llogaria ekonomike	Kodi i degës së thesarit	Pakësohet	Shtohet
				Forcat e luftimit	02120			97,874,561	
001	17	1017009	01	Reparti ushtarak 2001-Durrës				97,874,561	
001	17	1017031	01	Rep. Usht. nr. 2001-KF Detare Durrës	02120	600	0707	38,200,000	
001	17	1017031	01	Rep. Usht. nr. 2001-KF Detare Durrës	02120	601	0707	6,303,000	
	17	1017031	01	Rep. Usht. nr. 2001-KF Detare Durrës	02120	602	0707	53,371,561	
001				KNA, Pashaliman, Vlorë					97,874,561
001				KNA, Pashaliman, Vlorë		604			97,874,561

Burimi i të dhënave: Fletore Zyrtare

Kantieri i ndërtimit dhe riparimit të anijeve (KNRA) është ndërmarrje shtetërore, regjistruar në Degën e Tatimeve Vlorë me NIPT K56703248G.

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë rregullohet sipas dispozitave ligjore: Ligji nr. 9901, datë 14.04.008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; Ligji nr. 10276, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Miratimet e pasqyrave financiare janë bërë me vendimet e Këshillit Drejtues sa vijon:

Periudha	Dorëzuar në KD. nr/datë	Vendimet e KD nr/datë	Humbja për t’u mbartur	Dorëzuar në organet tatimore
2015	Nr. 95, datë 04/04/2016	Nr. 05, datë 04/04/2016	-105,970,572	Dorëzuar online në sistemin e tatimeve

2016	Nr. 125, datë 04/04/2017	Nr. 05, datë 26/05/2017	- 98,832,268	Dorëzuar online në sistemin e tatimeve
2017	Nr. 110, datë 05/04/2018	Nr. 05, datë 26/06/2018	- 52,376,395	Dorëzuar online në sistemin e tatimeve
2018	Nr. 225, datë 10/04/2019	Nr. 03, datë 10/04/2019	- 48,465,684	Dorëzuar online në sistemin e tatimeve
2019	Nr. 295, datë 12/04/2020	Nr. 04, datë 26/04/2020	-45,278,795	Dorëzuar online në sistemin e tatimeve
2020	Nr. 292, datë 21/04/2021	Nr. 07, datë 21/04/2021	- 71,667,717	Dorëzuar online në sistemin e tatimeve
2021	Nr. 216, datë 04/04/2022	Nr. 02, datë 04/04/2022	- 59,110,976	Dorëzuar online në sistemin e tatimeve
2022	Nr. 373, datë 03/04/2023	Nr. 03, datë 03/04/2023	- 46,240,987	Dorëzuar online në sistemin e tatimeve
2023	Nr. 194, datë 05/04/2024	Nr. 06, datë 05/04/2024	- 47,045,484	Dorëzuar online në sistemin e tatimeve

Objekt i auditimit janë pasqyrat financiare të cilat përfshijnë, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të mjeteve monetare. Regjistrimet kontabël janë të bazuara në dokumentacionin bazë, i cili është i autorizuar dhe i aprovuar nga personat e ngarkuar, me autoritetin që kanë në përputhje me rregulloren e brendshme.

Bilanci për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021 2022 dhe 2023, në mënyrë të përmblodhur paraqitet sipas tabelës sa më poshtë vijon:

Pasqyrat financiare për periudhën 01.01- 31.12.2015, 2016.

Në 000/lekë

	AKTIVET	31. 12. 2015	01/01/2016-31/12/2016
I	AKTIVET AFATSHKURTRA		
	Mjete Monetare	49,584	27,488
	Llogari të arketueshme tregtare	884	561
	Te tjera Llogari të arketueshme	351	68
	Inventarë	389,083	369,686
	Totali i aktiveve afatshkurtra	439,901	397,803
II	AKTIVET AFATGJATA		
	Aktive afatgjata materiale	2,005,104	1,945,425
	Total aktiveve afatgjata	2,005,104	1,945,425
	Total aktive	2,445,005	2,343,229
I	DETYRIMET		
	Detyrimet afatshkurtra		
	Llogari të pagueshme tregtare	1,022	1,096
	Detyrime tatimore	1,673	2,668
	Te tjera detyrime	4,015	-
	Total detyrime afatshkurtra	6,709	3,765
II	Detyrime afatgjata		
	Total detyrime afatgjata	-	-
	Total I detyrimeve	6,709	3,765
	KAPITALI I		
	Kapita i nënshkruar	2,544,267	2,544,267
	Rezerva ligjore		-
	Humbje të mbartura	36,027	105,970
	Humbje ushtrimit	69,943	98,832
	Total kapitali	2,438,296	2,339,464

Total i kapitalit dhe detyrimeve	2,445,005	2,343,229
---	------------------	------------------

Burimi i të dhënave :KNRA

Nga auditimi i kryer rezultoi se për vitet 2015-2023, hartimi dhe përgatitja e pasqyrave financiare është kryer në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" me ndryshime, të nenit 8 dhe 9 të ligjit nr. 7582, datë 13.07.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore", VKM-së nr.783, datë 22.11.2006 datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël" si dhe të udhëzimeve të miratuara për zbatimin e rregullave në përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore.

Për periudhën objekt auditimi hartimi i pasqyrave financiare, është bazuar në të dhënat e kontabilitetit, sipas ditarëve dhe konstatimit të drejtave dhe detyrimeve. Pasqyrat financiare të Kantierit të ndërtimit dhe riparimit të Anijeve janë të audituara dhe të çertifikuar edhe nga ekspert kontabel të jashtëm të pavarur sipas kërkesave të në nenit 9 të ligjit nr. 7582, datë 13.07.199 "Për ndërmarrjet shtetërore".

Në zbatim të ligjit për kontabilitetin në KNRA për është bërë edhe çertifikimi i pasqyrave financiare të bilancit nga një ekspertë kontabël i caktuar nga Ministria e Mbrojtjes.

I. Aktive afat gjata materiale paraqiten në bilanc me vlerën e tyre neto 1,633,778,431 lekë. Këto aktive janë pajisur me tituj pronësie dhe përbëhen nga ndërtesa, mjete transporti, makineri e pajisje, pajisjet dhe mjetet informatike. Trajtuar këto në bilancë sipas zërave, me vlerën në to konform standardeve kombëtare të kontabilitetit dhe konkretisht:

-Toka 823,195,800 lekë

-Ndërtesat dhe instalimet 637,773,954 lekë

-Makineri, pajisje dhe mjetë transporti 296,435,428 lekë

-Aktive të tjera afatgjata materiale 1,625,582 lekë.

II. Aktive afatshkurtra paraqiten në bilanc në vlerën 344,266,834 lekë. Të ndara si më poshtë:

1. Aktivët monetare ose likuiditete në vlerën 282,981 lekë.

2. Aktive të tjera financiarë afatshkurtra 21,434,426 lekë.

2. Kliente për mallra, produkte e shërbime 21,326,912 lekë

3. të tjera kërkesa 107,514 lekë

4. Inventarë 322,549,427 lekë nga ku:

Vlera e aktiveve financiare është ulur në krahasim me vitin e paraardhës si rezultat i likuidimeve të kryera për shërbimet e kreyra.

3. Inventari

Ndërmarrja disponon gjendje të materialeve të cilat janë vlerësuar me koston e tyre historike respektive në shumën 322,549,427 lekë, ku janë pasqyruar materiale të para, produkte të gatshme, dhe gjendja e inventarit të imët.

Inventari paraqitet si me poshtë;

Lëndet e para 282,202,155 lekë

Inventari i imët 38,873,523 lekë

Produkte të gatshme 1,473,749 lekë.

Aktivët në total për vitin 2023 paraqiten në vlerën 1,978,045,265 lekë.

I. Pasivet afat shkurtra paraqiten në bilanc me një vlerë 8,767,291 lekë të cilat përfaqësojnë.

Hua dhe parapagime

-Të pagueshme ndaj furnitorëve 4,676,995 lekë.

-Të pagueshme ndaj punonjësve 2,092,499 lekë.

-Detyrime për sigurime shoqërore e shëndetësore 574,141 lekë.

-Detyrime tatimore për tatim mbi paga 334,235 lekë.
 Pasivet afatgjata paraqiten në vlerën 0.
 Totali i pasiveve për vitin 2023 ka qenë 8,767,291 lekë.

Llogarite Analitike viti 2023, krahasuar me vitin 2022				
	AKTIVET	2022	2023	Diferenca/+(-)
I	AKTIVET AFATSHKURTRA	344,234,369	344,266,833	(32,465)
	1. Aktivët monetare	5,131,375	282,981	(4,848,394)
	>Banka	5,131,375	282,981	(4,848,394)
	2. Derivative dhe aktive të mbajtura për tregtim	-	-	-
	3. Aktive të tjera financiare afatshkurtra	14,508,138	21,434,426	6,926,288
	>Kliente për mallra, produkte e shërbime	13,741,687	21,326,912	7,585,225
	>Te tjera kerkesa	766,451	107,514	(658,937)
	4. Inventari	324,594,856	322,549,426	(2,045,430)
	>Lendet e para	282,746,662	282,202,155	(544,507)
	>Inventari imet	40,361,897	38,873,523	(1,488,374)
	>Produkte të gatshme	1,486,297	1,473,749	(12,548)
II	AKTIVET AFATGJATA	1,676,806,686	1,633,778,432	(43,028,254)
	1. Investimet financiare afatgjata			-
	2. Aktive afatgjata materiale	1,676,806,686	1,633,778,432	(43,028,254)
	>Toka	823,195,800	823,195,800	-
	>Ndertesa dhe instalime	671,341,004	637,773,955	(33,567,049)
	>Makinë dhe pajisje (mjete transporti)	180,192,732	171,183,095	(9,009,637)
	>Aktive të tjera afatgjata materiale	2,077,150	1,625,582	(451,568)
	TOTALI I AKTIVEVE (I+II)	2,021,041,055	1,978,045,265	(42,995,790)
	PASIV	2022	2023	
I	PASIVET AFATSHKURTRA	4,717,597	8,767,291	4,049,694
	3. Huat dhe parapagimet	4,717,597	8,767,291	4,049,694
	>Te pagueshme ndaj furnitoreve	1,253,840	4,676,995	3,423,155
	>Te pagueshme ndaj punonjeseve		2,092,499	2,092,499
	>Detyrime për Sigurime Shoq. Shënd.	674,205	574,141	(100,064)
	>Detyrime tatimore për TAP - in	165,463	334,235	168,772
	>Debitore dhe Kreditore të tjere	2,624,089	1,089,421	(1,534,668)
II	PASIVET AFATGJATA			-
	TOTALI I PASIVEVE (I+II)	4,717,597	8,767,291	4,049,694
III	KAPITALI	2,016,323,458	1,969,277,974	(47,045,484)
	1. Aksionet e pakices (PF të konsoliduara)			-
	2. Kapitali aksionerë të shoq. Meme (PF të kons.)			-
67	3. Kapitali aksionar	2,544,266,852	2,544,266,852	-
	9. Fitimet e pa shpërndara	(481,702,407)	(527,943,394)	(46,240,987)
	10. Fitimi (Humbja) e vitit financiar	(46,240,987)	(47,045,484)	(804,497)
	TOTALI I KAPITALEVE TË VETA (III)			-
	TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT (I+ III)	2,021,041,055	1,978,045,265	(42,995,790)

Llogarite Analitike (Aktiv), krahasim i vitit 2023 me vitin 2022 paraqitur në Tabelën 1.

1. Llogaria Bankare është me gjendje 282,981 leke, duke krahasuar me vitin 2022 ka një rënie në shumën (4,848,394) leke, kjo për faktin e mos arkëtimit nga FD të punimeve në fund të vitit në shumën 21,278,774 leke të cilat u arkëtuan në Janar 2024.

2. Llogaria Klientë është me gjendje 21,326,912 leke, duke krahasuar me vitin 2022 ka një rritje në shumën 7,585,225 leke, kjo për faktin pasi janë kryer me shume punime, si dhe të arkëtimit në shumën 13,741,687 leke të vitit 2022, të cilat u arkëtuan në Janar 2023.
3. Llogari të tjera kërkesa është me gjendje 107,514 leke, duke krahasuar me vitin 2022 ka një rënie në shumën (658,937) leke, kjo për shkak të uljes së gjendjes karburantit në depozitën e gjeneratorit.
4. Llogari Inventari është me gjendje 322,549,426 leke, duke krahasuar me vitin 2022 ka një rënie në shumën (2,045,430) leke, kjo kryesisht për shkak të nxjerrjes jashtë përdorimit të mjete vegla pune në shumën 1,514,459 leke.
5. Llogaria Aktive afatgjata është me gjendje 1,633,778,432 leke, duke krahasuar me vitin 2022 ka një rënie në shumën (43,028,254) leke, kjo për shkak të amortizimit vjetor.

Llogarite Analitike (Pasiv)

1. Llogaria të pagueshme ndaj furnitorëve është me gjendje 4,676,995 leke, duke krahasuar me vitin 2022 ka një rritje në shumën 3,423,155 leke, kjo për faktin të mos likuidimit për shkak të gjendjes financiare, të cilat u likuiduan në Janar 2024.
2. Llogaria të pagueshme ndaj punonjësve është me gjendje 2,092,499 leke, duke krahasuar me vitin 2022 ka një rritje në po të njëjtën shumë, kjo për faktin të mos likuidimit të pagave për shkak të gjendjes financiare, të cilat u likuiduan në Janar 2024.
3. Llogarite detyrime ndaj sigurimeve shoqërore, tatimorë dhe kreditore të tjerë (TVSH), janë detyrime të muajit dhjetor të cilat janë likuiduar në muajin Janar 2024.
4. Llogaria kapitali Aksionar është me gjendje 2,544,266,852 leke, duke krahasuar me vitin 2022 ka po të njëjtën shumë
5. Llogaria Fitim pashpërndare (humbje) është me gjendje 46,240,987 leke, duke krahasuar me vitin 2022 ka një rritje në po të njëjtën shumë, e cila është humbja e vitit 2022.
6. Llogaria Fitim e humbje e vitit financiar është me gjendje 47,045,484 leke, duke krahasuar me vitin 2022 ka një rritje. Nga auditimi rezulton se aktiviteti i KNRA-së ka qenë në humbje për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur aktiviteti fitim/humbje për periudhën e auditimit.

Pasqyra Fitim/Humbje për periudhat e mbyllura më 31 Dhjetor 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023 paraqiten:

Nr.	Vitet	Të Ardhura	Shpenzime	Fitim/humbje
1	2015	13,452,524	83,395,927	- 69,943,403
1	2015	Humbje e mbartur		- 36,027,169
2	2016	50,240,283	149,072,551	- 98,832,268
3	2017	59,833,280	112,209,675	- 52,376,395
4	2018	81,139,643	129,605,327	- 48,465,684
5	2019	68,879,305	114,158,100	- 45,278,795
6	2020	40,722,158	112,389,875	- 71,667,717
7	2021	49,273,156	108,384,132	- 59,110,976
8	2022	46,824,471	93,065,458	- 46,240,987
9	2023	47,041,534	94,087,018	-47,045,484
	Total	457,406,354	996,368,063	- 574,988,878

Humbja (2015-2023)

574,988,878

Amortizimi Total (minus)

440,541,832

Total

134,447,046

Humbja e mbartur (minus)

105,970,572

Humbja pa amortizim

28,476,474

KNRA ka një rezultat financiar negativ për të gjitha vitet e periudhës së auditimit. Kjo humbje ka për shkak të amortizimit të llogaritur për objektet (ndërtesa dhe makineri).

Humbja e llogaritur pa amortizimin deri në fund të viti 2023 është 28,476,474. KNRA gjatë viteve nga aktiviteti i saj ka patur likuiditet për të përballuar shpenzimet, dhe nuk ka detyrime ndaj të tretëve. Nga prilli i vitit 2024 likuiditet në banke janë 0.

Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve, Pashaliman, Vlorë ka në administrim 148,860 m² 2 tokë të vlerësuar në vlerën 823,195,800 lekë, ndërtime dhe instalime në vlerën 637,773,954 lekë, pasuritë e mësipërme janë të hipotekuara dhe të pasqyruar në kontabilitet sipas kërkesave dhe standardeve të kërkuara.

Sipas vërtetimit nga dokumentet hipotekore vërtetohet se në regjistrin hipotekor nr. 13 dt. 20.01.2016 figuron e regjistruar në pronësi të Ministria e Mbrojtjes, në administrim të KNRA, Pashaliman Vlorë, pasuria në zonën kadastrale 1568 me sipërfaqe 148,860 m², në adresën Karaburun Vlore, në vendin e quajtur Pashaliman.

Sipas dokumentacionit të vëne në dispozicion nga KNRA për ndërtesat dhe objektet, rezulton se shumë objekte janë të amortizuara dhe shumë objekte të tjera janë funksional por nuk gjejnë përdorim në aktivitetin e veprimtarinë e KNRA-së.

	Përshkrimi	Sasia	Kosto	Vlehtë	%	Shuma
Nr.	Magazina e Aktiveve				Amortizim	Amortizim
1	Objekti Marangozeve (Nr. 16)	1	7,574,838	7,574,838	1	75,748
2	Objekti L/A-Mekanizmave(Nr. 23)	1	26,047,623	26,047,623	1	260,476
3	Objekti Sharres(Nr. 12)	1	1,135,149	1,135,149	1	11,351
4	Objekti Galvanizimit (Nr. 24)	1	8,767,836	8,767,836	1	87,678
5	Objekti P. Ujit(Tragjas)	1	203,965	203,965	1	2,040
6	Objekt P. Zjarrfikse(Nr. 39)	1	443,620	443,620	1	4,436
7	Depo(Kapanon L. Drusore)Nr. 13	1	3,575,514	3,575,514	1	35,755
8	Objekti I Menses(Nr. 15)	1	23,351,239	23,351,239	1	233,512
9	Objekti Mirembajtjes Nr. 17(Turku)	1	54,114,186	54,114,186	1	541,142
10	Zyrat E Reja Administr. (Hoteli)Nr. 19(Turku)	1	27,422,799	27,422,799	1	274,228
11	Objekti I Kinemase Nr. 18(Turku)	1	36,469,335	36,469,335	1	364,693
12	Depo Kablosh Elektrike Nr. 20(Turku)	1	7,183,763	7,183,763	1	71,838
13	Poligon	1	2,369,528	2,369,528	1	23,695
	Shuma		198,659,395	915,347,235		1,986,594

Vlera fillestare e ndërtesave jashtë funksionit është në shumën 198,659,395 lekë, amortizimi vjetor në shumën 1,986,594 lekë, sipas tabelës nr. 1,

I. Ndërtesa që janë funksionale, të dobishme dhe që gjejnë përdorim dhe shërbejnë në gjenerimin e të ardhurave në veprimtarinë aktuale të Kantierit.

Nr.	Emërtimi	Funksioni
1	Objekti Radioelektrik Nr. 4	Magazinimi për materialeve si bojra, llaqe dhe kablo elektrik. Ambient Bar Kafe (Dhënë me qira)
2	Objekt Pune Nr. 1	Nënstacioni elektrik Repart I makinerive tubo kthyses Magazinë materialesh Pjesë rezerv Damen

3	Objekti I Pompave të ujit Nr 14	Objekt ku janë të instaluarat pompat për furnizimin me uje të KNRA-së
4	Objekt punim përfundimtar Nr 5	Objekt pune për kalandrimin dhe prerjen e pjastrave, I kompletuar me makineri si : Kalandër; tranxhë, presë hidraulike, presë elektrike.
5	Objekt riparimi 6A	Objekt ku magazinohen dhe prodhohen takot e drurit
6	Objekt Torneri -Motorra	Objekt I pajisur me ; Torno; retifik; frezë; bareno; bangoprovë; sistem presimi
7	Objekti Depo material elektrik Nr 22	Objekt elektrik që përdoret për karikimin e baterive dhe testimin e pajisjeve për rryma të ndryshme si 12 v;24v;110v 220v.
8	Zyra e administratës Nr 3	Administrata e Kantierit
9	Objekti dizel gjeneratori Nr. 26	Objekt ku është instaluar motogjeneratori I dritave
10	Objekti i Kompresorëve Nr 9	Objekt ku është instaluar kompresori i ajrit
11	Objekt I Nënstacionit Nr. 2	Nënstacioni elektrik
12	Kapanon I Montimit të Anijeve	Kapanon i Ri, I kompletuar me sistem vinxhash dhe sistem ajri. Ka në brendësi të tij edhe makineritë për punime marangozi
13	Reparti I lyerjes Nr. 35	Objekt për lyerje me bojë

Të gjitha këto objekte të sipërpërmendura janë funksionale dhe përdoren për gjenerimin e të ardhurave për veprimtarinë aktuale të punës që Kantieri kryen.

I. Objekte që janë funksionale, por që nuk gjejnë përdorim apo përdoren shumë rrallë në veprimtarinë aktuale të KNRA-së.

Nr.	Emërtimi I ndërtesës
A	Objekti i mirëmbajtjes Nr. 17 (Turku)
B	Objekti Nr. 19 Zyrat e reja Administrata (Turku)
C	Objekti i Mensës (ish mensa) Nr. 15
D	Depo kabllorsh elektrik Nr. 20 (Turku)
C	Depo Uji

Objekti i mirëmbajtjes Nr.17 (Turku) Funksional, Mirëmbahet dhe administrohet nga efektivët e Garnizonit Turk, Viti i ndërtimit–1960, Përmasat e godinës–Gjatësi =36m, gjerësi 16.2 m.

Objekti Nr.19 Zyrat e reja Administrata/Funksional, Mirëmbahet dhe administrohet nga efektivët e Garnizonit Turk, Viti i ndërtimit –1969, Përmasat e godinës;gjatësi 40m, gjerësi 13 m.

Objekti i Mensës (ish mensa) Nr. 15, Viti i ndërtimit – 1960, Përmasat e godinës, gjatësi =36m, gjerësi 16.2 m. Brenda këtij objekti dy katësh ndodhen dy dhoma që janë në gjendje të mirë dhe të kompletuara për në voja pune, dhoma e marangozave dhoma e kovaçanit.

Këto dy dhoma nuk përdoren në aktivitetin dhe veprimtarinë aktuale të punës.

Depo Uji - Funksionale: Ky objekt është funksional por nuk përdoret në veprimtarinë e Kantierit për gjenerimin e të ardhurave. Ndodhet jashtë planvendosjes të dal me VKM nr 397, dhe për këtë arsye nuk është bërë dhe regjistrimi në ZVRPP. Me një ndryshim akti ligjor pritët të kalohet në administrim të Komandës së Forcës Detare.

II. Objekte që nuk janë funksionale dhe që kanë një amortizim dukshëm të lartë.

Nr.	Emërtimi
1	Objekti i sharrës Nr. 12
2	Depo (kapanon lëndë drusore) Nr. 13
3	Objekti Nr. 16 (ish reparti i marangozëve
4	Objekti i Kinemasë Nr. 18
5	Depo kabllorsh elektrik Nr. 20
6	Objekti Linja Aksi mekanizma, Nr. 23
7	Objekti i Galvanizimit Nr. 24
8	Objekti i Pompës zjarrfikëse Nr. 39
9	Objekti Pompë e ujit Tragjas
10	Poligon

Objekti i sharrës Nr. 12 - Jashtë funksionit, Viti i ndërtimit – 1975, Përmasat e godinës – Gjatësi 11.5 m, gjerësi 5 m; Depo (kapanon lëndë drusore) Nr. 13- jashtë funksionit, Viti i ndërtimit – 1981, Përmasat e godinës – Gjatësi 32m, gjerësi 8.5 m; objekti Nr. 16 (ish reparti i marangozëve) jashtë funksionit, Viti i ndërtimit – 1969, Përmasat e godinës – Gjatësi 30m, gjerësi 12.3 m; Objekti i Kinemasë Nr. 18 – jashtë funksionit, Ky objekt ndodhet brenda hapësirës që administron Garnizoni Turk, Viti i ndërtimit – 1960, Përmasat e godinës – Gjatësi 42m, gjerësi 22 m; 3. Depo kabllorsh elektrik Nr. 20 jashtë funksionit, Ky objekt ndodhet brenda hapësirës që administron Garnizoni Turk, Viti i ndërtimit – 1960, Përmasat e godinës – Gjatësi 28m, gjerësi 13 m
Objekti Linja Aksi mekanizma, Nr. 23 - jashtë funksionit, Viti i ndërtimit – 1975, Përmasat e godinës – Gjatësi 73m, gjerësi 12 m
Objekti i Galvanizimit Nr. 24 – jashtë funksionit, Viti i ndërtimit – 1993, Përmasat e godinës – Gjatësi 31m, gjerësi 15 m
Objekti i Pompës zjarrëfikëse Nr. 39 –jashtë funksionit, -Viti i ndërtimit – 1985, -Përmasat e godinës – Gjatësi =7. 5m, gjerësi 4.5 m
Objekti Pompë e ujit Tragjas –jashtë funksionit Me një ndryshim akti ligjor pritet të kalohet në administrim të Komandës së Forcës Detare. -Viti i ndërtimit – 1957, -Përmasat e godinës – Gjatësi =12m, gjerësi 6.5 m
Poligon – jashtë funksionit, Vendi ku kryheshin provat e qitjes nga Forca Detare. Nuk ka objekt ose ndërtesë, është thjesht një sipërfaqe muri e cila nuk i duhet dhe nuk i shërben Kantierit.
Sipas informacioneve jozyrtare nga ana e punonjesve të KNRA u referua që disa nga godinat janë në shfrytëzim nga efektivet e garnizonit Turk, sipas një marrëveshje me Komandën e Forcës Detare që para krijimit të KNRA, marrëveshje për të cilën KNRA nuk ka dijeni.
Vlera Kontabël neto e Aktive Afatgjata Materiale - 2023

Nr	Emërtimi	Sasia	Gjendje 01-01-2023	Shtesa	Pakësime	Gjendje 31-12-2023
1	Toka		823,195,800	-	-	823,195,800
2	Ndërtime		671,341,004	(33,567,050)	-	637,773,954
3	Ndërtime dhe instalime		34,453,531	(1,722,677)	-	32,730,854
4	Makineri e pajisje		145,739,201	(7,286,960)	-	138,452,241
5	Mjete transporti		-		-	
6	Kompjuterike		239,784	(55,896)	(16,200)	167,688
7	Zyre		1,837,366	(364,473)	(15,000)	1,457,894
8	TE TJERA		-	-	-	
9			-	-	-	
	TOTALI		1,676,806,686	(42,997,056)	(31,200)	1,633,778,431

Burimi i të dhënave: KNRA

Sipas inoformacioneve referuar grupit të auditimit, asetet e Kantierit janë në gjëndje të mjerueshme. Këtu vlen të përmendet shkalla, linjat e shinave dhe kareli lëvizës. Në gjëndjen teknike që janë paraqesin një rrezik potencial për jetën, shëndetin e punonjësve dhe të efektivave të anijeve, por edhe për pasurinë shtetërore dhe atë të palëve të treta. Paisjet dhe veglat e punës, janë amortizuar, dalë jashtë përdorimit apo dëmtuar nga vitet në përdorim. Po ashtu ambientet e punës, si ndërtesa, kapanone, mjete transporti kanë në vujë për riparim dhe zëvendësim. (imazhe në ankesin bashkëngjitur ketij projektraporti)

Informacion për Debitorët

Gjendja e debitorëve në KNRA është mbartur prej vitit 2014 për debitorin (E. M.), viti 2016 (S.V.), viti 2018 (debitorë i paidentifikuar), në shumën 106,586 lekë.

Në vitin 2022 Klientë (riparim anije K. I.) për diferencë.

Prej vitit 2018 e në vazhdim s'janë krijuar debitorë të rinj.

Debitorët janë si më poshtë:

1. Z. E.M. Dëmi ekonomik i shkaktuar buxhetit të shtetit është në masën e **43,610 (dyzet e tre mijë e gjashtëqind e dhjetë) lekë**. (prej vitit 2014). Ky detyrim është parashkruar për shkak të kalimit të afatit të përcaktuar në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë
2. S.V., detyrimi kundrejt Kantierit të Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve, për punimet në bareno të kryera në datën 08.07.2016, referuar Faturë Tatimore Shitje Nr. 30474259 Serie, datë 08.07.2016, nuk është përmbushur ende detyrimi për likuidim **në shumën 15,320 lekë, është hapur akt padi**.
3. Debitore i paidentifikuar për karburant në shumën **62,976 lekë** (prej vitit 2018).
4. Klientë K. 1, riparim anije është debitorë për shumën **25,139 lekë** (viti 2022), si diferencë i cili nga kontaktet telefonike e ka njohur detyrimin dhe janë në pritje të pagesës. Detyrimi fillestar ka qënë në shumën 325,139 lekë, me fature tatimore nr. 02, nr. Serie 78188432, datë 17.02.2022. Klienti ka likuiduar faturën pjesërisht në shumën 300,000 lekë, është debitorë për shumën 25,139 lekë.

Debitore i paidentifikuar për karburant në shumën 62,976 lekë (prej vitit 2018).

Depozita e karburanit, e cila u gjet e hapur ku në shërbim ishte Z. I.K., i cili këtë ditë ishte me shërbim 24 orë.

Në momentin e konstatimit u njoftua Policia Ushtarake. Mbasi u kontrollua depozita, u gjend mangësi në sasinë e karburantit në shumën 62,976 lekë.

Me procedurën e hetimit nga Policia Ushtarake, nuk u indentifikua personi përgjegjës.

Për Z. I. K. nga ana u morën masa disiplinore, deri në largim nga puna.

Pas kërkesave nga ana KNRA-së për ecurinë e zhvillimit të hetimit, Policia Ushtarake ka dalë me konkluzionin që personi përgjegjës ngelet i paidentifikueshëm.

2. Inventarizimi i aktiveve materiale

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve njësia është bazuar në kërkesat e udhëzimit të MF-së nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Mbështetur në këto kërkesa Drejtori i KNRA-së ka nxjerrë urdhrat e brendshëm për çdo vit për kryerjen e inventarizimit fizik të aktiveve materiale të luajtshme e të paluajtshme të ndërmarrjes. Në këto urdhra janë përcaktuar komisioni qendror i inventarizimit dhe komisionet e inventarizimit.

Me shkresën nr. 455 date 24.08.2023 u ngrit komisioni për kryerjen e inventarizimit të aktiveve dhe detyrimeve në kantierin e ndërtimit dhe riparimit të anijeve. Periudha e kryerjes inventarizimit nga 01.09.2023 deri 20.11.2023.

Me shkresën nr. 597 prot. date 16.11.2023 nga përgjegjësja e sektorit ekonomik u përgatit informacion mbi kryerjen e inventarizimit për vitin 2023.

Sipas informacionit në shkresë nga komisionet e inventarizimit u konstatuan problematika si

- Magazina e konsumit ka nevojë për hidroizolim të soletës, pasi ka prani të lagështirës.
- Magazinat e tjera kanë nevojë për lyerje.

Fletët e inventarit janë të firmosura nga anëtarët e komisionit dhe përgjegjëset material.

Po kështu janë përpiluar procesverbalet për gjendjen e materialeve në magazine dhe deklarata e magazinierit për FH Nr. 1 date 01.03.2023 dhe FD Nr. 253 date 31.08.2023 e fundit.

Gjate inventarizimit të mjeteve informatike dhe të inventarit ekonomik komisionet konstatuan se printeri multifunksional BËA 4, si dhe frigoriferi për minibar të cilët u panë dhe nga specialistet janë me defekt të riparueshëm. Komisionet përkatëse të inventarizimit të mjeteve informatike dhe të inventarit ekonomik, mbajtën procesverbalet ku propozuan nxjerrjen jashtë përdorimit të tyre.

Gjate inventarizimit nuk u konstatuan mungesa materialesh si në magazine dhe në materialet në inventar personal.

Me relacionin nr. 598 date 16.11.2023 u paraqiten aktivet që propozohen për jashtë përdorimit.

Printer multifunksional BËA 4 sasia 1 vlera 16,200 lekë.

Frigorifer për minibar sasia 1 vlera 15,000 lekë.

Sipas procesverbalit të mbajtur nga komisioni i inventarizimit për materiale të vegla magazina e ndërmjetme, rezultoi se nuk ka mungesa të materialeve, por disa materiale si fashona ngritës peshash dhe kavo ngritës peshash të rinovohen.

Sipas procesverbalit të mbajtur nga komisioni i inventarizimit të magazinës se skrap u konstatua që nuk rezultojnë mungesa në materiale por duhet vepruar për transformimin e gjithë skrapit sepse koha e amortizon.

Sipas procesverbalit nr.10 në inventarizimi në magazinës L. Z. *Në magazine ishte e pranishme lagështia duke rrezikuar kështu cilësinë e pretenduar. Gjithashtu emërtimi i materialeve ishte dëmtuar si pasoje e lagështirës.*

Nga auditimi për inventarizimin e vlerave materiale u konstatua sa më poshtë:

Sipas fletë inventarëve, për të gjitha magazinat, të dhënat kontabël të nxjerra nga librat llogarisë rakordojnë me gjendjen fizike, ku nuk kanë rezultuar asnjë diferencë.

KNRA nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që kanë në pronësi apo posedim, me kërkesat që duhet të përmbajë ky regjistër. Për periudhën objekt auditimi, u konstatua se institucioni nuk ka mbajtur regjistrin e aktiveve në përputhje me pikën 30 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, date 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, pika 30, ku përcaktohet: “*Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia*”.

Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vazhdimësinë e saj.

Gjendja e materialeve stok dhe me qarkullim të ngadalshëm në magazinë është në një vlerë Shuma prej 44,244,183.8 lekë gjendje në datën 31.12.2023. Nga shoqëria se fundmi nuk janë marre masa për eliminimin e stokut.

Nga auditimi u konstatua se:

-Për vitet 2015-2023, hartimi dhe përgatitja e pasqyrave financiare është kryer në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” me ndryshime, të në nit 8 dhe 9 të ligjit nr. 7582, datë 13.07.1992 “*Për ndërmarrjet shtetërore*”, VKM-së nr. 783, datë 22.11.2006 datë 22.11. 2006 “*Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël*” si dhe të udhëzimeve të miratuara për zbatimin e rregullave në përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore.

Në zbatim të ligjit për kontabilitetin në KNRA për është bërë edhe certifikimi i pasqyrave financiare të bilancit nga një ekspertë kontabël i caktuar nga Ministria e Mbrojtjes.

-Nga auditimi rezulton se aktiviteti i KNRA-së ka qenë në humbje për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022 në vlerën 47,045,484 lekë.

-KNRA ka një rezultat financiar negativ për të gjitha vitet e periudhës së auditimit. Kjo humbje është për shkak të amortizimit të llogaritur për objektet (ndërtesa dhe makineri).

-Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve, Pashaliman, Vlorë ka në administrim 148,860 m² tokë të vlerësuar në vlerën 823,195,800 lekë, ndërtime dhe instalime në vlerën 637,773,954 lekë, pasuritë e mësipërme janë të hipotekuara dhe të pasqyruar në kontabilitet.

-Sipas dokumentacionit të vëne në dispozicion nga KNRA për ndërtesat dhe objektet, rezulton se shumë objekte janë të amortizuara dhe shumë objekte të tjera janë funksional por nuk gjejnë përdorim në aktivitetin e veprimtarinë e KNRA-së.

Sipas informacioneve nga ana e punonjesve të KNRA u referua që disa nga godinat janë në shfrytëzim nga efektivet e garnizonit Turk, sipas një marrëveshje me Komandën e Forcës Detare që para krijimit të KNRA, marrëveshje për të cilën KNRA nuk ka dijeni.

-Sipas informacioneve referuar grupit të auditimit, asetet e Kantierit janë në gjendje të mjerueshme. Këtu vlen të përmendet shkalla, linjat e shinave dhe kareli lëvizës. në gjendjen teknike që janë paraqesin një rrezik potencial për jetën, shëndetin e punonjësve dhe të efektiveve të anijeve, por edhe për pasurinë shtetërore dhe atë të palëve të treta. Pajisjet dhe veglat e punës, janë amortizuara, dalë jashtë përdorimit apo dëmtuar nga vitet në përdorim. Po ashtu ambientet e punës, si ndërtesa, kabanone, mjete transporti kanë nevojë për riparim dhe zëvendësim.

-Gjendja e debitorëve në KNRA është mbartur prej vitit 2014. Prej vitit 2018 e në vazhdim s'janë krijuar debitorë të rinj.

-Nga auditimi për inventarizimin e vlerave materiale u konstatua sa më poshtë:

Sipas fletë inventarëve, për të gjitha magazinat, të dhënat kontabël të nxjerra nga librat llogarisë rakordojnë me gjendjen fizike, ku nuk kanë rezultuar asnjë diferencë.

KNRA nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që kanë në pronësi apo posedim, me kërkesat që duhet të përmbajë ky regjistër. Për periudhën objekt auditimi, u konstatua se institucioni nuk ka mbajtur regjistrin e aktiveve në përputhje me pikën 30 të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 30, ku përcaktohet: “Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia”.

-Gjendja e materialeve stok dhe me qarkullim të ngadalshëm në magazinë është në një vlerë Shuma prej 44,244,183 (dyzetë e katër milion e dy qind e dyzetë e katër mijë e njëqind e tetëdhjetë e tre pikë tetë) lekë gjendje në datën 31.12.2023. Nga shoqëria vitet e fundit nuk janë marrë masa për eliminimin e stokut.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, neni 8, neni 2.

Për sa është trajtuar në projektraportin e auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 347/6 prot, datë 28.08.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Me anë të shkresës nr. 347/6 prot, datë 28.08.2024, është paraqitur observacioni në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

“ . . . Sa konkluduar nga grupi i audituar ju paraqesim komentet tona kundërshtuese për sa vijon:

1- Rregjistrin e aktiveve e kemi të detajuar sipas formatit, ku përfshihet data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, vendndodhjen, personin përgjegjës, amortizimin etj. Rregjistrin e aktiveve e hartojme cdo vit, por ndryshime s'ka, AQT KNRA-ja i ka në përdorim, si dhe kemi hartuar formularin e perditesimit të pronës.

- Bashkelidhur rregjistri i aktiveve.*
- Formulari i perditesimit të pronës Nr. 171 Prot, date 17.03.2023”*

Qëndrimi i grupit të auditimit

Grupi i auditimit shqyrtoi pretendimet tuaja dhe dokumentacioni bashkëngjitur observacionit tuaj dhe komenti juaj nuk qëndron Sipas udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kërkesat minimale që duhet të përmbaje regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia”.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

2.6 Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet për investime, për blerje mallrash e shërbimesh, si dhe zbatimi i kontratave.

U shqyrta dokumentacioni sa më poshtë vijon:

- a. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.*
- b. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.*
- c. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit).*
- d. Auditim mbi zbatimin e kushteve në kontratave të lidhura me operatorë ekonomik të shpallur fitues për mallra dhe shërbime, si dhe marrja në dorëzim e tyre sipas specifikimeve teknike.*

-Përshkrim i shkurtër rreth organizimit dhe funksionimit të Kantierit të Ndërtimit të Riparimit të Anijeve, këtu e më poshtë KNRA.

KNRA, bazuar në Ligjin për Ndërmarrjet Shtetërore, krijon të ardhura si dhe i shpenzon ato duke u mbështetur në ato të ardhura të krijuara. Shpenzimet e kryera duhet i nënshtrohen Ligjit dhe Rregullave të Prokurimit Publik. Në zbatim të Ligjit të Prokurimit Publik si dhe VKM-së për Rregullat e Prokurimit Publik, mbi zbatimin e kërkesave kriterëve, rregullave etj kemi konkluduar si më poshtë:

❖ Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nga auditimi rezultoi se është hartuar regjistri i parashikimeve për vitet 2016-2023 si dhe Regjistri i realizimit të prokurimeve për këto vite.

Rregjistri i parashikimeve është miratuar në sistem nga APP, regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitet objekt auditimi mbështetur në vendimet e këshillit drejtues "Mbi miratimin e planifikimit të shpenzimeve sipas kërkesave përkatëse të KNRA". Nuk ka pasur shtesa dhe pakësime.

NJP dhe NZ, kanë vepruar në përputhje me VKM, nenin 3 “Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik”, neni 4, pika 1, ku cilësohet: “Në bazë të kërkesave për punë, mallra ose shërbime, AK është përgjegjës për përgatitjen dhe dorëzimin e regjistrit vjetor të parashikimeve për procedurat e prokurimit publik, në përputhje me formën dhe mënyrën e parashikuar në udhëzimet e APP-së”.

Dërgimi i regjistrit të parashikimeve në APP, është bërë brenda afateve të përcaktuara në VKM nr. 914, neni 3, pika 6, ku cilësohet: “Organet e pushtetit vendor, ndërmarrjet shtetërore apo çdo AK tjetër jo buxhetor përgatitin regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit publik, jo më vonë se 10 ditë pas miratimit të buxhetit apo planit të blerjeve nga këshillat vendorë ose nga organet drejtuese përkatëse”.

Nga auditimi ka rezultuar se gjatë vitit nuk ka pasur ndryshim të regjistrit të parashikimeve, për të cilat është bërë planifikimi, referuar VKM neni 4, pika 4 ku cilësohet: “AK ka të drejtë të bëjë ndryshime në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit, vetëm në raste të justifikuara. Çdo ndryshim i regjistrit të parashikimeve bëhet nga vetë AK në sistemin e prokurimit elektronik dhe publikimi i tij nga APP-ja të bëhet brenda tri ditëve nga dita e nesërme e punës nga dërgimi i tij për publikim në sistem”.

❖ *Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.*

Për kryerjen e auditimit mbi disponimin e fondeve dhe angazhimin e tyre për kryerjen e procedurave të prokurimit për shpenzimet (mallra, shërbime) për periudhën objekt auditimi, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Programimi i nevojave; Plani i Hartuar; Fakti; Regjistri i Parashikimeve; Regjistri i Realizimeve.

Nga vlera totale e fondit limit të prokuruar rezultoi se 100 % e tyre është me burim financimi nga ardhurat e Institucionit, në mënyrë të përmbledhur sipas tabelës:

“Burimi i financimit”

Fondi limit total	Fondi limit KNRA	Financimi:
117,084,037	100%	

Burimi i të dhënave: KNRA

Sipas viteve objekt auditimi fondet limit të planifikuara për shpenzime dhe burimi i tyre i financimit paraqitet si në tabelë :

Periudha e auditimit	Të ardhurat e veta
Viti 2017	21,865,000
Viti 2018	19,886,855
Viti 2019	28,291,802
Viti 2020	18,192,930
Viti 2021	5,424,900
Viti 2022	8,915,850
Viti 2023	14,506,700

Burimi i të dhënave: KNRA

Konkluzion: Fillimi (nxjerrja e urdhër prokurimeve) dhe kryerja e procedurave të prokurimit publik, është realizuar pas miratimit të Këshillit Drejtues dhe APP të fondeve të KNRA, të zhvilluara gjatë periudhës objekt auditimi, me burim financimi me të ardhura të krijuara nga Institucioni.

❖ *Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit).*

Për auditimin e kësaj nën çështjeje u verifikuan: Dosjet e procedurave; Përcaktimi i kritereve të vlerësimit; Hartimi i DT;

Administrimi i dosjeve të prokurimit: Urdhrat e Titullarit të AK; Procesverbalet e mbajtura nga NJP dhe KVO, etj; Raporti përfundimtar; Korrespondenca me OE; Dokumentacioni që plotësohet nga AK; Korrespondenca me APP dhe KPP; Dokumentacioni mbi angazhimin e fondeve buxhetore.

Mbi administrimin e dosjeve nga NJP: Nga Grupi i auditimit u shqyrtua i gjithë dokumentacioni i ndodhur në Dosjen e prokurimit për të gjitha procedurat e audituara, nga ku rezultoi se: Në përgjithësi nga NJP, janë zbatuar të gjitha detyrat e përcaktuara, si: përgatitja e regjistrave të prokurimit; përzgjedhja e llojit të procedurës, hartimi Urdhrit të prokurimit; përgatitja e DT, plotësimi i gjithë dokumenteve standarde për t'u plotësuar nga AK, administrimi i procesverbaleve të mbajtura gjatë zhvillimit të procedurës (*Në një rast nuk është mbajtur procesverbal mbi dokumentimin e procesit të përllogaritjes së fondit limit dhe vlerësimit të ofertave nga anëtarët e komisioneve përkatëse (KFL), KVO*); respektimi i afateve të procedurës, administrimi i dokumentacionit të OE fitues, shqyrtimi dhe reflektimi të gjitha rekomandimeve të APP-së, mbi kriteret kualifikuese, sipas vërejtjeve të saj gjatë monitorimit të procedurave, etj. Nga ana e Juristit të NJP janë administruar dhe inventarizuar të gjitha dosjet e prokurimit por me mangësi në Inventarizim, pa fletë-inventari paraqiten dosjet e viteve 2016-2019. Pjesë e dosjeve ishte i gjithë dokumentacioni i kërkuar sipas akteve ligjore, nënligjore dhe DST.

- Mbi auditimin e zbatimit të procedurave të prokurimit publik:

Nga ana e AK, KNRA, gjatë periudhës objekt auditimi 01.01.17 – 31.12.2023, janë zhvilluar procedura prokurimi dhe janë audituar sa më poshtë vijon:

vitet në lekë procedura	Zhvilluar		audituar		në % kundrejt:	
	nr.	fond limit	nr.	fond limit	nr.	Vlerë
2017	8	21,865,000	5	20,163,240	62.5%	92.2%
• kërkesë për propozim	1	2,745,000	1	2,745,000	100%	100%
• e hapur	1	16,200,000	1	16,200,000	100%	100%
• blerje me vlerë të vogël	6	2,920,000	3	1,218,240	50%	41.7%
2018	16	19,886,855	8	10,452,735	50%	52.5
• kërkesë për propozim	4	16,410,300	2	8,504,880	50%	51.8%
• blerje me vlerë të vogël	12	3,476,855	6	1,947,855	50%	56%
2019	18	28,291,802	8	10,951,952	44.4%	39.2%
• kërkesë për propozim	7	24,371,055	2	7,551,055	28.5%	30.9%
• blerje me vlerë të vogël	11	3,920,747	6	3,400,897	54.5%	86.7%
2020	11	18,192,930	7	14,361,350	63.6%	78.9%
• kërkesë për propozim	4	15,676,550	3	12,576,550	75%	80.2%
• blerje me vlerë të vogël	7	2,516,380	4	1,784,800	57.1%	70.9%
2021	5	5,424,900	3	4,840,000	60%	89.2%
• e hapur e thjeshtuar	1	4,440,000	1	4,440,000	100%	100%
• Blerje me vlerë të vogël	4	984,900	2	400,000	50%	40.6%
2022	5	8,915,850	3	5,828,000	60%	65.3%
• e hapur e thjeshtuar	2	8,131,850	1	5,244,000	50%	64.4%
• blerje me vlerë të vogël	3	784,000	2	584,000	66.6%	74.4%
2023	6	14,506,700	5	9,875,760	83.3%	68%
• e hapur e thjeshtuar	3	13,442,700	2	8,811,760	66.6%	65.5%
• blerje me vlerë të vogël	3	1,064,000	3	1,064,000	100%	100%
Totali	69	117,084,037	39	76,473,037	56.5%	65.3%

Në mënyrë nominale procedurat e audituara sipas tabelës së mësipërme, nga ku rezulton se procedura më e përdorur është ajo “*kërkesë për propozim*” e cila zë 49.1% të fondeve të prokuruar, “*procedurë e hapur e thjeshtuar*” e cila zë 22.7%.

Sipas riskut dhe materialitetit bazuar në llojin e procedurave për gjithë vitet objekt auditimi (01.01.2017 – 31.12.2023), është audituar 65% e fondit limit.

Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit publik ka rezultuar se, në përgjithësi bazuar në kriterin e vlerësimit (*çmimi më i ulët*), oferta e shpallur është ajo me vlerën më të ulët. Në asnjë rast nuk janë paraqitur oferta anomalisht të ulëta. Procedurat e zhvilluara në të gjitha rastet, përjashtuar 1(një) rast procedurat e zhvilluara janë nën kufirin e ulët monetar, pra me vlerë të fondit limit të përlogaritur nën 12,000,000 lekë.

Vlera e kontratave të lidhura kundrejt fondit limit është **87%**.

Ndërkohë që për periudhën objekt auditimi nga procedurat e audituara ka rezultuar një pjesëmarrje e 82 OE prej së cilëve janë s`kualifikuar 46 prej tyre ose 56 % e tyre.

***Shënim:** Në rastin e shkeljeve të konstatuara për vitet 2017,2018,2019,2020 si referencë ligjore jemi mbështetur në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ndërsa për procedurat e viteve 2021,2022,2023 në varësi të hyrjes në fuqi të Ligjit dhe VKM-së së re sipas procedurave përkatëse.*

1- Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “*Blerje naftë D1 (GAZOIL 10 ppm ULSD)*”, si vijon:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, nuk u konstatuan parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “*Për prokurimin publik*”, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, si më poshtë:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “<i>Blerje naftë D1 (GAZOIL 10ppm ULSD)</i>” NR-REF-72138-03-16-2017			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “ <i>Kërkesë për Propozim</i> ” Urdhëri Prokurimit nr. 29 prot, datë 10.03.2017	1. 1 Komisioni i përlogaritjes të vlerësimit të kontratës/testimit tregut/ analizës kostos 1. A. H. 2. I. K. 3. A. T.	2. Njësia e Prokurimit 1. K. K. 2. A. Sh. 3. M. B.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhëri nr. 162 dt. 03.09.2017 1. A. K. 2. K. P. 3. A. H. 4. R. L. 5. I. V.
4. Fondi Limit (pa TVSH) 3,145,000 lekë	5. Oferta fituese (pa TVSH) 2,620,830 lekë Operatori Fitues: OE “F.” SHPK		6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 524,170 lekë
7/1 Data e hapjes së tenderit Datë 14.04.2017 (Sipas shtojcës)	8. Burimi Financimit Vetfinancim		9. Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 4 OE b) S`kualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE
7/2 Data e lidhjes së kontratës;Kohëzgjatja e kontratës: Datë 08.05.2017			

Nga auditimi i procedurës konstatohet që:***a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.***

Është organizuar në një dosje i gjithë dokumentacioni sipas përcaktimeve ligjore, pasqyruar në inventarin e dokumentave të dosjes. Ato përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për zhvillimin e procedurës (*informacionin e përgjithshëm dhe atë specifik, kërkesat kualifikuese specifike, specifikimet teknike, grafiku i lëvrimet të mallrave, etj*).

Nga të dhënat e dosjes së prokurimit konstatohet se, në lidhje me **“Parashikimi i fondit limit fillestar sipas rregjistrimit”**:

Referuar Rregjistrimit të parashikimeve për vitin 2017 si dhe mbështetur në gjendjen në magazinë, me shkresën me nr. 110 prot, datë 31.03.2017 është paraqitur kërkesa nga Z. A. H. me detyrë Specialist finance & furnizimi, me profesion Financier., mbi nevojat e zhvillimit të procedurës **“Blerje naftë D1 (GAZOIL 10ppm ULSD)”**. Personi përgjegjës për administrimin e procedurës në sistem është përcaktuar Z. A.SH me detyrë Jurist në KNRA.

Kërkesa për blerje naftë D1 (GAZOIL 10ppm ULSD)” sipas shkresës nr 110, datë 31.03.2017, bazohet në nevojat për naftë D1 (GAZOIL 10ppm ULSD)” sipas gjendjes së magazinës.

Komisioni i testimit i tregut kreu analizën e koston, sasinë e përlloritur e ka kryer duke u mbështetur në (*numrin e mjeteve që disponon, të dhënat teknike të mjeteve, dhe konsumin ditor të karburantit*). Ndërkohë që në lidhje me përlloraritjen e vlerës komisioni është mbështetur në (*cmimin sipas Buletinit të APP për naftën D1:767S/Ton*(kursi i këmbimit lekë/\$, datë lekë/ton, taksën doganore sipas të gjithë komponentëve të përfshirë si akciza, taksë karboni, taksë qarkullimi etj*) nga ku në total vlera e fondit limit të përlloritur rezultoi përlloritur rezultoi 3,145,000 lekë pa TVSH.

AK (NjP) në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve”:

Hartimi i DST (procesverbal hartimi nuk ka një numër protokolli, dhe datën e hartimit)

- Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, procesverbalit **“për përcaktimin/hartimin e kritereve të pranimit/kualifikimit”**, dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), nuk u konstatuan parregullsi në shkelje të Ligjit **“Për prokurimin publik”**. si dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**, i ndryshuar.

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me “Administrimin e Dokumentacionit”:

Nga auditimi i dosjes fizike të procedurës së prokurimit, konstatohet se personi përgjegjës ka kryer administrimin e dokumentacionit të dosjes në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin **“Për prokurimin publik”**.

Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve, KVO dhe NJP, mbi konfliktin e interesave.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Komisioni i vlerësimit të ofertave në datën 14.04.2017, hyri në sistemin elektronik(SPE) sipas orarit të përcaktuar në DST, në orën 10:00, nga ku u realizua hapja e ofertave dhe rezultoi se ishin pjesmarrës, 4 OE, nga ku KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	OE	Marzhi I fitimit	Skualifikuar/Kualifikuar
1	A.	9.9 %	SKualifikuar
2	E.	6.6 %	SKualifikuar
3	F.	6.4%	Kualifikuar
4	E.	6.4%	SKualifikuar

Referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave, rezulton se KVO-ja, ka kualifikuar vetëm 1(një) OE, duke e shpallur fitues të procedurës së prokurimit OE “F.” shpk me NIPT J.....K.

Arsyet sipas Komisionit të vlerësimit të ofertave për 3(tre) operatorët e skualifikuar janë si më poshtë:

- *Operatori A. – nuk ka paraqitur:*
- *Vetëdeklarim (konflikt interesi)*
- *Deklaraten për përmbushjen e specifikimeve teknike dhe gjendjen e pamjaftueshme në bankë në shumën 413. 000 lekë, e cila është më e vogël se 50% e vlerës së fondit limit të prokuruar.*
- *Operatri E.- nuk ka paraqitur:*
- *Vetëdeklarimin e konfliktit të interesit*
- *Vertetimin për detyrimet tatimore thekson se ka detyrime të palikujduera për TVSH 2,492,663 lekë dhe për tatim fitim, për të cilën është në proces gjyqësor.*
- *Operatori E.- nuk ka paraqitur;*
- *Dokumentacionin për mundësinë e shpërndarjes më tollona të naftës*

c. Në lidhje me zbatimin e kontratës:

Kontrata me Nr. 179 prot, datë 08.05.2019 lidhur ndërmjet OE “F.” shpk me NIPT J.....K dhe AK, KNRA Orikum. Afati i përcaktuar për dorëzimin e mallrave është sipas kërkesave të AK. Me urdhërin me nr. 164, prot, datë 26.09.2017 është ngritur komisioni i pritjes së mallit në magazinë me përbërje si vijon, (A. T. Kryetar, E. A. anëtar, F. G. anëtar, S. B. anëtar). Kontraktori ka kryer dorëzimin e mallrave brenda afatit.

2-Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “*Blerje materiale për riparimin e anijeve*”, si vijon:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave,

nuk u konstatuan parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin Publik si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, si më poshtë:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje materiale për riparimin e anijeve”			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “E hapur, me lote” Urdhëri Prokurimi nr. 66 prot, datë 22. 05. 2017	1. Komisioni i përlogaritjes të vlerësimit të kontratës/testimit tregut Urdhëri nr. 60, datë 11. 05. 2017 1. A.G 2. A.T 3. I.K	2 Njësia e Prokurimit 1. K.K 2. A.SH 3. R.L	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave 1. A.K 2. K.P 3. A.G 4. A.T 5. I.V
4. Fondi Limit (pa TVSH) 16,090,700 lekë Loti 1- 7,541,840 lekë Loti2 – 1,835,450 lekë Loti3- 3,999,450 lekë Loti 4- 910,600 lekë Loti5 – 897,360 lekë Loti 6 – 906,000 lekë	5. Oferta fituese (pa TVSH) Operatori Fitues: OE “U. C.” SHPK Operatori Fitues: OE “H.” SHPK ANULLUAR (mungesë dokumentacionesh) Operatori Fitues: OE “U. C.” SHPK ANULLUAR(mungesë dokumentacionesh) Operatori Fitues: OE “G.”	6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 1,603,890 lekë 311,600 lekë ANULLUAR 109,072 lekë ANULLUAR 0,00 lekë	
7/1 Data e hapjes së tenderit Datë 21.09.2017	8. Burimi Financimit Vetfinancim	9. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender	

(Sipas shtojcës)		Numër 6 b) S'kualifikuar c) Kualifikuar
7/2 Data e lidhjes së kontratës; Kohëzgjatja e kontratës: Datë		

Nga auditimi i procedurës konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Është organizuar në një dosje i gjithë dokumentacioni sipas përcaktimeve ligjore, pasqyruar në inventarin e dokumentave të dosjes. Ato përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për zhvillimin e procedurës (informacionin e përgjithshëm dhe atë specifik, kërkesat kualifikuese specifike, specifikimet teknike, grafiku i lëvrimit të mallrave, etj).

Nga të dhënat e dosjes së prokurimit konstatohet se, në lidhje me **“përlllogaritjen e fondit limit”**:

Referuar rregjistrin të parashikimeve për vitin 2017 si dhe mbështetur në gjendjen në magazinë, është paraqitur kërkesa nga z. A.K me detyrë Kryeinxhiner i KNRA me profesion Inxhinier mbi nevojat e zhvillimit të procedurës **“Blerje materiale për riparimin e anijeve”**. Personi përgjegjës për administrimin e procedurës në sistem është përcaktuar Z. A.SH me detyrë Jurist. Me urdhrin me nr. 60, datë 14.05.2017 është ngritur komisioni i testimit të tregut me përbërje, z. A. H., A. T., I. K.. Ky komisioni kreu përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës duke u mbështetur në testimin e tregut me 3(tre) oferta ekonomike të administruara nga ku rezultoi se vlera e fondit limit të përlllogaritur është 16,090,700 leke pa TVSH për 6(gjashtë) lote.

1. Loti 1- blerje bojra dhe llaqe, fondi 7,541,840 leke
2. Loti 2- blerje materiale riparim anije, fondi 1,835,840 leke
3. Loti 3 – blerje materiale elektrike, fondi 3,999,450 leke
4. Loti 4 – blerje materiale gazemimi, fondi 910,600 leke
5. Loti 5 – blerje materiale lene e zezë, fondi 897,360 leke
6. Loti 6 – blerje gazra teknike, fondi 906,000 leke

AK (NjP) në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve”:

Me procesverbalin nr. 195 pro, datë 24.05.2017 nga NJP u përcaktua lloji i procedurës së prokurimit, “E Hapur” me lote duke iu përmbajtuar nenit 23, nenit 34, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, **“Për Prokurimin Publik”**, si dhe nenit 39, nenit 57, nenit 60, nenit 61, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”**.

- Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, procesverbalit **“për përcaktimin/hartimin e kritereve të pranimit/kualifikimit”**, dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), nuk u konstatuan parregullsi në shkelje të Ligjit **“Për prokurimin publik”**.

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me “Administrimin e Dokumentacionit”:

Nga auditimi i dosjes fizike të procedurës së prokurimit, konstatohet se personi përgjegjës ka kryer administrimin e dokumentacionit të dosjes në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin **“Për prokurimin publik”**.

Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve, KVO dhe NjP, mbi konfliktin e interesave.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Komisioni i vlerësimit të ofertave në datën 21.09. 2017, hyri në sistemin elektronik(SPE) sipas orarit të përcaktuar në DST, në orën 10:00, nga ku u realizua hapja e ofertave dhe rezultoi se nga ku KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Loti I; 5(pesë) ofertues, shpallur fitues OE, “U. C.”shpk me vlerë 5,937,950 lekë pa TVSH.

Loti II; 7(shtatë) ofertues, shpallur fitues OE, “H.” shpk me vlerë 1,523,850 lekë pa TVSH.

Loti III; Anulluar.

Loti IV;7(shtatë) ofertues, shpallur fitues OE, “U. C.”shpk me vlerë 801,528 lekë pa TVSH.

Loti V;Anulluar.

Loti VI; 4(katër) ofertues, shpallur fitues OE, “G.”shpk me vlerë 906,000 lekë pa TVSH.

Si konkluzion, në lidhje me vlerësimin e ofertave të kryer nga KVO-ja, rezulton se kjo e fundit **ka vlerësuar drejt** OE pjesëmarrës në garë.

3- Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: **“Blerje materiale konstruksion shkalle”, viti 2018** si vijon:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 9643, datë 20.11 2006, “Për prokurimin publik”, si dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si më poshtë:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje materiale konstruksion shkalle” NR-REF-54630-03-08-2018			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për Propozim” Urdhëri Prokurimit nr. 37 prot, datë 28.02. 018	1. Komisioni i përlogaritjes të vlerësimit të kontratës/testimit tregut Urdhëri NUK KA 1. A. H. 2. A. T. 3. F. G.	2. Njësia e Prokurimit 1 A. K. 2. K. K. 3. A. Sh.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhëri nr. 41, dt. 01.03.2018 1. K.P 2. A.G 3. I. V.
4. Fondi Limit (pa TVSH) 5,925,580 lekë	5. Oferta fituese (pa TVSH) 5,749,800 lekë Operatori Fitues: OE “S & P 2003” SHPK		6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 175,780 lekë
7/1 Data e hapjes së tenderit Datë 12.03.2018 (Sipas shtojcës)	8. Burimi Financimit Vetfinancim		9. Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 2 OE b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
7/2 Data e lidhjes së kontratës;Kohëzgjatja e kontratës: Datë 03.04.2018 3 ditë			

Nga auditimi i procedurës konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Është organizuar në një dosje i gjithë dokumentacioni sipas përcaktimeve ligjore, pasqyruar në inventarin e dokumentave të dosjes. Ato përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për zhvillimin e procedurës (informacionin e përgjithshëm dhe atë specifik, kërkesat kualifikuese specifike, specifikimet teknike, grafiku i lëvrimin të mallrave, etj).

Nga të dhënat e dosjes së prokurimit konstatohet se, në lidhje me “Parashikimin e fondit limit fillestar sipas rregjistrin”:

Referuar rregjistrin të parashikimeve për vitin 2018 si dhe mbështetur në gjendjen në magazinë, me shkresën me nr. 64 prot, datë 15.02.2018 është paraqitur kërkesa nga Z. A.K me detyrë Kryeinxhinier, me profesion Inxhinier, mbi nevojat e zhvillimit të procedurës “Blerje materiale konstruksion shkalle”. Personi përgjegjës për administrimin e procedurës në sistem është përcaktuar Z. A.SH me detyrë Jurist në KNRA. Kërkesa për blerje materiale për riparimin e

shkallës Kosjakova e cila shërbën për ngritjen, riparimin e anijeve të Komandës së Forcave Detare dhe anijeve private, është bërë sipas shkresës nr 64, datë 15.02.2018, e cila bazohet në nevojat emergjente për riparimin e shkallës, për shkak të gjendjes kritike të saj dhe paraqitjes së rrezikshmërisë për ngjarje të jashtëzakonshme nga ku duhet bërë e mundur sigurimi i bazës materiale për riparimin e saj.

Me shkresën 64/1, datë 27.02.2018, komisioni i testimit të tregut mbështetur në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, neni 8, “kufijtë monetarë”, neni 9, “llogaritja e vlerës së kontratës”, neni 11, “përgjegjësia e autoritet kontraktor”, neni 56, “titullari i AK”, neni 59, “përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”, me përbërje, z. A. H. (Kryetar), z. A.T (anëtar) si dhe z. F.G(anëtar), kreu përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës bazuar në artikujt e përcaktuar të paraqitur në tabelën më poshtë ndërkohë që në lidhje me çmimin veproi duke u mbështetur në testimin e tregut me 3(tre) oferta ekonomike të administruara, si dhe çmimin e magazinës nga ku si referencë u përcaktua mesatarja e nxjerrë nga testimi i tregut me 3 (tre) oferta dhe çmimi i magazinës. Vlera e fondit limit të përlllogaritur rezultoi 5,925,580 lekë pa TVSH Artikujt e prokuruar të paraqitur sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Emertimi I Materialit	Specifikime teknike
1	Kuzhinët radiale-aksiale merula konik me Nr X 30219M	Të jete e pajisur me certifikat të cilesise se mallit,dhe të origjines se prodhimit. të jete sipas standardeve të CE. të siguroj ngarkesa statike të emertimi sipas sistemit suportave jo me të vogel se 325 KN dhe ngarkese dinamike të suportave jo me të vogel se 220KN
2	Gominë unazore 078 x 07	Të ketë diameter të brendëshem o 78 mm dhe diameter të seksionit terthor o 7mm. të jet e garantuar
3	Permistop 0120 x 95 x 12	Premistopi të kete karkase metalike dhe suste inoxi. të jete sipas standarteve të CE.
4	Bullon M10x22	Bullonat të jene me material celik dhe të xinguar. të garantuara sipas standarteve të CE
5	Vida me kokë konikeM6x16	Materiali të jete inox dhe i garantuar cilesishte sipas standarteve të CE.
6	Ddo M22	Materiali të jete celik, dhe i xinguar, i garantuar cilesishte sipas standarteve të CE.
7	Bullon M16x20	Materiali të jete celik, dhe i xinguar, i garantuar cilesishte sipas standarteve të CE.
8	Rondele suste o 16	Materiali të jet celik 65 mn i garantuar cilesishte sipas standarteve të CE
9	Rondele suste o22	Materiali të jet celik 65 mn i garantuar cilesishte sipas standarteve të CE
10	Rrotë shkalle o500	Rrotë shkalle materiali celik 45. Diametri i jashtem maksimal o530 mm, diametri i brendeshem o170 (sipa skemes)

Gjetjet e konstatuara,

-Komisioni i testimit të tregut nuk është ngritur sipas një urdhëri përkatës nga Titullari i AK për këtë procedurë prokurimi por është vepruar duke përcaktuar apo ngritur komisionin për përlllogaritjen e fondit limit në fillimit të vitit për të gjithë procedurat që do të zhvillohen. Ngritja e komisioneve nga Titullari AK, duhet të bëhet gjatë kohës së zhvillimit të procedurës sipas procedurave respektive pasi dokumenton ligjshmërinë apo të drejtën e komisioneve “mbi kryerjen e testimit të tregut” apo procesve të tjera të prokurimit, komisione të cilat në cdo rast përcaktohen nga Titullari i AK, në përputhje me VKM nr. 914 datë 29.12.2014, nenit 56, “Titullari i Autoritetit Kontraktor”, për me tepër që procesi i kryer nuk është i firmosur nga njëri prej antarëve që në cdo rast nuk ligjëron veprimin e kryer nga ky komision .

AK (NjP) në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Krieteve”:

-“Përzgjedhja e OE të ftuar për pjesmarrje”:Në lidhje me përzgjedhjen e OE, njësia e prokurimit pasi përcaktoi si procedurë prokurimi, “kërkesë për propozim”, bazuar në nenin 34 të LPP-së, dhe nenit 39 të RRPP, bëri përzgjedhjen e OE që do të ftohen për pjesmarrja nga ku u konstatua që OE të ftuar nëpërmjet sistemit elektronik, nuk janë të njëjtë me ato OE të procesverbalit bashkëngjitur, pjesë e dosjes së procedurës. Sipas njoftimit të OE në SPE rezultoi se OE të ftuar janë (U. C., A. T. S., S., A.-3., B. E.) ndërkohë që OE bashkëngjitur procesverbalit pjesë e dosjes së prokurimit janë (S., A. S. G., M., A.-3.). Pra ky proces i dokumentuar është jo i rregullt për me

tepër që OE të ftuar nëpërmjet SPE (U. C., A. T. S. dhe B. E.) nuk e kanë në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, veprime të cilat mund të ndikojnë në uljen e numrit të pjesmarrësve në procedurat e prokurimit me ftesë për pjesmarrje. Veprimet e kryera janë jo në përputhje me Ligjin nr. 9643, datë 20.11 2006, “Për Prokurimin Publik”, neni 34 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Rregullat e Prokurimit Publik”, neni 39. Nga ana e NJP në procedurat e prokurimit me ftesë për pjesmarrje duhet të ftojnë OE të cilët kanë në fushën e veprimtarisë dhe aktiviteti tyre lidhet me objektin e prokurimit.

-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, procesverbalit “për përcaktimin/hartimin e kritereve të pranimit/kualifikimit”, dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit “Për prokurimin publik”, si dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;

Hartimi i DST, procesverbali i hartimit të kritereve teknike apo procesverbali i emërtuar nga NJP procesverbali i fillimit të procedurës, **nuk ka** numër protokollit dhe datë.

Në të gjitha rastet, në rubrikat e procedurës cdo veprim i kryer duhet të dokumentohet dhe të mbahet me numër protokollit dhe datën e mbajtjes së protokollit pasi dokumenton kohën në të cilën është kryer veprimi.

-Në lidhje me hartimin e kritereve të veçanta, pika 2. 3 kapaciteti teknik nga ku kërkohet:

➤ Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit të realizuara gjatë 3(tre) viteve të fundit.

Kriteri i hartuar është në kundërshtim me V. K. M nr. 914, datë 29.12.2014, neni 27, “kontratat e mallrave”, pika 4 ku shpreh:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Pra nuk është përcaktuar pragu prej 40% që duhet të përmbushin OE ofertues. Veprimet e kryera i shkaktojnë paqartësi OE në lidhje me paraqitjen e kontratave të ngjashme pasi nuk ka një prag apo kufi në të cilën OE do duhet të ngarkojnë në SPE këto dokumenta. Pra nisur nga fakti i veprimeve të kryera ky kriter i përcaktuar në mënyrë të paqartë lë hapësirë për pjesëmarrje dhe për OE të cilët mund të mos përmbushin kufirin mbi 40% të vlerës së kontratave të ngjashme të përcaktuar në LPP neni 27 i sipërcituar. AK, NJP në cdo rast në procedurat e prokurimit sipas natyrës dhe llojit të procedurës të përcaktojnë drejtë dhe në përputhje me LPP dhe VKM vlerën e kontratës përvojës së mëparshme që duhet të përmbushin OE.

-Në hartimin e kritereve për kualifikim pjese e DST, NJP ka përcaktuar kriteret që duhet të përmbushin OE si kapacitetin ekonomik-financiar, kapaciteti teknik dhe specifikimet teknike.

-“**Në lidhje me kapacitetin teknik**”, në hartimin e kritereve, NJP është mjaftuar vetëm me kërkesën mbi kontratat e ngjashme që duhet të paraqesin OE ndërkohë që pjesë të DST nuk janë përcaktuar kërkesa apo kritere teknike të tjera që duhet të përmbushin OE. Më konkretisht NJP, kërkesat teknike të mallit si: (*certifikata cilësie, certifikatë origjine, të përmbush standartin CE*) i ka kërkuar në specifikimet teknike të mallit, në dokumentacion shoqërues i cili do të paraqitet pas lidhjes së kontratës. Pra këto kërkesa apo kritere të sipërcituara si dhe kërkesa të tjera të nevojshme për të vërtetuar kapacitetet që zotërojnë OE duhet të ishin përcaktuar si pjese e aspektit teknik apo kritereve teknike që duhet të përmbushin OE në fazën e vlerësimit të ofertave. Dokumentacion provues në fazën e vlerësimit të ofertave i shërben AK për të vërtetuar që OE zotërojnë kapacitet, kualifikimet, certifikimet e nevojshme në mënyrë të tillë që të mos çenohen karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të kontratës, dhe duhet të ishin pjesë e DST.

Në përfundim, për sa konstatuar më sipër, është vepruar në mospërputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, si dhe

Neni 27, pika 3 e VKM nr. 914, datë 29. 12. 2014 “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

AK, NJP, në hartimin e DST në lidhje me kapacitetin teknik për të vërtetuar kapacitetet që zotërojnë OE duhet të vendosin kriteret në lidhje me kualifikimet, certifikimet në mënyrë që të mos çenohen kushtet, karakteristikat dhe kërkesat e kontratës si pjesë e aspektit teknik të DST.

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me “Administrimin e Dokumentacionit”:

Nga auditimi i dosjes fizike të procedurës së prokurimit, konstatohet se personi përgjegjës ka kryer administrimin e dokumentacionit të dosjes në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin “Për prokurimin publik”.

Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve, KVO dhe NJP, mbi konfliktin e interesave.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Komisioni i vlerësimit të ofertave në datën 12.03.2018, hyri në sistemin elektronik(SPE) sipas orarit të përcaktuar në DST, në orën 10:30, nga ku u realizua hapja e ofertave dhe rezultoi se ishin pjesmarrës, 2 OE, nga ku KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta Lekë pa TVSH	Skualifikuar/Kualifikuar
1	S . shpk	5,749,800	Kualifikuar/Fituesi
2	S. shpk	4,941,200	Skualifikuar

Referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave, rezulton se KVO-ja, ka kualifikuar vetëm 1(një) OE, duke e shpallur fitues të procedurës së prokurimit OE “S & P 2003” shpk me NIPT ., pasi sipas KVO-së është konsideruar OE i vetëm i cili ka paraqitur dokumentacionin e rregullt, ndërkohë që OE “S.”shpk është konsideruar nga KVO me dokumentacion jo të rregullt dhe jo në përputhje me DST si më poshtë:

1. OE “S.” shpk me NIPT., Arsyet e mëposhtë:

Nuk ka plotësuar tre nga kërkesat e vecanta të kualifikimit të pasqyruara në DST, konkretisht:

Nuk ka depozituar vërtetim nga institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kontratës së lidhur.

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a) kontrata për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshmetë punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

2. Vërtetimi për likuidimin e detyrimeve tatimore duhet të ishte lëshuar brenda periudhës së zhvillimit të procedurës.

Si konkluzion, në lidhje me vlerësimin e ofertave të kryer nga KVO-ja, rezulton se kjo e fundit ka vlerësuar drejt OE pjesëmarrës në garë.

c. Në lidhje me zbatimin e kontratës:

Kontrata me Nr. 138 prot, datë 03.04.2018 lidhur ndërmjet OE “S.” shpk me NIPT . dhe AK, KNRA Orikum. Afati i përcaktuar për dorëzimin e mallrave është 3(tre) ditë kalendarike. Me urdhërin me nr. 54, prot, datë 03.04.2018 është ngritur komisioni i pritjes së mallit në magazinë me përbërje si vijon, (A.T Kryetar, E. S. anëtar, F.G anëtar, S.B anëtar). Kontraktori ka kryer dorëzimin e mallrave më datë 06.04.2018, brenda afatit.

Në lidhje me cilësinë e mallrave të dorëzuar rezulton se nuk janë respektuar kushtet e kontratës, neni 2, pika 2. 1“Qëllimi i furnizimit dhe përshtatshmëria e mallrave me specifikimet”, neni 3 “Përshtatshmëria e mallrave me standartet teknike”, neni 9, “Garancitë” termat e përcaktuar në dispozitat e kontratave mbi “Kushtet e dorëzimit” të mallit, duke administruar në kohën e marrjes në dorëzim të mallrave edhe dokumentacionin shoqërues të përcaktuar në kontratën e nënshkruar si: Çertifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat”, që shërbejnë AK për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë apo garancinë që mallrat duhet të kenë, në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor”.

Si rrjedhojë grupi auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e mallrave. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test-raportit të fabrikës (raportet e testeve), që të konfirmohet që këto mallra janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën OE “S.” shpk

ka fituar tenderin dhe është likuiduar. Grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e mallrave.

4-Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje boje dhe aksesore për lyerje”, viti 2019 si vijon:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12. 014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si më poshtë:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “ Blerje boje dhe aksesore për lyerje ” NR-REF-38565-10-08-2019			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për Propozim” Urdhëri Prokurimit nr. 165 prot, datë 06.09.2019	1. 1 Komisioni i përlogaritjes të vlerësimit të kontratës/testimit tregut 1. A. H. 2. A.T 3. F.G	3. Njësia e Prokurimit 1 . A.K 2. A. H. 3. I.V	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhëri nr. 162 dt. 03.09.2019 1. K. P. 2. E. B. 3. A.T 4. S. Sh.
4. Fondi Limit (pa TVSH) 5,922,940 lekë	5. Oferta fituese (pa TVSH) 5,759,400 lekë Operatori Fitues: OE “V. D.” SHPK		6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 163. 540 lekë
7/1 Data e hapjes së tenderit Datë 21.10.2019	8. Burimi Financimit Vetfinancim		9. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender

(Sipas shtojcës)		Numër 3 OE b) S'kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
7/2 Data e lidhjes së kontratës; Kohëzgjatja e kontratës: Datë 06.11.2019 3 ditë		

Nga auditimi i procedurës konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Është organizuar në një dosje i gjithë dokumentacioni sipas përcaktimeve ligjore, pasqyruar në inventarin e dokumentave të dosjes. Ato përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për zhvillimin e procedurës (informacionin e përgjithshëm dhe atë specifik, kërkesat kualifikuese specifike, specifikimet teknike, grafiku i lëvrimit të mallrave, etj).

Nga të dhënat e dosjes së prokurimit konstatohet se, në lidhje me ***“Parashikimi i fondit limit fillestar sipas rregjistrit”***:

Referuar Rregjistrin të parashikimeve për vitin 2019 si dhe mbështetur në gjendjen në magazinë, me shkresën me nr. 553 prot, datë 29.08.2019 është paraqitur kërkesa nga Z. I.V me detyrë Përgjegjës sektori, me profesion Inxhinier, dhe z. A.K me detyrë Kryeinxhinier, mbi nevojat e zhvillimit të procedurës ***“Blerje bojë dhe aksesore për lyerje”***. Personi përgjegjës për administrimin e procedurës në sistem është përcaktuar Z. A. H. me detyrë Specialist finance & furnizimit në KNRA.

Kërkesa për blerje boje dhe aksesore per lyerje sipas shkresës nr 553, datë 29.08.2019, bazohet në nevojat emergjente për blerje bojë dhe aksesore për lyerje sipas gjendjes së magazinës.

Komisioni i testimi të tregut vlerësoj përlllogaritjen e fondit limit të procedurës për tu prokuruar duke u mbështetur në testimin e tregut me 3(tre) oferta ekonomike të administruara, si dhe referuar çmimeve të artikujve që gjenden në magazinë. Vlera e fondit limit të përlllogaritur rezultoi 5,922,940 lekë pa TVSH.

Artikujt e prokuruar të paraqitur sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Emertimi i Materialit	Specifikime teknike
1	bishta ruli sfungjeri	bishta per lyerje me boje per ryla të vegjel
2	Rula boje të medhenj me bisht	Rula per lyerje me boje: Duhet të jete material pellush i qendrueshem ndaj shkriresave e bojrave, vajrave,naftes
3	Pinello boje 1e 1/2"	Pinello boje 1e 1/2" Duhet të jene material me fije sintetike me dhe bisht druri
4	Pinello boje 2"	Pinello boje 2" Duhet të jene material me fije sintetike me bishtdruri
5	Pinello boje 2 e 1/2"	Pinello boje 2 e 1/2" Duhet të jene material me fije sintetike me doreza druri
6	Paste abrazive	Perdoret per zmerilime të ndryshme në anije. Duhet të jete në kuti plastike 1 kg dhe me ashpersi nga 00 deri 500 mikron. Ngjyra e materialit e bardh
7	Bojë antivegetative	Bojë antivegetative pa organinë, me fortësi të lartë, me veti vetëpastruese 80%. Standarti "Free - TBT" lidhur me mospermbajtjen e biocidit Tributyltin dhe respekton Konventen IMO (Konventa Nderkombetare e Detarisë per Kontrollin e Sistemeve të Demshme anti-fouling (antivegetative)
8	Tretës për bojë antivegetative	Ti pershtatet bojës antivegetative

9	Boje antikorozive e nenujshme	Bojë me dy përbërëse, rezistente ndaj gërryerjes, e veshur me epoksi të pastër, e pigmentuar me alumin, e cila krijon një shtresë rezistente ndaj gërryerjes për t'i dhënë mbrojtje të shkëlqyeshme afatgjatë kundërndryshkut.
10	Tretes per boje antikorozive	Ti pershtatet bojës antikorozive
11	Boje bordi perfundimetare per anije, ngjyra e kuqe	Bojë me rrëshirë alkidi, me shkëlqim, e përshtatshme për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm në sipërfaqe metalike ose druri. :
12	Boje bordi per anije, ngjyra e zezë	Bojë me rrëshirë alkidi, me shkëlqim, e përshtatshme për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm në sipërfaqe metalike ose druri.
13	Boje bordi perfundimetare per anije, ngjyra e bardhë	Bojë me rrëshirë alkidi, me shkëlqim, e përshtatshme për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm në sipërfaqe metalike ose druri.
14	Boje bordi perfundimetare per anije, ngjyra e gri	Bojë me rrëshirë alkidi, me shkëlqim, e përshtatshme për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm në sipërfaqe metalike ose druri.
15	Boje bordi perfundimetare per anije, ngjyra e verdhe	Bojë me rrëshirë alkidi, me shkëlqim, e përshtatshme për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm në sipërfaqe metalike ose druri.
16	Ryla të vegjel me qime të gjata	Ryla boje të vegjel 10 cm të gjate me bishte të zevendesueshem, Materiali të jete sintetik dhe jo pambuk
17	Dylent	Eshtë një përzierje e formuluar posaçërisht e tretësve të dizajnuar për t'u përzierë me bojën për të krijuar konsistencë optimale për aplikim.
18	Defkon per ngjitje (i zi)	Sherben per ngjitjen e metalit me gome (shiritat inox me gomen e gomones si dhe gominat e bokaportave të anijeve)
19	Paste per ngjitje metalesh	Perdoret per ngjitje pjesesh metalike të vogla që nuk punojne nen peshe në anije. Perdoret per të salduar të gjitha metalet e buta (pervec aluminit) Sipas standartit CE
20	Bazament gome Ø 125 me ngjitje	Bazament gome me shterese adezive
21	Bazament gome Ø 150 me ngjitje	Bazament gome me shterese adezive
22	Leter zmerile P-36	Leter zmerile P-36 me ngjitje Ø 125
23	Leter zmerile P-36	Leter zmerile P-36 me ngjitje Ø 150
24	Leter zmerile P-40	Leter zmerile P-40 me ngjitje me Ø 125
25	Leter zmerile P-40	Leter zmerile P-40 me ngjitje Ø 150
26	Leter zmerile P-24	Leter zmerile P-24 me ngjitje me Ø 125
27	Leter zmerile P-24	Leter zmerile P-24 me ngjitje Ø 150
28	Leter zmerile P-220	Leter zmerile P-220 me ngjitje Ø 125
29	Leter zmerile P-220	Leter zmerile P-220 me ngjitje Ø 150
30	Tenie leter e gjere	Tenie leter e gjere
31	Tenie leter e ngushte	Tenie leter e ngushte
32	Stuko rezine	Stuko rezine kuti 1 kg
33	Solucion per shkrirje vajrash	Perdoret per pastyrimin e vendeve ku ka rrjedhje vaji.
34	Leter zmerrile diskore Ø120 mm	Leter zmerile Ø 120 mm grandit P-60
35	Leter zmerrile diskore Ø 150 mm	Leter zmerile Ø 150 mm grandit P-80
36	Leter zmerile P-60	Leter zmerile P-60
37	Leter zmerile P-120	Leter zmerile P-120
38	Leter zmerile P-1200-2000	Leter zmerile P-1200-2000

39	Silikon poliuretani sallam	Silikon poliuretani sallam
40	Maska hunde me filter	Mask mbrojtese me filter karboni sipas CE 0194
41	Maska hunde me dopio filter të zvendesueshem	Maska hunde 3m me dopio filter të zvendesueshem
42	Doreza per lyerje me boje	Doreza per lyerje me boje
43	Filtra Q-045	Filtra per makineri me skorje Q-045
44	Filtra C-005	Filtra per makineri me skorje C-005
45	Filtra Q-005	Filtra per makineri me skorje Q-005

AK (NjP) në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Krieteve”:

Hartimi i DST, procesverbal hartimi nuk ka numër protokollit, datë 24.09.2018, datë e hartimit të procesverbalit. Në të gjitha rastet, në rubrikat e procedurës çdo veprim i kryer duhet të dokumentohet dhe të mbahet me numër protokollit dhe datën e mbajtjes së protokollit pasi dokumenton kohën në të cilën është kryer veprimi.

-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, procesverbalit “për përcaktimin/hartimin e krieteve të pranimit/kualifikimit”, dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), nuk u konstatuan parregullsi në shkelje të Ligjit “Për prokurimin publik”. Si dhe VKM 914 datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar.

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me “Administrimin e Dokumentacionit”:

Nga auditimi i dosjes fizike të procedurës së prokurimit, konstatohet se personi përgjegjës ka kryer administrimin e dokumentacionit të dosjes në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin “Për prokurimin publik”.

Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve, KVO dhe NjP, mbi konfliktin e interesave.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Komisioni i vlerësimit të ofertave në datën 21.10.2019, hyri në sistemin elektronik(SPE) sipas orarit të përcaktuar në DST, në orën 10:00, nga ku u realizua hapja e ofertave dhe rezultoi se ishin pjesmarrës, 3 OE, nga ku KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta Lekë pa TVSH	Skualifikuar/Kualifikuar
1	E.- V.	-	SKualifikuar
2	M.	-	SKualifikuar
3	O.-V.	5. 759. 400	Kualifikuar

Referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave, rezulton se KVO-ja, ka kualifikuar vetëm 1(një) OE, duke e shpallur fitues të procedurës së prokurimit OE “O.-V.” shpk me NIPT J.....U.

Sipas Komisionit të vlerësimit të ofertave, 2 operatorët e skualifikuar nuk kishin ngarkuar asnjë dokumentacion në SPE.

Si konkluzion, AK ka vepruar drejtë në përcaktimin e ofertues fituese, me dokumentacion të rregullt kualifikues dhe në përputhje me DST.

c. Në lidhje me zbatimin e kontratës:

Kontrata me Nr. 736 prot, datë 06.11.2019 lidhur ndërmjet OE “O.-V.” shpk me NIPT J.....U dhe AK, KNRA Orikum. Afati i përcaktuar për dorëzimin e mallrave është **3 ditë** kalendarike. Me urdhërin me nr. 221, prot, datë 04.11.2019 është ngritur komisioni i pritjes së mallit në magazinë me përbërje si vijon, (M. D. Kryetar, B. B. anëtar, R. E. anëtar, S.B anëtar). Kontraktori ka kryer

dorëzimin e mallrave më datë 11.11.2020, jashtë afatit, 2 ditë me vonesë nga afati i parashikuar për të gjithë vlerën e kontratës.

Në këto kushte referuar neni 24 (*Likuidimi i dëmeve për dorëzim të vonuar*), neni 24 pika 1, dëmet e likujduara për dorëzimin e vonuar të mallrave do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë sa 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimumi mbi 25% të vlerës së kontratës.

Për sa më sipër aplikimi i dëmit do të përlllogaritet $4/1000 * 5,759,400 * 2 \text{ ditë} = 46,075 \text{ lekë}$, vlerë e cila i është mbajtur OE **“O.-V.” shpk**.

5-Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje boje dhe aksesore për lyerje”, viti 2020 si vijon:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkëlqje të Ligjit nr. 9643, datë 20.12.2020, *“Për prokurimin publik”*, si më poshtë:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje boje dhe aksesore për lyerje” NR-REF-68284-08-11-2020			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për Propozim” Urdhëri Prokurimit nr. 534 prot, datë 11.08.2020	1. 1 Komisioni i përlllogaritjes të vlerësimit të kontratës/testimit tregut Urdhëri nr. 515, datë 06.08.2020 1. A. M. 2. B. B. 3. F. G.	2 Njësia e Prokurimit 1. A. K. 2. L. L. 3. I. V.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhëri nr. 519, dt. 07.08.2020 1. K. P. 2. A.G 3. M. M. 4. A.T 5. T. V.
4. Fondi Limit (pa TVSH) 5,734,750 lekë	5. Oferta fituese (pa TVSH) 5,369,500 lekë Operatori Fitues: OE “O. V.” SHPK	6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 365,350 lekë	
7/1 Data e hapjes së tenderit Datë 31. 08. 2020(Sipas shtojcës)	8. Burimi Financimit Vetfinancim	9. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 6 OE b) S’kualifikuar 5 OE, c) Kualifikuar 1 OE	
7/2 Data e lidhjes së kontratës; Kohëzgjatja e kontratës: Datë 05. 10. 2020 3 ditë			

Nga auditimi i procedurës konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Është organizuar në një dosje i gjithë dokumentacioni sipas përcaktimeve ligjore, pasqyruar në inventarin e dokumentave të dosjes. Ato përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për zhvillimin e procedurës (informacionin e përgjithshëm dhe atë specifik, kërkesat kualifikuese specifike, specifikimet teknike, grafiku i lëvrimit të mallrave, etj).

Nga të dhënat e dosjes së prokurimit konstatohet se, në lidhje me **“përlllogaritjen e fondit limit”**:

Referuar rregjistrin të parashikimeve për vitin 2020 si dhe mbështetur në gjendjen në magazinë, me shkresën me nr. 511 prot, datë 06.08.2020 është paraqitur kërkesa nga përgjegjësi i sektorit të nxjerrjes së anijes në shkallë, z. I.V me profesion Inxhinier si dhe z. A.K me detyrë Kryeinxhinier,

me profesion Inxhiner, mbi nevojat e zhvillimit të procedurës “Blerje materiale boje dhe aksesore për lyerje”. Personi përgjegjës për administrimin e procedurës në sistem është përcaktuar znj. L.L me detyrë përgjegjëse sektori në administratë.

Me urdhrin me nr. 515, datë 06.08.2020 është ngritur komisioni i testimit të tregut me përbërje, z. A. M. (Kryetar), z. B. B.(anëtar) si dhe z. F.G(anëtar). Ky komisioni kreu përlloraritjen e vlerës limit të kontratës duke u mbështetur në testimin e tregut me 3(tre) oferta ekonomike të adminstruara, Vlera e fondit limit të përlloratur rezultoi 5,734,750 lekë pa TVSH.

Artikujt e prokuruar të paraqitur sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Emertimi i Materialit	Specifikime teknike
1	Bishta ruli sfungjeri	Bishta për lyerje me bojë për ryla të vegjël bisht plastik për ryla 10 cm
2	Rula boje të medhenj me bisht	Rula per lyerje me boje: Duhet të jete material pellush i qendrueshem ndaj shkriresave e bojrave, vajrave, naftes dhe detergjenteve. me doreze me gatesi të ndryshme.
3	Bojë antivegjetative	Afati i skadencës minimumi 2 vjet Ngjyra e kuqe (kuti 20 l). Kufijte e temperatures se perdorimit + 10 ; -35 grad celcius. L. së
4	Tretës për bojë antivegjetative	Te pershtatet me tipin e bojës
5	Boje antikorozive e nenujshme	Boje antiruxho 2 komponenteshe me katalit
6	Tretes per bije antikorozive	Ti pershtatet bojës antikorozive
7	Boje bordi perfundimetare per anije, ngjyra e kuqe	Kapaciteti teorik i mbulimit..... . 11-12 m ² / liter . Pikakritike e ndezjes..... . tipike ≥40 ° C. Konfeksioni kuti 5 liter
8	Boje bordi per anije, ngjyra e zezë	Kapaciteti teorik i mbulimit..... . 11-12 m ² / liter . Pikakritike e ndezjes..... . tipike ≥40 ° C. Konfeksioni kuti 5 liter
9	Boje bordi perfundimetare per anije, ngjyra e bardhë	Kapaciteti teorik i mbulimit..... . 11-12 m ² / liter . Pikakritike e ndezjes..... . tipike ≥40 ° C. -. Konfeksioni kuti 5 liter
10	Boje bordi perfundimetare per anije, ngjyra e gri	Kapaciteti teorik i mbulimit..... . 11-12 m ² / liter . Pikakritike e ndezjes..... . tipike ≥40 ° C. - Koha e tharjes në diapazonin e temperatures 5°C deri 35 ° C a- në prekjen me dore sipas ISO 9117/3: 2010 ose ekuivalentnga 18 ore deri 5 ore. b- në tharjen e forte ISO 9117-1: 2009 ose ekuivalent nga 62 ore deri 12 ore
11	Boje bordi perfundimetare per anije, ngjyra e verdhe	Konfeksioni kuti 5 liter
12	Ryla të vegjël me qime të gjata	Ryla boje të vegjël 10 cm të gjatë me bishtë të zvendësueshem
13	Hollues boje (Dylent)	Eshtë një përzierje e formuluar posaçërisht e tretësve të dizajnuar për t'u përzierë me bojën për të krijuar konsistence optimal për aplikim. 11.3%(butan-1-ol) Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson të gjitha kerkesat e ketij Specifikimi Teknik.
14	Defkon per ngjitje (i zi)	defkon për ngjitje, ngjyra e zezë, 2 komponentësh konfeksion 400 ml.
15	Tenie leter e gjere	Tenie leter e gjere. 50 mm e gjerë, minimumi i gjatësisë 38 m gjatësi minimumi i temperaturës që duron 60 grad
16	Tenie leter e ngushte	Tenie leter e ngushte 19 mm gjerësi, minimumii gjatësisë 38 m gjatësi. minimumi i temperaturës që duron 60 grad
17	Stuko rezine	Stuko rezine kuti 1 kg
18	Leter zmerile P24 Φ125	Leter zmerile Ø 120 mm grand P-24
19	Leter zmerile P24 Φ150	Leter zmerile Ø 150 mm grand P-24

Gjetjet e konstatuara,

-Komisioni i ngritur nuk ka mbajtur procesverbal mbi testimin e tregut të kryer, veprim i cili dokumenton procesin e kryerjes të testimit të tregut duke përcaktuar gjurmën e auditimit në përmbajtje të përcaktimeve të bëra në Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Pra mbajtja e procesverbalit konfirmon procesin e kryer nga ana e komisionit.

-Kriteri i paraqitjes së mostrave me qëllim për të vërtetuar përmbushjen e kërkesave, kriterëve, kushteve, specifikimeve teknike etj, është jo i mirëargumentuar teknikisht nga Njësia e Prokurimit. Referuar kriterit të kërkuar grupi auditimit gjykon që në lidhje me përmbushjen e kapaciteteve teknike, specifikimeve teknike, kërkesave, kushteve, karakteristikave të përgjithme dhe të vecanta etj AK, duhet të ishte mjaftuar vetëm me ato të listuara përcaktuara në DST. Pra përmbushja e dokumentacionit kërkuar nga AK në DST si psh (*autorizim nga prodhuesi/distributori, katalogje të prodhuesit për produktet objekt procedure, certifikata cilësie, etj*) janë të mjaftueshme për të vërtetuar cilësinë apo përmbushjen e kriterëve nga ana e OE. Ndërkohë që mbi këto kërkesa, kriteri i paraqitjes së mostrave është mund të sjellë kufizimin e numrit të OE pjesmarrës. Për me tepër KNRA është zonë e kufizuar sa i përket lëvizjes pasi është zonë ushtarake dhe hyrjet-daljet bëhen sipas rregullave të përcaktuara në Procedurën Standarte të të Veprimit SOP 209/3, të miratuar nga Ministri i Mbrojtjes me Urdhërin nr. 1044, datë 09.07.2019 “Për miratimin e procedurës Standarte”,

Si konkluzion, kriteret apo kërkesat e përcaktuara nga AK si (paraqitja e mostrave) duhet të mirëargumentohet pasi mund të ngushtojë konkurrencën si dhe mund të mos nxisin pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm duke u bërë pengesë si dhe duke çënuar parimet kryesore të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP).

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me “Administrimin e Dokumentacionit”:

Nga auditimi i dosjes fizike të procedurës së prokurimit, konstatohet se personi përgjegjës ka kryer administrimin e dokumentacionit të dosjes në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin “Për prokurimin publik”.

Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve, KVO dhe NjP, mbi konfliktin e interesave.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Komisioni i vlerësimit të ofertave në datën 24.08.2020, hyri në sistemin elektronik(SPE) sipas orarit të përcaktuar në DST, në orën 9:00, nga ku u realizua hapja e ofertave dhe rezultoi se ishin pjesmarrës, 6 OE, nga ku KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta Lekë pa TVSH	Skualifikuar/Kualifikuar
1	O. V.	5,369,500	Kualifikuar/Fituesi
2	U. C.	4,283,000	SKualifikuar
3	G. H.	5,520,250	Skualifikuar
4	V. A.	5,021,580	Skualifikuar
5	M.	0,00	Skualifikuar
6	F. V.	0,00	Skualifikuar

Referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave, rezulton se KVO-ja, ka kualifikuar vetëm 1(një) OE, duke e shpallur fitues të procedurës së prokurimit OE “O. V.” shpk me NIPT ., sipas KVO-së OE i vetëm i cili ka paraqitur mostrat, ndërkohë që 5(pesë) OE, janë skualifikuar pasi KVO-ja i ka konsideruar si jo të rregullt dhe jo në përputhje me DST dokumentacion e tyre si më poshtë:

1. OE “U. C.”shpk me NIPT; ., Arsyet e mëposhtë:
Nuk ka paraqitur mostrat e kërkuara ndërkohë që dokumentacioni tekniko-ligjor është konsideruar i rregullt dhe në përputhje me DST.

2. OE “G. H.”PF me NIPT; ., Arsyet e mëposhtë:
Nuk ka paraqitur mostrat e kërkuara ndërkohë që dokumentacioni tekniko-ligjor është konsideruar i rregullt dhe në përputhje me DST.

3. OE, “M.”shpk, shpk me NIPT; ., Arsyet e mëposhtme:
Nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë të kërkuar sipa DST.

4. OE “V. A.”sh. a me NIPT; ., Arsyet e mëposhtë:
Nuk ka paraqitur mostrat e kërkuara ndërkohë që dokumentacioni tekniko-ligjor është konsideruar i rregullt dhe në përputhje me DST.

5. OE “F. V.”shpk me NIPT; ., Arsyet e mëposhtë:
Nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë të kërkuar sipa DST.

-Në lidhje me vlerësimin e ofertave është paraqitur ankesë pranë AK, nga OE,

Si konkluzion, për sa më sipër, në lidhje me vlerësimin e ofertave të kryer nga KVO-ja, rezulton se kjo e fundit **se ka vlerësuar drejtë** OE pjesëmarrës në garë, kërkesa apo kriteri në lidhje me paraqitjen e mostrave ka rezultuar se ka ndikuar në në shpalljen e ofertës fituese.

c. Në lidhje me zbatimin e kontratës:

Kontrata me Nr. 690 prot, datë 05.10.2020 lidhur ndërmjet OE “O.-V.”shpk me NIPT . dhe AK, KNRA Orikum. Afati i përcaktuar për dorëzimin e mallrave është 3 ditë kalendarike. Me urdhërin me nr. 693, prot, datë 06.10.2020 është ngritur komisioni i pritjes së mallit në magazinë me përbërje si vijon, (E. A. Kryetar, B. B. anëtar, S. K. anëtar, A. M. anëtar). Kontraktori ka kryer dorëzimin e mallrave më datë 12. 10. 2020, jashtë afatit, 4 ditë me vonesë nga afati i parashikuar për të gjithë vlerën e kontratës.

Në këto kushte referuar neni **24** (*Likuidimi i dëmeve për dorëzim të vonuar*), neni 24. 1, dëmet e likuajuara për dorëzimin e vonuar të mallrave do të llogaritet me tarifat e mëposhtme ditore:

a) *Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë sa 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimumi mbi 25% të vlerës së kontratës.*

Sa më sipër nga Njësia i është përlllogaritur dëmi për dorëzim të vonuar në vlerën **85,912 lekë pa TVSH**.

6-Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Sigurimi i shkallës me limit përgjegjësie 100,000,000 lekë”, viti 2020 si vijon:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, proces-verbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, nuk u konstatuan parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, si më poshtë:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “ Sigurimi i shkallës 2020 ” NR-REF-64485-07-07-2020			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për Propozim” Urdhëri Prokurimit nr. 162 prot, datë 02.07.2020	1. 1 Komisioni i përlllogaritjes të vlerësimit të kontratës/testimit tregut/ analizë kosto 1. A.K 2. L.L 3. T. V.	2. Njësia e Prokurimit 1. A.K 2. L.L 3. T. V.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhëri nr. 160 dt. 01.07.2020 1. K.P 2. A.T 3. A. H.

			4. E. B. 5. S. Sh.
4. Fondi Limit (pa TVSH) 4. 440. 000 lekë	5. Oferta fituese (pa TVSH) 4. 433. 000 lekë Operatori Fitues: OE “E.” SHPK	6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 110. 000lekë	
7/1 Data e hapjes së tenderit Datë 20.07.2020 (Sipas shtojcës)	8. Burimi Financimit Vetfinancim	9. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 1 OE b) S’kualifikuar 0 OE , c) Kualifikuar 1 OE	
7/2 Data e lidhjes së kontratës; Kohëzgjatja e kontratës: Datë 14.08.2020 Sherbim nga dita e lidhjes se kontratës			

Nga auditimi i procedurës konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Është organizuar në një dosje i gjithë dokumentacioni sipas përcaktimeve ligjore, pasqyruar në inventarin e dokumentave të dosjes. Ato përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për zhvillimin e procedurës (informacionin e përgjithshëm dhe atë specifik, kërkesat kualifikuese specifike, specifikimet teknike, grafiku i lëvrimit të mallrave, etj).

Nga të dhënat e dosjes së prokurimit konstatohet se, në lidhje me “Parashikimi i fondit limit fillestar sipas rregjistrit”:

Referuar Rregjistrin të parashikimeve për vitin 2020 si dhe mbështetur në gjendjen në magazinë, me shkresën me nr. 342 prot, datë 29.06.2020 është paraqitur kërkesa nga Z. A.K me detyrë kryeinxhinier, me profesion inxhinier,, mbi nevojat e zhvillimit të procedurës “**SIGURIMI I SHKALLËS**”

Personi përgjegjës për administrimin e procedurës në sistem është përcaktuar Znj. L.L me detyrë Jurist në KNRA.

Kërkesa për **SIGURIMI I SHKALLËS**” sipas shkresës nr 342, datë 29.03.2020, bazohet në riskun se prej më shumë se tre vitesh, platforma (shkalla Kosjakova) që mundëson nxjerrjen e mjeteve lundruese në tokë, për shkak të amortizimit dhe veprimtarisë së punës mbi 50 vite, ka bërë që dokimi i mjeteve lundruese të kryhet me një shkallë të lartë risku dhe pasiguri teknike, ç’ka mund të sillte dhe ngjarje të jashtëzakonshme si dëmtime në burime njerëzore apo materiale. Me këtë procedurë sigurohet “Sigurimin e përgjegjësive Profesionale ndaj Palëve të Treta me limit të përgjegjësive 100,000,000 (njëqind milion) lekë”.

Komisioni i testimi i tregut kreu përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës duke u mbështetur në testimin e tregut me 3(tre) oferta ekonomike të administruara, si dhe cmimin e magazinës. Vlera e fondit limit të përlllogaritur rezultoi 4,498,387 lekë pa TVSH.: Cmimi mesatar i ofertave të paraqitura nga subjektet e sigurimit dhe cmimi i ofruar për këtë shërbim nga kompania fituese në vitin 2019 është më i lartë se fondi i planifikuar në Rregjistrin e prokurimeve për vitin 2020. Për sa më sipër cmimi i fondit limit për zhvillimin e kësaj procedure është lënë cmimi i publikuar në rregjistrin e prokurimit publik.

- Sigurimin e përgjegjësive Profesionale ndaj Palëve të Treta me limit të përgjegjësive 100,000,000 (njëqind milion) lekë”.

AK (NjP) në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Krieteve”:

Hartimi i DST (procesverbal hartimi nr 355 prot, datë 02.07.2020, datë e hartimit)

-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, procesverbalit “për përcaktimin/hartimin e krieteve të pranimit/kualifikimit”, dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), nuk u konstatuan parregullsi në shkelje të Ligjit “Për prokurimin publik”.

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me “Administrimin e Dokumentacionit”:

Nga auditimi i dosjes fizike të procedurës së prokurimit, konstatohet se personi përgjegjës ka kryer administrimin e dokumentacionit të dosjes në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin “Për prokurimin publik”.

Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve, KVO dhe NjP, mbi konfliktin e interesave.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Komisioni i vlerësimit të ofertave në datën 27.07.2020 hyri në sistemin elektronik(SPE) sipas orarit të përcaktuar në DST, në orën 10:30, nga ku u realizua hapja e ofertave dhe rezultoi se ishin pjesmarrës, 1 OE, nga ku KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta Lekë pa TVSH	Skualifikuar/Kualifikuar
1.	E. sha	4. 433. 000	Kualifikuar

Referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave, rezulton se KVO-ja, ka kualifikuar të vetmin OE i cili ka shfaqur interes për këtë procedurë, duke e shpallur fitues të procedurës së prokurimit OE “E. sha” shpk me NIPT K.....Ë.

Si konkluzion.

c. Në lidhje me zbatimin e kontratës:

Kontrata me Nr. 568 prot, datë 14.08.2020 lidhur ndërmjet OE E. sha me NIPT . dhe AK, KNRA Orikum. Afati i përcaktuar për fillimin e shërbimit nga dita e lidhjes së kontratës datë 14.08.2020.

7-Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje rrota për vagonat e shkallës”,viti 2020 si vijon:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, proces-verbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, nuk konstatuan parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si më poshtë:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “ Blerje rrota për vagonat e shkallës ” NR-REF-66550-08-12-2020			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për Propozim” Urdhëri Prokurimit nr. 220 prot, datë 12.08.2020	1. 1 Komisioni i përlogaritjes të vlerësimit të kontratës/testimit tregut/ analizë kosto	2. Njësia e Prokurimit	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave
	1. A. M. 2. A.T 3. A. A.	1A.K 2. L.L 3. T .V	Urdhëri nr. 216 dt. 11.08.2020 1. K.P 2. M. M. 3. A. H. 4. E. B. 5. S. Sh.

4. Fondi Limit (pa TVSH) 2,401,800 lekë	5. Oferta fituese (pa TVSH) 2,388,000 lekë Operatori Fitues: OE "S." SHPK	6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 13,800lekë
7/1 Data e hapjes së tenderit Datë 25.08.2020 (Sipas shtojcës)	8. Burimi Financimit Vetfinancim	9. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 1 OE b) S'kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
7/2 Data e lidhjes së kontratës; Kohëzgjatja e kontratës: Datë 08.05.2017 15 ditë		

Nga auditimi i procedurës konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Është organizuar në një dosje i gjithë dokumentacioni sipas përcaktimeve ligjore, pasqyruar në inventarin e dokumentave të dosjes. Ato përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për zhvillimin e procedurës (informacionin e përgjithshëm dhe atë specifik, kërkesat kualifikuese specifike, specifikimet teknike, grafiku i lëvrimit të mallrave, etj).

Nga të dhënat e dosjes së prokurimit konstatohet se, në lidhje me *"Parashikimi i fondit limit fillestar sipas rregjistrimit"*:

Referuar Rregjistrimit të parashikimeve për vitin 2020 si dhe mbështetur në gjendjen në magazinë, me shkresën me nr. 532 prot, datë 10.03.2020 është paraqitur kërkesa nga Z. A.K me detyrë kryeinxhinier, me profesion inxhinier,, mbi nevojat e zhvillimit të procedurës "Blerje rrota për vagonat e shkallës 2020".

Personi përgjegjës për administrimin e procedurës në sistem është përcaktuar Znj. L.L me detyrë Jurist në KNRA.

Kërkesa për "Blerje rrota për vagonat e shkallës 2020" sipas shkresës nr 532, datë 10.08.2020, bazohet në nevojat për të mbajtur në eficiencë të plotë shkallën Kosjakova si dhe për të bërë të mundur vendosjen në funksion të vagonave që janë dëmtuar.

Komisioni i testimit i tregut kreu përllogaritjen e vlerës limit të kontratës duke u mbështetur në testimin e tregut me 3(tre) oferta ekonomike të administruara, si dhe cmimin e magazinës për artikullin sipas tabelës së mëposhtme. Vlera e fondit limit të përllogaritur rezultoi 2,401,800 lekë pa TVSH. :

Nr	Emertimi I Materialit	Specifikime teknike
1	Rrota shkalle o530	Rrota shkalle material çelik45 maksimal o 530mm, diametri i. Sipas vizatimit

AK (NjP) në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Krieteve":

Hartimi i DST (procesverbal hartimi nr . 550prot, datë 12.08.2020)

- Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, procesverbalit *"për përcaktimin/hartimin e krieteve të pranimit/kualifikimit"*, dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), nuk u konstatuan parregullsi në shkelje të Ligjit *"Për prokurimin publik"*.

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":

Nga auditimi i dosjes fizike të procedurës së prokurimit, konstatohet se personi përgjegjës ka kryer administrimin e dokumentacionit të dosjes në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin *"Për prokurimin publik"*.

Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve, KVO dhe NjP, mbi konfliktin e interesave.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Komisioni i vlerësimit të ofertave në datën 25.08.2020 hyri në sistemin elektronik(SPE) sipas orarit të përcaktuar në DST, në orën 09:00, nga ku u realizua hapja e ofertave dhe rezultoi se ishin pjesmarrës, 1 OE, nga ku KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta Lekë pa TVSH	Skualifikuar/Kualifikuar
1	S.	2. 388. 000	Kualifikuar

Referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave, rezulton se KVO-ja, ka kualifikuar të vetmin OE i cili ka shfaqur interes për këtë procedurë, duke e shpallur fitues të procedurës së prokurimit OE “S.” shpk me NIPT K.....,O.

Si konkluzion, KVO ka vepruar drejtë në shpalljen e ofertës fitues pasi dokumentacioni i OE S. është i rregullt dhe në përputhje me DST.

c. Në lidhje me zbatimin e kontratës:

Kontrata me Nr. 638 prot, datë 10.09.2020 lidhur ndërmjet OE “S.”shpk me NIPT . dhe AK, KNRA Orikum. Afati i përcaktuar për dorëzimin e mallrave është 15 ditë. Me urdhërin me nr. 248, prot, datë 10.09.2020 është ngritur komisioni i pritjes së mallit në magazinë me përbërje si vijon, (A.T Kryetar, K. K. anëtar, D. M. anëtar, A. M. anëtar). Kontraktori ka kryer dorëzimin e mallrave më datë 11.09.2020. brenda afatit.

8-Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje boje dhe aksesore për lyerje”, viti 2022 si vijon:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si më poshtë:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje boje dhe aksesore për lyerje” NR-REF-21873-03-11-2022			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “E hapur e thjeshtuar” Urdhëri Prokurimit nr. 166 prot, datë 07.03.2022	1. 1 Komisioni i përlogaritjes të vlerësimit të kontratës/testimit tregut Urdhëri nr. 125, datë 28.02.2022 1. A. M. 2. B. B. 3. F. G.	2 Njësia e Prokurimit 1. A. K. 2. L. L. 3. I. V.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhëri nr. 167, dt. 06.03.2022 1. K. P. 2. M. R. 3. S. S. 4. A. M. 5. G. B.
4. Fondi Limit (pa TVSH) 5,417,250 lekë	5. Oferta fituese (pa TVSH) 5,244,000 lekë Operatori Fitues: OE “V.D.” SHPK		6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 173,250 lekë
7/1 Data e hapjes së tenderit Datë 25.03.2022	8. Burimi Financimit Vetfinancim		9. Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 2 OE b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
7/2 Data e lidhjes së kontratës;Kohëzgjatja e kontratës: Datë 15. 04. 2022 12 muaj			

Nga auditimi i procedurës konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Është organizuar në një dosje i gjithë dokumentacioni sipas përcaktimeve ligjore, pasqyruar në inventarin e dokumentave të dosjes. Ato përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për zhvillimin e procedurës (informacionin e përgjithshëm dhe atë specifik, kërkesat kualifikuese specifike, specifikimet teknike, grafiku i lëvrimit të mallrave, etj).

Nga të dhënat e dosjes së prokurimit konstatohet se, në lidhje me **“përlllogaritjen e fondit limit”**: Referuar rregjistrin të parashikimeve për vitin 2022 që KNRA ka miratuar si dhe mbështetur në gjendjen në magazinë, nga ku sasisa është drejt përfundimit, me shkresën me nr. 101 prot, datë 21.02.2022 është paraqitur kërkesa nga përgjegjësi i sektorit të nxjerrjes së anijes në shkallë, z. I.V me profesion Inxhinier si dhe z. A.K me detyrë Kryeinxhinier, me profesion inxhinier, mbi nevojat e zhvillimit të procedurës **“Blerje materiale boje dhe aksesore për lyerje”**. Personi përgjegjës për administrimin e procedurës në sistem është përcaktuar znj. L.L me detyrë Jurist i KNRA.

Kërkesa e paraqitur e mbështetur në dokumentacion justifikues si, gjendjen në magazinë normativat e konsumit (kryesisht të bojës), sipërfaqen që mbulon, si dhe numrin e anijeve që do të mbulohet me të gjithë sasinë.

Me urdhrin me nr. 125 prot, datë 28.02.2022 është ngritur komisioni i testimin të tregut me përbërje, z. A. M.(Kryetar), z. B. B. (anëtar) si dhe z. F.G(anëtar). Ky komisioni kreu përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës duke u mbështetur në testimin e tregut me 3(tre) oferta ekonomike të adminstruara, ofertat e OE “R.” shpk me NIPT ., “G. N.” shpk me NIPT ., “.”shpk me NIPT . me vlerë mesatare 5,417,250 lekë pa TVSH. Vlera e fondit limit të përlllogaritur rezultoi 5,734,750 lekë pa TVSH.

Artikujt e prokuruar të paraqitur sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Emertimi I Materialit	Specifikime teknike
1	Bishta ruli sfungjeri	Bishta për lyerje me bojë për ryla të vegjël bisht plastik për ryla 10 cm
2	Rula boje të medhenj me bisht	Rula per lyerje me boje: Duhet të jete material pellush i qendrueshem ndaj shkriresave e bojrave, vajrave,naftes dhe detergjenteve. me doreze me gjatesi të ndryshme. .
3	Bojë antivegetative	Afati i skadencës minimumi 2 vjet Ngjyra e kuqe (kuti 20 l). Kufijte e temperatures se perdorimit + 10 ; -35 grad celcius. L. së
4	Tretës për bojë antivegetative	Te pershtatet me tipin e bojës
5	Boje antikorozive e nenujshme	Boje antiruxho 2 komponenteshe me katalit
6	Tretes per bije antikorozive	Ti pershtatet bojës antikorozive
7	Boje bordi perfundimetare per anije, ngjyra e kuqe	Kapaciteti teorik i mbulimit..... . 11-12 m ² / liter . Pikakritike e ndezjes..... . tipike ≥40 ° C. Konfeksioni kuti 5 liter
8	Boje bordi per anije, ngjyra e zezë	Kapaciteti teorik i mbulimit..... . 11-12 m ² / liter . Pikakritike e ndezjes..... . tipike ≥40 ° C. Konfeksioni kuti 5 liter
9	Boje bordi perfundimetare per anije, ngjyra e bardhë	Kapaciteti teorik i mbulimit..... . 11-12 m ² / liter . Pikakritike e ndezjes..... . tipike ≥40 ° C. -. Konfeksioni kuti 5 liter
10	Boje bordi perfundimetare per anije, ngjyra e gri	Kapaciteti teorik i mbulimit..... . 11-12 m ² / liter . Pikakritike e ndezjes..... . tipike ≥40 ° C. - Koha e tharjes në diapazonin e temperatures 5°C deri 35 ° C a- në prekjen me dore sipas ISO 9117/3: 2010 ose ekuivalentnga 18 ore deri 5 ore. b- në tharjen e forte ISO 9117-1: 2009 ose ekuivalent nga 62 ore deri 12 ore
11	Boje bordi perfundimetare per anije, ngjyra e verdhe	. Konfeksioni kuti 5 liter
12	Ryla të vegjël me qime të gjata	Ryla boje të vegjël 10 cm të gjatë me bishtë të zvendësueshem

		Eshtë një përzierje e formuluar posaçërisht e tretësve të dizajnuar për t'u përzierë me bojën për të krijuar konsistence optimal për aplikim. : 11.3% (butan-1-ol)
13	Hollues boje (Dylent)	Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai plotëson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik.
14	Defkon per ngjitje (i zi)	defkon për ngjitje, ngjyra e zezë, 2 komponentësh konfeksion 400 ml.
15	Tenie leter e gjere	Tenie leter e gjere. 50 mm e gjerë, minimumi i gjatësisë 38 m gjatësi minimumi i temperaturës që duron 60 grad
16	Tenie leter e ngushte	Tenie leter e ngushte 19 mm gjerësi, minimumi i gjatësisë 38 m gjatësi. minimumi i temperaturës që duron 60 grad
17	Stuko rezine	Stuko rezine kuti 1 kg
18	Leter zmerile P24 Φ125	Leter zmerile Ø 120 mm grand P-24
19	Leter zmerile P24 Φ150	Leter zmerile Ø 150 mm grand P-24

-Komisioni i ngritur nuk ka mbajtur procesverbal mbi testimin e tregut të kryer, veprim i cili dokumenton procesin e kryerjes të testimit të tregut duke përcaktuar gjurmën e auditimit në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Rregullat e Prokurimit Publik”, **neni 2, pika 1, 2, a), nenin 73, nenin 74** si dhe Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

AK (NjP) në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriereve”:

Janë hartuar dhe publikuar dokumentat e tenderit në hartimin e të cilave nuk ka pasur ankesa. ME procesverbalin me nr. 168, datë 08.03.2022 janë argumentuar kriteret e vendosura.

- Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, procesverbalit “për përcaktimin/hartimin e kriereve të pranimit/kualifikimit”, dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit “Për prokurimin publik”.

-Konkretisht, konstatohet se në kriteret e veçanta për kualifikim, pjesë e dokumenteve të tenderit(DST) të hartuara dhe miratuara nga NJP, është mbajtur procesverbali i hartimit të kriereve të veçanta, me nr. 168 prot, datë 08.03.2022. Në procesverbal Njësia e prokurimit ka listuar kriteret e kërkesave të veçanta për kualifikim, në të cilin është mjaftuar me pasqyrimin në terma të përgjithshëm se; “ për kriteret e përcaktuara njësia e prokurimit ka zbatuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,Ligjin nr. 162 datë 23.12.2020 ndërsa në asnjë rast nuk ka argumentim teknik në lidhje me vendosjen e kërkesave dhe kriteret e kualifikimit, por është mjaftuar vetëm me pasqyrimin se, vendosja e këtyre kërkesave është në mbështetje të VKM, të ligjit. Baza ligjore së cilës i referohet NJHDT është pjesa e së drejtës që AK, ka për të parashikuar në kriteret e vendosura për nevojën e mjeteve, pajisjeve teknike, përmbushjen e specifikimeve teknike ndërsa argumentimi teknik në lidhje me to, është detyrimi që ka AK për vendosjen kriereve.

Veprim ky në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **neni 78, pika 2** “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se:“Në çdo rast, hartimi i kriereve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të **argumentohen teknikisht** dhe ligjërisht dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

-Në lidhje me “**kriterin e paraqitjes së mostrave**” me qëllim për të vërtetuar përmbushjen e kërkesave, kriereve, kushteve, specifikimeve teknike etj, grupi auditimit gjykon që në lidhje me përmbushjen e kapaciteteve teknike, specifikimeve teknike, kërkesave, kushteve, karakteristikave të përgjithme dhe të veçanta etj AK, duhet të ishte mjaftuar vetëm me ato të listuara përcaktuara në DST. Pra përmbushja e dokumentacionit kërkuar nga AK në DST si psh (autorizim nga prodhuesi/distributori, katalogje të prodhuesit për produktet objekt procedure, certifikata cilësie,

etj.) janë të mjaftueshme për të vërtetuar cilësinë apo përmbushjen e kritereve nga ana e OE. Ndërkohë që mbi këto kërkesa, kriteri i paraqitjes së mostrave është i tepërt. Për me tepër KNRA është zonë e kufizuar sa i përket lëvizjes pasi është zonë ushtarake dhe hyrjet-daljet bëhen sipas rregullave të përcaktuara në Procedurën Standarte të Veprimit SOP 209/3, të miratuar nga Ministri i Mbrojtjes me Urdhërin nr. 1044, datë 09.07.2019, “Për miratimin e procedurës Standarte.

Si konkluzion, kriteret apo kërkesat e përcaktuara nga AK si (paraqitja e mostrave dhe mos argumentimi teknik i kritereve të listuara) mund të ngushtojnë konkurrencën si dhe mund të mos nxisin pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm .

Veprim ky në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 40, nenin 78, pika 2 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të **argumentohen teknikisht** dhe ligjërishit dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me “Administrimin e Dokumentacionit”:

Nga auditimi i dosjes fizike të procedurës së prokurimit, konstatohet se personi përgjegjës ka kryer administrimin e dokumentacionit të dosjes në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin “Për prokurimin publik”.

Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve, KVO dhe NjP, mbi konfliktin e interesave.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) nuk e ka dokumentuar procesin e vlerësimit të ofertave me procesverbal. Pra veprimet e kryera nga anëtarët e KVO dokumentohen nëpërmjet një procesverbali duke iu përmbajtuur përcaktimeve të bëra në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, neni 74, pika 3, e) ku shpreh:

Administrimin e të gjitha procesverbaleve për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti;

Komisioni i vlerësimit të ofertave në datën 25.03.2020, hyri në sistemin elektronik(SPE) sipas orarit të përcaktuar në DST, në orën 8:30, nga ku pas hapjes së ofertave rezultuan pjesmarrës, 2 OE, nga ku KVO-ja ka kreu në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta Lekë pa TVSH	Skualifikuar/Kualifikuar
1	V. D.	5,244,000	Kualifikuar/Fituesi
2	U. C.	4,388,000	SKualifikuar

Referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave, rezulton se KVO-ja, ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues sipas formularit të njoftim fituesit më nr. 204 prot, datë 31.03.2022 OE “V.D.”, shpk me NIPT . duke e shpallur fitues të procedurës së prokurimit ndërkohë që OE “U. C.” shpk me NIPT ., është skualifikuar pasi sipas KVO-së nuk ka paraqitur mostrat.

c. Në lidhje me zbatimin e kontratës:

Kontrata me Nr. 245 prot, datë 15. 04. 2022 lidhur ndërmjet OE “V. D.”shpk me NIPT . dhe AK, KNRA Orikum. Afati i përcaktuar për dorëzimin e mallrave është 12 muaj. Me urdhërin me nr. 248, prot, datë 15.04.2022 është ngritur komisioni i pritjes së mallit në magazinë me përbërje si vijon, T. V. (Kryetar), E. B. (anëtar), S. Sh. (anëtar). Kontraktori ka kryer lëvizimin pjesor të mallrave më datë 11.05.2022, me vlerë 2,622,000 lekë si dhe pjesën tjetër 25.07.2022 sipas fletë-

hyrjes nr. 4 në vlerën 2,622,000 lekë pa TVSH. Pra dorëzimi i kryer i mallrave është bërë brenda kusheve të marrëveshjes kuadër (MK).

9-Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje boje dhe aksesore për lyerje”, viti 2023 si vijon:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, si më poshtë:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “ Blerje boje dhe aksesore për lyerje ” NR-REF-78027-08-22-2023			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për Propozim” Urdhëri Prokurimit nr. 391 prot, datë 20.07.2023	1. 1 Komisioni i përlogaritjes të vlerësimit të kontratës/testimit tregut 1. A. M. 2. O. H. 3. F.G	1Njësia e Prokurimit 1. L.L 2. A.K 3. I.V	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhëri nr. 164 dt. 20.07.2023 1. K.P 2. A. M. 3. S. Sh. 4. O. H. 5. G. B.
4. Fondi Limit (pa TVSH) 5,733,000 lekë	5. Oferta fituese (pa TVSH) 5,586,955 lekë Operatori Fitues: OE “V. D.” SHPK	6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 146,045 lekë	
7/1 Data e hapjes së tenderit Datë 06.09.2023 (Sipas shtojcës)	8. Burimi Financimit Vetfinancim	9. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 2OE b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE	
7/2 Data e lidhjes së kontratës; Kohëzgjatja e kontratës: Datë 22.09.2023 Sipas kërkesës së AK			

Nga auditimi i procedurës konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Është organizuar në një dosje i gjithë dokumentacioni sipas përcaktimeve ligjore, pasqyruar në inventarin e dokumentave të dosjes. Ato përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për zhvillimin e procedurës (informacionin e përgjithshëm dhe atë specifik, kërkesat kualifikuese specifike, specifikimet teknike, grafiku i lëvrimit të mallrave, etj).

Nga të dhënat e dosjes së prokurimit konstatohet se, në lidhje me **“Parashikimi i fondit limit fillestar sipas rregjistrit”:**

Referuar Rregjistrin të parashikimeve për vitin 2023 si dhe mbështetur në gjendjen në magazinë, me shkresën me nr. 364 prot, datë 04.07.2023 është paraqitur kërkesa nga z. A.K me detyrë Kryeinxhinier, mbi nevojat e zhvillimit të procedurës “Blerje bojë dhe aksesore për lyerje”. Personi përgjegjës për administrimin e procedurës në sistem është përcaktuar Znj. L.L me detyrë Përgjegjëse Administrate në KNRA, me profesion jurist.

Kërkesa për blerje boje dhe aksesore per lyerje sipas shkresës nr 364, datë 04.07.2023, bazohet në nevojat emergjente për blerje bojë dhe aksesore për lyerje sipas gjendjes së magazinës.

Komisioni i testimi i tregut kryehu përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës duke u mbështetur në testimin e tregut me 3(tre) oferta ekonomike të administruara, si dhe cmimin e magazinës. Vlera e fondit limit të përlllogaritur rezultoi 5,733,000 lekë pa TVSH

Artikujt e prokuruar të paraqitur sipas tabelës së mëposhtme:

1	Maske Respirator Frymarrje (maska hunde)	Materiali: Pambuk. ngjyra e bardhe . në Forme Kupe Valvul nxjerrese per frymemarrje të lehte. Kapese hunde e rregullueshme per me shume rehati. Ideale per aplikimet që perfshijne pluhur, perzierje dhe fibra.
2	Bishta ruli sfungjeri	Bishta për lyerje me bojë për ryla të vegjël bishtë plastik për ryla 10 cm
3	Pinello boje 1e 1/2"	Pinello boje 1e 1/2" Duhet të jene material me fije sintetike me doreza druri
4	Pinello boje 2 e 1/2"	Pinello boje 2 e 1/2" Duhet të jene material me fije sintetike me doreza druri
5	Bojë antivegetative	Afati i skadencës minimumi 2 vjet Ngjyra e kuqe Konfeksioni 20 liter. Koha e tharjes 3-16 ore . Perqindja e hollimit 10 % . Shpejtësia >32 knots. VOC <500G/L
6	Tretës për bojë antivegetative	Te pershtatet me tipin e bojes
7	Boje antikorozive e nenujshme	Boje antiruxho 2 komponenteshe me katalit Afati i skadencës minimumi 2 vjet Ngjyra e gri Konfeksioni 20 liter. Koha e tharjes 4-12 ore . Perqindja e hollimit 5 %.
8	Tretes per bije antikorozive	Ti pershtatet bojes antikorozive
9	Boje bordi per anije, ngjyra e zezë	Kapaciteti teorik i mbulimit..... . 11-12 m ² / liter . Pikakritike e ndezjes tipike ≥ 40 ° C. - Koha e tharjes në diapazonin e temperatures 5°C deri 35 ° C a- në prekjen me dore sipas ISO 9117/3: 2010.....nga 18 ore deri 5 ore. b- në tharjen e forte ISO 9117-1: 2009 nga 62 -12 ore Afati i skadences minimumi 2 vjet
10	Boje bordi per anije, ngjyra gri	Kapaciteti teorik i mbulimit. 11-12 m ² / liter. Pikakritike e ndezjes... tipike ≥ 40 ° C.- Koha e tharjes në diapazonin e temperatures 5 ° C deri 35°C, a- në prekjen me dore sipas ISO 9117/3: 2010...nga 18 ore deri 5 ore. b- në tharjen e forte ISO 9117-1: 2009 nga 62-12 ore. Afati i skadences minimumi 2 vjet
11	Boje bordi perfundimetare per anije, ngjyra e verdhe	Kapaciteti teorik i mbulimit..... . 11-12 m ² / liter . Pikakritike e ndezjes... . tipike ≥ 40 ° C. - Koha e tharjes në diapazonin e temperatures 5°C deri 35 ° C a- në prekjen me dore sipas ISO 9117/3: 2010.....nga 18 ore deri 5 ore. b- në tharjen e forte ISO 9117-1: 2009 nga 62 ore deri 12 ore Afati i skadences minimumi 2 vjet. Konfeksioni kuti 5 liter
12	Boje bordi perfundimetare per anije, ngjyra jeshile	Kapaciteti teorik i mbulimit . 11-12 m ² / liter. Pikakritike e ndezjes. tipike ≥ 40 ° C.- Koha e tharjes në diapazonin e temperatures 5°C deri 35 ° C, a- në prekjen me dore sipas ISO 9117/3: 2010 nga 18 ore deri 5 ore. b- në tharjen e forte ISO 9117-1: 2009 nga 62-12 ore. Afati i skadences minimumi 2 vjet. Konfeksioni kuti 5 liter
13	Ryla të vegjel me qime të gjata	Ryla boje të vegjel 10 cm të gjate me bishte të zevendesueshem
14	Hollues boje (Dylent)	Eshtë një përzierje e formuluar posaçërisht e tretësve të dizajnuar për t'u përzierë me bojën për të krijuar konsistence optimal për aplikim. Mund të përdoret dhe për pastrimin e disa sipërfaqeve para aplikimit të bojes ose dhe per pastrimin të pajisjeve që perdoren per lyerje ,si furca ose rulo të ndryshem.

		<p>Produkti klasifikohet si i rrezikshëm sipas Direktivës 1999/45 / EC dhe ndryshimet e tij. Karakteristikat teknike</p> <ul style="list-style-type: none"> - Perzierje e 4 substancave tretese, perkatesisht solvent nafte në mase ≥ 50 deri <75 %, butan-1-o në mase ≥ 25 deri <35 %, xylene ≥ 5 deri <10 %, ethylbenzene ≥ 1 - < 3 % - Solucion i lengshem ,pa ngjyre ,me ere të solventit. - Pika e vlimit fillestar vlera më e ulët e njohur: 117 °C (butan-1-ol). - Pika e nxehjes në ene të mbyllur rreth 30 °C - Shkalla e avullimit e pa disponueshme - Ndezshmeria e larte ose e ulet ose kufijt e shperthyes.... . diapazoni më i madh i njohur: niveli i ulët: 1. 4% niveli I siperm : 11. 3% (butan-1-ol) - Dendësia e avullimit.....e padisponueshme -Densiteti relative 0.854 -Tretshmëria (et). I pazgjdhshëm në materialet të tilla si ujë të ftohtë - Viskoziteti kinematik në temperature e dhomës 4 mm2 /Legjislacioni për sigurinë, shëndetin dhe mjedisin specific për substancën ose përzierjen sipas Rregullores se BE-së Nr. 1907/2006 Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson të gjitha kerkesat e ketij SpecifikimiTeknik. Legjislacioni për sigurinë, shëndetin dhe mjedisin specific për substancën ose përzierjen sipas Rregullores se BE-së Nr. 1907/2006 Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson të gjitha kerkesat e ketij SpecifikimiTeknik.
15	Furc teli celik për troko ø 125	Furc teli celik për troko ø 125. Furç pastrimi me qime celiku per troko
16	Furc teli per fresibel qime bronxi	Furç teli me qime bronxi per fresibel
17	Bazament gome Ø 125 me ngjitje	Bazament gome me shterse adezive
18	Bazament gome Ø 150 me ngjitje	Bazament gome me shterse adezive
19	Tenie leter e gjere	Tenie leter e gjere. 50 mm e gjerë, minimumi i gjatësisë 38 m gjatësi minimumi i temperaturës që duron 60 grad
20	Silikon sallam	Silikon sallam I zi (polinetrum)
21	Leter zmerile diskore P24 Φ125	Leter zmerile Ø 120 mm grand P-24
22	Leter zmerile diskore P24 Φ150	Leter zmerile Ø 150 mm grand P-24

AK (NjP) në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Krieteve”:

Hartimi i DST (procesverbal hartimi nr. 397 protokolli, datë 21.07.2023, datë e hartimit)

-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, procesverbalit “për përcaktimin/hartimin e krieteve të pranimit/kualifikimit”, dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit “Për prokurimin publik”.

-Në lidhje me “kriterin e paraqitjes së mostrave” në procedurën e prokurimit “Blerje boje dhe aksesore për lysterje” viti 2020, 2022, 2023 të përcaktuar në DST, 2. 3(kapaciteti teknike), h) me qëllim për të vërtetuar përmbushjen e kërkesave, krieteve, kushteve, specifikimeve teknike etj, grupi auditimit gjyon që, në lidhje me përmbushjen e kapaciteteve teknike,specifikimeve teknike, kërkesave, kushteve, karakteristikave të përgjithme dhe të vecanta etj AK, duhet të ishte mjaftuar vetëm me ato të listuara të përcaktuara në DST. Pra përmbushja e dokumentacionit pjesë e DST si psh (autorizim nga prodhuesi/distributori, katalogje të prodhuesit për produktet objekt

procedure, certifikata cilësie, etj.) janë të mjaftueshme për të vërtetuar cilësinë apo përmbushjen e kriterëve nga ana e OE. Ndërkohë që mbi këto kërkesa, kriteri i paraqitjes së mostrave mund të ishte evituar nga AK, Njësia e Prokurimit (NJP). Për me tepër KNRA është zonë e kufizuar sa i përket lëvizjes pasi është zonë ushtarake dhe hyrjet-daljet bëhen sipas rregullave të përcaktuara në Procedurën Standarte të të Veprimit SOP 209/3, të miratuar nga Ministri i Mbrojtjes me Urdhërin nr. 1044, datë 09.07.2019, “Për miratimin e procedurës Standarte”. gjë e cila mund të pengojë OE në dorëzimin e mostrave pasi duhet të pajisen me leje të veçantë.

Nisur nga fakti i veprimeve të kryera AK dhe NJP, në lidhje me përcaktimin e kriterit mbi paraqitjen e mostrave vihet re që ky kriter ka ndikuar në shpalljen ofertës fituese me vlerën më të lartë pasi në 2(dy) procedurat e zhvilluara në vitin 2022, 2023, OE ofertues me vlerë më të ulët janë skualifikuar për mos paraqitje mostrash. Më konkretisht në procedurën, “Blerje boje dhe aksesore për lyerje”, viti 2022, me NR-REF-21873-03-11-2022 me ofertues OE “V. D.” shpk me vlerë 5,244,000 lekë pa TVSH dhe OE “U. C.” shpk me vlerë 4,388,400 lekë pa TVSH rezultoi se është skualifikuar OE “U. C.” me vlerë 855,600 lekë pa TVSH më të ulët se sa OE i shpallur fitues. Ndërsa në procedurën me të njëjtin objekt prokurimi dhe me të ofertues të njëjtë procedura “Blerje boje dhe aksesore për lyerje”, viti 2023, me NR-REF-78027-08-22-2023, me ofertues përkatësisht OE “V. D.”shpk me ofertë 4,985,520 lekë pa TVSH dhe OE “U. C.” shpk, me vlerë 5,586,955 lekë pa TVSH rezultoi se është skualifikuar e OE “V. D.” shpk me vlerë 601,434 lekë pa TVSH më të ulët se sa OE i shpallur fitues.

Si konkluzion, NJP, në procedurat e mallrave në të cilat në vlerësimin e aspektit teknik gjykon që është e rëndësishme paraqitja e mostrave duhet ta mirëanalizojë vendosjen e kriterit, pasi referuar procedurave të zhvilluara me të njëjtin objekt prokurimi viti 2020, 2022, 2023, përcaktimi i kriterit të mostrave ka shkaktuar shpenzim të njësisë në vlerën **1,457,034 lekë pa TVSH** pa **ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet** duke mos iu përmbajtur përcaktimeve të bëra në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40, neni 78, pika 2. Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin Publik”, nenin 5, nenin 8, nenin 12 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me “Administrimin e Dokumentacionit”:

Nga auditimi i dosjes fizike të procedurës së prokurimit, konstatohet se personi përgjegjës ka kryer administrimin e dokumentacionit të dosjes në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin “Për prokurimin publik”.

Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve, KVO dhe NjP, mbi konfliktin e interesave.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Komisioni i vlerësimit të ofertave në datën 06.09.2023, hyri në sistemin elektronik(SPE) sipas orarit të përcaktuar në DST, në orën 09.30, nga ku u realizua hapja e ofertave dhe rezultoi se ishin pjesmarrës, 2 OE, nga ku KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta Lekë pa TVSH	Skualifikuar/Kualifikuar
1	U.C.	5,586,955	Kualifikuar
2	V. D.	4,985,520	SKualifikuar

Referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave, rezulton se KVO-ja, ka kualifikuar vetëm 1(një) OE, duke e shpallur fitues të procedurës së prokurimit OE “United Colors” shpk me NIPT **K.....A**.

Sipas Komisionit të vlerësimit të ofertave, operatori ‘V. D.’ SHPK me nipt L.....M është skualifikuar me arsyen se operatori nuk ka paraqitur mostrat e kërkuara në DST, pika 2. 3. h, Kapacitete teknike.

Si konkluzion,

për sa më sipër, në lidhje me vlerësimin e ofertave të kryer nga KVO-ja, rezulton se kjo e fundit **pavarësisht se ka vlerësuar drejtë** OE pjesëmarrës në garë, kërkesa apo kriteri në lidhje me paraqitjen e mostrave ka rezultuar se ka ndikuar në shpalljen fituese të ofertës më vlerën më të lartë ndërmjet 2 (dy) ofertuesve.

c. Në lidhje me zbatimin e kontratës:

Kontrata me Nr. 499 prot, datë 22.09.2023 lidhur ndërmjet OE “U.C.” shpk me NIPT..... dhe AK, KNRA Orikum. Afati i përcaktuar për dorëzimin e mallrave është **sipas kërkesës së AK** . Me urdhërin me nr. 494, prot, datë 19.09.2023 është ngritur komisioni i pritjes së mallit në magazinë me përbërje si vijon, (T. V. Kryetar, A. R. anëtar, M. G. anëtar,). Kontraktori ka kryer dorëzimin e mallrave më datë 26.09.2023, brenda afatit.

10-Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje karburant”, viti 2023 si vijon:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, si më poshtë:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “ Blerje karburant” NR-REF-65921-04-13-2023			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “E hapur e thjeshtuar” Urdhëri Prokurimit nr. 225 prot, datë 11.04.2023	1. 1 Komisioni i përlogaritjes të vlerësimit të kontratës/testimit tregut 1. A. M. 2. S. Sh. 3. G. B.	2. Njësia e Prokurimit 1. L.L 2. A.K 3. A. R.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhëri nr. 164 dt. 20.07.2023 1. K.P 2. I. V. 3. A. M.
4. Fondi Limit (pa TVSH) 3,080,931 lekë	5. Oferta fituese (pa TVSH) 3,078,760 lekë Operatori Fitues: OE “E. ” SHPK NIPT .		6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 2,171 lekë
7/1 Data e hapjes së tenderit Datë 24.04.2023	8. Burimi Financimit Vetfinancim		9. Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 1OE b) S’kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
7/2 Data e lidhjes së kontratës;Kohëzgjatja e kontratës: Datë 28.04.2023 12 muaj			

Nga auditimi i procedurës konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Është organizuar në një dosje i gjithë dokumentacioni sipas përcaktimeve ligjore, pasqyruar në inventarin e dokumentave të dosjes. Ato përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për zhvillimin e procedurës (informacionin e përgjithshëm dhe atë specifik, kërkesat kualifikuese specifike, specifikimet teknike, grafiku i lëvrimit të mallrave, etj).

Nga të dhënat e dosjes së prokurimit konstatohet se, në lidhje me **“Parashikimi i fondit limit fillestar sipas rregjistrit”:**

Referuar Rregjistrin të parashikimeve për vitin 2023 si dhe mbështetur në gjendjen në magazinë, me shkresën me nr. 216 prot, datë 06.04.2023 është ngritur grupi i punës i cili ka kryer një analizë kostoje për sasinë e nevojshme për tu furnizuar me karburant për mjetet e transportit dhe motogeneratorët e ndërrmarjes. Komisioni sasinë e përlllogaritur e ka kryer duke u mbështetur në (numrin e mjeteve që disponon, të dhënat teknike të mjeteve, dhe konsumin ditor të karburantit). Ndërkohë që në lidhje me përlllogaritjen e vlerës komisioni është mbështetur (Cmimin sipas Buletinit të APP për naftën D1:767S/Ton*(kursi i këmbimit lekë/\$, datë 06.04.2023=79,484.21 lekë/ton. „taksën doganore sipas të gjithë komponentëve të përfshirë si akciza, taksë karboni, taksë qarkullimi etj) nga ku në total vlera e fondit limit të përlllogaritur rezultoi 3,080,931 lekë pa TVSH.

Nga të dhënat e dokumentuara në lidhje me analizën e kostos të kryer nga komisioni grupi auditimit gjykon që:në lidhje me normativat e konsumit të karburantit për mjetin(Autobus tip Benz 303, prodhimi i vitit 1985, me targa MM435MM në gjendje jo të mirë teknike, konsumi 38L/100km) rezulton se është shpenzuar sasia e karburantit vetëm për mjetin e sipërcituar si më poshtë :

Nr	Viti	Sasia/L	Vlera/lekë
1	2016	7003	861,369
2	2017	6709	1,013,059
3	2018	7200	1,221,120
4	2019	7080	1,180,165
5	2020	6010	973,620
6	2021	6990	933,025
7	2022	5360	1,243,520
8	2023	6620	1,211,460
Totali	52972		8,755,212

Pra nisur nga këto të dhëna, përlllogaritja e shpenzimeve në lidhje me karburantin vetëm për mjetin e transportit të sipërcituar paraqiten në shumën 17,157,655 lekë. Pra nga KNRA, nuk është kryer një analizë kostoje apo nuk është gjetur një zgjidhje nëse shpenzimi për blerjen e një mjete transporti të ri është më me leverdi për AK. Vlen të theksohet fakti se sigurimi i një mjete transporti të ri me kapacitet të njëjtë është tepër vështirë të realizohet pasi Institucioni mbështet me vet financim dhe në asnjë moment nuk ka buxhet të përcaktuar stabël dhe në cdo rast pret të sigurojë të ardhura nga aktiviteti që kryen dhe likuidimi ndaj OE që do shpallej fitues do ishte i vështirë. Pra veprimet e kryera kanë ardhur si shkak i vështirësisë financiare në të cilët ndodhet KNRA.

Veprimet e kryera kanë shkaktuar shpenzim të njësisë vlerën 8,755,212 lekë pa TVSH pa ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet duke mos iu përmbajtur përcaktimeve të bëra nenin 5, nenin 8, nenin 12 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;

AK (NjP) në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve”:

-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, procesverbalit “për përcaktimin/hartimin e kritereve të pranimit/kualifikimit”, dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), nuk u konstatuan parregullsi në shkelje të Ligjit “Për prokurimin publik”.

Në kritere e DST janë përcaktuar kriteret e përgjithshme dhe të vecanta, kërkesat mbi kapacitetin ekonomik, kërkesat mbi kapacitetin Teknik, specifitime teknike në përputhje dhe në zbatim të LPP dhe VKM RPP.

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me “Administrimin e Dokumentacionit”:

Nga auditimi i dosjes fizike të procedurës së prokurimit, konstatohet se personi përgjegjës ka kryer administrimin e dokumentacionit të dosjes në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin “Për prokurimin publik”.

Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve, KVO dhe NjP, mbi konfliktin e interesave.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Komisioni i vlerësimit të ofertave në datën 24.04.2023, hyri në sistemin elektronik(SPE) sipas orarit të përcaktuar në DST, në orën 09:00, nga ku u realizua hapja e ofertave dhe rezultoi se ishte pjesëmarrës, 1 OE, nga ku KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta Lekë pa TVSH	Skualifikuar/Kualifikuar
1	E. D. Albania	3,078,760	Kualifikuar/Fituesi

Referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave, rezulton se KVO-ja e ka kualifikuar duke e shpallur fitues të procedurës së prokurimit OE “E.P. Durres Albania”.

Si konkluzion,

Për sa më sipër, në lidhje me vlerësimin e ofertave të kryer nga KVO-ja, **ka vlerësuar drejtë OE pjesëmarrës në garë pasi përmbush kriteret dhe kërkesat e DST.**

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të P/Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresën me nr. 495/1 prot, datë 26.08.2024, protokolluar në KLSH me nr. 347/6 prot, datë 28.08.2024“Kundërshtime për akt konstatimet e grupit të auditimit të KLSH”, nga ana e përfaqësuesve të institucionit, të cilat janë të paraqitura më poshtë, pa ndërhyrje dhe rregullime nga ana drejtshkrimore:

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje konstatimet e bëra nga ana juaj, në lidhje akt-konstatimin nr. 5, “Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet për investime, për blerje mallrash dhe shërbimesh si dhe zbatimi i kontratave”, nga ku pretendoni se:

1.Në lidhje me procedurën “Blerje boje dhe aksesore për lyerje” për vitin 2023, hartimi i kriterit të mostrave është bërë nga anetare te specializuar per objektin qe prokurohet, I ngritur me urdher të titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Mostrat e artikujve të kerkuar kanë një natyre të vecante të cilat shërbejnë për të bërë të mundur vlerësimin e tyre.....

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Pra në përlllogaritjen e kosos për shpenzimet e automjetit jemi bazuar tek vlera e planifikuar.

1.Në lidhje me pretendimet tuaja sa i përket hartimit të kriterit të mostrave sic e kemi theksuar me qëllim për të vërtetuar përmbushjen e kërkesave, kriterëve, kushteve, specifikimeve teknike etj, grupi auditimit gjykon që në lidhje me përmbushjen e kapaciteteve teknike, specifikimeve teknike, kërkesave, kushteve, karakteristikave të përgjithme dhe të vecanta etj AK, duhet të ishte mjaftuar vetëm me ato të listuara përcaktuara në DST. Pra përmbushja e dokumentacionit kërkuar nga AK në DST si psh (autorizim nga prodhuesi/distributori, katalogje të prodhuesit për produktet objekt procedure, certifikata cilësie, etj.) janë të mjaftueshme për të vërtetuar cilësinë apo përmbushjen e kriterëve nga ana e OE. Ndërkohë që mbi këto kërkesa, kriteri i paraqitjes së mostrave është i tepërt. Për me tepër KNR A është zonë e kufizuar sa i përket lëvizjes pasi është zonë ushtarake dhe hyrjet-daljet bëhen sipas rregullave të përcaktuara në Procedurën Standarte të të Veprimit SOP 209/3, të miratuar nga Ministri i Mbrojtës me Urdhërin nr. 1044, datë 09. 07. 2019, “Për miratimin e procedurës

Standarte. Pra opinion jonë është që duke parë që në 2 situata kriteri mostrave ka ndikuar në shpalljen e ofertës fituese ju rekomandojmë që ky kriter të hiqet. Kriteret apo kërkesat e përcaktuara nga AK si (paraqitja e mostrave) mund të ngushtojnë konkurrencën si dhe mund të mos nxisin pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.

Për sa më sipër observacioni juaj nuk pranohet.

Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: **“Blerje boje dhe aksesore për lyerje”** :

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave u konstatua si më poshtë:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “ Blerje boje dhe aksesore për lyerje ” NR-REF-87211-09-25-2018			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për Propozim” Urdhëri Prokurimit nr. 185 prot, datë 21. 09. 2018	1. 1 Komisioni i përlogaritjes të vlerësimit të kontratës/testimit tregut 4. I.V 5. K. K. 6. A. Sh.	2 Njësia e Prokurimit 7. I.V 8. K. K. 9. A. Sh.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhëri nr. 184, dt. 20. 09. 2018 1. A. K. 2. K.P 3. A. H.
4. Fondi Limit (pa TVSH) 2. 579. 300 lekë	5. Oferta fituese (pa TVSH) 1. 953. 578 lekë Operatori Fitues: OE “V. D.” SHPK		6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 625. 722 lekë
7/1 Data e hapjes së tenderit Datë 08. 10. 2018 (Sipas shtojcës)	8. Burimi Financimit Vetfinancim		9. Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 6 OE b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 5 OE
7/2 Data e lidhjes së kontratës;Kohëzgjatja e kontratës: Datë 09. 01. 2019 3 ditë			

Nga auditimi i procedurës konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Është organizuar në një dosje i gjithë dokumentacioni sipas përcaktimeve ligjore, pasqyruar në inventarin e dokumentave të dosjes. Ato përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për zhvillimin e procedurës (informacionin e përgjithshëm dhe atë specifik, kërkesat kualifikuese specifike, specifikimet teknike, grafiku i lëvrimit të mallrave, etj).

- **Në lidhje me specifikimet teknike** konstatohet se: Mallrat e kërkuara nuk kanë një shpjegim ose argumentim për sasinë dhe specifikimet e kërkuara, gjithashtu konstatohet se në këto specifikime ka element të cilat nuk përbëjnë kusht për arritjen e qëllimit të kësaj procedure më konkretisht për zërat “Boje antikorrozive e nënujshme” ku përcaktohet specifikimi “kuti 20 kg”, “Ryla të vegjel me qime të gjatë” ku përcaktohet gjatësia fikse e objektit etj. Gjithashtu ka elemente të tjerë përcaktues për disa nga zërat e kërkuar si më poshtë:

Nr	Emertimi I Materialit	Specifikime teknike
1	Sfungjer zmerili	Sfungjer zmerili
2	Bojë antivegjetative	Afati i skadencës minimumi 2 vjet. Ngjyra e kuqe konfeksion 20 l. kufijte e temperaturës së përdorimit + 10; -35 grad C. koha e tharjes 3-16 ore. Përqindja e hollimit 10% shpejtësia > 32 knots. VOC < 500G/L
3	Bishta ryli	Bishta per lyerje me boje per ryla të vegjel
4	Tretes per boje antivegjetative	Te pershtatet me tipin e bojes
5	Boje antikorrozive e nenujshme	Boje antikorrozive 2 komponenteshe me katalit. Afati I skadencës minimum 2 vjet.

		Ngjyre gri (kuti 20 kg) kufijet e tepm të përdorimit +5-35 grad C. Koha e thajes 4-12 ore . perqindja e hollimit 5%
6	Tretes per boje antikorrozive	Te pershtatet me tipin e bojës
7	Ryla të vegjel me qime të gjatë	Ryla boje të vegjel 10 cm të gjate me bishte të zvendesueshem
8	Ryla 20 cm me qime të gjate	Ryla boje 20 cm
9	dylent	Dylent universal
10	Furc lyerje me boje 2"	Furc lyerje me boje 2"
11	Furc lyerje me boje 3"	Furc lyerje me boje 3"
12	Silicon poliuretani sallam	Vetite tharje e shpejt, fortesim I shpejt, rezistent ndaj ujit
13	Leter zmerile diskore	leter leter zmerile 150 o me ngjitje grandí p-60zmeril diskor
14	Mask hundesh	Maske hunde me perdorim ditor
15	Doreza per lyerje me boje	Doreza per lyerje me bojje

Këto veprime bien në kundërshtim me LPP Nenin 23 “Specifikimet Teknike” pika 4 ku përcaktohet se “. . . *specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta*”.

Për këtë veprim mban përgjegjësi I.V, Konstatin Kume dhe A.SH.

Nga të dhënat e dosjes së prokurimit konstatohet se, në lidhje me **“Parashikimi i fondit limit fillestar sipas regjistrit”**:

Referuar regjistrin të parashikimeve për vitin 2018 si dhe mbështetur në gjendjen në magazinë, me shkresën me nr. 372 prot, datë 06.09.2018 është paraqitur kërkesa nga Z. I.V me detyrë Përgjegjës sektori, me profesion Inxhinier, mbi nevojat e zhvillimit të procedurës “*Blerje bojë dhe aksesore për lyerje*”. Personi përgjegjës për administrimin e procedurës në sistem është përcaktuar Z. A.SH me detyrë Jurist në KNRA, me profesion Jurist.

Kërkesa për blerje material për riparimin e shkallës Kosjakova sipas shkresës nr 372, datë 06.09.2018, bazohet në nevojat emergjente për blerje bojë dhe aksesore për lyerje sipas gjëndjes së magazinës.

Njësia e prokurimit kreu përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës duke u mbështetur në testimin e tregut me 3(tre) oferta ekonomike të administruara, si dhe cmimin e magazinës. Vlera e fondit limit të përlllogaritur rezultoi 2,579,300 lekë pa TVSH. (me duhen ofertat)

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me “Administrimin e Dokumentacionit”:

Nga auditimi i dosjes fizike të procedurës së prokurimit, konstatohet se personi përgjegjës ka kryer administrimin e dokumentacionit të dosjes në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin “*Për prokurimin publik*”.

Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve, KVO dhe NjP, mbi konfliktin e interesave.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Komisioni i vlerësimit të ofertave në datën 29.10.2018, hyri në sistemin elektronik(SPE) sipas orarit të përcaktuar në DST, në orën 10:30, nga ku u realizua hapja e ofertave dhe rezultoi se ishin pjesmarrës, 6 OE, nga ku KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta Lekë pa TVSH	Skualifikuar/Kualifikuar
1	T. T. C. shpk	1,862,280	Kualifikuar
2	V. D.	1,953,578	Kualifikuar
3	U. C.	2,281,350	Kualifikuar

4	A. A. I. G. shpk	2,281,790	Kualifikuar
5	O.-V.	2,300,174	sKualifikuar
6	S. shpk	2,450,555	Kualifikuar

Referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave, rezulton se KVO-ja, ka kualifikuar vetëm 5 (pesë) OE, duke e shpallur fitues të procedurës së prokurimit OE “T. T. C.” shpk me NIPT ., KVO me shkresë 438, date 17. 10. 2018, është drejtuar ketij OE, me kërkesën për arsyetimin e ofertës anomalisht të ulët.

Mbas përgjigjes së OE me shkresën “Sqarim”, KVO e konsideroj të mjaftueshme arsyetimin e operatorit ekonomik .

Në datë 02. 10. 2018, është depozituar nga shërbimi postar pranë AK, ankesa e OE “ V. D.“ shpk, me anë të së cilës kundërshtohet kualifikimi i OE “T. T. C.” shpk, të renditur në vendin e parë, me pretendimin se nga ana e këtij operatori nuk janë plotësuar kriteret e vecanta të kualifikimit të përcaktuar në DST.

Me vendim 838/2018, datë 12. 12. 2018, Komisioni i Prokurimit Publik vendos shfyqizimin e KVO-së mbi kualifikimin e OE ‘T. T. C.’ shpk, dhe kualifikimin e OE “V. D.” shpk në këtë procedurë prokurimi.

c. Në lidhje me zbatimin e kontratës:

Kontrata me Nr. 10 prot, datë 09. 01. 2019 lidhur ndërmjet OE “V. D.” shpk me NIPT . dhe AK, KNRA Orikum. Afati i përcaktuar për dorëzimin e mallrave është 3 ditë kalendarike. Me urdhërin me nr. 251, prot, datë 18. 12. 2018 është ngritur komisioni i pritjes së mallit në magazinë me përbërje si vijon, (A.K Kryetar, E. P. anëtar, T. V. anëtar, S.B anëtar). Kontraktori ka kryer dorëzimin e mallrave më datë 11. 01. 2019, brenda afatit.

Si konkluzion,

Mallrat e kërkuara nuk kanë një shpjegim ose argumentim për sasinë dhe specifikimet e kërkuara, gjithashtu konstatohet se në këto specifikime ka element të cilat nuk përbëjnë kusht për arritjen e qëllimit të kësaj procedure më konkretisht për zërat “Boje antikorrozive e nënujshme” ku përcaktohet specifikimi “kuti 20 kg”, “Ryla të vegjel me qime të gjatë” ku përcaktohet gjatësia fikse e objektit etj.

Këto veprime bien në kundërshtim me LPP Nenin 23 “Specifikimet Teknike” pika 4 ku përcaktohet se “. . . specififikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta”.

Nga auditimi konstatohet që: Autoriteti Kontraktor për mallrat e kërkuara nuk ka një shpjegim ose argumentim për sasinë dhe specifikimet e kërkuara, gjithashtu konstatohet se në këto specifikime ka element të cilat nuk përbëjnë kusht për arritjen e qëllimit të kësaj procedure më konkretisht për zërat “Boje antikorrozive e nënujshme” ku përcaktohet specifikimi “kuti 20 kg”, “Ryla të vegjel me qime të gjatë” ku përcaktohet gjatësia fikse e objektit etj. Këto veprime bien në kundërshtim me LPP Nenin 23 “Specifikimet Teknike” pika 4 ku përcaktohet se: “. . . specififikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet

krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta”.

Moszbatim i ligjit të LPP Nenin 23 “Specifikimet Teknike” pika 4. Kjo përben risk për devijimin e ofertës fituese nga Autoriteti Kontraktor.

Për ketë veprim mban përgjegjësi I.V, K. K. dhe A.SH.

Për sa është trajtuar në Projektraprotin e auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë 347/6 prot, datë 28.08.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

”Nga përvoja jonë në këtë fushë parametrat e paketimit të bojës janë ato që ne kemi hasur gjatë veprimtarisë sone dhe për më tepër që gjatë procesit të lyerjes së anijeve ky lloj paketimi është më i përshtatshëm për përdorim nga ana jonë jovetëm nga ana praktike por edhe nga ana e menaxhimit financiar (lidhur me hyrje daljet në magazine). Për më tepër specifikimet e kërkuara për kg e bojës ose të gjatësisë të qimes së rulave, nuk janë të pamundur për tu gjendur. Këto produkte janë në shitje nga cdo operator, dhe artikujt e kërkuar duhet të jenë në funksion të specialistit i cili i përdorë. ”

Qëndrimi i grupit të auditimit

Këto veprime bien në kundërshtim me LPP Nenin 23 “Specifikimet Teknike” pika 4 ku përcaktohet se: “. . . specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta”.

Prandaj ky koment nuk do të merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

Blerje vegla pune 2019

2-Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: **“Blerje vegla pune”** :

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave u konstatua si më poshtë:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje vegla pune”			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për Propozim” Urdhëri Prokurimit nr. 249 prot, datë 12.12 2019	1. 1 Komisioni i përlogaritjes të vlerësimit të kontratës/testimit tregut Urdhëri 204. Date 21.10.2019 10. A.K 11. A.H. 12. I.V	2 Njësia e Prokurimit 1. A.K 2. A. H. 3. I.V	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhëri nr. 204 21.10.2019 1. K.P 2. E. b. 3. L.L 4. A.T 5. T. V.
4. Fondi Limit (pa TVSH) 1,624,000 lekë	5. Oferta fituese (pa TVSH) 1,583,600 lekë Operatori Fitues: OE “V. D.” SHPK	6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 40,400 lekë	

7/1 Data e hapjes së tenderit Datë 30.12.2019 (Sipas shtojcës)10	8. Burimi Financimit Vetfinancim	9. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 2 OE b) S'kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
7/2 Data e lidhjes së kontratës; Kohëzgjatja e kontratës: Datë 20. 01. 2020 5 ditë		

Nga auditimi i procedurës konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Është organizuar në një dosje i gjithë dokumentacioni sipas përcaktimeve ligjore, pasqyruar në inventarin e dokumentave të dosjes. Ato përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për zhvillimin e procedurës (informacionin e përgjithshëm dhe atë specifik, kërkesat kualifikuese specifike, specifikimet teknike, grafiku i lëvrimit të mallrave, etj).

Referuar regjistrin të parashikimeve për vitin 2019 si dhe mbështetur në gjendjen në magazinë, me kërkesën datë 22.10.2019 është paraqitur kërkesa nga stafi inxhinierik, Z. A.K me detyrë Kryeinxhinier, me profesion Inxhinier, Z. K. K. me detyrë Përgjegjës Sektori, me profesion inxhinier, Z. I.V me detyrë Përgjegjës Sektori, me profesion inxhinier, Z. A.T me detyrë Përgjegjës Sektori Logjistik, me profesion inxhinier mbi nevojat e zhvillimit të procedurës “*Blerje vegla pune*”. Kërkesa për blerje material për riparimin e anijeve sipas shkresës me datë 22.10.2019, bazohet në nevojat që aktiviteti riparues i KNRA të jetë efikas dhe me rendiment.

Me shkresën datë 23.10.2019 komisioni i testimit të tregut me përbërje, A.K (kryetar), A.H. (anëtar), I.V (anëtar), kreu përlllogaritjen e vlerësimit të kontratës duke u mbështetur në testimin e tregut me 3 (tre) oferta ekonomike të administruara, si dhe cmimin e magazinës. Vlera e fondit limit të përlllogaritur rezultoi 1,624,000 lekë pa TVSH.

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me “Administrimin e Dokumentacionit”:

Nga auditimi i dosjes fizike të procedurës së prokurimit, konstatohet se personi përgjegjës ka kryer administrimin e dokumentacionit të dosjes në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin “*Për prokurimin publik*”.

Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve, KVO dhe NjP, mbi konfliktin e interesave.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Komisioni i vlerësimit të ofertave në datën 30. 12. 2019, hyri në sistemin elektronik(SPE) sipas orarit të përcaktuar në DST, nga ku u realizua hapja e ofertave dhe rezultoi se ishin pjesmarrës, 2 OE, nga ku KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta Lekë pa TVSH	Skualifikuar/Kualifikuar
1	V. D.	1. 583. 600	Kualifikuar/Fituesi
2	Z.	1. 485. 000	Skualifikuar

Referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave, rezulton se KVO-ja, ka kualifikuar 1(nje) OE i cili ka shprehur interes dhe ka dorëzuar dokumentacionin dhe mostrat e kërkuar në SPE, duke e shpallur fitues të procedurës së prokurimit OE “V. D.” shpk me NIPT ., operatori i skualifikuar Z. me nipt . nuk ka paraqitur mostrat. OE i kualifikuar ka një diferencë oferte nga OE i skualifikuar me 98,600 lekë me shumë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se OE fitues nuk ka paraqitur autorizimin nga prodhuesi për mallrat e caktuara edhe pse ka një autorizim nga distributori por pika 2.3 a) Kapaciteti teknik kërkon që për disa artikuj të caktuar të vërtetohet nëpërmjet dokumentave

originalë ose të noterizuar që distributori është përfaqësues i kompanisë prodhuese për të gjithë mallin/mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje autorizimi distributori, operatori ekonomik duhet të paraqesë një letër angazhim ose akt marrëveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre. Vendosja e kërkesave fikse sic janë ato në pikën 2.3 a) Kapaciteti teknik ku kërkohet autorizim nga distributori dhe prodhuesi për mallra të caktuara mund të sjellë diskriminim të OE, ky veprim gjithashtu bie në kundërshtim me Nenin 20 të ligjit “PËR PROKURIMIN PUBLIK”.

c. Në lidhje me zbatimin e kontratës:

Kontrata me Nr. 28 prot, datë 20.01.2020 lidhur ndërmjet OE “V. D.” shpk me NIPT . dhe AK, KNRA Orikum. Afati i përcaktuar për dorëzimin e mallrave është **5 ditë** kalendarike. Me urdhërin me nr. 08 prot, datë 21. 01. 2020 është ngritur komisioni i pritjes së mallit në magazinë me përbërje si vijon, (A.K Kryetar, S. K. anëtar, D. M. anëtar, S.B anëtar). Kontraktori ka kryer dorëzimin e mallrave brenda afatit.

Si konkluzion,

Certifikata e sjellë nga distributori i autorizuar nuk vërteton që mallrat e sjella janë ato të cilat janë të përcaktuara në pikën 2.3 a) Kapaciteti teknik. Konkretisht certifikata nga T. T. e cila autorizon distributorin A.-E. shpk nuk përcakton ose vërteton se cilat mallra janë të autorizuar nga prodhuesi. Ky veprim bie në kundërshtim me Nenin 53 pika 3, pika 5 c) të ligjit “PËR PROKURIMIN PUBLIK”. Vendosja e kërkesave fikse sic janë ato në pikën 2.3 a) Kapaciteti teknik ku kërkohet autorizim nga distributori dhe prodhuesi për mallra të caktuara mund të sjellë diskriminim të OE, ky veprim gjithashtu bie në kundërshtim me Nenin 20 të ligjit “PËR PROKURIMIN PUBLIK”.

Certifikata e sjellë nga OE nuk vërteton që mallrat e sjella janë ato të cilat janë të përcaktuara në pikën 2.3 a) Kapaciteti teknik. Konkretisht certifikata nga T. T. e cila autorizon distributorin A.-E. shpk nuk përcakton ose vërteton se cilat mallra janë të autorizuar nga prodhuesi. Nga distributori i autorizuar ka vetëm një certifikatë nga e cila vërtetohet se është distributori zyrtar për prodhimet e markës “T. T.”. Gjithashtu Autoriteti Kontraktor ka bërë kërkesa fikse sic janë ato në pikën 2.3 a) *Kapaciteti teknik ku kërkohet autorizim nga distributori dhe prodhuesi për mallra të caktuara dhe specifik pa asnjë argument.*

Në zbatim të plotë të ligjit “Për Prokurimin Publik” Autoriteti Kontraktor në asnjë rast nuk duhet të lejojë hapsira ose devijime të vogla që mund të sjellin papajtueshmëri me Nenin 53 pika 3 dhe 5 të ligjit “Për Prokurimin Publik” edhe pse Neni 53 pika 4 e ligjit “Për Prokurimin Publik” lejon devijimet e vogla të me kusht që të jenë të argumentuara, nuk duhet të ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Gjithashtu vendosja e kërkesave fikse sic janë ato në pikën 2.3 a) Kapaciteti teknik ku kërkohet autorizim nga distributori dhe prodhuesi për mallra të caktuara mund të sjellë diskriminim të OE, ky veprim gjithashtu bie në kundërshtim me Nenin 20 të ligjit “Për Prokurimin Publik”. Kjo përben Risk për devijimin e ofertës fituese nga Autoriteti Kontraktor ose nga Komisioni i vlerësimit të ofertave.

Për sa është trajtuar në projektraportin e auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë 347/6 prot, datë 28.08.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

“ . . . Në zbatim të Nenit 53, të ligjit 9643, datë 20. 11. 2006 “Për prokurimin Publik”, Shqyrtimi i ofertave pika 4. Autoriteti kontraktor vlerëson nje ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe

kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur permbajtjen e saj. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka gjykuar se në certifikatën nga Prodhuesi, në letër angazhim të prodhuesit si dhe në autorizimin e distributorit fjala ". të gjitha produktet. " presupozon të ketë edhe artikujt e kërkuar në DST. . "

Qëndrimi i grupit të auditimit

Duke qënë se ju keni argumentuar se në autorizimin e distributorit cilësohet se është i autorizuar për të gjitha produktet e prodhuesi, në zbatim të Nenit 53, të LPP, Shqyrtimi i ofertave pika 4 observacioni juaj do të merret parasysht pjesërisht.

Prandaj ky koment do të merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Ankandet

KNRA në bazë të ligjit nr. 9874 datë 14.02.2008 "Për ankandin Publik", me anë të Këshilli Drejtues ka vendosur shitjen me procedurë ankandi publik të materialeve stok, materialeve me qarkullim të ngadalshëm në 3 raste të ndryshme. Nga auditimi u konstatua se nga këto 3 procedura, 2 procedura janë anuluar dhe vetëm në një nga procedurat e shitjes me anë të ankandit publik është zhvilluar dhe përfunduar.

Procedura e ankandit për kontenierët

Me shkresën Nr. 240/1 Prot. Datë 04.04.2016 Kryinxhinjeri i KNRA i është drejtuar Këshillit Drejtues me informacionin për gjendjen e kontenierëve dhe amortizimin e tyre.

Përbërja dhe të dhëna për kontenierët:

Kontenier 12 m të mbyllur: 23 copë

Kontenier 12 m të hapur: 14 copë

Kontenier 6 m të mbyllur: 19 copë

Kontenier 6 m të hapur: 1 copë

Sipas shkresës Nr. 240/1 Prot. Datë 04.04.2016

Për nevoja të punës Kantierit i duhen 3 (tre) copë kontenier 12 m të mbyllur dhe 2 (dy) copë kontenier 6 m të mbyllur. Dy kontenier, 1 (një) 12 m i mbyllur dhe 1 (një) 6 m i hapur kanë dalë jashtë përdorimit dhe nuk mund të jenë më funksional, pasi gjatë transportit për shkak dhe të peshave janë deformuar dhe janë çarë. Duhet që disa prej këtyre kontenierëve të shiten sipas procedurave të ankandit duke qënë se Kantierit nuk i nevojiten.

Me shkresën Nr. 240/3 Prot. datë 06.04.2016 Drejtori i Ndërmarrjes ka kërkuar nga Ministri i Mbrojtjes autorizim për shitjen e kontenierëve nëpërmjet procedurave të ankandit publik.

Me shkresën Nr. 2933/2 Prot. datë 06.05.2016, Ministria e Mbrojtjes ka konfirmuar lejimin e fillimit të procedurave të shitjes me anë të ankandit publik të kontenierëve.

KNRA ka filluar procedurën për shitjen me anë të ankandit të kontenierëve ku me urdhërin Nr. 405 datë 14.06. 016 është krijuar njësia përgjegjëse për zhvillimin e ankandit e përbërë nga:

- A.K Kryetar
- A. H. Anëtar
- A.SH Anëtar

Ankandi Publik me objekt "Shitje publike me ankand të kontenierëve" është llogaritur me fondin total fillestar prej 5,118,715 (pesë milion njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH dhe me vlerë 6 142 458 (gjashtë milion e njëqind e dyzetë e dy mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë) lekë me TVSH, sipas tabelës së mëposhtme:

Kontenierë FT 40 të mbyllur nga lartë, me gjatësi 12 m 18 copë x 163 698 lekë

Kontenierë FT 40 të hapur nga lartë, me gjatësi 12 m 10 copë x 109 132 lekë

Kontenierë FT 20 të mbyllur nga lartë, me gjatësi 6 m 14 copë x 73 693 lekë

Kontenierë FT 20 të hapur nga lartë, me gjatësi 6 m 1 copë x 49 129 lekë

Çmimi fillestar për shitjen e kontenierëve do të jetë ai i llogaritur në kontabilitet me vlerën e mbetur duke marrë parasysh vlerën e rivlerësuar të tyre dhe amortizimin.

Me procesverbalin Nr. 124 prot. datë 04.04.2017 procedura ankandit është përsëritur me vlerë 20% më të ulët sesa vlera fillestare pasi deri në momentin e parashikuar në njoftim nuk u paraqit asnjë ofertues për blerje sipas ligjit të ankandit publik duke e ulur shumën nga 5,118,715 lekë në 4,094,972 lekë.

Me procesverbalin Nr. 160 prot. datë 02.05.2017 procedura ankandit është përsëritur me vlerë 20% më të ulët sesa vlera e mëparëshme pasi deri në momentin e parashikuar në njoftim nuk u paraqit asnjë ofertues për blerje sipas ligjit të ankandit publik duke e ulur shumën nga 4,094,972 lekë në 3,275,978 lekë.

Me procesverbalin Nr. 200 prot. datë 29.05.2017 procedura ankandit është përsëritur me vlerë 20% më të ulët sesa vlera e mëparëshme pasi deri në momentin e parashikuar në njoftim nuk u paraqit asnjë ofertues për blerje sipas ligjit të ankandit publik duke e ulur shumën nga 3,275,978 lekë në 2,620,782 lekë.

Me procesverbalin datë 27.06.2017 procedura ankandit është përsëritur me vlerë 20% më të ulët sesa vlera e mëparëshme pasi deri në momentin e parashikuar në njoftim nuk u paraqit asnjë ofertues për blerje sipas ligjit të ankandit publik duke e ulur shumën nga 2,620,782 lekë në 2,096,630 lekë.

Për vlerën e fundit ulur në 2,096,630 lekë ka paraqitur ofertë vetëm një subjekt "S & P" Shpk Dokumentacioni i paraqitur nga ana e tij për ankandin përmbante dhe dokumentacionin e ofertës ekonomike. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike rezultoi se oferta që ka paraqitur ishte në shumën 2,105,737 (dy milion e njëqind e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e shtatë) lekë pa TVSH pra më e madhe se ajo e fiksuar në njoftimin e ankandit prej 2,096,630 (dy million e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH.

Mbasi u shqyrtuan dhe dokumentat e tjera ligjore të paraqitura nga subjekti kjo ofertë u konsiderua nga njësia e ankandit si ofertë e suksesshme dhe Njësia e Ankandit vendosi që të shpallet oferta fituese ajo e firmës "S." Shpk.

Nga auditimi për ankandin e kontenierëve rezultoi se:

- U konstatua se mungon vendimi i Këshillit Drejtues për shitjen e këtyre mjeteve veprim i cili bie në kundërshtim me Nenin 23 pika 6 e ligjit "Për Ndërmarrjet Shtetërore".

- Autoriteti Kontraktor nuk ka nxjerrë nga përdorimi sasinë e plotë të kontenierëve, konkretisht vetëm 2 kontenierë janë nxjerrë nga përdorimi. Këto veprime bien në kundërshtim me Nenin 4 pika c të LIGJIT Nr. 9874, datë 14.02.2008 "Për ankandin publik". Sipas Nenit 4 të ligjit për "Për ankandin publik", ky ligj gjen zbatueshmërinë vetëm për mallrat e dala jashtë përdorimit.

KNRA ka filluar procedurën për shitjen me anë të ankandit të kontenierëve me urdhërin Nr. 405 datë 14. 06. 2016. Kjo procedurë është zhvilluar në kundërshtim me Nenin 23 pika 6 e ligjit "Për Ndërmarrjet Shtetërore" ku mungon vendimi i Këshillit Drejtues për shitjen e këtyre mjeteve. Drejtori i ndërmarrjes ka lejuar zhvillimin e kësaj procedure në kundërshtim me Nenin 4 pika c të LIGJIT Nr. 9874, datë 14. 2. 2008 "Për ankandin publik".

Mungesa e vendimt të Këshillit Drejtues për shitjen e këtyre mjeteve veprim i cili bie në kundërshtim me Nenin 23 pika 6 e ligjit "Për Ndërmarrjet Shtetërore". LIGJI Nr. 9874, datë 14. 2. 2008 "PËR ANKANDIN PUBLIK" Neni 4 pika c gjen zbatueshmërinë vetëm për mallrat e dala jashtë përdorimit.

Moszbatim i LIGJIT Nr. 9874, datë 14.02.2008 "Për ankandin publik" dhe ligjit "Për Ndërmarrjet Shtetërore".

Procedura e shitjes me anë të ankandit është kryer në kundërshtim me fushën e zbatimit të këtij ligji ku këto mallra nuk duhet të ishin shitur pa dalë nga përdorimi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi Drejtori i KNRA z. A. G.

2.7 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.

Në zbatim të Pikës 7 të Programit të Auditimit “Nr. 347/2 Prot. datë 28.03.2024”,

“*Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit*”.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, të cilat vendosen, ruhen dhe përditësohen rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihen në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar riskun e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet veprimtarive efektive, efëiente dhe me ekonomi, pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat, informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota dhe mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Në zbatim të pikës 7 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Rregullorja e brendshme.
2. Deklarata e misionit të KNRA
3. Struktura organizative dhe analitike e KNRA

Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, në KNRA, grupi auditues kreu verifikimet mbi implementimin dhe plotësimin e kërkesave mbi funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale dhe realizimin e objektivave të vendosura për komponentët e mëposhtëm:

1. *Mjedisin e kontrollit*
2. *Menaxhimin e riskut*
3. *Aktivitetet e kontrollit*
4. *Informimin dhe komunikimin*
5. *Monitorimin*

Për vlerësimin, nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaria dhe kontrolli kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare të Institucionit është efektiv dhe eficient duke i adresuar drejt risqet pontenciale për të dhënë garanci të mjaftueshme në realizimin e misionit dhe objektivave të vendosura nga KNRA. Nëpërmjet ushtrimit të veprimtarive efektive, efëiente dhe me ekonomikitet, zbatimit dhe pajtueshmërisë me legjislacionin në fuqi dhe me aktet e brendshme, gjenerimit të informacioneve operative dhe financiare të besueshme e të plota dhe mbrojtjes së informacionit dhe të aktiveve.

Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të MFK.

Me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, KNRA me V. K. M Nr 397, datë 11.05.2015, fiton statusin e Ndërmarrjes Shtetërore, ku si objekt të veprimtarisë ka riparimin dhe mbajtjen në gadishmëri të mjeteve lundruese të Forcave të Armatosura por dhe puninme dhe shërbime me të tretë (subjekte private). Objekti i veprimtarisë së KNRA-së është ndërtimi dhe riparimi i mjeteve lundruese ushtarake dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura, të mjeteve lundruese civile, të tilla si anije, skafe, motovedeta, gomone etj. , si dhe kryerja e punimeve dhe shërbimeve për të tretë, në përputhje me kapacitetet teknike të ndërmarrjes. Me vendimin Nr. 07, datë 10.05.2016 të Këshillit Drejtues është miratuar rregullorja “*Për organizimin dhe funksionimin e Kantierit të Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve, Pashaliman, Vlorë*” ku qëllimi dhe objekti i kësaj rregulloreje janë:

1. Qëllimi i hartimit të kësaj rregulloreje është realizimi i shpejtë, i saktë, dhe i drejtë i funksioneve dhe kompetencave të strukturave përbërëse të ndërmarrjes, të drejtat dhe detyrimet si dhe bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punës midis tyre.

2. Objekti i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i organizimit, mënyrës së funksionimit, të drejtat e detyrimet e të gjitha strukturave përbërëse të Ndërmarrjes Shtetërore Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve, Pashaliman, si dhe vendosja e normave mbi bazën e të cilave KNRA do të kryejë dhe referojë veprimtarinë e saj, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Drejtimi dhe Administrimi i Shoqërisë realizohet nga:

a. Këshilli Drejtues.

b. Drejtori i KNRA.

Këshilli Drejtues vëzhgon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare. Drejtori i ndërmarrjes ka kompetenca të plota për të vepruar në emër të KNRA dhe kryen të gjitha veprimet e Administrimit të Shoqërisë.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është ndërtimi dhe riparimi i mjeteve lundruese ushtarake dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura, të mjeteve lundruese civile, të tilla si anije, skafe, motovedeta, gomone etj. , si dhe kryerja e punimeve dhe shërbimeve për të tretë, në përputhje me kapacitetet teknike të ndërmarrjes.

1. Mjedisi i Kontrollit. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se: Mjedisi kontrollit përbën bazën ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit dhe përfshin vendosjen e objektivave që sigurojnë përmbushjen e misionit të institucionit, etikën personale dhe profesionale, strukturën organizative, filozofinë dhe praktikën e menaxhimit të burimeve njerëzore. Institucioni nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) në përputhje me Udhëzimin Nr. 10359 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinators të menaxhimit financiar” dhe kontrollit dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike” pika 2. 2. 4.

Ndërmarrja ka një rregullore për rekrutimin e punonjësve e miratuar me Vendimin nr. 4, datë 28.12.2015 të Këshillit Drejtues. Sipas Nenit 23 të ligjit për “Ndërmarrjet shtetërore” Këshilli Drejtues ka të drejtë të marrë vendime për përcaktimin e pagave të punës, rritjen e tyre dhe shpërblimin suplementar të punonjësve dhe përcaktimin e kriterëve të përgjithshme të marrjes në punë dhe të largimit nga puna të punonjësve. Pagat e kësaj ndërmarrjeje nuk motivojnë përmirësimin e sistemit pasi sistemi i pagave nuk është motivues.

Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.

Kodi i Etikës i Kantierit të Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve, Pashaliman, Vlorë (në vijim K.N.R.A.) është hartuar në zbatim të ligjit Nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën shtetërore”, i ndryshuar, të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, të Ligjit Nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të Statutit të KNRA, si dhe të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi që kanë të bëjnë me fushën e veprimit të këtij kodi.

Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Me vendimin Nr. 08 datë 28.12.2015 është miratuar organika e KNRA. Me këtë vendim është përcaktuar përcaktuar saktë organika e KNRA, janë përcaktuar sektorët me detyrat e tyre dhe numri i punonjësve.

Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve.

Për vitet objekt auditimit, u konstatua se ky institucion ka lejuar programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës. Konkretisht me vendimin Nr. 2 datë 16.10.2015 të Këshillit Drejtues është lejuar përdorimi i fondeve për trajnim profesional të punonjësve në lidhje me prokurimet publike.

Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Nga auditimi u konstatua se, në këtë ndërmarrje rezulton se janë caktuar detyra sipas sektorëve, specialistëve dhe punonjësve të tjerë, të cilat janë pasqyruar në rregulloren dhe kontratat individuale të lidhura ndërmjet titullarit dhe punonjësve.

2. Menaxhimi i riskut. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se: Për periudhën e audituar nga KNRA nuk është krijuar regjistri i riskut, sipas kërkesave të nenit 12 pika 3/d e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin". Për sa më lart, drejtuesit e KNRA, në cilësinë e nëpunësit autorizues, për periudhën respektive brenda periudhës së auditimit, nuk ka zbatuar detyrimin e përcaktuar në nenin 10, të ligjit Nr. 10296 datë 08.07.2010 të MFK, "Përgjegjshmëria menaxheriale e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut".

3. Aktivitetet e kontrollit. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se: Nga ana e KNRA nuk është hartuar regjistri i riskut në lidhje me zhvillimin e aktivitetit të saj nga viti 2017 deri në vitin 2021. Identifikimi i riskut për ecurinë e aktivitetit të kantierit rrit dhe përmirëson sistemet e menaxhimit, vlerëson kontrollin të cilat adresojnë risk, si dhe inkurajon kontrole efektive, eficiente dhe nxitje për përmirësim të vazhdueshëm. Hartimi i regjistrit të riskut rrit vlerësimin dhe pasqyrimin e procesit që siguron besueshmëri dhe integritet të informacionit financiar dhe operacional.

4. Informimi dhe komunikimi. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi: Bazuar në të drejtën e informimit, i cili zbatohet dhe është publikuar në faqen zyrtare të KNRA ku konkretisht është vënë në dispozicion për publikun e gjerë baza ligjore me të cilën KNRA funksionon dhe aktiviteti bashkë me shërbimet që kjo ndërmarrje ofron.

5. Monitorimi. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se: Sistemet e kontrollit të brendshëm duhen monitoruar për të vlerësuar cilësinë e sistemit të performancës në kohë. Monitorimi kryhet nëpërmjet një monitorimi në vazhdimësi, nëpërmjet vlerësimeve të shkëputura ose duke i kombinuar të dyja. Monitorimi i aktiviteteve të kontrollit të brendshëm duhet të dallohet qartë nga verifikimi dhe monitorimi i operacioneve të institucionit. U konstatua se nuk është kryer analizë për punën e kantierit. Nga qendra e monitorimit duhet të mbahet informacion ditor mbi monitorimin e proceseve operacionale të punës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi Drejtori i KNRA z. A. G.

Konkluzion

Për sa më lartë, sistemi i kontrollit të brendshëm i KNRA vlerësohet **jo efektiv** dhe me mangësi në lidhje me funksionimin e të pestë komponentëve që veprojnë së bashku në një mënyrë të integruar, duke ndikuar drejtpërdrejt në mosfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të kësaj njësie. Rritja e efektivitetit të KNRA për arritjen e objektivave të vendosura, krahas përcaktimit të misionit, strategjisë, në mënyrë të veçantë duhet të fokusohet në drejtim të hartimit dhe monitorimit të planeve konkrete të veprimit, të cilat duhet të përmbajnë afatet kohore dhe personat përgjegjës për realizimin e tyre. KNRA nuk është hartuar një plan për zhvillimin e strategjisë dhe nuk ka kryer analiza pune periodike e vjetore të aktiviteteve të saj për periudhën e auditimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi Drejtori i KNRA z. A. G.

Nga auditimi konstatohet që: Nga ana e KNRA nuk është hartuar regjistri i riskut në lidhje me zhvillimin e aktivitetit të saj ekonomik financiar nga viti 2017 deri në vitin 2021. Sistemi i kontrollit të brendshëm i KNRA vlerësohet jo efektiv edhe për arsye të mos përgjigjeve nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes në lidhje me kërkesat që KNRA i ka drejtuar. U konstatua se KNRA nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik dhe nuk ka caktuar koordinatorin e riskut.

Ky veprim është në mospërputhje me: Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Kjo si shkak i mungesës së vendimmarrjes të KNRA-së që përben risk për mosrealizimin e objektivave dhe besueshmerine e ndermarrjes.

Për sa është trajtuar në projektraportin e auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 347/6 prot, datë 28.08.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

“ . . Kemi hartuar regjistra risku per vitet 2021,2022,2023,2024. . . . Analiza vjetore kemi kryer cdo vit, si dhe Keshilli Drejtues ka marre vendime per analizen e treguesve ekonomik financiar,bashkelidhur analizat vjetore per vitet 2016,2017,2018,2019,2020,2021,2022,2023. . ”

Qëndrimi i grupit të auditimit

Duke qënë se ju keni paraqitur pretendimet tuaja me dokumentacionin përkatës për konstatimet e mësipërme observacioni juaj do të merret parasysh pjesërisht.

Për sa më sipër observacioni pranohet pjesërisht dhe do të kryhen rregullimet përkatëse përgjate materialit.

2.8. Auditim mbi realizimin e kontratave të lidhura për riparimin e mjeteve lundruese të Forcave të Armatosura si dhe për kryerjen e punimeve dhe shërbimeve për të tretë, në përputhje me kapacitetet teknike të ndërmarrjes.

Në zbatim të pikës 8, të Programit të Auditimit nr. 347/2, datë 28.03.2024, pika 8/1- “Mbi realizimin e kontratave të lidhura për riparimin e mjeteve lundruese të Forcave të Armatosura në përputhje me kapacitetet teknike të ndërmarrjes”, u shqyrtua dokumentacioni sa më poshtë vijon:

Nr.	Vitet	Kontrata	
		datë	Lekë me tvsh
1	2016	29.03.2016	64,405,000
2	2017	05 04.2017	45,000,000
3	2018	19.03.2018	45,000,000
4	2019	04.03.2019	74, 520,000
5	2020	19.06.2020	40,000,000
6	2021	20.04.2021	55,000,000
7	2022	26.05.2022	54,370,951
8	2023	27.03.2023	55,000,000

Burimi i të dhënave KNRA

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

- Kontrata e shërbimit lidhur ndërmjet KNRA^{së} dhe Komandës së Forcës Detare që prej krijimit të KNRA^{-së} si ndërmarrje shtetërore, është lidhur në kohë vonesë, kjo për shkak të mosmiratimit në kohë të tarifave të shërbimeve për mjetet lundruese nga Komisioni i Miratimit të Kostove.

- Në bazën ligjore të lidhjes së kontratave vjetore për shërbime riparimi dhe dokimi për mjetet lundruese të Forcave të Armatosura të lidhur ndërmjet KNRA^{-së} dhe Komandës së Forcës Detare, përveç akteve ligjore e nënligjore në vijim:

- a- Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil”, nenet 850-875, i ndryshuar.
- b- Ligji nr. 7582, datë 13.07.1992, “Për ndërmarrjet shtetërore”, i ndryshuar.
- c- VKM nr. 397, datë 11.05.2015 “Për krijimin e ndërmarrjes shtetërore “KNRA”.

është dhe baza nënligjore, sipas viteve sa vijon:

1. Kontrata e riparimit për vitin 2016, nr. 227 Prot., datë 29.03.2016 të KNRA^{-së} dhe nr. 1048/1, datë 29.03.2016 të KFD^{-së}, me vlerë 64,405,000 lekë.

a- Urdhëri i Ministrit të Mbrojtjes nr. 430, datë 04.03.2016, “Për miratimin e tarifave të shërbimeve për mjetet lundruese dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura për vitin 2016”.

b- Urdhrit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, nr. 50/1, datë 19.02.2016, “Për planin e vjetor të dokimit dhe riparimit të teknikës detare për vitin 2016”.

c- Shkresa e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, nr. 119/2, datë 10.03.2016, “Për përgatitjen dhe lidhjen e kontratës me objekt “Dokimi dhe Riparimi i anijeve të Forcës Detare, për vitin 2016”.

d- Urdhëri i Komandantit të Forcës Detare, nr. 129, datë 10.03.2016, “Për përgatitjen dhe lidhjen kontratës me objekt: “Dokimi dhe Riparimi i anijeve të Forcës Detare për vitin 2016”.

2. Për vitin 2017: Kontrata e riparimit, nr. 128 Prot., datë 05.04.2017 të KNRA-së dhe nr.1016/1, datë 03.04.2017 të KFD-së me vlerë 45,000,000 lekë.

a- Urdhëri i Ministrit të Mbrojtjes, nr. 548, datë 21.03.2017, “Për miratimin e tarifave të shërbimeve për mjetet lundruese dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura”.

b- Urdhri i Zv/Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA nr. 80, datë 24.01.2017, “Për planin e dokimit dhe riparimit të teknikës detare për vitin 2017”.

c- Shkresa e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, nr. 1016/1, datë 20.02.2017, “Dërgohet buxheti i detajuar për Art 602 “Mallra dhe shërbime për vitin 2017”.

d- Urdhri i Komandantit të Forcës Detare, nr. 174, datë 29.03.2017, “Për përgatitjen dhe lidhjen kontratës me objekt: “Dokimi dhe Riparimi i anijeve të Forcës Detare për vitin 2017”.

3. Për vitin 2018: Kontrata e riparimit, nr. 114 Prot., datë 15.03.2018 të KNRA^{-së} dhe nr. 755/2, datë 19.03.2018 të KFD^{-së}, me vlerë 45,000,000 lekë.

a- Urdhëri i Ministrit të Mbrojtjes nr. 246, datë 21.02.2018 “Për miratimin e tarifave të shërbimeve për mjetet lundruese dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura”.

b- Urdhri i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA nr. 13, datë 09.02.2018 “Për planin e dokimit dhe riparimit të teknikës detare për vitin 2018”.

c- Shkresa e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, nr. 876, datë 07.02.2018 “Dërgohet buxheti i detajuar për Art 602 “Mallra dhe shërbime për vitin 2018”.

d- Urdhri i Komandantit të Forcës Detare nr. 106, datë 26.02.2018 “Për përgatitjen dhe lidhjen kontratës me objekt “Dokimi dhe Riparimi i anijeve të Forcës Detare për vitin 2018”.

4. Për vitin 2019: Kontrata e riparimit, nr. 118 Prot datë 01.03.2019 të KNRA^{-së} dhe nr.640, datë 04.03.2019 të KFD^{-së} me vlerë 74,520,000 lekë.

a- Urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 219, datë 15.02.2019 “Për miratimin e tarifave të shërbimeve për mjetet lundruese dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura për vitin 2019”.

b- Urdhrit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA nr. 19, datë 08.01.2019, “Për planin e vjetor të dokimit dhe riparimit të teknikës detare për vitin 2019”.

c- Plani vjetor i riparimit të teknikës detare dhe plani vjetor i dokimit të teknikës detare për vitin 2019, miratuar me Urdhër të Komandantit të Forcës Detare, nr. 22, datë 10.01.2019, “Për zbatimin e planit vjetor të dokimit dhe riparimit të teknikës detare për vitin 2019”.

d- Shkresa e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, nr. 873/7, datë 15.02.2019, “Dërgohet buxheti i detajuar për Art 602, “Mallra dhe shërbime për vitin 2019”.

e- Shkresën e Degës së Logjistikës së Forcës Detare, nr. 640/1, datë 22.02.2019, “Kërkesë për lidhje kontrate për mirëmbajtjen e anijeve të Forcës Detare për vitin 2019 me KNRA Pashaliman, Vlorë”.

f- Urdhri i Komandantit të Forcës Detare, nr. 107, datë 26.02.2019, “Për përgatitjen dhe lidhjen kontratës me objekt “Dokimi dhe riparimi i anijeve të Forcës Detare për vitin 2019”.

5. Për vitin 2020: Kontrata e riparimit, nr. 308, Prot., datë 19.06.2020 të KNRA^{-së} dhe nr. 1775, datë 19.06.2020 të KFD^{-së} me vlerë 40,000,000 lekë.

a- Urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 637, datë 08.06.2020 “Për miratimin e tarifave të shërbimeve për mjetet lundruese dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura për vitin 2020”.

b- Urdhrit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA nr. 60, datë 22.01.2020, “Për planin e vjetor të dokimit dhe riparimit të teknikës detare për vitin 2020”, i ndryshuar.

c- Shkresa nr. 1650/2, datë 16.06.2020, “Kërkesë për ndryshim grafiku mbi dokimin e mjeteve detare për vitin 2020, drejtuar Shtabit të Përgjithshëm të FA-së.

d- Plani vjetor i riparimit të teknikës detare dhe Plani vjetor i dokimit të teknikës detare për vitin 2020, i miratuar me nr. 1650/2 Prot, datë 16.06.2020.

e- Shkresa e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, nr. 237/3, datë 27.02.2020, “Dërgohet detajimi i buxhetit të vitit 2020, 2021 dhe 2022 për shpenzimet korente”.

f- Shkresa e Degës së Logjistikës së Forcës Detare nr. 1650/1, datë 16.06.2020, “Kërkesë për lidhje kontrate për dokimin dhe mirëmbajtjen e anijeve të Forcës Detare për vitin 2020 me KNRA, Pashaliman, Vlorë”.

g- Urdhri i Zv/Komandantit të Forcës Detare, nr. 201, datë 17.06.2020, “Për përgatitjen dhe lidhjen kontratës me objekt “Dokimi dhe Riparimi i anijeve të Forcës Detare për vitin 2020”.

6. Për vitin 2021: Kontrata e riparimit, nr. 279 Prot. , datë 16.04.2021 të KNRA^{-së} dhe nr. 1171/2, datë 20.04.2021 të KFD^{-së} me vlerë 55,000,000 lekë.

a- Urdhëri i Ministrit të Mbrojtjes nr. 470, datë 07.04.2021, “Për miratimin e tarifave të shërbimeve për mjetet lundruese dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura për vitin 2021”.

b- Urdhrit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, nr. 47, datë 21.01.2021, “Për planin e vjetor të dokimit dhe riparimit të teknikës detare për vitin 2021”.

c- Plani vjetor i riparimit të teknikës detare dhe plani vjetor i dokimit të teknikës detare për vitin 2021, i miratuar nga Komandanti i Forcës Detare me shkresën 1325, datë 14.04.2021.

d- Shkresa e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, nr. 5662/4, datë 28.01.2021, “Njoftim mbi detajimin e buxhetit të vitit 2021, 2023 dhe 2023 për shpenzimet korente”.

e- Shkresën e Degës së Logjistikës së Forcës Detare, nr. 1325, datë 14.04.2021, “Kërkesë për lidhje kontrate për dokimin dhe mirëmbajtjen e anijeve të Forcës Detare për vitin 2021 me KNRA, Pashaliman, Vlorë”.

f- Urdhri i Komandantit të Forcës Detare nr. 164, datë 14.04.2021, “Për përgatitjen dhe lidhjen kontratës me objekt “Dokimi dhe Riparimi i anijeve të Forcës Detare për vitin 2021”.

7. Për vitin 2022: Kontrata e riparimit, nr. 298 Prot. , datë 24.05.2022 të KNRA^{-së} dhe nr. 1568/3, datë 26.05.2022 të KFD^{-së}, me vlerë 54,370 951 lekë.

a- Urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes, nr. 716, datë 13.05.2022, “Për miratimin e tarifave të shërbimeve për mjetet lundruese dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura, për vitin 2022”.

b- Urdhri i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, nr. 33, datë 19.01.2022, “Për planin e vjetor të dokimit dhe riparimit të teknikës detare për vitin 2022”.

c- Shkresa e Komandantit të Forcës Detare nr 1677, datë 23.05.2022, “Ridërgim i planit e vjetor riparimit të teknikës detare në KNRA, Pashaliman për vitin 2022”, drejtuar Shefit të SHP të FA.

d- Shkresa e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, nr. 737/1, datë 15.02.2022 “Dërgohet buxheti i detajuar për artikullin 602, mallra dhe shërbime”, viti 2022”.

e- Shkresën e Degës së Logjistikës së Forcës Detare nr. 1568, datë 18.05.2022, “Kërkesë për lidhje kontrate për dokimin dhe mirëmbajtjen e anijeve të Forcës Detare për vitin 2022 me KNRA, Pashaliman, Vlorë”.

f- Urdhri i Komandantit të Forcës Detare nr. 213, datë 23.05.2022, “Për përgatitjen dhe lidhjen kontratës me objekt -Dokimi dhe Riparimi i anijeve të Forcës Detare për vitin 2022”.

8- Për vitin 2023: Kontrata e riparimit, nr. 268, Prot. , datë 17.03.2023 të KNRA^{-së} dhe nr.1467/2, datë 17.03.2023 të KFD^{-së}, me vlerë 55,000,000 lekë.

a- Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes nr. 320, datë 06.03.2023 “Për miratimin e tarifave të shërbimeve për mjetet lundruese dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura për vitin 2023”.

b- Urdhri i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, nr. 75, datë 25.01.2023, “Për planin e vjetor të dokimit dhe riparimit të teknikës detare për vitin 2023”.

c- Urdhri i Komandantit të Forcës Detare, nr. 54, datë 31.01.2023, “Për zbatimin e planit vjetor të dokimit dhe riparimit të teknikës detare të FD, për vitin 2023”.

d- Shkresa e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, nr. 1195/1, datë 27.02.2023 “Dërgohet buxheti i detajuar për artikullin 602 “Mallra dhe shërbime” i vitit 2023.

e- Shkresën e Degës së Logjistikës së Forcës Detare nr. 894, datë 09.03.2023 “Kërkesë për lidhje kontrate me KNRA, Pashaliman, Vlorë, për dokimin dhe riparimin e anijeve të Forcës Detare për vitin 2023”.

Ku nga auditimi rezultoi se, në të gjitha kontratat vjetore, në këtë bazë ligjore, është përcaktuar plani vjetor i dokimit dhe riparimit të teknikës detare për vitin përkatës, i cili është edhe objekti kryesor i veprimtarisë së KNRA dhe buxheti i detajuar për artikullin 602 “Mallra dhe shërbime” i vitit përkatës, referuar:

- VKM nr. 397, datë 11.05.2015 “Për krijimin e ndërmarrjes shtetërore, “Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve”, pika 3, 5 dhe 6 ku citohet:

3. *Objekti i veprimtarisë së KNRA-së është ndërtimi dhe riparimi i mjeteve lundruese ushtarake dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura, të mjeteve lundruese civile, të tilla si anije, skafe, motovedeta, gomone etj. , si dhe kryerja e punimeve dhe shërbimeve për të tretë, në përputhje me kapacitetet teknike të ndërmarrjes.*

5. *Tarifat e shërbimit të mjeteve lundruese dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura përcaktohen me urdhër të ministrit të Mbrojtjes.*

6. *Riparimi i mjeteve lundruese të Forcave të Armatosura do të kryhet bazuar në kontratat e lidhura midis palëve dhe sipas një grafiku vjetor. Riparimi i mjeteve të Forcave të Armatosura ka prioritet mbi të gjitha subjektet e interesuara.*

- Urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 03, datë 06.01.2016, “Për ngritjen dhe funksionimin e komisionit të miratimit të tarifave të shërbimeve për mjetet lundruese dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura”.

Komanda e Forcës Detare, referuar detyrimeve që rrjedhin nga urdhri i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, “Për planin e dokimit dhe riparimit të teknikës detare”, dhe shkresave të Sekretarit të Përgjithshëm për buxhetin e detajuar të miratuar, nuk ka futur për

riparim/dokim në KNRA të gjitha mjetet lundruese të planifikuara dhe miratuara sipas grafikut (bashkëlidhur kontratave të çdo viti), kriter i VKM nr. 397, datë 11.05.2015 “Për krijimin e ndërmarrjes shtetërore, “Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve”, pika 6 ku citohet: “6. Riparimi i mjeteve lundruese të Forcave të Armatosura do të kryhet bazuar në kontratat e lidhura midis palëve dhe sipas një grafiku vjetor. Riparimi i mjeteve të Forcave të Armatosura ka prioritet mbi të gjitha subjektet e interesuara”.

Për sa më sipër rezulton se nga viti 2016 deri në vitin 2023, nuk kanë dalë në shkallë për dokim/riparim 49 mjete lundruese, të cilat kanë qenë pjesë e anekseve të kontratës dhe grafikut të miratuar nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Në tabelën në vijim, janë mjetet lundruese që nuk kanë dalë për dokim/riparim në KNRA për vitet objekt auditimi 2016 -2023:

Nr.	Emërtimi i anijes	Mjetet lundruese që nuk kanë dal për dokim/riparim në KNRA.							
		2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
1	Arch - Angel P-02					jo			
2	Arch - Angel P-05			jo		jo			
3	Arch - Angel P-04			jo			jo		jo
4	Arch -Angel P-03			jo		jo			jo
5	Arch -Angel P-01			jo		jo		jo	jo
6	Pantoni I Qitjes	jo	jo	jo		jo			
7	Anija Amerikane P-118		jo						
8	Anija Amerikane P-117			jo					jo
9	Anija Oriku		jo						
10	Anija Antidotje Y-32		jo	jo		jo			
11	Anija Antidotje Y-31			jo		jo			
12	Anija e hidrografisë A-81			jo		jo			
13	Anija Iliria P-131			jo				jo	
14	Skafi i Hidrogr. Ms 1171			jo		jo	jo	jo	
15	Anija Amerikane P-116								
16	Anija BUTRINTI						jo		
17	Anija Lissus P-133								
18	Anija Shqiponja A-82	jo				jo		jo	jo
19	Anija Amerikane P-110			jo				jo	
20	Anija Amerikane P-112		jo		jo				jo
21	Skafi I Polumbareve	jo		jo	jo	jo			jo
	Totali	3	5	13	2	11	3	5	7

Mos dalja për riparim e 49 mjeteve lundruese për periudhën 2016-2023, për arsye të mos miratimit në kohe të tarifave të shërbimeve për mjetet lundruese, ka ndikuar negativisht në arkëtimin e të ardhurave dhe në gjendjen financiare të ndërmarrjes në një vlerë prej 87,193,861 leke pa TVSH, referuar grafikut të mjeteve lundruese të miratuar çdo vit nga Shefit i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, buxhetit të miratuar për këtë qëllim dhe kontratës dy palëshe të riparimit në një kohë që KNRA ka planifikuar burime materiale dhe njerëzore për përbalimin e punimeve dhe shërbimeve për këto mjete lundruese.

Në tabelën në vijim paraqitet vlera e anijeve që nuk kanë dal në shkallë për riparim.

Nga kontrolli i praktikave (situacione dhe anekse) të faturimit për çdo mjet lundrues rezulton se dokimi dhe riparimi i anijeve të Forcës Detare si dhe faturimi i punimeve dhe shërbimeve që KNRA ka kryer në këto mjete lundruese është bërë sipas tarifave të miratuara me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes. Çdo vit KNRA dhe Komanda e Forcës Detare lidhin një kontratë shërbimi ku KFD është Porositës dhe KNRA është Sipërmarrës.

Në kontratën e shërbimit parashikohet që :

Neni 4. Të drejtat dhe detyrimet e paleve: 4. 3. *Palët do të bashkrendojnë programin e punës për realizimin praktik të objektit të kontratës duke ngritur struktura përkatëse për kordinim, bashkëpunim e për organizimin e punës .*

Referuar nenit të sipërcituar të dy repartet respektive cdo vit përcaktojnë një komision që ndjek dhe zbaton kushtet e kontratës dhe anekset e kontratës .

4. 7“Porositësi”, nëpërmjet komisionit për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, ka të drejtë të inspektojë, verifikojë cilësinë dhe zërat e punimeve në përshtatje me preventivin e punimeve dhe nëse konstatohen mangësi apo defekte të kësaj natyre lajmëron “Sipërmarrësin”, duke kërkuar nga ky i fundit eliminimin e tyre në përputhje me standartet e kërkuara.

Në asnjë rast komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, ngritur me urdhër të Komandantit të FD-së nuk ka konstatuar mangësi apo defekte në zërat e punimeve që KNRA ka kryer dhe ka faturuar për mjetet lundruese . Kjo evidentohet edhe referuar nenit 6 dhe nenit 9 të Kontratës së shërbimit ku citohet se;

Neni 6: Testimet dhe Inspektimet gjatë dokimit dhe riparimit.

6. 2 “Porositësi”, do të refuzojë çdo zë punimi që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

6“Porositësi”, ka të drejtë të inspektojë kryerjen e punimeve të dokimit dhe riparimit të m.3 jeteve lundruese, nëpërmjet komisionit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës.

Neni 9: Egzaminimi dhe Pranimi i shërbimeve të kryera

9.1 Përpara marrjes në dorëzim të mjetit lundrues, “Porositësi”, me komision, në prani të “Sipërmarrësit” ka të drejtë të egzaminojë, inspektojë dhe testojë zërat e punimeve dhe të riparimeve të kryera, **jo më vonë se 7 ditë nga njoftimi i përfundimit të punimeve.**

9.2 “Porositësi”, duhet të pranojë ose refuzojë punimet e kryera menjëherë pas dorëzimit dhe duhet t’i japi “Sipërmarrësit” njoftim me shkrim për veprimin e tij, për të pranuar ose refuzuar punimet e kryera.

Për sa më sipër, rezulton se të gjitha riparimet dhe shërbimet për mjetet lundruese të FA-së janë kryer konform neneve dhe anekseve ligjore që parashikon kontrata e shërbimit lidhur ndërmjet KFD-së dhe KNRA-së.

Vlen të theksohet se KNRA mban përgjegjësi për çdo difekët që shfaqet (për faj të KNRA) për punimet e kryera apo materialet e vendosura gjatë riparimit deri në përfundimin e afatit të garancisë. Për çdo riparim mjeti lundrues, KNRA lëshon një deklaratë garancie që i bashkëlidhet dokumentacionit të anijes për likuidim, dhe ka fuqi veprimi deri në 1 vit nga data e dorëzimit të mjetit lundrues. Nga ana e KFD ose Komisionit të ndjekjes dhe zbatimit të Kontratës nuk është paraqitur/reklamuar asnjë shërbim që nuk ka përmbushur kushtet e garancisë. Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve është i detyruar që çdo shërbim / riparimi për mjetet e FD-së t’a kryej me cilësi dhe konformë kushteve dhe parametrave teknikë.

U audituan me zgjedhje disa praktika, ku po përshkruajmë, konkretisht:

Anija “Rodon Y-31, bashkëlidhur praktikës ndodhen:

- Akt dorëzimi për riparimin e anijës, për riparim/ dokim mujor, të firmosur nga Komisioni i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës të Forcës detare, një komision i përbërë nga 6 anëtarë dhe nga Komisioni i KNRA i përbërë nga 4 anëtarë.
- Akt Dokimi nr. 5, datë 27.07.2023, sipas të cilit pasi janë kontrolluar pjesët e nënujshme të anijes dhe të tjera pjesë të saj, ka vendosur të marrë përsipër kryerjen e vëllimit të përcaktuara në këtë akt dokimi, gjithsej 12 zëra. Ky akt është firmosur nga komisioni i Forcës Detare përbërë nga 6 anëtarë dhe nga Komisioni i KNRA i përbërë nga 4 anëtarë.
- Më tej në dosje ndodhet “Preventivi financiar për zërat e punimeve që do të kryheb gjatë riparimit të nivelit të tretë të anijës të rep ushtrak”, i firmosur përsëri i nga të dy komisionet dhe i miratuar nga Drejtori i KNRA.
- Deklaratë garancie nr. 05, datë 22.08.2023 i firmosur nga Komisioni i KNRA, sipas së cilës deklarohet me përgjegjësi të plotë se punimet janë kryer me cilësi dhe në përputhje të plotë me kontratën e lidhur midis palëve (nr. 1072, datë 20.03.2023) dhe specifikimet e kësaj kontrate. Gjithashtu në këtë deklaratë garancie evidentohet se: “Në rast se në punimet e kryera nga ana e KNRA në mekanizmat, sistemet, paisjet e anijes do të evidentohen difekte apo parregullsi në funksionimin e tyre, brenda periudhës së garancisë prej 12 muaj (sikurse shprehet në kontratë), KNRA do ti kryejë sërish këto punime falas (pa faturë financiare për Komandën e Forcës Detare).
- Situacioni përmbledhes përfundimtar i punimeve të riparim/ dokimit të firmosur nga të dy komisionet.
- Situacionet pjesore (dy) të cilat janë të firmosura përsëri nga të dy komisionet
- Faturat elektronike të firmosura nga të dy komisionet.

Kjo praktikë nga auditimi me zgjedhje është ndjekur për të gjitha anijet sipas viteve objekt auditimi.

Konkluzion:

- Kontrata e shërbimit lidhur ndërmjet Kantierit të Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve dhe Komandës së Forcës Detare që prej krijimit të KNRA-së si Ndërmarrje Shtetërore, **është lidhur në kohë vonesë, kjo për shkak të mosmiratimit në kohë të tarifave të shërbimeve për mjetet lundruese nga Komisioni i Miratimit të Kostove.**

- Mos dalja për riparim e 49 mjeteve lundruese, **ka ndikuar negativisht në arkëtimin e të ardhurave dhe në gjendjen financiare të ndërmarrjes** në një vlerë prej **87,193,861 leke pa TVSH**, referuar grafikut të mjeteve lundruese të miratuar çdo vit nga Shefit i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, buxhetit të miratuar për këtë qëllim dhe kontratës dy palëshe të riparimit.

- Nga ana e KFD ose Komisionit të ndjekjes dhe zbatimit të Kontratës **nuk është paraqitur/reklamuar asnjë shërbim që nuk ka përmbushur kushtet e garancisë.**

8/2- Mbi realizimin e kontratave të lidhura për shërbimet për të tretë, në përputhje me kapacitetet teknike të ndërmarrjes.

Në zbatim të pikës 8/2 të Programit të auditimit nr. 347/2, datë 28.03.2024, “Mbi realizimin e kontratave të lidhura për shërbimet për të tretë, në përputhje me kapacitetet teknike të ndërmarrjes”, u shqyrtua dokumentacioni

- Procedura standarte e Veprimit (SOP 209/3), “Për paisje me leje hyrje/kalimi tranzit të vizitorëve vendas dhe të huaj që vizitojnë parkun arkeologjik të Orikut, subjekteve private që

kryejnë aktivitet në zonën e Karaburunit dhe KNRA”, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Mbrojtjes me nr. 1044, datë 09.07.2018.

- Kontratat me subjektet private dhe likuidimi i tyre.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Referuar VKM nr. 397, datë 11.05.2015 “Për krijimin e ndërmarrjes shtetërore, “Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve”, pika 3, dhe 6, ku citohet:

3. Objekti i veprimtarisë së KNRA-së është ndërtimi dhe riparimi i mjeteve lundruese ushtarake dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura, të mjeteve lundruese civile, të tilla si anije, skafe, motovedeta, gomone etj. , si dhe kryerja e punimeve dhe shërbimeve për të tretë, në përputhje me kapacitetet teknike të ndërmarrjes.

6. Riparimi i mjeteve lundruese të Forcave të Armatosura do të kryhet bazuar në kontratat e lidhura midis palëve dhe sipas një grafiku vjetor. Riparimi i mjeteve të Forcave të Armatosura ka prioritet mbi të gjitha subjektet e interesuara.

Është konstatuar se për periudhën 2016 deri në 2023 KNRA, në bazë të hapsirave përpunuese dhe kapaciteteve teknike ka kryer shërbime dhe riparime me të tretë sipas tabelës së mëposhtëme:

Vitet	Ardhura Privat		Realizimi në %
	plan	fakt	
2016	15,000,000	11,038,160	73.59
2017	14,000,000	11,207,889	80.06
2018	10,000,000	5,196,795	51.97
2019	13,000,000	6,754,887	51.96
2020	12,000,000	3,605,771	30.05
2021	10,000,000	3,874,433	38.74
2022	8,400,000	2,037,772	24.26
2023	4,400,000	1,166,928	26.52
TOTAL	86,800,000	58,335,159	67.21

Burimi i të dhënave KNRA

Të gjitha punimet dhe shërbimet e kryera nga KNRA kundrejt subjekteve private janë kryer referuar një kontrate sipërmarrje.

Nga ku rezultoi se:

- Nga ana e pronarëve të mjeteve lundruese private paraqitet kërkesë në KNRA, në të cilën përcaktohen shërbimet e kërkuara, efektiviteti i mjetit lundrues, mjetet e transportit si dhe dokumentacioni i mjetit lundrues. Ky dokumentacion përbëhet nga:

a- Certifikatë rregjistrimi të personit të tatueshëm;

b- Certifikatë nga rregjistrimi detar shqiptar;

c- Aneksi i certifikatës, ku përcaktohet **tonazhi i mjetit**, bruto dhe neto;

d- Vërtetimi nga rregjistrimi detar shqiptar që anija është në përputhje me kërkesat kombëtare. . . .

- Nga ana e KNRA bazuar në procedurën standarte të Veprimit (SOP 209/3), “Për paisje me leje hyrje / kalimi tranzit të vizitorëve vendas dhe të huaj që vizitojnë parkun arkeologjik të Orikut, subjekteve private që kryejnë aktivitet në zonën e Karaburunit dhe KNRA”, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Mbrojtjes me nr. 1044, datë 09.07.2018, i kërkohet Komandës së Forcës Detare autorizim për paisjen me leje hyrje për në KNRA për kryerjen e punimeve për mjetin lundrues përkatës.

- Autorizim për leje hyrje të përkohshme në Pashaliman, KNRA, nga Komanda e Forcës Detare/ Komandanti, ku janë të përcaktuara:

a- Personat

b- Automjetet me targë;

c- Vlefshmëria e lejes me afat dhe e shoqëruar me mjet identifikimi me fotografi;

d- Orari 7 -17.

Pas plotësimit të këtij dokumentacioni:

- Del urdhëri nga KNRA për daljen në shkallë të mjetit lundrues;

- Me përfundimin e shërbimeve të kërkuara nga Drejtoria e KNRA hartohet akti për zbritjen në ujë të mjetit lundrues, sipas të cilit: “nga ky moment KNRA nuk mban përgjegjësi për difekte teknike ose anomali që mund të shfaqë.

Nga auditimi me zgjedhje (periudha 2015 -2023), u audituan dosje të veçanta për vitet 2021, 2022 dhe 2023, vite në të cilat janë riparuar mjetet detare civile sipas tabelës sa më poshtë vijon:

Nr	Emertimi	Vlera me TVSH	Dru /Metalike	Nr	Emertimi	Vlera me TVSH	Dru/ Metalike	Nr	Emertimi	Vlera me TVSH	Dru/ Metalike
2021				2022				2023			
1	Anija D.	190,162	Metalike	1	Klodi 1	325,139	Dru	1	Anija Metalike Andi II	387,040	Metalike
2	S. H.	324,335	Dru	2	Alqivjadhi	328,757	Dru	2	Anija Sulejman Hasani 1	188,531	Dru
3	A. I.	602,872	Metalike	3	Shen Vasili	294,253	Rezine	3	Anija Ardit	203,789	Dru
4	A.A.	107,258	Metalike	4	Oqeania	109,921	Dru	4	Anija Dus Zamani	189,826	Rezine
5	Sh.	364,850	Dru	5	Honezmusi 1	356,801	Rezine	5	Anija Pavarsia	195,665	Dru
6	S.	276,482	Dru	6	Saliko	276,482	Dru	6	Anija Riciola	235,989	Dru
7	A.	251,698	Dru	7	Mario	301,480	Dru				
8	B. P.	335,461	Dru	8	Mario 1	265,014	Dru				
9	N.	436,892	Dru	9	Riciola	158,945	Dru				
10	Anija P.	287,954	Metalike	10	Babale	213,544	Dru				
11	Anija L. S.	295,132	Dru								
12	Anija D. A.	329,428	Metalike								
13	Anija V.M.	212,670	Dru								
14	Anija M.	191,944	Dru								
15	Anija Z. III	217,334	Dru								
16	Anija K.	224,848	Dru								
	SHUMA	4,649,320			SHUMA	2,630,336			SHUMA	1,400,840	

Burimi i të dhënave KNRA

Dosjet e audituara sipas viteve janë:

1- Anije druri S., viti 2019

1	Kërkesë për kryerje shërbimesh nga pronari i mjetit lundrues	e protokolluar në KNRA me nr. 462, datë 12.07.2019
2	Kërkesë për paisje me leje hyrje të përkohshme dërguar nga KNRA për autorizim në KFD	nr. 462/1, datë 12.07.2019.
3	Autorizim për leje hyrje të përkohshme në Pashaliman, KNRA	dërguar nga KFD me shkresë nr. 2568/1, datë 30. 07. 2019
4	Kontratë sipërmarrje lidhur ndërmjet Drejtorit të Kantierit dhe	nr. 462/3, datë 30.07.2019,

	Pronarit të mjetit lundrues .	
5	Urdhër për daljen në shkallë të peshkarrexhes SOKOLAJ ,nxjerr nga Drejtori i KNRA-së për sektorët teknik .	nr. 462 /4, datë 30.07.2019
6	Situacion i punimeve dhe faturë tatimore për punimet dhe shërbimet e kryera nga KNRA në këtë mjet lundrues	datë 14.08.2019
7	“Akt për zbritjen në ujë”, pasi është konfirmuar mandati i pagesës dhe likuidimit në bankë nga porositësi .	Shkresa Nr. 462/5, datë 14.08. 2019
Të dhëna teknike të mjetit lundrues		
Tonazhi sipas Rregjistrimit Detar GRT (ton) 42		
Gjatesia sipas Rregjistrimit Detar (m) 18. 10 m		
Gjersia sipas Rregjistrimit Detar 5. 35 m		

Burimi i të dhënave KNRA

Shërbimet e kryera dhe të faturuara janë :

Nr	Emertimi i shërbimit	Njësi	Sasi	Cmim njësi pa TVSH	TVSH	Vlerfta me TVSH
1	Dokim i anijes	copë	1	147,547	29,509	177,057
2	Larje me Uje	m ²	80	84	1,347	8,082
3	Pastrim mbetjesh (mbeturina)	m ³	1	8784. 0	1,757	10,541
4	Tarifa per 20 ditet e para në shina	dite	15	1508. 3	4,525	27,150
5	Spostim të takove	copë	6	4167. 5	5,001	30,006
6	Konsum energji elektrike	kW	300	11. 0	660	3,960
SHUMA					42,799	256,796

Burimi i të dhënave KNRA

2- Anije Turistike B. P., viti 2019.

1	Kërkesë për kryerje shërbimesh	e prot. në KNRA me nr. 168, 20. 03. 19
2	Kërkesë për paisje me leje hyrje të përkohshme, dërguar nga KNRA për autorizim në Komandën e Forcës Detare	nr. 168/1, datë 21. 03. 2019
3	Autorizim për leje hyrje të përkohshme, KNRA	dërguar nga KFD me nr. 1077/1, 25. 03. 19
4	Kontratë sipërmarrje lidhur KNRA dhe Pronarit të mjetit	nr. 168/3, datë 03. 04. 2019
5	Urdhër për daljen në shkallë të peshkarrexhes B. P.	nr. 168/4, datë 03. 04. 2019
6	Situacion i punimeve dhe faturë tatimore për punimet dhe shërbimet e kryera nga KNRA në këtë mjet lundrues	datë 16. 04. 2019
7	“Akt për zbritjen në ujë”, pasi është konfirmuar mandati i pagesës dhe likuidimit në bankë nga porositësi .	Nr. 168/5, datë 16. 04. 2019

Të dhëna teknike të mjetit lundrues

Tonazhi sipas Rregjistrimit Detar GRT (ton) 99

Gjatesia sipas Rregjistrimit Detar (m) 23. 95 m

Gjersia sipas Rregjistrimit Detar 6. 90 m

Burimi i të dhënave KNRA

Shërbimet e kryera dhe të faturuara janë :

Nr	Emertimi i shërbimit	Njësi	Sasi	Cmim njësi lekë pa TVSH	TVSH	Vlerfta me TVSH
1	Dokim i anijes	copë	1	214,201	42,840	257,042
2	Larje me Uje	m ²	110	84	1,852	11,114
3	Pastrim mbetjesh (mbeturina)	m ³	1	8784	1,757	10,541
4	Tarifa per 20 ditet e para në shina	dite	12	204. 4	491	2,944

5	Spostim të takove	copë	13	1987.9	5,168	31,010
6	Konsum energji elektrike	kW	300	11	660	3,960
SHUMA					52,769	316,611

3- Anija Metalike P., viti 2021:

1	Kërkesë për kryerje shërbimesh	e prot. në KNRA me nr. 360, 25. 05. 2021				
2	Kërkesë për paisje me leje hyrje të përkohshme, dërguar nga KNRA për autorizim në Komandën e Forcës Detare	nr360/1, datë 25. 05. 2021				
3	Autorizim për leje hyrje të përkohshme, KNRA	dërguar nga KFD me nr. 2021, datë 03. 06. 2021				
4	Kontratë sipërmarrje lidhur KNRA dhe Pronarit të mjetit	nr. 360/3, datë 08. 06. 2021				
5	Urdhër për daljen në shkallë të peshkarrexhes BLACK PERLA.	nr. 360 /4, datë 08. 06. 2021				
6	Situacion i punimeve dhe faturë tatimore për punimet dhe shërbimet e kryera nga KNRA në këtë mjet lundrues	datë 21. 06. 2021				
7	“Akt për zbritjen në ujë”, pasi është konfirmuar mandati i pagesës dhe likuidimit në bankë nga porositësi .	nr. 360/5, datë 21. 06. 2021				

Të dhëna teknike të mjetit lundrues

Tonazhi sipas Rregjistrimit Detar GRT (ton) 75

Gjatesia sipas Rregjistrimit Detar (m) 22. 85 m

Gjersia sipas Rregjistrimit Detar 6. 90 m

Burimi i të dhënave KNRA

Shërbimet e kryera dhe të faturuara janë :

Nr	Emertimi i shërbimit	Njësi	Sasi	Cmim njësi pa TVSH	TVSH	Vlerfta me TVSH
1	Dokim i anijes	copë	1	193,570	38,714	232,284
2	Larje me Uje	m ²	120	84	2,021	12,125
3	Pastrim mbetjesh (mbeturina)	m ³	1	8784.0	1,757	10,541
4	Tarifa per 20 ditet e para në shina	dite	13	1904.2	4,951	29,705
5	Konsum energji elektrike	kW	250	11	550	3,300
SHUMA					47,992	287,954

Burimi i të dhënave KNRA

4- Anije druri N., viti 2021

1	Kërkesë për kryerje shërbimesh	e prot. në KNRA me nr. 06, 06.01.2021				
2	Kërkesë për paisje me leje hyrje të përkohshme, dërguar nga KNRA për autorizim në Komandën e Forcës Detare	nr. 69/1, datë 14.01.2021				
3	Autorizim për leje hyrje të përkohshme, KNRA	dërguar nga KFD me nr. 2021, 03. 06. 2021				
4	Kontratë sipërmarrje lidhur KNRA dhe Pronarit të mjetit	nr. 06/5, datë 10.05.2021				
5	Urdhër për daljen në shkallë të peshkarrexhes B. P.	nr. 06/4, datë 10.05.2021				
6	Situacion i punimeve dhe faturë tatimore për punimet dhe shërbimet e kryera nga KNRA në këtë mjet lundrues	datë 21.06.2021				
7	“Akt për zbritjen në ujë”, pasi është konfirmuar mandati i pagesës dhe likuidimit në bankë nga porositësi .	Nr. 06/6, datë 27.05.2021				

Të dhëna teknike të mjetit lundrues

Tonazhi sipas Rregjistrimit Detar GRT (ton) 140

Gjatesia sipas Rregjistrimit Detar (m) 28. 12 m

Gjersia sipas Rregjistrimit Detar 7. 02 m

Burimi i të dhënave KNRA

Shërbimet e kryera dhe të faturuara janë :

Nr	Emertimi i shërbimit	Njësi	Sasi	Cmim njësi pa TVSH	TVSH	Vlerfta me TVSH
1	Dokim i anijes	copë	1	276,499	55,300	331,799
2	Larje me Uje	m ²	120	84	2,020	12,123
3	Pastrim mbetjesh (mbeturina)	m ³	1	8784. 0	1,757	10,541
4	Spostim takosh	dite	6	4167. 5	5,001	30,006
5	Tarifa per 20 ditet e para në shina	copë	17	2343. 3	7,967	47,804
6	Konsum energji elektrike	kWh	350	11	770	4,620
SHUMA					72,815	436,893

Burimi i të dhënave KNRA

5- Anije Metalike A. II, viti 2023.

1	Kërkesë për kryerje shërbimesh	e prot. në KNRA me nr. 41, 24.01.2023				
2	Kërkesë për paisje me leje hyrje të përkohshme, dërguar nga KNRA për autorizim në Komandën e Forcës Detare	nr. 42, datë 24.01.2023				
3	Autorizim për leje hyrje të përkohshme, KNRA	dërguar nga KFD nr. 328/1, 03.02.2023				
4	Kontratë sipërmarrje lidhur KNRA dhe Pronarit të mjetit	nr. 42/3, datë 03.02.2023				
5	Urdhër për daljen në shkallë të peshkarrexhes BLACK PERLA.	nr. 42/4, datë 03.02.2023				
6	Situacion i punimeve dhe faturë tatimore për punimet dhe shërbimet e kryera nga KNRA në këtë mjet lundrues	datë 06.03.2023				
7	“Akt për zbritjen në ujë”, pasi është konfirmuar mandati i pagesës dhe likuidimit në bankë nga porositësi .	nr. 144/2, datë 06.03.2023				

Të dhëna teknike të mjetit lundrues

Tonazhi sipas Rregjistrimit Detar GRT (ton) 75

Gjatesia sipas Rregjistrimit Detar (m) 25. 77 m

Gjersia sipas Rregjistrimit Detar 5. 65 m

Burimi i të dhënave KNRA

Shërbimet e kryera dhe të faturuara janë :

Nr	Emertimi i shërbimit	Njësi	Sasi	Cmim njësi pa TVSH	TVSH	Vlerfta me TVSH
1	Dokim i anijes	copë	1	193,570	38,714	232,284
2	Pastrim mbetjesh (mbeturina)	m ³	1	8784. 0	1,757	10,541
3	Tarifa per 20 ditet e para në shina	ditë	20	2138. 9	8,556	51,334
4	Tarifa per 21-30 dite në shina	ditë	9	6442. 5	11,597	69,579
5	Spostim takosh	copë	4	4167. 0	3,334	20,002
6	Konsum energji elektrike	kWh	250	11	550	3,300
SHUMA					64,507	387,039

Burimi i të dhënave KNRA

6- Anije Turistike D. Z., viti 2023

1	Kërkesë për kryerje shërbimesh	e prot. në KNRA nr. 159, datë 10.03.2023				
2	Kërkesë për paisje me leje hyrje të përkohshme, dërguar nga KNRA për autorizim në Komandën e Forcës Detare	nr. 159/1, datë 10.03.2023				
3	Autorizim për leje hyrje të përkohshme, KNRA	dërguar nga KFD nr. 1042/1, 24.03.2023				
4	Kontratë sipërmarrje lidhur KNRA dhe Pronarit të mjetit	nr. 159/3, datë 30.03.2023				
5	Urdhër për daljen në shkallë të peshkarrexhes B. P.	nr159/4, datë 30.04.2023				
6	Situacion i punimeve dhe faturë tatimore për punimet dhe shërbimet e kryera nga KNRA në këtë mjet lundrues	datë 20.04.2023				
7	“Akt për zbritjen në ujë”, pasi është konfirmuar mandati i pagesës dhe likuidimit në bankë nga porositësi .	Nr. 159/6, datë 20.04.2023				

Të dhëna teknike të mjetit lundrues

Tonazhi sipas Rregjistrimit Detar GRT (ton) 21. 45

Gjatesia sipas Rregjistrimit Detar (m) 14. 60 m
Gjersia sipas Rregjistrimit Detar 4. 75 m

Burimi i të dhënave KNRA

Shërbimet e kryera dhe të faturuara janë :

Nr	Emertimi i shërbimit	Njësi	Sasi	Cmim njësi pa TVSH	TVSH	Vlerfta me TVSH
1	Dokim i anijes	copë	1	123,188	24,638	147,825
2	Pastrim mbetjesh (mbeturina)	m ³	1	8784. 0	1,757	10,541
3	Tarifa per 20 ditet e para në shina	ditë	20	1211. 8	4,847	29,083
4	Konsum energji elektrike	kWh	180	11	396	2,376
SHUMA					31,638	189,825

2.9 Të ndryshme, të rezultuara gjatë auditimit.

• Mbi shkallën Kosjakova.

Veprimtaria e punës së KNRA-së mbi arkëtimin e të ardhurave është e lidhur në mënyrë direkte nga gjendja teknike dhe kapacitetet përpunuese të platformës së nxjerrjes së mjeteve lundruese dhe linjës së shinave (Shkallës Kosjakova). Për shkak të vitit të prodhimit të kësaj platforme si dhe gjendjes teknike dhe amortizimit tej mase të rënduar dhe akumuluar ndër vite, ka bërë që vitet e fundit veprimtaria e punës së KNRA-së të jetë e kushtëzuar por edhe me risk për ngjarje të jashtëzakonshme dhe aksidente si në burime njerëzore dhe në burime materiale.

Ndërtimi fillestar dhe konstruksioni kryesor dhe bazë i shkallës Kosjakova së bashku me linjën e shinave nënujore është realizuar në vitin **1969**. Prej këtij viti prodhimi deri në vitin 2000, kjo strukturë nuk ka patur riparim kapital të strukturës së platformës dhe linjës së shinave. Kjo për faktin se veprimtaria e punës për riparimin e mjeteve lundruese ka qenë e kufizuar për shkak se mjetet lundruese me tonazh mbi 150 ton, realizoheshin nëpërmjet dokut lundrues. Prej vitin 2000 deri në vitin 2018, në platformën e shkallës dhe në linjën e shinave nuk është realizuar asnjë riparim ose investim për mirëmbajtje.

Vlera fillestare e përcaktuar nga ekspertët vlerësues në vitin 2015 është në shumën 120,378,876 lekë dhe pas riparimit në vitin 2019, ka një vlerë fillestare në shumën 132,812,515 lekë. Amortizimi i kësaj shkalle në 31.12.2023 është në shumën 91,421,173 dhe vlera e mbetur është në shumën 41,391,341 lekë ose 31% e vlerës fillestare, pra tejet e amortizuar (në këto shifra nuk është përfshirë amortizimi i akumuluar deri në 31.05.2015, vit i krijimit të KNRA).

Tabela: Analizë e amortizimit të shkallës Kosjakova në vite

Në lekë

Viti	Vlera fillestare dhe vlera e mbetur	Amortizimi i akumuluar në vite	Amortizimi i akumuluar i vitit
2015	2015 (rivlerësimi nga ekspertët)	120,378,876	73,369,586
2016			2,240,000
2017			2,238,464
2018			2,126,541
	2019 (pas riparimit)	132,812,515	
2019		81,994,806	2,020,214
2020		84,535,692	2,540,885
2021		86,949,533	2,413,841
2022		89,242,682	2,293,149
2023		91,421,173	2,178,492
	vlera e mbetur 31. 12. 23	41,391,341. 53	

Burimi i të dhënave KNRA

Përveç viteve të punës, një faktor tjetër që ka ndikuar në amortizimin e shkallës ka qenë edhe dalja për dokim e të gjitha mjeteve lundruese me anë të kësaj platforme (shkalle), pasi në vitin 2006 doku lundrues nuk ka qenë funksional.

Administrata e KNRA-së, në vitin 2016, e ka trajtuar zyrtarisht gjendjen teknike dhe amortizimin që platforma ka pasur.

Kjo situatë është marrë në konsideratë nga grupi i auditimit të brendshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, i cili këtë shqetësim ja ka paraqitur Ministrit të Mbrojtjes.

Ministri i Mbrojtjes me urdhër nr. 2347, datë 21.12.2017, “Për përfundimet e angazhimit të auditimit të plotë të ushtruar në Kantierin e Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve Pashaliman, Vlorë“, ka urdhëruar si me poshtë vijon:

1. Shtabi i Përgjithshëm i FA-së dhe Drejtoria e Modernizimit pranë MM-së, në bashkëpunim me Forcën Detare, IGJIU-në dhe KNRA-në, të krijojnë një komision të përbashkët me specialistë të fushës, për të inspektuar dhe për të vlerësuar gjendjen teknike të platformës (shkallës) të KNRA-së, nëpërmjet të cilës realizohet dalja e anijeve në dok. Komisioni të përgatit një relacion të detajuar mbi gjendjen teknike ekzistuese të shkallës, si dhe të dalë me propozime konkrete për të garantuar normalitetin e këtij aktiviteti për të ardhmen.

Me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, nr. 172, datë 15.02.2018, “Për ngritjen e grupit të punës, për vlerësimin e platformës së shkallës së nxjerrjes së anijeve në dok, në KNRA, Pashaliman, Vlorë“, u bë e mundur ngritja e një komisioni, i cili në datë 28.02.2018 verifikoi gjendjen në terren të shkallës (platformës), që shërben për nxjerrjen e anijeve në tokë.

Nga kontrolli i ushtruar në shkallën “Kosjakova”, grupi i punës në mënyrë unanime i propozoi dhe i rekomandoi Ministrisë së Mbrojtjes:

1. Fillimin e punimeve për riparimin e shkallës nga KNRA.
2. Angazhimin e polumbarëve të Qendrës së Zhytjes, të FD-së, në punimet e nevojshme për riparimin e shkallës.
3. Dhënia e asistencës dhe bashkëpunim i nevojshëm (me specialistë dhe instrumenta matës) nga IGJIU, për rëlevimin dhe për zbatimin e punimeve të riparimit.

KNRA, në datë 24.07.2018 ka bërë të mundur nxjerrjen në tokë për riparim të shkallës “Kosjakova”, duke përballuar gjithë kostot e riparimit si në burime njerëzore dhe materiale me fondet të veta. Ky riparim i mesëm i realizuar nga KNRA në vitin 2018, kishte kosto riparimi (investimi) 12,000,000 lekë.

Gjatë procesit të riparimit të platformës KNRA ka kërkuar zyrtarisht asistencën e polumbarëve të Qendrës së Zhytjes së Forcës Detare dhe të IGJIU, për kontrollin dhe difektimin e pjesës së nënujshme ku janë të montuara linjat e shinave.

Specialistët e IGJIU-së bënë të mundur matjen dhe llogaritjen e devijimeve që paraqisnin linjat e shinave të nënujshme. Me anë të këtyre matjeve specialistët e IGJIU-së, kanë hartuar dokumentacionin teknik, “Plani i spostimeve të shinave në rrafshin horizontal dhe atë vertikal”, me nr. prot 898/8, datë 11.10.2018. Referuar këtij dokumentacioni teknik dhe konkluzioneve që specialistët e IGJIU konstatuan, Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve në bashkëpunim me polumbarët e Qendrës së Zhytjes së Forcave Detare bënë të mundur spesorimin e shinave deri në vijën e projektit. Pas këtij riparimi (investimi) që KNRA bëri, me polumbarët e Qendrës së Zhytjes, specialistët e IGJIU-së bënë përsëri matje për të evidentuar disnivelet e linjave të shinave të nënujshme. Nga matjet e bëra rezultoi se spesorimi që polumbarët kryen në linjat e shinave nënujore bëri të mundur zvogëlimin e disniveleve dhe spostimeve që shinat kishin me njëra-tjetrën, në masën 40 %. Konkretisht në matjet fillestare shinat kishin disnivel me njëra tjetrën 7-9 cm. Ky disnivel ishte i përqëndruar kryesisht në gjatësinë 30-70 metra, nga dy skajet e shinave (veri, jug).

Pas spesorimit nga ana e polumbarëve ky disnivel u reduktua në masën 3-4 cm. Duke qenë se shinat janë të montuara në trarë betoni të zhytur në ujë, ku thellësia e zhytjes në pikën fundore të

shinave arrin në 9 metra thellësi, riparimi optimal në parametrat fillestar ishte i pa mundur të realizohej, si nga polumbarët e Qendrës së Zhytjes ashtu dhe nga Specialistët e IGJIU-së. Riparimi në kushte optimale (teknike) i linjës së shinave nënujore kërkon kompani me eksperiencë dhe të specializuara në të tillë fushë.

Procesi i riparimit të platformës së nxjerrjes së anijeve u bë në gjëndje pune në datë 03.10.2018. Vlen të theksohet se ky riparim do të zgjaste ciklin e përdorimit të shkallës me 1. 5-2 vite. Me plotësimin e këtij afati, shkallës “Kosjakova” (platforma) nuk mund t’i kryhet më remont për shkak të amortizimit tej mase të konstruktit (trarëve kryesorë) metalikë, ku bëhet i mundur montimi i rrotave lëvizëse. Zvogëlimi i spesorit (trashësisë) të trarëve kryesorë, aktualisht është i konsumuar në masën 55-60 %. Pra trashësia e spesorit nga 14 mm në pjesën më të madhe ka arritur në 7.5 mm. Gjëndja teknike e mësipërme është konfirmuar teknikisht nga specialistët e IGJIU-së, **të cilët kanë gjykuar se pas këtij riparimi, platformës nuk mund t’i kryhet më riparimi kapital.**

Referuar gjëndjes teknike të aseteve “Shkallës Kosjakova dhe linja e shinave”, për ecurinë e zhvillimit të KNRA-së në të ardhmen, siç është gjykuar dhe në relacionin e hartuar me nr. 1627/1, ”Relacion mbi vlerësimin e gjëndjes së platformës së shkallës së nxjerrjes së anijeve në Kantierin e Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve, Pashaliman, Vlorë”, nga komisioni i ngritur me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së Nr. 172, datë 15.02.2018 “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e platëformës së shkallës së nxjerrjes së anijeve” do jenë të vlefshme dhe të domosdoshme investime si:

Prodhim i ri i konstruksionit metalik të shkallës së KNRA^{së}.

a) Blerja e një Tranvelift-i me kapacitet ngritës 300-500 ton dhe ndërtimi i bankinës për ta bërë funksional atë.

b) Ndërtimi i një doku të thatë për riparimin e anijeve.

Përsa më sipër, vlen të theksohet se që prej vitit 2018 deri në vitin 2023, shkallës nuk i është bërë asnjë lloj riparimi apo shërbimi në elementet konstruktiv dhe në traun kryesor. Kjo për shkak të gjëndjes financiare por edhe pamundësisë teknike dhe burimeve njerëzore për riparim. Staf i teknik dhe inxhinierik i KNRA^{së}, në mënyrë të përsëritur ka paraqitur shqetësime për rrezikshmërinë mbi veprimtarinë e punës së shkallës Kosjakova. Konkretisht :

✓ Shkresa nr. 741/1, datë 30.12.2016, “Informacion mbi gjëndjen teknike të Shkallës Kosjakova, transportierit të lëvizjes së anijeve dhe sistemit të linjës së shinave”;

✓ Shkresa nr. 456, datë 04.10.2020, “Informacion mbi gjëndjen teknike të Shkallës Kosjakova”;

✓ Shkresa nr. 216, datë 02.06.2017, “Informacion mbi gjëndjen teknike të Shkallës Kosjakova, transportierit të lëvizjes së anijeve dhe sistemit të linjës së shinave nënujore”;

✓ Shkresa nr. 808, datë 20.11.2020 “Informacion mbi gjëndjen teknike të Shkallës Kosjakova”;

✓ Shkresa nr. 29, datë 13.01.2023, “Analizë vjetore për realizimin e detyrave dhe problematikave të ndeshura gjatë vitit 2022”;

✓ Shkresa nr. 42/3, datë 18.01.2024, “Analizë vjetore për realizimin e detyrave dhe problematikave të ndeshura gjatë vitit 2023”.

Për sa më sipër ajo që rezulton është mos reagimi nga ana e strukturave drejtuese të Ministrisë së Mbrojtjes për moskthim përgjigje dhe mosreagim të shumë shkresave zyrtare të KNRA^{së} drejtuar kësaj Ministrie (Sekretarit të Përgjithshëm), Konkretisht:

➤ Shkresa nr. 741/1, datë 30.12.2016, “Informacion mbi gjëndjen teknike të shkallës Kosjakova, transportierit të lëvizjeve të anijeve, agregateve dhe sistemit të linjës së shinave”;

➤ Shkresa nr. 456, datë 04.10.2017, “Informacion mbi gjëndjen teknike të shkallës Kosjakova, transportierit të lëvizjeve të anijeve, agregateve dhe sistemit të linjës së shinave”;

- Shkresa nr. 877, datë 11.12.2020 “*Informacion mbi gjendjen teknike të shkalles Kosjakova*”;
- Shkresa nr. 878, datë 11.12.2021, “*Informacion mbi problematikat e hasura në KNRA*”;
- Shkresa nr. 879, datë 11.12.2020, “*Informacion mbi analizën e të ardhurave*”;
- Shkresa nr. 519, datë 03.10.2022, “*Informacion mbi gjendjen teknike të shkalles Kosjakova*”;
- Shkresa nr. 163, datë 07.03.2024, “*Informacion mbi gjendjen teknike dhe rrezikshmërinë që paraqet platforma(shkalla Kosjakova)*”.

Për sa më lartë, shqetësimet për gjendjen teknike dhe rrezikshmërinë që platforma paraqet, administrata e KNRA^{së} e ka pasqyruar tek të gjitha analizat vjetore për çdo vit, që ka dërguar në Ministri të Mbrojtjes .

Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve është një aset kombëtar me rëndësi strategjike prej të cilit varet gadishmëria ose mos gadishmëria operationale e mjeteve lundruese të Forcave të Armatosura. **Për këtë arsye në gjykimin e audituesit Ministria e Mbrojtjes të duhet të merrte në konsideratë problematikat e paraqitura zyrtarisht të trajtonte problematikat dhe të kthente përgjigje zyrtare sipas çdo problemi dhe shkrese.**

Ministria e Mbrojtjes me veprimet e saj duke mos ju përgjigjur kërkesave të KNRA është në kundërshtim me parimet e përgjithshme të Kodit të Procedurës Administrative, konkretisht këto veprime bien në kundërshtim me nenin 14 “Parimi i objektivitetit”, nenin 15, “Parimin e përgjegjësisë”, neni 16 “Parimi i marrjes së vendimeve” dhe neni 18, “Parimi i deburokratizimit dhe i efikasitetit” të Kodit të Procedurës Administrative. Këto veprime sipas auditimit vazhdojnë sjellin pasoja sociale dhe ekonomike për KNRA.

Në shumë raste kryesisht për miratimin e tarifave Ministria e Mbrojtjes nuk është përgjigjur kundrejt vendimeve të Këshilli Drejtues të KNRA. Sipas Kodit të Procedurës Administrative në Kreun VIII, “*Vendimmarrja e përbashkët dhe ndihma ndërmjet organeve publike*” neni 70, pika 3 dhe neni 71, Ministria e Mbrojtjes nuk i është përmbajtur legjislacionit në fuqi.

- Këshilli Drejtues i KNRA^{së} ka gjykuar që për çdo ndodhi/ose ngjarje të jashtëzakonshme”, për përballimin e ndodhive dhe ngjarjeve të jashtëzakonshme (aksidenteve) që mund të ndodhin në mjetet lundruese si private ashtu dhe ato shtetërore, për gabime njerëzore ose teknike, gjatë procesit të dokimit dhe riparimit në mjetet lundruese të Forcave të Armatosura si dhe ndaj palëve të treta, ka bërë sigurimin e përgjegjësisë profesionale në kompani sigurimi për proceset e punës që kryen.

Referuar gjendjes teknike, pamundësisë për të investuar për riparim si dhe shqetësimeve të stafit inxhinieriko- teknik të KNRA^{së}, është realizuar “sigurimi i përgjegjësisë profesionale të biznesit të KNRA, me limit përgjegjësie 100 milion lekë” në Kompani Sigurimi për vitet 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2023 me vlerë primi sigurimi 4,440,000 lekë/ vit.

- **Mos realizimi i detyrave të lëna në Plan-Veprim të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, detyrë e realizuar në vitin 2020, ose pas 4 vitesh.**

Një tregues që ka ndikuar ndjeshëm në mungesën e të ardhurave të ndërmarrjes, është edhe mos realizimi i detyrave të lëna në Plan-Veprim të dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm, me shkresën nr. 6118/1 Prot. datë 22.07.2015, ku ndër të tjera është lënë si detyrë që **të merren masa për lirimin e bankinës dhe të vaskës brënda datës 15.09.2015.** Kjo hapësirë është kërkuar nga subjekte të ndryshme për të ankoruar mjetet e tyre të lundrimit, pasi kushtet që ofrohen aty, janë më të mira se operatori privat që operon në Orikum.

Edhe sot mjetet lundruese të Forcës Detare vazhdojnë të qëndrojnë të ankoruara në bankinë dhe në akuariumin e Kantierit. Përveç anijeve në gadishmëri edhe mjetet lundruese të dala jashtë përdorimit qëndrojnë aty duke u bërë pengesë në veprimtarinë e përditëshme. Dy prej këtyre anijeve të vjetra janë mbytur prej amortizimit dhe rrezikojnë të mbyten edhe të tjerat. Kosto e

Buxhetit të Shtetit për ti nxjerrë nga fundi i detit do të ishte në disa qindra milion lekë. Bazuar në kapacitetin e vaskës, numri i mjeteve lundruese që mund të akomodoheshin në këtë hapësirë është rreth 50 të tilla, me një gjatësi mesatare 14 ml, dhe referuar çmimit për ankorimin e një mjete lundrues në vit, ndërmarrja ka të ardhura të munguara në vlerën 298. 935€ (1. 17 € për ml x 14 ml x 365 ditë x 50 (skafe) = 298. 935 €).

- Mungesa e investimeve të kërkuara përpara ndryshimit të statusit të Kantierit, është një faktor tjetër negativ në financat e ndërmarrjes. Referuar shkresës Nr. 49 Prot. , datë 08.01.2015 “Dërgim i Plan-Bisnesit të Kanterit të Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve Pashaliman”, dërguar Komandantit të Forcës Detare dhe për dijeni Ministrit të Mbrojtjes, investimi kryesor i kërkuar për vitin 2015 ka qenë **ndërtimi i linjës së dytë të shinave**, duke marrë parasysh se VKM nr. 397, datë 11.05.2015 “Për krijimin e Ndërmarrjes Shtetërore “Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve” përcakton se, “Riparimi i mjeteve të Forcave të Armatosura ka prioritet mbi të gjitha subjektet e interesuara”, çka ka detyruar ndërmarrjen që të refuzojë disa herë kërkesat për riparim të mjeteve lundruese private.

Një kërkesë tjetër ka qenë **rikonstruksioni i linjës ekzistuese dhe transportierit lëvizës**, për shkak të amortizimit të tyre, investim që do të garantonte një rendiment më të lartë dhe shkurtimin e kohës së riparimeve si dhe shmangjen e ndonjë incidenti të mundshëm me pasojë dëmtime në njerëz apo dëme materiale, të cilat do të rëndonin më tej në gjëndjen financiare të ndërmarrjes.

- Ndërtesa jashtë funksionit (që nuk përdoren për veprimtarinë e ndërrmatjes) janë 13 të tilla. Nga këto katër godina në pronësi të KNRA, i shfrytëzon një Kompanin Turke, që shfrytëzon godinat sipas një marrëveshje me Komandën e Forcës Detare që para krijimit të KNRA, marrëveshje për të cilën nuk KNRA nuk ka dijeni. Konkretisht sipërfaqja (truall + ndërtesë), vlera, amortizimi dhe vlera e mbetur janë sipas tabelës sa më poshtë vijon:

Nr.	Përshkrimi i objektit	Sipërfaqja m ²	Vlera objektit në lekë	Shuma amortizimit ^e	Vlera e mbetur
1	Objekti i mirmbajtjes, me nr. 17	592	54,114,186	541,142	53,573,044
2	Zyrat e reja administrata (hoteli), me nr. 18	520	27,422,799	274,228	27,148,571
3	Objekti i kinemasë, me nr. 18	924	36,469,335	364,693	36,104,642
4	Depo kabllosh elektrike, me nr. 20.	364	7,183,763	71,838	7,111,925
	Totali	2,400	125,190,083	1,251,901	123,938,182

Burimi i të dhënave KNRA

Per mbientet që ju shërbejnë forcave të armatosura turke Komanda e Forcës Detare duhet të kompesonte në vlerë pamundësinë fizikë që ka KNRA per t’i administruar. Administrata e KNRA përgjigjet për pronën pasuri shtetërore që ka marrë në administrim, ndërkohë që nuk ka dijeni shkresore dhe nuk arkëton për qiradhënie për shfrytëzimin e pasurisë së saj nga të tretë.

- KNRA ka bërë gjithë përpjektet e mundëshme për ta ndryshuar situatën financiare, duke kërkuar bashkëpunim me kompani të tregut vendas dhe atë të jashtëm, për prodhime të reja apo edhe bashkëpunim në fushën e riparimit të anijeve. Për këtë i janë drejtuar organeve eprore me dy projekte bashkëpunimi për të cilat nuk kanë marrë përgjigje. VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, sipas pikës 6 të saj ka kufizime për Këshillin Drejtues të Ndërmarrjes. Kantieri nuk ka kompetencë sipas kësaj VKM ta administrojë këtë pronë plotësisht, sipas ligjit për ndërmarrjet shtetërore.

Administrata e KNRA-së ka paraqitur disa sugjerime për përmirësimin dhe ecurinë normale të veprimtarisë ekonomike të Kantierit të Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve si më poshtë:

Opsioni i shtimit të kapitalit të ndërmarrjes në natyrë (demontimi i anijeve dhe paisjeve jashtë përdorimit, inventarizimi dhe shitje në ankand) apo në fond likuid duke bërë ndryshimet përkatëse në VKM, nr. 397, datë 11.05.2015 “Për Krijimin e ndërmarrjes shtetërore, Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve“. Kjo do të shërbente për të bërë investimet e domosdoshme dhe vazhdimin normal të punës në Kantier.

Vlen të përmendim faktin se KNRA qysh kur u krijua ka reduktuar shpenzimet për paga (aktualisht është sa gjysma e shpenzimeve që kryheshin kur ishte ndërmarrje buxhetore), janë reduktuar shpenzimet e panevojshme, si konsumi i energjisë elektrike, karburantit, vlerave materiale, financiare etj.

Me shkresën nr. 2983/3, datë 27.08.2021, e cila ka Urdhërin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 1226, datë 27.08.2021, “Për ngritjen e grupit të punës për ndryshimin e statusit juridik të Kantierit të Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve”, është urdhëruar (pika 1)-ngritja e grupit të punës për realizimin e studimit ekonomik operacional për ndryshimin e statusit juridik të KNRA, si dhe është (pika 2) ngritur grupi i punës.

Në zbatim të Urdhrit Nr. 1226 datë 27.08.2021 “Për ngritjes së Grupit të Punës për ndryshimin e statusit juridik të KNRA”, më datë 11.05.2022, ky grup ka argumentuar “*nevojën për ndryshimin e statusit juridik të KNRA Pashaliman, por gjithashtu janë parashtruar dhe studiuar edhe skenarët e ndryshimit të statusit juridik të Kantierit Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve.*

Në këtë kontekst si konkluzion për mbarëvajtjen e KNRA ky grup është shprehur se është e nevojshme rritja e aseteve dhe kapaciteteve riparuese të Kantierit nëpërmjet investimeve nga buxheti i shtetit dhe bërja pjesë e KNRA në PAZH FA (PAZH FD) me qëllim që Kantieri :

- *Të jetë i aftë ti përgjigjet nevojave dhe kërkesave në rritje të Komandës FD për riparimin e anijeve ushtarake;*
- *Të jetë i aftë ti përgjigjet nevojave dhe kërkesave në rritje të flotës tregëtare për riparimin e anijeve civile;*
- *Të jetë i aftë për prodhimin e anijeve të reja të FD (sipas mënyrës që u veprua me Projektin Hollandez ‘Damen Shipyards’ 2008-2014 ku u ndërtuan 3 anije patrulluese ‘Valiant 42-07’ në KD Pashaliman, duke i kursyer buxhetit të shtetit fonde të konsiderueshme krahasuar me prodhimin e anijeve në vende të tjera)*
- *Të jetë i aftë për prodhimin e anijeve të reja civile (peshkarexha, jahte, rimorkiator etj).*

Përsa i përket të ardhmes së KNRA ndjekja e hapave të mëposhtëm do të sillte rritjen e efikasitetit të kësaj strukture:

▪ *Fillimisht kalimin e KNRA në varësi funksionale të FD nëpërmjet një Vendimi të Këshillit të Ministrave, pra duke i ndryshuar statusin e tij nga Ndërmarrje Shtetërore me vetëfinancim SHA në Ndërmarrje (Rep. Usht.) në varësi të FD sikundër ka qënë para vitit 2015, por duke i alokuar fonde dhe duke e bërë atë njësi shpenzuese. Kjo pasi para vitit 2015 KNRA nuk ishte njësi shpenzuese dhe nuk kishte efektivitet të lartë për riparimin e anijeve për shkak të mungesës së fondeve dhe gjithçka që i nevojitej (edhe për blerjet e vogla emergjente) i dërgonte kërkesë për prokurim Komandës së FD, procedurë e cila krijonte vonesa dhe zgjaste kohën e riparimit anijeve dhe ulte efektivitetin.*

- *Miratimin (pas ndryshimit të statusit me VKM) e strukturës së re organike TOP.*
- *Futjen e Kantierit në PAZH FD duke listuar dhe miratuar investimet më të nevojshme që rrisin kapacitetet riparuese të tij.*

▪ *Kryerja e investimeve në infrastrukturën e KNRA (linja e dytë e shinave, bankina dhe sheshi për traveliftin 500 tonë, doku thatë).*

▪ *Modernizimi i KNRA me paisje e mjete themelore të reja që i rrisin kapacitetet riparuese (Travelifti 500 tonësh, Shkalla e re 1000 tonë, Doku Lundrues 100 m)”.*

Deri në datën e mbajtjes së këtij akt konstatimi, në përfundim të punës së bërë nga Komisioni i ngritur me Urdhërin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 1226, datë 27.08.2021, “Për ngritjen e grupit të punës për ndryshimin e statusit juridik të Kantierit të Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve”, **nuk është marrë asnjë hap i mëtejshëm.**

- në pikën 5 të tij, është përcaktuar se: “Përgjigjet për zbatimin e këtij urdhëri Kryetari i grupit të punës, Forca Detare dhe KNRA”.

Në zbatim të pikës nr. 5, nga ana e Grupit të punës nuk është paraqitur asnjë kërkesë për bashkëpunim për cështjen në fjalë dhe KNRA nuk ka dijeni mbi aktivitetin e këtij grupi i cili ka lidhje me studimin ekonomik operacional për ndryshimin e statusit juridik të KNRA

Konkluzion:

• Ndërtimi fillestar dhe konstruksioni kryesor dhe bazë i shkallës Kosjakova së bashku me linjën e shinave nënujore është realizuar në vitin **1969**. Deri në vitin 2000, kjo strukturë nuk ka patur riparim kapital të strukturës së platformës dhe linjës së shinave. KNRA, në datë 24.07.2018 ka bërë të mundur riparim të mesëm me kosto riparimi (investimi) 12,000,000 lekë. **Përsa më sipër, vlen të theksohet se që prej vitit 2018 deri në vitin 2023, shkallës nuk i është bërë asnjë lloj riparimi apo shërbimi në elementet konstruktiv dhe në traun kryesor.** Kjo për shkak të gjëndjes financiare por edhe pamundësisë teknike dhe burimeve njerëzore për riparim. Stafi teknik dhe inxhinierik i KNRA^{-së}, në mënyrë të përsëritur ka paraqitur shqetësime për rrezikshmërin mbi veprimtarinë e punës së shkallës Kosjakova. Vlera fillestare e përcaktuar nga ekspertët vlerësues në vitin 2015 është në shumën 120,378,876 lekë dhe pas riparimit në vitin 2019, ka një vlerë fillestare në shumën 132,812,515 lekë. Amortizimi i kësaj shkalle në 31.12.2023 është në shumën 91,421,173 dhe vlera e mbetur është në shumën 41,391,341 lekë ose 31% e vlerës fillestare, pra tejet e amortizuar (në këto shifra nuk është përfshirë amortizimi i akumuluar deri në 31.05.2015, vit i krijimit të KNRA). **Për sa më sipër ajo që rezulton është mos reagimi nga ana e strukturave drejtuese të Ministrisë së Mbrojtjes për moskthim përgjigje dhe mosreagim të shumë shkresave zyrtare të KNRA^{-së} drejtuar kësaj Ministrie (Sekretarit të Përgjithshëm).** Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve është një aset kombëtar me rëndësi strategjike prej të cilit varet gadishmëria ose mos gadishmëria operationale e mjeteve lundruese të Forcave të Armatosura. Për këtë arsye në gjykimin e audituesit Ministria e Mbrojtjes të duhet të merrte në konsideratë problematikat e paraqitura zyrtarisht të trajtonte problematikat dhe të kthente përgjigje zyrtare sipas çdo problemi dhe shkrese.

• Mos realizimi i detyrave të lëna në Plan-Veprim të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, detyrë e realizuar në vitin 2020, ose pas 4 vitesh. Bazuar në kapacitetin e vaskës, numri i mjeteve lundruese që mund të akomodoheshin në këtë hapësirë është rreth 50 të tilla, me një gjatësi mesatare 14 ml, dhe referuar çmimit për ankorimin e një mjeti lundrues në vit, ndërmarrja ka të ardhura të munguara në vlerën 298. 935€ (1. 17 € për ml x 14 ml x 365 ditë x 50 (skafe) = 298. 935 €).

• Ndërtesa jashtë funksionit (që nuk përdoren për veprimtarinë e ndërmarrjes) janë 13 të tilla. Nga këto katër godina në pronësi të KNRA, i shfrytëzon një Kompanin Turke, që shfrytëzon godinat sipas një marrëveshje me Komandën e Forcës Detare që para krijimit të KNRA, marrëveshje për të cilën nuk KNRA nuk ka dijeni. Konkretisht sipërfaqe (truall + ndërtesë) është 2,400 m² dhe vlera e mbetur e objekteve është 123,938,182 lekë (+ amortizimi **1,251,901** lekë).

Per mbientet që ju shërbejnë forcave të armatosura turke Komanda e Forcës Detare duhet të kompesonte në vlerë pamundësinë fizikë që ka KNRA per t'i administruar. Administrata e KNRA përgjigjet për pronën pasuri shtetërore që ka marrë në administrim, ndërkohë që nuk ka dijani shkresore dhe nuk arkëton për qiradhënie për shfrytëzimin e pasurisë së saj nga të tretë.

- Me shkresën nr. 2983/3, datë 27.08.2021, e cila ka Urdhërin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 1226, datë 27.08.2021, “Për ngritjen e grupit të punës për ndryshimin e statusit juridik të Kantierit të Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve”, është urdhëruar (pika 1)-ngritja e grupit të punës për realizimin e studimit ekonomik operacional për ndryshimin e statusit juridik të KNRA. Deri në datën e mbajtjes së këtij akt konstatimi, në përfundim të punës së bërë nga Komisioni i ngritur me Urdhërin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 1226, datë 27.08.2021, “Për ngritjen e grupit të punës për ndryshimin e statusit juridik të Kantierit të Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve”, **nuk është marrë asnjë hap i mëtejshëm.**

Nga auditimi u konstatua që: Shkalla Kosjakova së bashku me linjën e shinave nënujore është realizuar në vitin 1969. Vlera fillestare e përcaktuar nga ekspertët vlerësues në vitin 2015 është në shumën 120,378,876 lekë dhe pas riparimit në vitin 2019, ka një vlerë fillestare në shumën 132,812,515 lekë. Amortizimi i kësaj shkalle në 31.12.2023 është në shumën 91,421,173 dhe vlera e mbetur është në shumën 41,391,341 lekë ose 31% pra tejet e amortizuar.

Veprimtaria e punës së KNRA-së mbi arkëtimin e të ardhurave është e lidhur në mënyrë direkte nga gjendja teknike dhe kapacitetet përpunuese të platformës së nxjerrjes së mjeteve lundruese dhe linjës së shinave (Shkallës Kosjakova). Për shkak të vitit të prodhimit të kësaj platforme si dhe gjendjes teknike dhe amortizimit tej mase të rënduar dhe akumuluar ndër vite, ka bërë që vitet e fundit veprimtaria e punës së KNRA-së të jetë e kushtëzuar por edhe me risk për ngjarje të jashtëzakonshme dhe aksidente si në burime njerëzore dhe në burime materiale.

Tabela: Analizë e amortizimit të shkallës Kosjakova në vite

Në lekë

viti	vlera fillestare dhe vlera e mbetur		Amortizimi i akumuluar vite	Amortizimi i akumuluar i vitit
	2015 (rivlerësimi nga ekspertët)	120,378,876		
2015			69,625,241	73,369,586
2016			75,609,586	2,240,000
2017			77,848,051	2,238,464
2018			79,974,592	2,126,541
	2019 (pas riparimit)	132,812,515		
2019			81,994,806	2,020,214
2020			84,535,692	2,540,885
2021			86,949,533	2,413,841
2022			89,242,682	2,293,149
2023			91,421,173	2,178,492
	vlera e mbetur 32. 12. 23	41,391,341. 53		

Burimi i të dhënave KNRA

Ndërtimi fillestar dhe konstruksioni kryesor dhe bazë i shkallës Kosjakova së bashku me linjën e shinave nënujore është realizuar në vitin **1969**. Prej këtij viti prodhimi deri në vitin 2000, kjo strukturë nuk ka patur riparim kapital të strukturës së platformës dhe linjës së shinave.

Kjo për faktin se veprimtaria e punës për riparimin e mjeteve lundruese ka qenë e kufizuar për shkak se mjetet lundruese me tonazh mbi 150 ton, realizoheshin nëpërmjet dokut lundrues.

Prej vitin 2000 deri në vitin 2018, në platformën e shkallës dhe në linjën e shinave nuk është realizuar asnjë riparim ose investim për mirëmbajtje.

Përveç viteve të punës, një faktor tjetër që ka ndikuar në amortizimin e shkallës ka qënë edhe dalja për dokim e të gjitha mjeteve lundruese me anë të kësaj platforme (shkalle), pasi në vitin 2006 doku lundrues nuk ishte funksional.

Administrata e KNRA-së, në vitin 2016, e ka trajtuar zyrtarisht gjendjen teknike dhe amortizimin që platforma ka pasur. Kjo situatë është marrë në konsideratë nga grupi i auditimit të brendëshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, i cili këtë shqetësim ja ka paraqitur Ministrit të Mbrojtjes.

Ministri i Mbrojtjes me urdhër nr. 2347, datë 21.12.2017, “Për përfundimet e angazhimit të auditimit të plotë të ushtruar në Kantierin e Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve Pashaliman, Vlorë”, ka urdhëruar si me poshtë vijon:

1. Shtabi i Përgjithshëm i FA-së dhe Drejtoria e Modernizimit pranë MM-së, në bashkëpunim me Forcën Detare, IGJIU-në dhe KNRA-në, të krijojnë një komision të përbashkët me specialistë të fushës, për të inspektuar dhe për të vlerësuar gjendjen teknike të platformës (shkallës) të KNRA-së, nëpërmjet të cilës realizohet dalja e anijeve në dok. Komisioni të përgatit një relacion të detajuar mbi gjendjen teknike ekzistuese të shkallës, si dhe të dalë me propozime konkrete për të garantuar normalitetin e këtij aktiviteti për të ardhmen.

Me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, nr. 172, datë 15.02.2018, “Për ngritjen e grupit të punës, për vlerësimin e platformës së shkallës së nxjerrjes së anijeve në dok, në KNRA, Pashaliman, Vlorë”, u bë e mundur ngritja e një komisioni, i cili në datë 28.02.2018 verifikoi gjendjen në terren të shkallës (platformës), që shërben për nxjerrjen e anijeve në tokë.

Nga kontrolli i ushtruar në shkallën “Kosjakova”, grupi i punës në mënyrë unanime i propozoi dhe i rekomandoi Ministrisë së Mbrojtjes:

4. Fillimin e punimeve për riparimin e shkallës nga KNRA.

5. Angazhimin e polumbarëve të Qendrës së Zhytjes, të FD-së, në punimet e nevojshme për riparimin e shkallës.

6. Dhënia e asistencës dhe bashkëpunim i nevojshëm (me specialistë dhe instrumenta matës) nga IGJIU, për rievimin dhe për zbatimin e punimeve të riparimit.

KNRA, në datë 24.07.2018 ka bërë të mundur nxjerrjen në tokë për riparim të shkallës “Kosjakova”, duke përballuar gjithë kostot e riparimit si në burime njerëzore dhe materiale me fondet të veta. Ky riparim i mesëm i realizuar nga KNRA në vitin 2018, kishte kosto riparimi (investimi) 12,000,000 lekë

Gjatë procesit të riparimit të platformës KNRA ka kërkuar zyrtarisht asistencën e polumbarëve të Qendrës së Zhytjes së Forcës Detare dhe të IGJIU, për kontrollin dhe difektimin e pjesës së nënujshme ku janë të montuara linjat e shinave.

Specialistët e IGJIU^{së} bënë të mundur matjen dhe llogaritjen e devijimeve që paraqisnin linjat e shinave të nënujshme. Me anë të këtyre matjeve specialistët e IGJIU^{së} kanë hartuar dokumentacionin teknik, “Plani i spostimeve të shinave në rrafshin horizontal dhe atë vertikal”, me nr. prot 898/8, datë 11.10.2018. Referuar këtij dokumentacioni teknik dhe konkluzioneve që specialistët e IGJIU konstatuan, Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve në bashkëpunim me polumbarët e Qendrës së Zhytjes së Forcës Detare bënë të mundur spesorimin e shinave deri në vijën e projektit. Pas këtij riparimi (investimi) që KNRA bëri, me polumbarët e Qendrës së Zhytjes, specialistët e IGJIU^{së} bënë përsëri matje për të evidentuar disnivelet e linjave të shinave të nënujshme. Nga matjet e bëra rezultoi se spesorimi që polumbarët kryen në linjat e shinave nënujshme bëri të mundur zvogëlimin e disniveleve dhe spostimeve që shinat kishin me njëra-tjetrën, në masën 40 %. Konkretisht në matjet fillestare shinat kishin disnivel me njëra tjetrën 7-9 cm. Ky disnivel ishte i përqëndruar kryesisht në gjatësinë 30-70 metra, nga dy skajet e shinave (veri, jug).

Pas spesorimit nga ana e polumbarëve ky disnivel u reduktua në masën 3-4 cm. Duke qenë se shinave janë të montuara në trarë betoni të zhytur në ujë, ku thellësia e zhytjes në pikën fundore të shinave arrin në 9 metra thellësi, riparimi optimal në parametrat fillestar ishte i pa mundur të realizohej, si nga polumbarët e Qendrës së Zhytjes ashtu dhe nga Specialistët e IGJIU-së. Riparimi në kushte optimale (teknike) i linjës së shinave nënujore kërkon kompani me eksperiencë dhe të specializuara në të tillë fushë.

Procesi i riparimit të platformës së nxjerrjes së anijeve u bë në gjëndje pune në datë 03.10.2018. Vlen të theksohet se ky riparim do të zgjaste ciklin e përdorimit të shkallës me 1. 5-2 vite. Me plotësimin e këtij afati, shkallës “Kosjakova” (platforma) nuk mund t’i kryhet më remont për shkak të amortizimit tej mase të konstruktit (trarëve kryesorë) metalikë, ku bëhet i mundur montimi i rrotave lëvizëse. Zvogëlimi i spesorit (trashësisë) të trarëve kryesorë, aktualisht është i konsumuar në masën 55-60 %. Pra trashësia e spesorit nga 14 mm në pjesën më të madhe ka arritur në 7.5 mm. Gjëndja teknike e mësipërme është konfirmuar teknikisht nga specialistët e IGJIU-së, **të cilët kanë gjykuar se pas këtij riparimi, platformës nuk mund t’i kryhet më riparimi kapital.**

Referuar gjëndjes teknike të aseteve “Shkallës Kosjakova dhe linja e shinave”, për ecurinë e zhvillimit të KNRA-së në të ardhmen, siç është gjykuar dhe në relacionin e hartuar me nr. 1627/1, “*Relacion mbi vlerësimin e gjëndjes së platformës së shkallës së nxjerrjes së anijeve në Kantierin e Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve, Pashaliman, Vlorë*”, nga komisioni i ngritur me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së Nr. 172, datë 15.02.2018” Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e platformës së shkallës së nxjerrjes së anijeve” do jenë të vlefshme dhe të domosdoshme investime si:

Prodhim i ri i konstruksionit metalik të shkallës së KNRA^{-së}.

c) Blerja e një Tranvelift-i me kapacitet ngritës 300-500 ton dhe ndërtimi i bankinës për ta bërë funksional atë.

d) Ndërtimi i një doku të thatë për riparimin e anijeve.

Përsa më sipër, vlen të theksohet se që prej vitit 2018 deri në vitin 2023, shkallës nuk i është bërë asnjë lloj riparimi apo shërbimi në elementet konstruktiv dhe në traun kryesor. Kjo për shkak të gjëndjes financiare por edhe pamundësisë teknike dhe burimeve njerëzore për riparim. Staf i teknik dhe inxhinierik i KNRA^{-së}, në mënyrë të përsëritur ka paraqitur shqetësime për rrezikshmërinë mbi veprimtarinë e punës së shkallës Kosjakova. Konkretisht :

✓ Shkresa nr. 741/1, datë 30.12.2016, “Informacion mbi gjëndjen teknike të Shkallës Kosjakova, transportierit të lëvizjes së anijeve dhe sistemit të linjës së shinave”;

✓ Shkresa nr. 456, datë 04.10.2020, “Informacion mbi gjëndjen teknike të Shkallës Kosjakova”;

✓ Shkresa nr. 216, datë 02.06.2017, “Informacion mbi gjëndjen teknike të Shkallës Kosjakova, transportierit të lëvizjes së anijeve dhe sistemit të linjës së shinave nënujore”;

✓ Shkresa nr. 808, datë 20.11.2020 “Informacion mbi gjëndjen teknike të Shkallës Kosjakova”;

✓ Shkresa nr. 29, datë 13.01.2023, “Analizë vjetore për realizimin e detyrave dhe problematikave të ndeshura gjatë vitit 2022”;

✓ Shkresa nr. 42/3, datë 18.01.2024, “Analizë vjetore për realizimin e detyrave dhe problematikave të ndeshura gjatë vitit 2023”.

Për sa më sipër ajo që kemi konstatuar është mos reagimi nga ana e strukturave epërore të Ministrisë së Mbrojtjes i shumë shkresave zyrtare të KNRA^{-së}, Konkretisht:

➤ Shkresa nr. 741/1, datë 30.12.2016, “Informacion mbi gjëndjen teknike të shkallës Kosjakova, transportierit të lëvizjes së anijeve, agregateve dhe sistemit të linjës së shinave”;

- Shkresa nr. 456, datë 04.10.2017, “Informacion mbi gjendjen teknike të shkallës Kosjakova, transportierit të lëvizjeve të anijeve, agregateve dhe sistemit të linjës së shinave”;
- Shkresa nr. 877, datë 11.12.2020 “Informacion mbi gjendjen teknike të shkallës Kosjakova”;
- Shkresa nr. 878, datë 11.12.2021 “Informacion mbi problematikat e hasura në KNRA”;
- Shkresa nr. 879, datë 11.12.2020 “Informacion mbi analizën e të ardhurave”;
- Shkresa nr. 519, datë 03.10.2022 “Informacion mbi gjendjen teknike të shkallës Kosjakova”;
- Shkresa nr. 163, datë 07.03.2024 “Informacion mbi gjendjen teknike dhe rrezikshmërinë që paraqet platforma(shkalla Kosjakova”.

Për sa më lartë, shqetësimet për gjendjen teknike dhe rrezikshmërinë që platforma paraqet, administrata e KNRA^{së} e ka pasqyruar të gjitha analizat vjetore për çdo vit, që ka dërguar në Ministri të Mbrojtjes .

Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve është një aset kombëtar me rëndësi strategjike prej të cilit varet gadishmëria ose mos gadishmëria operationale e mjeteve lundruese të Forcave të Armatosura. **Për këtë arsye në gjykimin e audituesit Ministria e Mbrojtjes të duhet të merrte në konsideratë problematikat e paraqitura zyrtarisht të trajtonte problematikat dhe të kthente përgjigje zyrtare sipas çdo problemi dhe shkrese.**

Ministria e Mbrojtjes me veprimet e saj duke mos ju përgjigjur kërkesave të KNRA është në kundërshtim me parimet e përgjithshme të Kodit të Procedurës Administrative, konkretisht këto veprime bien në kundërshtim me nenin 14 “Parimi i objektivitetit”, nenin 15, “Parimin e përgjegjësisë”, neni 16 “Parimi i marrjes së vendimeve” dhe neni 18, “Parimi i deburokratizimit dhe i efiçencës” të Kodit të Procedurës Administrative. Këto veprime sipas auditimit vazhdojnë sjellin pasoja sociale dhe ekonomike për KNRA.

Në shumë raste kryesisht për miratimin e tarifave Ministria e Mbrojtjes nuk është përgjigjur kundrejt vendimeve të Këshilli Drejtues të KNRA. Sipas Kodit të Procedurës Administrative në Kreun VIII, “Vendimmarrja e përbashkët dhe ndihma ndërmjet organeve publike” neni 70, pika 3 dhe neni 71, Ministria e Mbrojtjes nuk i është përmbajtur legjislacionit në fuqi.

Gjetje nga auditimi: Referuar gjendjes teknike, pamundësisë për të investuar për riparim si dhe shqetësimeve të stafit inxhinieriko- teknik të KNRA^{së}, Këshilli Drejtues ka gjykuar që për çdo ndodhi/ose ngjarje të jashtëzakonshme” të realizoj “sigurimin e përgjegjësisë profesionale” në Kompani Sigurimi.

Sigurimi i përgjegjësisë profesionale në kompani sigurimi për proceset e punës që kryen KNRA është gjykuar si një opsjon për përballimin e ndodhive dhe ngjarjeve të jashtëzakonshme (aksidenteve) që mund të ndodhin në mjetet lundruese si private ashtu dhe ato shtetërore, për gabime njerëzore ose teknike, gjatë procesit të dokimit dhe riparimit në mjetet lundruese të Forcave të Armatosura si dhe ndaj palëve të treta.

Nga ana e Këshillit Drejtues të KNRA-së pamundësia për të siguruar fonde për investim në riparimin e shkallës Kosjakova ka bërë që në mënyrë të përsëritur të pasqyrohet situata financiare dhe gjendja teknike e aseteve si (shkallës dhe linjës së shinave).

Gjetje nga auditimi: Mos realizimi i detyrave të lëna në Plan-Vepim të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, detyrë e realizuar në vitin 2020, ose pas 4 vitesh.

Një tregues që ka ndikuar ndjeshëm në mungesën e të ardhurave të ndërmarrjes, është edhe mos realizimi i detyrave të lëna në Plan-Vepim të dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm, me shkresën Nr. 6118/1 Prot. , datë 22.07.2015, ku ndër të tjera është lënë si detyrë që **të merren masa për lirimin e bankinës dhe të vaskës brënda datës 15.09.2015.** Kjo hapësirë është kërkuar nga subjekte të ndryshme për të ankoruar mjetet e tyre të lundrimit, pasi kushtet që ofrohen aty, janë më të mira se operatori privat që operon në Orikum.

Edhe sot mjetet lundruese të Forcës Detare vazhdojnë të qëndrojnë të ankoruara në bankinë dhe në akuariumin e Kantierit. Përveç anijeve në gadishmëri edhe mjetet lundruese të dala jashtë përdorimit qëndrojnë duke u bërë pengesë në veprimtarinë e përditëshme. Dy prej këtyre anijeve të vjetra janë mbytur prej amortizimit dhe rrezikojnë të mbyten edhe të tjerat. Kosto e Buxhetit të Shtetit për ti nxjerrë nga fundi i detit do të ishte në disa qindra milion lekë. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për Kompaninë Turke, që shfrytëzon godinat në pronësi të Kantierit sipas një marrëveshje me Komandën e Forcës Detare që para krijimit të KNRA, marrëveshje për të cilën nuk kemi dijeni. Administrata e KNRA përgjigjet për pronën pasuri shtetërore që ka marrë në administrim.

Bazuar në kapacitetin e vaskës, numri i mjeteve lundruese që mund të akomodoheshin në këtë hapësirë është rreth **50** të tilla, me një gjatësi mesatare 14 ml, **dhe referuar çmimit për ankorimin e një mjeti lundrues në vit, ndërmarrja ka të ardhura të munguara në vlerën 298.935€ (1.17 € për ml x 14 ml x 365 ditë x 50 (skafe) = 298.935 €).**

KNRA ka bërë gjithë përpjekjet e mundëshme për ta ndryshuar këtë situatë financiare, duke kërkuar bashkëpunim me kompani të tregut vendas dhe të huaja, për prodhime të reja apo edhe bashkëpunim në fushën e riparimit të anijeve. Për këtë i janë drejtuar organeve eprore me dy projekte bashkëpunimi për të cilat nuk kanë marrë përgjigje. VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, sipas pikës 6 të saj ka kufizime për Këshillin Drejtues të Ndërmarrjes. Kantieri nuk ka kompetencë sipas kësaj VKM ta disponojë këtë pronë plotësisht, sipas ligjit për ndërmarrjet shtetërore.

Gjetje nga auditimi: Mungesa e investimeve të kërkuara.

Mungesa e investimeve të kërkuara përpara ndryshimit të statusit të Kantierit, është një faktor tjetër negativ në financat e ndërmarrjes. Referuar shkresës Nr. 49 Prot. datë 08.01.2015 “Dërgim i Plan-Biznesit të Kanterit të Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve Pashaliman”, dërguar Komandantit të Forcës Detare dhe për dijeni Ministrin të Mbrojtjes, investimi kryesor i kërkuar për vitin 2015 ka qenë **ndërtimi i linjës së dytë të shinave**, duke marrë parasysh se VKM Nr. 397, datë 11.05.2015 “Për krijimin e Ndërmarrjes Shtetërore “Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve” përcakton se, “Riparimi i mjeteve të Forcave të Armatosura ka prioritet mbi të gjitha subjektet e interesuara”, çka ka detyruar ndërmarrjen që të refuzojë disa herë kërkesat për riparim të mjeteve lundruese private.

Një kërkesë tjetër ka qenë **rikonstruksioni i linjës ekzistuese dhe transportierit lëvizës**, për shkak të amortizimit të tyre, investim që do të garantonte një rendiment më të lartë dhe shkurtimin e kohës së riparimeve si dhe shmangjen e ndonjë incidenti të mundshëm me pasojë dëmtime në njerëz apo dëme materiale, të cilat do të rëndonin më tej në gjëndjen financiare të ndërmarrjes.

Nga auditimi u konstatua që: Ndërtesa jashtë funksionit (që nuk përdoren për veprimtarinë e ndërrmatjes) janë 13 të tilla. Nga këto katër godina në pronësi të KNRA, i shfrytëzon një Kompanin Turke, që shfrytëzon godinat sipas një marrëveshje me Komandën e Forcës Detare që para krijimit të KNRA, marrëveshje për të cilën nuk ka dijeni. Konkretisht sipërfaqja (truall + ndërtesë), vlera, amortizimi dhe vlera e mbetur janë sipas tabelës sa më poshtë vijon:

Nr.	Përshkrimi i objektit	Sipërfaqja m ²	Vlera objektit në lekë	Shuma amortizimit ^e	Vlera e mbetur
1	Objekti i mirmbajtjes, me nr. 17	592	54,114,186	541,142	53,573,044
2	Zyrat e reja administrata (hoteli), me nr. 18	520	27,422,799	274,228	27,148,571
3	Objekti i kinemasë, me nr. 18	924	36,469,335	364,693	36,104,642
4	Depo kabllorsh elektrike, me nr. 20.	364	7,183,763	71,838	7,111,925

Nr.	Përshkrimi i objektit	Sipërfaqja m ²	Vlera objektit në lekë	Shuma amortizimit ^e	Vlera e mbetur
	Totali	2,400	125,190,083	1,251,901	123,938,182

Burimi i të dhënave KNRA

Per ambientet që ju shërbejnë forcave të armatosura turke Komanda e Forcës Detare duhet të kompesonte në vlerë pamundësinë fizikë që ka KNRA për t'i administruar. Administrata e KNRA përgjigjet për pronën pasuri shtetërore që ka marrë në administrim, ndërkohë që nuk ka dijani shkresore dhe nuk arkëton për qiradhënie për shfrytëzimin e pasurisë së saj nga të tretë.

Nga auditimi u konstatua qe: KNRA ka bërë gjithë përpjekjet e mundëshme për ta ndryshuar këtë situata financiare, duke kërkuar bashkëpunim me kompani të tregut vendas dhe atë të jashtëm, për prodhime të reja apo edhe bashkëpunim në fushën e riparimit të anijeve. Për këtë i janë drejtuar organeve eprore me dy projekte bashkëpunimi për të cilat nuk kemi marrë përgjigje. VKM nr. Nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, sipas pikës 6 të saj ka kufizime për Këshillin Drejtues të Ndërmarrjes. Kantieri nuk ka kompetencë sipas kësaj VKM ta administrojë këtë pronë plotësisht, sipas ligjit për ndërmarrjet shtetërore.

Administrata e KNRA-së ka paraqitur disa sugjerime për përmirësimin dhe ecurinë normale të veprimtarisë ekonomike të Kantierit të Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve si më poshtë:

Opsioni i shtimit të kapitalit të ndërmarrjes në natyrë (demontimi i anijeve dhe paisjeve jashte perdorimit, inventarizimi dhe shitje në ankand) apo në fond likuid duke bërë ndryshimet përkatëse në VKM, Nr. 397, datë 11.05.2015 “Për Krijimin e ndërmarrjes shtetërore, Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve“. Kjo do të shërbente për të bërë investimet e domosdoshme dhe vazhdimin normal të punës në Kantier. Alternativat për ndryshimet e statusit aktual të Kantierit dhe mbetja e tij po sërish pasuri e Shtetit nuk janë zgjidhje e duhur sipas vlerësimit tonë, pasi në çdo rast Buxheti i Shtetit nuk do kursente asgjë, përkundrazi do të rëndohej. Eficenca dhe mënyra e organizimit të një ndërmarrje shtetërore vetëfinancuese dhe konkuese në tregun e lirë është dukshëm shumë më e mirë se një ndërmarrje buxhetore që fondet i merr nga Buxheti i Shtetit. Vlen të përmendim faktin se KNRA qysh kur u krijua ka reduktuar shpenzimet për paga (aktualisht është sa gjysma e shpenzimeve që kryheshin kur ishte ndërmarrje buxhetore). Me të njëjtin ndjenjë përgjegjësie dhe në masë të konsiderueshme janë reduktuar shpenzimet e panevojshme, si konsumi i energjisë elektrike, karburantit, vlerave materiale, financiare etj. Po ashtu vlen të theksohet se vlera e mjeteve lundruese të Forcës Detare është rritur vit pas viti dhe volumet e punës janë shtuar edhe për shkak të 4 anijeve të klasit „Iliria“, mirëmbajtja e të cilave është shumë më e kushtueshme për shkak të teknologjisë moderne që ato mbartin. Përveç sa më lart ndryshimi i statusit në një ndërmarrje buxhetore do të mbyllte çdo hapësirë bashkëpunimi me kompani vendase dhe të huaja. Statusi aktual i KNRA është i duhuri, pasi nga njëra anë interesi i Kantierit është të gjenerojë sa më shume fitime dhe nga ana tjetër interesi FA është të mbajnë në gadishmëri mjetet lundruese dhe paisjet, pa patur interes tek fitimet dhe shtimi i aktivitetit ekonomik të Kantierit. Varesia organike e KNRA nga Ministria e Mbrojtjes balancon dhe rregullon një marrëdhënie bashkëpunimi me eficiency të plotë midis të dyja palëve.

Me shkresën nr. 2983/3, datë 27.08.2021, e cila ka Urdhërin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 1226, datë 27.08.2021, “Për ngritjen e grupit të punës për ndryshimin e statusit juridik të Kantierit të Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve”, është urdhëruar (pika 1)-ngritja e grupit të punës për realizimin e studimit ekonomik operacional për ndryshimin e statusit juridik të KNRA, si dhe është (pika 2) ngritur grupi i punës me përbërje:

1- N. L., Drejtor i buxhetit dhe menaxhimit financiar – Kryetar;

dhe anëtarë:

- 2- Drejtori i Drejtorisë së Operacioneve në SHPFA;
- 3- Drejtori i Drejtorisë së Personelit në SHPFA;
- 4- A. Gj., Përgjegjës i Sektorit në Drejtorinë e programimit standartizimit dhe harmonizimit të akteve rregullatore;
- 5- Përgjegjës i Sektorit të menaxhimit të personelit ushtarak dhe civil në Ministrinë e Mbrojtjes;
- 6- Përgjegjës i Sektorit të operacioneve në Forcën Detare;
- 7- Përgjegjës i Sektorit të financës në Forcën Detare;
- 8- M. Xh., Specialist në Sektorin e buxhetit në Ministrinë e Mbrojtjes;
- 9- B. H., Specialist në SMTMT në DMPA në Ministrinë e Mbrojtjes;
- 10- E. Ç., Specialist në Sektorin e buxhetit në Ministrinë e Mbrojtjes;

Sipas këtij Urdhëri:

- në pikën 4 të tij është përcaktuar se: “Grupi i punës të informojë me shkrim Ministrin e Mbrojtjes mbi skenarët e ndryshimit të statusit juridik të KNRA në përfundimin e procesit”.

Nga auditimi rezulton se në KNRA, nga ana e këtij grupi pune nuk është kërkuar asnjë e dhënë mbi ecurinë e kantierit, pavarësisht se se cdo vit nga ana e KNRA I janë dërguar kësaj Ministrie analizat vjetore të veprimtarisë të cilat në fakt janë të përgjithshme dhe jo me të dhëna analitike statistikore. Në KNRA nga auditimi rezultoi se vdo 6 muaj hartohen të dhëna analitike statistikore për veprimtarinë e punës së saj.

- në pikën 5 të tij, është përcaktuar se: “Përgjigjet për zbatimin e këtij urdhëri Kryetari i grupit të punës, Forca Detare **dhe KNRA**”.

Në zbatim të pikës nr. 5, nga ana e Grupit të punës nuk është paraqitur asnjë kërkesë për bashkëpunim për çështjen në fjalë dhe KNRA nuk ka dijeni mbi aktivitetin e këtij grupi i cili ka lidhje me studimin ekonomik operacional për ndryshimin e statusit juridik të KNRA.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, për vendimet e marra nga Këshilli Drejtues, rezulton se gjatë vitit 2018 janë zhvilluar 10 mbledhje, gjatë vitit 2019 janë zhvilluar 7 mbledhje dhe gjatë vitit 2020 janë zhvilluar 10 mbledhje, duke mos përmbushur detyrimin për zhvillimin mbledhjeve jo më pak se 1 (një) herë në muaj, të përcaktuar në nenin 13 të Rregullores së KRNA-së (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 10-12 të Raportit të auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Nga Këshilli Drejtues të merren masa për të zbatuar detyrimin e tyre për realizimin e objektivave dhe besueshmërisë së kësaj ndërmarrjeje në lidhje me zhvillimin e mbledhjeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se KNRA ka filluar procedurën për shitjen me anë të ankandit të kontenierëve bazuar vetëm në Urdhrin nr. 405 datë 14.06.2016, të Drejtorit të KNRA-së, pa marrë miratim nga Këshilli Drejtues. Lejimi i zhvillimit të kësaj procedure nga ana e Drejtorit të KNRA është në kundërshtim me Ligjin Nr. 7582 , datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore” nenin 23 pika 6 dhe Ligjin nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, neni 4, germa c. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 55-96 të Raportit të auditimit*).

2.1 Rekomandimi: Strukturat përkatëse të ngarkuara dhe organet drejtuese të marrin masa për plotësimin të kriterëve dhe përgjegjësi që parashikon ligji për ankandin në lidhje me fushën e zbatimit.

2.2 Rekomandimi: Nga strukturat drejtuese të merren masat për fillimin e procedurave për ankandet publike mbas miratimit nga Këshilli Drejtues.

Në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje boje dhe aksesori për lysterje”, Autoriteti Kontraktor për mallrat e kërkuara nuk ka argumentuar sasinë dhe specifikimet e kërkuara. Gjithashtu, konstatohet se në këto specifikime ka elementë të cilët nuk përbëjnë kusht për arritjen e qëllimit të kësaj procedure, më konkretisht për zërat “Boje antikoroze e nënujshme” ku përcaktohet specifikimi “kuti 20 kg”, “Ryla të vegjël me qime të gjatë” ku përcaktohet gjatësia fikse e objektit etj. Ky veprim nuk është në përputhje me LPP Nenin 23 “*Specifikimet Teknike*” pika 4 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 55-96 të Raportit të auditimit*).

3.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor gjatë hartimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, në procedurat e prokurimit duhet të argumentojë teknikisht dhe ligjrisht çdo kriter të vendosur, duke përdorur vetëm ato kriterë të cilat janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “*Blerje vegla pune*” viti 2020, certifikata e sjellë nga OE nuk vërteton që mallrat e sjella janë ato të cilat janë të përcaktuara në pikën 2.3 a) Kapaciteti teknik. Konkretisht certifikata nga T. T. e cila autorizon distributorin A.-E. shpk nuk përcakton ose vërteton se cilat mallra janë të autorizuar nga prodhuesi. Nga distributori i autorizuar ka vetëm një certifikatë nga e cila vërtetohet se është distributori zyrtar për prodhimet e markës “T. T.”. Gjithashtu Autoriteti Kontraktor ka bërë kërkesa fikse siç janë ato në pikën 2.3 a) Kapaciteti teknik veprim në kundërshtim me Nenin 20 të ligjit “*Për prokurimin publik*”, ku kërkohet autorizim nga distributori dhe prodhuesi për mallra të caktuara dhe specifik pa asnjë argument (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 55-96 të Raportit të auditimit*).

4.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor gjatë hartimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, në procedurat e prokurimit duhet të argumentojë teknikisht dhe ligjrisht çdo kriter të vendosur, duke përdorur vetëm ato kriterë të cilat janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Në vijimësi

5.Gjetje nga auditimi: Nga ana e KNRA nuk është hartuar regjistri i riskut në lidhje me zhvillimin e aktivitetit të saj ekonomik financiar nga viti 2017 deri në vitin 2021. Sistemi i kontrollit të brendshëm i KNRA vlerësohet jo efektiv. U konstatua se KNRA nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik dhe nuk ka caktuar koordinatorin e riskut sipas ligjit Nr. 10 296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 96-99 të Raportit të auditimit*).

5.1 Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese të KNRA të analizohet situata dhe të merren masa për hartimin e një regjistri risku si dhe ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik, duke caktuar dhe një kordinator risku.

6. Gjetje nga auditimi: Ministria e Mbrojtjes nuk ka miratuar pagat e punonjësve të KNRA sipas niveleve të pagave të përcaktuar në VKM. Këshilli Drejtues i KNRA-së me vendim nr. 6, datë 01.02.2016, ka propozuar për miratim pagat e punonjësve në Ministri të Mbrojtjes në mbështetje të pikës 4, të ndryshuar, shkronja a, të pikës 1, nenit nr 6, të ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 “*Për kompetencat e përcaktimit të pagave dhe shpërblimeve*”. Me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 405 datë 02.03.2016 “*Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të ndërmarrjes shtetërore*” dhe në zbatim të VKM-së nr. 717, datë 23.06.2009, “*Për pagat e punonjësve*” është bërë i mundur miratimi dhe trajtimi i nivelit të pagave për punonjësit e KNRA. Për vitet 2017 dhe në vazhdim dhe pse me ndryshimin e VKM-së, pra hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 187, datë 08.03.2017, trajtimi financiar nuk ka ndryshuar por është vazhduar me trajtimin financiar sipas VKM-në nr. 717, datë 23.06.2009, pasi nuk ka pasur miratim nga Ministria e Mbrojtjes mbi ndryshimin e kategorisë së pagave. Këshilli drejtues, referuar VKM-së nr. 113, datë 01.03.2023 “*Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi*” si dhe VKM-së Nr. 325, datë 31.05.2023, me vendimin nr. 5, datë 26.06.2023, propozoi ndryshimin e nivelit të pagave për personelin e KNRA-së. Administrata e KNRA-së me shkresë nr. 350, datë 27.06.2023 “*Propozim për ndryshim të nivelit të pagave për KNRA*”, i është drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes. Ministria e Mbrojtjes në asnjë rast nuk i ka kthyer përgjigje KNRA për miratimin e nivelit të pagave sipas VKM-së në fuqi, pra dhe miratimin e nivelit të pagave sipas legjislacionit në fuqi. Administrata i është rridrejtuar përsëri Ministrit të Mbrojtjes për miratimin e nivelit të pagave të tyre. Aktualisht nuk ka asnjë përgjigje zyrtare për miratim ose mosmiratim të pagave të cilat janë propozuar nga Administrata e KNRA-së. Vlen të theksohet se që prej vitit 2015 nuk është aplikuar rritje page (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 32 – 38 të Raportit të auditimit*).

6.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Buxhetit të marrë në shqyrtim propozimin e KNRA-së për trajtimin financiar të punonjësve, sipas klasifikimit të nivelit të pagave në përputhje me VKM-në në fuqi, situata e cila cenon ndjeshëm aktivitetin e Institucionit si shkak i largimeve nga puna të punonjësve.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zërit detyrime ndaj të tretëve janë konstatuar vonesa në likuidimin e këtyre detyrimeve (subjekteve privatë), kontrata furnitorësh me afat pagesë të përcaktuar 30 ditë nga hartimi i faturës përfundimtare. Pra mbështetur në dokumentacionin justifikues si (urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit) likuidimi ndaj tyre është kryer me kohë vonesë, veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 48/2014, neni 7 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 38 -43, Raportit të auditimit*).

7.1 Rekomandimi: KNRA duhet të analizojë dhe të shlyejë në kohë detyrimet ndaj të tretëve sipas afateve të përcaktuara në kontratë duke shmangur penalitetet e mundshme ndaj Institucionit për mos shlyerjen e detyrimeve në kohë.

8. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale konstruksion shkalle”, të zhvilluar në vitin 2018 rezultoi se në pikën 2.3 kapaciteti teknik janë kërkuar shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit të realizuara gjatë 3(tre) viteve të fundit. Kriteri i hartuar është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 27, “*kontratat e mallrave*”,

pika 4 pasi nuk është përcaktuar pragu prej 40% që duhet të përmbushin OE ofertues. Veprimet e kryera i shkaktojnë paqartësi OE në lidhje me paraqitjen e kontratave të ngjashme pasi nuk ka një prag apo kufi në të cilën OE do duhet të ngarkojnë në SPE këto dokumente. Pra nisur nga fakti i veprimeve të kryera ky kriter i përcaktuar në mënyrë të paqartë lë hapësirë për pjesëmarrje dhe për OE të cilët mund të mos përmbushin kufirin e vlerës së kontratave të ngjashme të përcaktuar në LPP neni 27 i sipërcituar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 55-96 të Raportit të auditimit*).

8.1 Rekomandimi: AK, NJP në çdo rast në procedurat e prokurimit sipas natyrës dhe llojit të procedurës, kontratë malli/shërbimi/pune të përcaktojë drejtë dhe në përputhje me LPP dhe VKM vlerën e kontratës së përvijës së mëparshme mbi 40% që duhet të përmbushin OE.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje materiale konstruksion shkalle*”, të zhvilluar në vitin 2018 rezulton se në hartimin e kriterëve për kualifikim pjese e DST, NJP ka përcaktuar kriteret që duhet të përmbushin OE si kapacitetin ekonomik-financiar, kapaciteti teknik dhe specifikimet teknike. Në lidhje me kapacitetin teknik në hartimin e kriterëve, NJP është mjaftuar vetëm me kërkesën mbi kontratat e ngjashme që duhet të paraqesin OE ndërkohë që pjesë të DST nuk janë përcaktuar kërkesa apo kriterë teknike të tjera që duhet të përmbushin OE. Më konkretisht NJP, kërkesat teknike të mallit si: (*certifikata cilësie, certifikatë origjine, të përmbush standartin CE*) i ka kërkuar në specifikimet teknike të mallit, në dokumentacion shoqërues i cili do të paraqitet pas lidhjes së kontratës. Pra këto kërkesa apo kriterë të sipërcituara si dhe kërkesa të tjera të nevojshme për të vërtetuar kapacitetet që zotërojnë OE duhet të ishin përcaktuar si pjese e aspektit teknik apo kriterëve teknike që duhet të përmbushin OE në fazën e vlerësimit të ofertave. Dokumentacion provues në fazën e vlerësimit të ofertave i shërben AK për të vërtetuar që OE zotërojnë kapacitet, kualifikimet, certifikimet e nevojshme në mënyrë të tillë që të mos cenohen karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të kontratës, dhe duhet të ishin pjesë e DST. Veprimet e kryera janë në mospërputhje me Nenin 27, pika 3 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 55-96 të Raportit të auditimit*).

9.1 Rekomandimi: NJP, në procedurat e mallrave lidhje me kapacitetin teknik për të vërtetuar kapacitetet që zotërojnë OE duhet të vendosin kriterë në lidhje me kualifikimet, certifikimet kërkesat teknike të mallit si: (*katalogje të prodhuesit, certifikata cilësie, certifikatë origjine, të përmbush standardin CE*), këto kërkesa dhe kërkesa të tjera të nevojshme për të vërtetuar kapacitetet që zotërojnë OE në mënyrë që të mos cenohen kushtet, karakteristikat dhe kërkesat e kontratës. Dokumentacion provues në fazën e vlerësimit të ofertave i shërben AK për të vërtetuar që OE zotërojnë kapacitet, kualifikimet, certifikimet e nevojshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt “*Blerje boje dhe aksesore për lyerje*”, të zhvilluara në vitin 2022, 2023 kriteri i paraqitjes së mostrave ka ndikuar në shpalljen ofertës fituese me vlerën më të lartë pasi në 2(dy) procedurat e zhvilluara në vitin 2022, 2023, OE ofertues me vlerë më të ulët janë skualifikuar për mos paraqitje mostrash. Si konkluzion, NJP, në procedurat e mallrave në të cilat në vlerësimin e aspektit teknik gjykon që është e rëndësishme paraqitja e mostrave duhet ta mirë analizojë vendosjen e kriterit, pasi referuar procedurave të zhvilluara me të njëjtin objekt prokurimi viti 2022, 2023, përcaktimi i kriterit të

mostrave ka shkaktuar shpenzim të njësisë në vlerën 1,457,034 lekë pa TVSH pa ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet duke mos iu përmbajtur përcaktimeve të bëra në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40, neni 78, pika 2. Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin Publik”, nenin 5, nenin 8, nenin 12 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 55-96 të Raportit të auditimit).

10.1 Rekomandimi: Titullari i Njesisë Publike, NJP me qëllim eliminimin e efekteve financiare negative të analizojnë mirë hartimin e kritereve teknike pjesë të DT pasi hartimi i tyre mund të ndikoj në shpalljen fituese të ofertës më vlerën më të lartë.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës me objekt “Blerje karburant” për vitet 2016-2023, nga të dhënat e dokumentuara në lidhje me analizën e koston të kryer nga komisioni, në lidhje me normativat e konsumit të karburantit për mjetin (Autobus tip Benz 303, prodhimi i vitit 1985, me targa MM435MM në gjendje jo të mirë teknike, konsumi 38L/100km) rezulton se është shpenzuar sasia e karburantit prej 52972 litër në vlerën 8,755,212 lekë pa TVSH vetëm për mjetin e sipërcituar e cila përbën efekt financiar negativ për Institucionin. Nga KNRA, nuk është kryer një analizë kostoje apo nuk është gjetur një zgjidhje nëse shpenzimi për blerjen e një mjeti transporti ka kosto më të ulët se vlera e karburantit të shpenzuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 55-96 të Raportit të auditimit).

11.1 Rekomandimi: Titullari i Njesisë Publike, të marre në konsiderate sigurimin e një mjeti të ri transporti, për të reduktuar kostot e transportit për personelin në lidhje me shpenzimet për karburant .

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: KNRA nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që kanë në pronësi apo posedim, me kërkesat që duhet të përmbajë ky regjistër. Për periudhën objekt auditimi, u konstatua se institucioni nuk ka mbajtur regjistrin e aktiveve. Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vazhdimësinë e saj. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 43-55 të Raportit të auditimit).

12.1 Rekomandim: Strukturat drejtuese/ përgjegjësi i zyrës së financës të marrin të marrin masa për vlerësimin e gjendjes së aktiveve dhe të plotësojnë regjistrin e aktiveve që zotërojnë me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i zërave kontabël u konstatua që në magazinat e KNRA-së kishte dhe mallra stok. Gjendja e materialeve stok dhe me qarkullim të ngadalshëm në magazinë është në një vlere prej 44,244,183 lekë gjendje në datën 31.12.2023. Nga shoqëria së fundmi nuk janë marrë masa për eliminimin e stokut. Artikujt e ngelur stok si dhe ato me qarkullim të ngadalshëm kanë tendencën që të dëmtohen dhe të bëhen të papërdorshëm, duke sjellë ulje të aktiveve të shoqërisë. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 1 dhe 2, të ligjit

nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 43-55 të Raportit të auditimit)

13.1 Rekomandim: Strukturat përgjegjëse në KNRA të marrin masa për eliminimin e stokut të krijuar duke bërë një analizë të mallrave stok, vlerësimin e materialeve që gjejnë përdorim në aktivitetin e shoqërisë dhe nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e mallrave të tjerë.

Deri më 31.03.2025

13.2 Rekomandim: Nga KNRA dhe strukturat e tjera përgjegjëse, të llogaritet me kujdes nevoja për blerje, duke evidentuar më parë gjendjen ekzistuese në magazinë dhe nevojat reale mbi këtë gjendje. Kërkesat për mall të shoqërohen me argumentim dhe relacion përkatës.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se njeri prej asetëve më të rëndësishme të kësaj ndërmarrje Shkalla “Kosjakova” së bashku me linjën e shinave nënujore është realizuar në vitin 1969 dhe amortizimi i kësaj shkalle në 31.12.2023 është në shumën 91,421,173 dhe vlera e mbetur është në shumën 41,391,341 lekë ose 31%, pra tejet e amortizuar.

Vlera fillestare e përcaktuar nga ekspertët vlerësues në vitin 2015 është në shumën 120,378,876 lekë. Veprimtaria e punës së KNRA-së mbi arkëtimin e të ardhurave është e lidhur në mënyrë direkte nga gjendja teknike dhe kapacitetet përpunuese të platformës së nxjerrjes së mjeteve lundruese dhe linjës së shinave (Shkallës Kosjakova). Viti i prodhimit të kësaj platforme, gjendja teknike dhe amortizimi ndër vite, bën që veprimtaria e punës së KNRA-së të jetë e kushtëzuar dhe me risk për ngjarje të jashtëzakonshme. Kantieri nuk ka kapacitetet teknike dhe njerëzore për ta bërë e vetme këtë proces delikat. Dalja jashtë pune e shkallës përveç se rrezikon jetën dhe pronën nxjerr nga gatishmëria operationale të gjithë mjetet lundruese të FA. Ministria e Mbrojtjes me veprimet dhe mosveprimet e saj është në kundërshtim me parimet e përgjithshme të Kodit të Procedurës Administrative, konkretisht këto veprime bien në kundërshtim me nenin 14 “Parimi i objektivitetit”, nenin 15, “Parimin e përgjegjësisë”, neni 16 “Parimi i marrjes së vendimeve” dhe neni 18, “Parimi i deburokratizimit dhe i efijencës” të Kodit të Procedurës Administrative. Këto veprime sipas auditimit vazhdojnë sjellin pasoja sociale dhe ekonomike për KNRA (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqe 111-125 të Raportit të auditimit).

14.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes/Strukturat drejtuese dhe KNRA, të marrin të gjitha masat e nevojshme për kryerjen e një inspektimi, kontrolli dhe plani për përmirësimin e gjendjes së shkallës në pjesën e nënujshme dhe të mbiujshme, të linjave të shinave dhe karelit lëvizës.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua që Komanda e Forcës Detare, referuar detyrimeve që rrjedhin nga urdhri i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, “Për planin e dokimit dhe riparimit të teknikës detare”, dhe shkresave të Sekretarit të Përgjithshëm për buxhetin e detajuar të miratuar, nuk ka futur për riparim/dokim në KNRA të gjitha mjetet lundruese të planifikuara dhe miratuara sipas grafikut (bashkëlidhur kontratave të çdo viti), kriter i VKM nr. 397, datë 11.05.2015 “Për krijimin e ndërmarrjes shtetërore, “Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve”, pika 6.

Për sa më sipër, rezulton se nga viti 2016 deri në vitin 2023, nuk kanë dalë në shkallë për dokim/riparim 49 mjete lundruese, të cilat kanë qenë pjesë e anekseve të kontratës dhe grafikut të miratuar nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Mosdalja për riparim e 49 mjeteve lundruese, ka ndikuar negativisht në arkëtimin e të ardhurave dhe në gjendjen financiare të ndërmarrjes në një vlerë prej 87,193,861 leke pa TVSH.

Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga riparimi i mjeteve lundruese të KFD, për vitet objekt auditimi paraqitet me një realizim i cili shkon nga 73% deri në masën 38% (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 13-32 të Raportit të auditimit*).

15.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese pranë Ministrisë së Mbrojtjes, të evidentojnë përgjegjësitë dhe të marrin vendimet përkatëse për përmirësimin e situatës, për arsye se kjo ka sjellë të ardhura të munguara për KNRA në vlerën 87,93,861 lekë.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet që amortizimi i llogaritur për ndërtesat dhe makineritë i pasqyruar në bilanc ka sjellë një rezultat financiar negativ për KNRA për të gjitha vitet e periudhës së operimit që nga krijimi i shoqërisë.

Amortizimi i akumuluar prej vitit 2015 deri në vitin 2023, është në shumën 574,988,878 lekë. Amortizimi si shpenzim ka ndikuar në humbjen e veprimtarisë së KNRA. Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve, Pashaliman, ka në administrim 148,860 m² 2 tokë të vlerësuar në vlerën 823,195,800 lekë, ndërtime dhe instalime në vlerën 637,773,954 lekë.

Ndërtesa jashtë funksionit (që nuk përdoren për veprimtarinë e ndërmarrjes) janë 13 të tilla. Nga këto katër godina janë në pronësi të KNRA, ndërsa pjesa tjetër shfrytëzohen nga efektivet e garnizonit turk, që shfrytëzon godinat sipas një marrëveshje me Komandën e Forcës Detare që para krijimit të KNRA, marrëveshje për të cilën nuk KNRA nuk ka dijeni. Kjo në mospërputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit SKK 5 "*Trajtimet kontabël për aktivet afatgjata materiale*" (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 13-32 të Raportit të auditimit*).

16.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse dhe drejtuese në bashkëpunim me ekspertin kontabël duhet të rivlerësojnë asetet e ndërmarrjes (makineri + ndërtesa) të cilat janë jashtë funksionit dhe jo të dobishme, duke përcaktuar saktë vlerën e mbetur të tyre me qëllim ndërprerjen e përlogaritjes së shpenzimeve të amortizimit për këtë kategori.

Deri më 31.03.2025

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se nga ana e Komandës së Forcës Detare nuk është realizuar plani i dokimit i miratuar nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, nuk janë paraqitur për riparim dokim mjetet lundruese sipas planit të miratuar. Mos realizimi i detyrave të lëna në Plan-Vepimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes ndaj KFD, ka ndikuar ndjeshëm në mungesën e të ardhurave të ndërmarrjes, ku ndër të tjera është lënë si detyrë që të merren masa për lirimin e bankinës dhe të vaskës brenda datës 15.09.2015. Kjo hapësirë është kërkuar nga subjekte të ndryshme për të ankoruar mjetet e tyre të lundrimit, pasi kushtet që ofrohen aty, janë më të mira se operatori privat që operon në Orikum. Edhe sot mjetet lundruese të Forcës Detare vazhdojnë të qëndrojnë të ankoruara në bankinë dhe në akuariumin e Kantierit. Përveç anijeve në gatishmëri edhe mjetet lundruese të dala jashtë përdorimit qëndrojnë aty duke u bërë pengesë në veprimtarinë e përditshme. Bazuar në kapacitetin e vaskës, numri i mjeteve lundruese që mund të akomodoheshin në këtë hapësirë është rreth 50 të tilla, me një gjatësi

mesatare 14 ml, dhe referuar çmimit për ankorimin e një mjeti lundrues në vit, ndërmarrja ka të ardhura të munguara në vlerën 298,935€(1.17 € për ml x 14 ml x 365 ditë x50(skafe) = 298,935-€)

-Nga auditimi i zbatimit të afateve të miratimit të tarifave, sipas VKM-së, rezulton se **afati i përcaktuar për miratim, është tejkaluar** nga Komisioni dhe Titullari i Ministrisë së Mbrojtjes, mbi afatin e përcaktuar në Urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 03, datë 06.01.2016, dhe që shkojnë nga 46 – 135 ditë, (1.5 muaj deri 3.5 muaj), duke sjellë:

- ndërprerjen e vonesa në veprimtarinë e punës për riparimin e mjeteve lundruese të FA, në pritje të ardhjes së tarifave të miratuara nga Komisioni i Ministrisë së Mbrojtjes dhe lidhjes së kontratës së riparimit,

- mos riparimin e gjithë mjeteve lundruese brenda vitit kalendarik, pasi tarifatat kanë afat kohor vlefshmërie një brenda vitit kalendarik, duke mos realizuar në këtë mënyrë të ardhurat.

Nga auditimi rezulton që mungesa e investimeve në kantier dhe mungesa e të ardhurave, ka çuar ndërmarrjen në kolaps financiar, në pamundësi për të bërë investime të reja apo për të kryer shpenzime për të mbajtur në gatishmëri teknike asetet e saj. Këtu vlen të përmendet shkalla, linjat e shinave dhe kareli lëvizës. Në gjendjen teknike që janë paraqesin një rrezik potencial për jetën, shëndetin e punonjësve dhe të efektivave të anijeve, por edhe për pasurinë shtetërore dhe atë të palëve të treta. Ministria e Mbrojtjes me veprimet dhe mosveprimet e saj është në kundërshtim me parimet e përgjithshme të Kodit të Procedurës Administrative, konkretisht këto veprime bien në kundërshtim me nenin 14 “Parimi i objektivitetit”, nenin 15, “Parimin e përgjegjësisë”, neni 16 “Parimi i marrjes së vendimeve” dhe neni 18, “Parimi i deburokratizimit dhe i efikasitetit” të Kodit të Procedurës Administrative. Këto veprime vazhdojnë sjellin pasoja sociale dhe ekonomike për KNRA.

17.1 Rekomandimi: Kalimin e ndërmarrjes Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve në institucion buxhetor si njësi shpenzuese në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe jo të Forcave të Armatosura. FA kanë si pjesë të fushës së veprimtarisë objekt të ligjshëm mbajtjen në gatishmëri vetëm të mjeteve lundruese të saj, kurse KNRA ka riparimin e mjeteve lundruese të FA dhe punimet me të tretë. Kalimi në varësi të institucionit qëndror do të balanconte më mirë interesat e ligjshme të dy institucioneve të varësisë dhe do të mund të shërbente për të bërë investimet e domosdoshme për vijueshmërinë normale të punës.

Menjëherë

B. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratës me nr. 138 prot, datë 03.04.2018 të lidhur ndërmjet OE “S.” shpk me dhe AK, KNRA Orikum me objekt “Blerje materiale konstrukcion shkalle” rezultoi se Kontraktori, në lidhje me cilësinë e mallrave të dorëzuar rezultoi se nuk ka respektuar kushtet e kontratës pasi bashkëlidhur dokumentacionit të bankës mungonte dokumentacioni shoqërues sipas përcaktimeve të bëra në kontratë. Veprimet e kryer janë në kundërshtim me nenin 2, pika 2.1 “Qëllimi i furnizimit dhe përshtatshmëria e mallrave me specifikimet”, neni 3 “Përshtatshmëria e mallrave me standardet teknike”, neni 9, “Garancitë” termat e përcaktuar në dispozitat e kontratave mbi “Kushtet e dorëzimit” të mallit, duke administruar në kohën e marrjes në dorëzim të mallrave edhe dokumentacionin shoqërues të

përcaktuar në kontratën e nënshkruar si: Certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat”, që shërbejnë AK për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë apo garancinë që mallrat duhet të kenë, në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor”. *Si rrjedhojë nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e mallrave. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test-raportit të fabrikës (raportet e testeve), që të konfirmohet që këto mallra janë të njëjta me ato të prokurara (specifikimeve teknike), dhe për të cilën OE “S.” shpk ka fituar tenderin dhe është likuiduar. Veprimet e kryera kanë shkaktuar shpenzim të njësisë në vlerën 5,749,800 lekë pa TVSH pa ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet pasi mallrat e marr në dorëzim nuk japin garanci mbi cilësinë e ofruar duke mos iu përmbajtur përcaktimeve të bëra në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40, neni 78, pika 2. Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin Publik”, nenin 5, nenin 8, nenin 12 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 55-96 të Raportit të auditimit).*

1.1 Rekomandimi: KNRA/ Strukturat drejtuar komisionit të marrjes në dorëzim të me qëllim eliminimin e efekteve financiare negative, të analizojnë mirë zbatimin e detyrimeve kontraktuale për të gjithë kontratat e lidhura nga ku pjesë e praktikës së bankës duhet të jetë bashkëngjitur dokumentacionin justifikues sipas përcaktimeve të bëra në specifikimet teknike të kontratës si certifikata origjinës së mallit, raportet-testet e fabrikës, certifikatat e cilësisë, si dhe certifikatat e garancisë së mallit.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: 1. KNRA pas krijimit është përballur me një mori procedurash për ekzekutim vullnetar të vendimeve gjyqësore të cilat e kanë detyruar Kantierin të paguaj ndaj ish-punonjësve shuma të konsiderueshme dhe me efekt financiar negativ të konsiderueshëm ndaj Institucionit. Krijimi i detyrimeve, ka ardhur si shkak i ndërprerjes së marrëdhënieve të punës për punonjësit e KNRA në kohën që KNRA ka qenë në varësi të plotë nga Komanda e Forcës Detare pasi u shkurtua i numri i punonjësve si shkak i largimit të Kompanisë Hollandeze “D. Sh.”, largimi i të cilës ndikoi në uljen e aktivitetit të Institucionit. Ndërmarrja refuzoi dhënien e pagës për shpërblim për vjetërsi në punë dhe dietën ushqimore të munguar pasi e konsideroi si detyrim që nuk i përket Ndërmarrjes dhe si shkak i likuiditete të pakta që trashëgoi. Refuzimi i dhënies së pagës ka bërë që punonjësit ti drejtohen Gjykatës nga ku si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës në një rast për një ish-punonjës është shoqëruar me nxjerrjen e urdhrit për vënien e sekuestros konservative nga një zyrë përmbarimore mbi llogaritë e ndërmarrjes. Pra mos kryerja e veprimeve nga MM ka detyruar KNRA të shlyej detyrimet e krijuara përpara krijimit të Institucionit detyrime të cilat nuk i përkasin kësaj të fundit. Shuma apo vlera që Kantieri ka shlyer ndaj të gjithë ish-punonjësve është **19,839,570 lekë. Kjo vlere përben efekt financiar negativ për buxhetin e KNRA.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 33 - 38 të Raportit të auditimit).

2. Ndërpërja e padrejtë e marrëdhënieve të punës për 23 ish-punonjës të KNRA pa respektuar asnjë procedurë, e diktuar dhe nga vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit nr. 1062 datë 18.06.2024, ka ndikuar në krijimin e detyrimeve me efekt financiar negativ në vlerën 11.558.727 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 32 - 38 të Raportit të auditimit).

2.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes në të gjitha vendimmarrjet e tyre të kryejë një analizë të plotë të veprimtarisë dhe të situatës financiare të institucioneve të vartësisë në përputhje me rolin dhe përgjegjësit që ato kanë.

C. TË ARDHURA TË MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet që amortizimi i llogaritur për ndërtesat dhe makineritë i pasqyruar në bilanc ka sjellë një rezultat financiar negativ për KNRA për të gjitha vitet e periudhës së operimit që nga krijimi i shoqërisë.

Amortizimi i akumuluar prej vitit 2015 deri në vitin 2023, është në shumën 574,988,878 lekë. Amortizimi si shpenzim ka ndikuar në humbjen e veprimtarisë së KNRA. Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve, Pashaliman, ka në administrim 148,860 m² 2 tokë të vlerësuar në vlerën 823,195,800 lekë, ndërtime dhe instalime në vlerën 637,773,954 lekë.

Ndërtesa jashtë funksionit (që nuk përdoren për veprimtarinë e ndërmarrjes) janë 13 të tilla. Nga këto katër godina janë në pronësi të KNRA, ndërsa pjesa tjetër shfrytëzohen nga efektivet e garnizonit turk, që shfrytëzon godinat sipas një marrëveshje me Komandën e Forcës Detare që para krijimit të KNRA, marrëveshje për të cilën nuk KNRA nuk ka dijeni. Kjo në mospërputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit SKK 5 “*Trajtimet kontabël për aktivet afatgjata materiale*” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 13-32 të Raportit të auditimit).

1.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse dhe drejtuese në bashkëpunim me ekspertin kontabël duhet të rivlerësojnë asetet e ndërmarrjes (makineri + ndërtesa) të cilat janë jashtë funksionit dhe jo të dobishme, duke përcaktuar saktë vlerën e mbetur të tyre me qëllim ndërprerjen e përlllogaritjes së shpenzimeve të amortizimit për këtë kategori.

Deri më 31.03.2025

D. MASA DISIPLINORE:

D.1 Kontrolli i Lartë i Shtetit, mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*, mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 7961, date 12.7.1995 “*Kodi i Punës*”, i ndryshuar, kontratës individuale të punës, Urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 1250, date 28.07.2015 “*Për miratimin e statutit të ndërmarrjes shtetërore*”, i rekomandojmë Ministrit të Mbrojtjes (MM) të vlerësojë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për periudhën nga krijimi i shoqërisë deri me 31.12.2023, si dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore “**Zgjidhje e Menjëhershme e Marrëdhënive të Punës**”, për:

1.Z. A. G., me detyrë drejtor i ndërmarrjes së KNRA-së;

-Për mos maksimalizim, efikasitet dhe efikasitet në përdorimin e fondeve publike, në referencë të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006, neni 12 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 162/2020, “*Për prokurimin publik*” neni 21, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe Neni 8 “*Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit*”, pika 1.

-Për moszbatimin e ligjit Nr. 9874, datë 14.02.2008 “*Për ankandin publik*”.

Drejtori i KNRA nuk ka nxjerrë nga përdorimi sasinë e plotë të kontenierëve, konkretisht vetëm 2 kontenierë nga 43 janë nxjerrë nga përdorimi, përpara shitjes në ankand. Këto veprime bien në kundërshtim me Nenin 4 pika c të Ligjit Nr. 9874, datë 14.02.2008 “*Për ankandin publik*”. Ky ligj gjen zbatueshmëri vetëm për materialet e nxjerra jashtë përdorimit. Nuk ka një vendim të Këshillit Drejtues për shitjen e këtyre materialeve, veprim i cili bie në kundërshtim me Nenin 23 pika 6 e ligjit “*Për Ndërmarrjet Shtetërore*”.

-dhe problematika të tjera të trajtuara hollësisht në raportin përfundimtar të auditimit. (Trajtuar në pikën 2.6, faqe 55-96 të Raportit të auditimit).

D.2 Kontrolli i Lartë i Shtetit, mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, mbështetur në nenet 58, 59 të Ligjit Nr.152, date 30.05.2013 “Per nëpunësin civil”, i ndryshuar, kontratës individuale të punës, Urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 1250, date 28.07.2015 “Për miratimin e statutit të të ndërmarrjes shtetërore”, Urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 03, datë 06.01.2016, “Për ngritjen dhe funksionimin e komisionit të miratimit të tarifave të shërbimeve për mjetet lundruese dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura”, i rekomandojmë Ministrit të Mbrojtjes (MM) të vlerësojë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për periudhën nga krijimi i shoqërisë deri me 31.12.2023, si dhe të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje” deri në “Mbajtja deri 1/3 pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” për 15 (pesëmbëdhjetë) punonjësit, si më poshtë:

1. **Z. N. L.** në cilësinë e anëtarit të komisionit të miratimit të tarifave në MM;
2. **Z. E. A.** në cilësinë e anëtarit të komisionit të miratimit të tarifave në MM;
3. **Z. L. Ç.** në cilësinë e anëtarit të komisionit të miratimit të tarifave në MM;
4. **Z. O. Sh.** në cilësinë e anëtarit të komisionit të miratimit të tarifave në MM;
5. **Znj. E. M.** në cilësinë e anëtarit të komisionit të miratimit të tarifave në MM;
6. **Znj. E. D.** në cilësinë e anëtarit të komisionit të miratimit të tarifave në MM;
7. **Z. S. Xh.** në cilësinë e anëtarit të komisionit të miratimit të tarifave në MM;
8. **Z. A. S.** në cilësinë e anëtarit të komisionit të miratimit të tarifave në MM;
9. **Z. A. K.** në cilësinë e anëtarit të komisionit të miratimit të tarifave në MM;
10. **Z. A. B.** në cilësinë e anëtarit të komisionit të miratimit të tarifave në MM;
11. **Z. D. I.** në cilësinë e anëtarit të komisionit të miratimit të tarifave në MM;
12. **Z. F. R.** në cilësinë e anëtarit të komisionit të miratimit të tarifave në MM;
13. **Z. P. S.** në cilësinë e anëtarit të komisionit të miratimit të tarifave në MM;
14. **Znj. E. T.** në cilësinë e anëtarit të komisionit të miratimit të tarifave në MM;
15. **Z. A. H.** në cilësinë e anëtarit të komisionit të miratimit të tarifave në MM;

për mos miratimin në kohe të tarifave të shërbimit të mjeteve lundruese dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura, në tejkallim të afateve të percaktuara në urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes.

D.3. Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 7961, date 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, kontratës individuale të punës neni 19, pika 3, kontratave individuale të punës, neni 13, i kërkojmë Titullarit të KNRA të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, për 5 (pesë) punonjësit:

1. **Z. I.V** në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të specifikimeve teknike dhe;
2. **Z. K. K.** në cilësinë e anëtarit të njësië së prokurimit dhe komisionit të hartimit të specifikimeve teknike per proceduren e prokurimit “Blerje boje dhe aksesore për lysterje” të vitit 2019, për mos zbatim të Ligjit “Për prokurimin publik”, Neni 23 për specifikimet teknike. Për hartimin e specifikimeve teknike nuk është lënë hapësirë por janë vendosur specifikime teknike të percaktuara me vlera fikse dhe të paargumentuara, që kufizojne konkurrencën. (Trajtuar në pikën 2.6, faqe 55-96 të Raportit të auditimit).
3. **Z. A.K** në cilësinë e anëtarit të Njësisë së prokurimit për procedurën “Blerje materiale konstruktion shkalle”, viti 2018, për arsye se:

- OE të ftuar nëpërmjet sistemit elektronik janë të ndryshëm nga OE të ftuar sipas procesverbalit bashkangjitur, pra nuk përcaktohen qartë se cilët OE janë përzgjedhur në ftesën për pjesëmarrje sipas përcaktimeve të bëra në LPP.

- Hartimin e gabuar të kriterëve të veçanta, kapaciteti teknik, në shërbimet e ngjashme nuk është përcaktuar kufi apo prag në përputhje me LPP pasi nga është në kriterin e hartuar NJP ka kërkuar vetëm shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit gjatë 3 viteve të fundit, pra pa përcaktuar kufi.

- Në hartimin e kriterëve teknike, pjesë të DST nuk janë hartuar kriterë të cilat vërtetojnë kapacitetet teknike që zotërojnë dhe duhet të përmbushin OE në fazën e vlerësimit të ofertave nga KVO të cilat i shërbejnë AK për të vërtetuar kapacitetet, kualifikime e nevojshme të tilla si certifikata cilësie, certifikatë origjine malli, standardi CE i mallit si dhe dokumentacion tjetër të nevojshëm (*Trajtuar në pikën 2.6, faqe 55-96 të Raportit të auditimit*).

4. Z. F.G në cilësinë e anëtarit të komisionit të pritjes së mallit në magazinë dhe;

5. Z. S.B në cilësinë e anëtarit të komisionit të pritjes së mallit në magazine për procedurën “Blerje material konstruksion shkalle”, viti 2018, për arsye se:

- Për mos respektimin e kushteve të kontratës, marrja në dorëzim e mallrave pa dokumentacion shoqërues të përcaktuar në kontratë si certifikata e origjinës së mallit, raportet testet, certifikata cilësisë, certifikata e garancisë së mallrave (*Trajtuar në pikën 2.6, faqe 55-96 të Raportit të auditimit*).

D.4. “PËR PUNONJËSIT E LARGUAR”

Për ish-punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte:

“Vërejtje” për:

1. Z. E. S. në cilësinë e anëtarit të komisionit të pritjes së mallit në magazine për procedurën “Blerje material konstruksion shkalle”, viti 2018.

2. Z. A.T në cilësinë e anëtarit të komisionit të pritjes së mallit në magazine për procedurën “Blerje material konstruksion shkalle”, viti 2018.

3. Z. A.SH në cilësinë e anëtarit të njësië së prokurimit dhe komisionit të hartimit të specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit “Blerje boje dhe aksesore për lyerje” të vitit 2019

III. ANEKSE

Nr	Emertimi i Anijes	Te faturuara pa TVSH, vitet:								Vlera mesatare e anijeve që nuk kane dal per dokim	Vlera anijeve pa dal në shkalle
		2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023		
1	Arch - Angel P-02	447,605	1,616,142	2,038,510	638,754		1,155,668	1,466,297.8	1,009,181	1,196,023	1,196,023
2	Arch - Angel P-05	534,943	1,662,514		1,425,249		1,070,644	1,449,096.4	983,500	1,187,658	2,375,315
3	Arch - Angel P-04	608,842	1,629,700		573,767	1,318,119		1,153,607		793,183	2,379,550
4	Arch -Angel P-03	314,628	741,745		606,006		1,995,662	1,988,150.2		1,129,238	3,387,715
5	Arch -Angel P-01	218,578	671,352		648,870		1,427,537			741,584	2,966,337
6	Pantoni I Qitjes				689,840		342,550	502,604.8	214,211	437,301	1,749,206
7	Anija Amerikane P-118	1,310,685		4,143,483	1,308,660	1,723,478	2,119,875	2,090,797.7	4,643,856	2,231,051	2,231,051
8	Anija Amerikane P-117	1,069,884	3,125,750		3,328,760	2,545,685	2,170,126	2,538,078		2,038,766	4,077,533
9	Anija Oriku	9,521,650		12,587,929	7,742,547	7,695,677	9,159,896	8,028,376.8	7,940,264	7,854,380	7,854,380
10	Anija Antindotje Y-32	936,992			2,635,298		2,027,375	2,209,270.6	1,543,241	1,870,435	5,611,306
11	Anija Antindotje Y-31	900,855	3,347,827		2,403,050		3,437,940	2,580,052	2,015,142	2,447,478	4,894,955
12	Anija e Hidrografisë A-81	1,387,656	2,143,669		1,932,170		1,429,919	1,338,669	1,761,722	1,665,634	3,331,268
13	Anija Iliria P-131	5,450,163	8,775,738		8,781,969	5,867,020	6,208,644		7,846,249	6,177,127	12,354,254
14	Skafi I Hidrografisë Ms 1171	675,992	1,026,173		1,061,722				711,656	868,886	3,475,543
15	Anija Amerikane P-116	1,113,913	3,837,446	2,763,864	3,680,422		2,333,318	2,375,687.5		2,684,108	5,368,217
16	Anija Butrinti	3,476,375	9,651,152	7,501,771	10,639,366	6,752,925		7,445,718	6,955,055	6,524,205	6,524,205
17	Anija Lissus P-133	6,494,970	811,646	10,132,217	10,481,811	7,338,589	6,182,897	7,180,633	7,537,150	0	0
18	Anija Shqiponja A-82		402,664	592,771	658,399		806,040			614,969	2,459,874
19	Anija Amerikane P-110	561,742	2,836,240		2,860,298	2,017,289	1,400,969		1,879,797	1,589,841	3,179,682
20	Anija Amerikane P-112	1,824,001		4,367,241		1,811,528	1,488,161	1,002,826		1,736,446	5,209,337
21	Skafi i Polumbareve		2,681,136				618,350	641,380		1,313,622	6,568,110
SHUMA PA TVSH		36,849,474	44,960,894	44,127,786	62,096,958	37,070,310	45,375,570	43,991,244.6	45,041,024		87,193,861

Pasqyrat financiare për periudhën 01. 01- 31. 12. 2017, 2018, 2019, 2020.

	AKTIVET	01/01/2017-31/12/2017	01/01/2018-31/12/2018	01/01/2019-31/12/2019	01/01/2020-31/12/2020
I	AKTIVET AFATSHKURTRA	399,912	385,176		
	Aktivët monetarë	9824	30,408	22,960	13,290
	Banka	9,824	30,408		13,290
	Arka	9,824			
	2. Derivative dhe aktive të mbajtura për tregtim				
	3. Aktive të tjera financiare afatshkurtra	22,923	9,886		

	Klientë për mallra, produkte e shërbime/ të drejta të arketueshme nga 2019	22,424	9047	16,802	25
II	Debitorë, Kredi tor e të tjerë				
	Tatim mbi fitimin				
	TVSH				
	Te drejta e detyrime ndaj ortakeve				
I	Te tjera kërkesa	498	839	617	980
	te ardhura për tu marrë				
	4. Inventari	367,165	344 880	295,382	338,092
	Lendet e para	312,623	296537		
	Inventari imët	47,071	46170		
	Prodhim në proces	1,333		45,279	
	Produkte të gatshme/Mallra	6,136	2173	1. 497	1496
	TOTALI I AKTIVEVE AFATSHKURTRA			382,540	353,885
II	AKTIVET AFATGJATA	1,894,451	1,860,834		
	1. Investimet financiare afatgjata				
	2. Aktive afatgjata materiale	1,894,451	1,860,834		
	Toka dhe ndërtesa	823,195	823,195	823,195	1,567,063
	Impiante dhe makineri	771,328	762,175	753,021	199,569
	Te tjera instalime dhe pajisje	296,435	272,282	239,509	3297
	Aktive të tjera afatgjata materiale	3,491	3,181		
	Totali i aktiveve afatgjata			1,815,727	1,770,020
	TOTALI I AKTIVEVE (I+II)	2,294,364	2,246,010	2,198,267	2,123,906
	PASIVET AFATSHKURTRA	7,276	7,388		
	Huat dhe parapagimet	7,276	7,388		
	Te pagueshme ndaj fumitoreve	1,278	1,858	971	1,034
	Te pagueshme ndaj punonjësve				
	Detyrime për Sigurime Shoq. Shend.	756	318	808	808
	Detyrime tatimore për TAP - in	182	195	197	201
	Detyrime tatimore për Tatim Burim	9	5,016	2,948	
	Debitorë dhe Kreditorë të tjerë	5,049	7,388		185
	Totali i detyrimeve afatshkurtra			4,924	2,230
	PASIVET AFATGJATA			0	
	TOTALI I PASIVEVE (I+II)	7,276	73,881	4,924	2,230
	KAPITALI	2,287,087	2,238,621	2,544,266	2,544,266
	Kapitali aksionar	2,544,266	2,544,266		
	Fitimi(humbja) e pa shpërndare	(204,802)	(257,179)	(305,644)	-350,293
	Fitimi (Humbja) e vitit financiar	(52,376)	(48,465)	-45,278	-71,667
	TOTALI I KAPITALEVE të VETA (ill)		2,238,621	2,193,343	2,121,675
	TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT (I + ill)	2,246,010	2,246,010	2,198,267	2,123,906

Burimi i të dhënave :KNRA

Pasqyrat financiare për periudhën 01. 01- 31. 12. 2021, 2022, 2023.

	AKTIVET	01/01/2021-31/12/2021	01/01/2022-31/12/2022	01/01/2023-31/12/2023
I	AKTIVET AFATSHKURTRA	342,470	344,234	344,266
	Aktivet monetare	13,145	5,131	282
	Banka	13,145	5,131	282
	Arka			
	2. Derivative dhe aktive të mbajtura për tregtim			
	3. Aktive të tjera financiare afatshkurtra	196	14,508	21,434

	Klientë për mallra, produkte e shërbime/ të drejta të arketueshme nga 2019	26	13,741	21,326
II	Debitorë, Kreditore të tjerë			
	Tatim mbi fitimin			
	TVSH			
	Të drejta e detyrime ndaj ortakeve			
I	Të tjera kërkesa	170	766	107
	Të ardhura për tu marre			
	4. Inventari	329,128	324,594	322,549
	Lendet e para	284,584	282,746	282,202
	Inventari imët	43,047	40,361	38,873
	Prodhim në proces			
	Produkte të gatshme/Mallra	1,496	1,486	1,473
	TOTALI I AKTIVEVE AFATSHKURTRA			
II	AKTIVET AFATGJATA	1,722,163	1,676,806	1,633,778
	1. Investimet financiare afatgjata			
	2. Aktive afatgjata materiale	1,722,163	1,676,806	1,633,778
	Toka dhe ndërtesa	823,195	823,195	823,195
	Impiante dhe makineri	706,694	671,341	637,773
	Te tjera instalime dhe pajisje	189,676	180,192	171,183
	Aktive të tjera afatgjata materiale	2,616	2,077	1,625
	Totali i aktiveve afatgjata			
	TOTALI I AKTIVEVE (I+II)	2,064,634	2,021,041	1,978,045
	PASIVET AFATSHKURTRA	2,069	4,717	8,767
	Huat dhe parapagimet	2,069	4,717	
	Te pagueshme ndaj fumitoreve	1,151	1,253	4,676
	Te pagueshme ndaj punonjësve			2,092
	Detyrime për Sigurime Shoq. Shend.	720	674	574
	Detyrime tatimore për TAP - in	179	165	334
	Detyrime tatimore për Tatim Burim	17		
	Debitorë dhe Kreditore të tjerë		2,624	1,089
	Totali i detyrimeve afatshkurtra			
	PASIVET AFATGJATA			0
	TOTALI I PASIVEVE (I+II)	2,069	4,717	8,767
	KAPITALI	2,062,564	2. 016. 323	1. 969. 277
	Kapitali aksionar	2. 544. 266	2. 544. 266	2. 544. 266
	Fitimi(humbja) e pa shpërndare	(422. 591)	(481. 702)	(527. 943)
	Fitimi (Humbja) e vitit financiar	(59. 110)	(46. 240)	(47. 045)
	TOTALI I KAPITALEVE të VETA			
	TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT (I + II)	2. 064. 634	2. 021. 041	1. 978. 045

Burimi i të dhënave :KNRA [BV](#)

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT